



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 483

Këshilli i përhershëm komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i komunës së gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota

**FJALËSI I EMRAVE TË PERSONALITETEVE DHE NGJARJEVE
NGA TERRITORI I KOMUNËS SË GJILANIT DHE TËRËSIA
ETNIKE SHQIPTARE, POR EDHE NGA BOTA**

Nëntor 2016

PËRMBAJTJA

Përmbajtja	2
Hyrje	10
Lista emërore e personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i komunës së Gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota.....	12
Koha e lashtë dhe mesjeta (nga lashtësia deri më 1455)	19
Personalitete.....	19
Antika	19
Longari	19
Busti i gruas dardane	19
Mesjeta.....	20
Justiniani i Madh	20
Ngjarje	21
Dardanët, harta e mbretërisë.....	21
Periudha Osmane (XV - 1912)	21
Personalitete.....	21
Idriz Seferi (1847-1927).....	21
Dom Mikel Tarabulluzi (1868-1933).....	22
Qamil Bala (1878-1933).....	23
Sinan Maxherja – hoxhë (1863-1910).....	24
Murat Bilalli (?-1912)	24
Islam Pira.....	25
Ramë Abdyli	25
Salih aga i Gjilanit.....	26
Baftije Seferi (1864-1969)	27
Ibrahim Popoci	27

Xhelal Beu.....	28
Haxhi Salihi – Pogragja.....	28
Ngjarje	30
Shpërnguljet e shqiptare gjatë gjithë historisë.....	30
Çlirimi i Gjilanit (më 1843, 21 janar 1881, 26 korrik 1912, 1915, 1945, 1999).....	32
Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878 – 1881).....	33
Klubi kombëtar i Gjilanit (1908).....	36
Kongresi kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909) dhe Shkolla normale e Elbasanit (1 dhjetor 1909)	38
Beteja e Kaçanikut (30 prill 1910)	38
Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore (1912 – 1918)	38
Personalitete.....	38
Leo Freundlich (1875 - 1953)	38
Ngjarje	39
Pushtimi serb i vitit 1912 dhe ai bullgar i vitit 1915.....	39
Periudha ndërmjet dy luftërave botërore (1919 – 1939).....	40
Personalitete.....	40
Lotë Vaku.....	40
Ngjarje	41
Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1918-1924).....	41
Lëvizja e armatosur kaçake në Gjilan (1918-1928)	42
Masakrat e pushtetit serb kundër popullsisë shqiptare (1912-1999).....	43
Kolonizimi serb i Kosovës respektivisht i Gjilanit dhe Reforma agrare mes dy luftërave botërore.....	44
Lufta e Dytë Botërore (1939 – 1945).....	46
Personalitete.....	46
Idriz Hajrullahu – Mulla Idriz Gjilani (1901-1949)	46

Xheladin Kurbaliu.....	48
Esat Berisha (1913-1944).....	49
Lazer Berisha.....	51
Jusuf Bafjtjari – Hoxhë Lipovica (1883-1948)	51
Ymer Myqibaba.....	52
Isuf Pidiqi	52
Fazli Haxha	53
Ngjarje	54
Lidhja e Dytë e Prizrenit (16-20 shtator 1943 – janar 1944)	54
Lufta e Livoçit (26 prill 1943).....	55
Lufta e Kikës (28 qershor 1944)	56
Lufta e Raincës 29 gusht 1944	57
Lufta e Myqibabës 30 nëntor 1944	57
Beteja e Desivojcës 19 dhjetor 1944.....	58
Masakra e Tivarit (24 mars 1945).....	58
Sulmi në Gjilan 23 dhjetor 1944	59
Periudha pas Luftës së Dytë Botërore (1946 – 1989).....	60
Personalitete.....	60
Anëtarët e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare	60
Halim Orana (1914-1947).....	60
Metush Krasniqi (1927-1986)	61
Hasan Alia – Remniku (1913-1951)	62
Haki Sermaxhaj (1914-1948).....	63
Mustafë Rushiti - Kokaj.....	63
Ibrahim Kelmendi	64
Isak Gashi (Brestovci).....	65
Agush Haziri	66

Rexhep Dajkoci	67
Mark Gashi	67
Personalitete nga Lëvizja ilegale	68
Kadri Zeka (1953-1982).....	68
Rexhep Mala	69
Nuhi Berisha.....	69
Zija Shemsiu (1950-1985).....	70
Rexhep Elmazi	70
Vehbi Ibrahimimi	71
Intelektual	73
Beqir Musliu (1945-1996).....	73
Xhavit Ahmeti (1952-1996).....	73
Halil Alidema (1936-1996)	74
Sadulla Brestovci (1933-1979).....	77
Muharrem Shahiqi.....	79
Tribun popullor.....	79
Ramiz Cernica (1903-1979).....	79
Ngjarje	80
Lëvizja Nacional Demoraktike Shqiptarë në Anamoravë	80
Aksionet e mbledhjes së armëve në Kosovë (1912 – 1999)	81
Demonstratat e 27 nëntorit të vitit 1968.....	82
Demonstratat e mars-prillit 1981.....	83
Demonstratat gjithë popullore e shqiptarëve kundër Serbisë (1988 - 1990).....	85
Grupet ilegale në Kosovë (1968 - 1999)	86
Periudha për liri, pavarësi dhe demokraci.....	89
Personalitete.....	89
Xhevat Qerimi	89

Reshat Ymeri.....	90
Agim Rashiti	90
Ngjarje	91
Helmimet në komunën e Gjilanit (19 mars 1990).....	91
Lëvizja për pajtimin e gjaqeve në Kosovë (1990).....	91
Deklarata kushtetuese e Kuvendit të Kosovës (2 korrik 1990), Miratimi i Kushtetutës së Kosovës (7 shtator 1990) dhe Referendumi për shpalljen e Pavarësisë së Kosovës (26 deri në 30 shtator 1991).....	92
Themelimi dhe kontributi i partive politike gjatë viteve 1990 – 1999.....	93
Krijimi dhe funksionimi i institucioneve të përkohëshme të Gjilanit (1992 - 1999).....	95
Sistemi i pavarur arsimor, shtëpitë shkolla (1990 - 1999)	96
Themelimi dhe funksionimi i Mbrojtjes territoriale të komunës së Gjilanit.....	97
Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1997 – 1999).....	98
Personalitete.....	98
Zona Operative e Karadakut.....	98
Abdullah Tahiri	98
Hanumshahe Abdullahu - Zymberi	99
Tefik Zymberi	99
Pajazit Ahmeti.....	100
Muharrem Ibrahim i	101
Besnik Maroca.....	103
Alban Ajeti	103
Bashkim Selishta	103
Brigada 171 “Kadri Zeka”	104
Ibrahim Uruqi.....	104
Fadil Jakupi	104
Sahit Baftiu.....	104

Nijazi Osmani.....	105
Bahtir Jahiri.....	105
Ibrahim Pacolli.....	106
Enver Miftari.....	106
Ibrahim Fejzullahu.....	107
Kastriot Baftiu.....	107
Mehmedali Behluli.....	108
Zylfie Gashi.....	108
Bahri Sadiku.....	108
Shahin Baftiu.....	108
Blerim Ademi.....	109
Fatmir Ademi.....	109
Ramadan Hyseni.....	109
Shaban Hyseni.....	109
Ilmi Hyseni.....	109
Afrim Gagica.....	110
Naser Azemi.....	110
Sherif Sherifi.....	110
Ismet Ajeti.....	110
Fadil Ajeti.....	110
Feim Ajeti.....	111
Ismet Sadiku.....	111
Ibrahim Beqiri.....	111
Mehmetali Ajvazi.....	111
Shyqeri Ajvazi.....	111
Bajram Gashi.....	112
Bashkim Ramadani.....	112

Bejtush Gerbeshi	112
Enver Pacolli	112
Gafurr Hyseni	112
Shefki Salihu	113
Hasan Maloku	113
Ukshin Maloku	113
Sabedin Hamiti	113
Nezir Shurdhani	113
Nusret Hajdari	114
Avni Arifi	114
Brigada 153 "Agim Ramadani"	114
Agim Ramadani	114
Arben Jusufi	115
Urim Mehmeti	115
Fatos Limani	116
Ushtria Çlirimtare për Preshevë, Bujanoc e Medvegjë	118
Fatmir Ibishi	118
Arben Ramadani	118
Shaban Ukshini	118
Sami Ukshini	118
Kastriot Arifi	119
Besim Mazrreku	119
Ushtria Çlirimtare Kombëtare	119
Skifter Arifi	119
Shefik Miftari	120
Kastriot Vokshi	121
Hysni Xhemajli	121

Ngjarje	122
Demonstratat e studentëve (1 tetor 1997)	122
Zona Operative e Karadakut e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës	123
Beteja e Zhegocit (15 prill 1999)	124
Intervenimi ushtarak i NATO-s në Kosovë (24 mars 1999) dhe hyrja ushtarake e saj në Kosovë respektivisht në Gjilan (12 qershor 1999).....	128
Dëbimi me dhunë të popullsisë së Gjilanit nga forcat serbe prill 1999	130
Masakra në Lladovë (2 prill 1999).....	130
Masakra e Llovçës (5 prill 1999)	131
Masakra në Bresalc (10 prill 1999).....	131
Masakrat në Llashticë (13-30 prill 1999).....	132
Masakra në Zhegër (mars 1999).....	132
Të vrarët në Gjilan (mars-prill 1999)	134
Të tjera	135
Ngjarje	135
Pllakë ose simbol me emrat e dëshmorëve, martirëve e viktimave në secilin fshat të komunës së Gjilanit, duke përfshirë çdo periudhë historike.	135
Simbol për shtetet që kontribuan në çlirimin e Kosovës.....	138
Simbol për gruan – nënën në avancime të përgjithshme të shqiptarëve.	139
Simbol për rolin dhe kontributin e mërgatës shqiptare në procese të lirisë dhe pavarësisë kombëtare.	141
Përbërja e këshillit.....	144

HYRJE

Në bazë të rregullores për procedurat dhe kriteret e vendosjes së përmendoreve, shtatoreve, busteve dhe simboleve 01. Nr. 16 – 16481 të datës 09 shkurt 2012 të Kuvendit të Komunës së Gjilanit. Sipas nenit 2, pika e parë të kësaj rregullore lejon formimin e Këshillit të përhershëm komunal për vlerësimin e meritave historike e shoqërore të personaliteteve dhe ngjarjeve nga territori i komunës së gjilanit dhe tërësia etnike shqiptare, por edhe nga bota. Ky Këshill u themelua në bazë të vendimit 01. Nr. 16 – 24255 të datës 15 mars 2013. Këshilli takimin e parë e ka mbajtur më 22 maj 2013 si takim njoftues dhe u vendos në bazë të rregullores në fjalë t'i hartoj kriteret bazë dhe listën me personalitete dhe ngjarje historike. Në përbërje të Këshillit janë Arzie Nuhiu, kryesuese, Sabit Rustemi zëvendës – kryesues dhe anëtarët Blerim Sylejmani, Naim Musliu, Fitim Rifati, Ilir Tahiri, Fadil Gashi, Sadudin Berisha dhe Tefik Maksuti. Përveç kriterëve që dalin nga rregullorja 01 Nr. 16 – 24255 të datës 15 mars 2013, në mbledhjen e mbajtur më 24 gusht 2013, Këshilli e delegoj Naim Musliun dhe Fitim Rifatin që t'i hartoj kriteret e brendshme në bazë të metodologjisë shkencore të fushës së Historisë. Në mbledhjen e 3 korrikut të vitit 2013 u shqyrtuan kriteret bazë nënë për nënë dhe u miratua unanimitisht ku dhanë kontribut të çmueshëm të gjithë anëtarët e Këshillit. Kurse sipas mbledhjes së datës 21 gusht të vitit 2013 filloi diskutimi i hartimit të listës, kontribut në përpilimin e kësaj liste kanë dhënë Naim Musliu dhe Fitim Rifati që të dy historian kurse për hartimin e listës së periudhën e UÇK-së u ngarkua përfaqësuesi i Veteranëve të Luftës së UÇK-së dega në Gjilan, Ilir Tahiri. Në takimin tjetër të datës 10 shtator 2013 kjo listë bazë është plotësuar me propozime tjera duke kontribuar të gjithë anëtarët e Këshillit me propozime të tyre. Me që mujat e fundit të vitit 2013 ishin vit zgjedhor, Këshilli i pezulloi punimet. Kurse me ardhjen e qeverisë së re komunale më 30 korrik 2015 miratohet vendimi i ri 01. Nr. 016 – 73826 për emërimin e përbërjes së Këshillit. Në përbërje janë Sabit Rustemi – kryesues, Zyrije Shala, Naim Musliu, Shaban Rexhepi dhe Ahmet Daku. Në mbledhjen e parë të mbajtur më 16 shtator 2016 u njoftua me përbërjen e Këshillit dhe mënyrën e punës së tij. Aty u vendos që Këshilli të vazhdoj punën e mbetur nga përbërja e më hershme e vitit 2013. Në mbledhjen e mbajtur më 21 shtator 2016 unanimitisht hyri prapë në fuqi rregullorja e brendshme e miratuar nga përbërja e më hershme me të vetmin plotësim që të ftohen ekspert të fushës së Historisë kur Këshilli e sheh të nevojshme. Më 4 tetor 2016 Këshilli filloi të shqyrtoj listën e hartuar në përbërjen e më hershme nga historianët Naim Musliu e Fitim Rifati dhe plotësimi me propozime të reja. Mbledhje tjera me propozime dhe me hartim të listës u bënë më 5, 12, 19 dhe 26 tetor 2016 dhe më 2 nëntor

2016. Kurse në mbledhjen e 19 tetorit të vitit 2016 me kërkesën e Naim Musliut dhe me miratimin unanim të Këshillut u bë ftesë ekspertëve të fushës së Historisë Dr. Fehmi Rexhepi, Mr. Aliriza Selamni dhe Mr. Fitim Rifati të prezantojnë në mbledhjen e 26 tetorit 2016. Në këtë takim historianët si ekspertë të jashtëm dhanë kontribut të madh në përpilimin përfundimtar të listës. Sa i përket listës së periudhës së UÇK-së kontribut të çmueshëm dha përfaqësuesi i Shoqatës së Veteranëve të Luftës së UÇK – së Ahmet Daku. Materialin me biografi e hartoi Naim Musliu. Në mbledhjen e datës 30 nëntor 2016 nga pjesëmarrësit u miratua lista me unanim të plotë nga Këshilli në përjashtim të përfaqësuesit të AAK z. Shaban Rexhepit, që u larguar nga Këshilli pa ndonjë arsyetim zyrtar dërguar Këshillit.

LISTA EMËRORE E PERSONALITETEVE DHE NGJARJEVE NGA TERRITORI I KOMUNËS SË GJILANIT DHE TËRËSIA ETNIKE SHQIPTARE, POR EDHE NGA BOTA

1. Koha e lashtë dhe mesjeta (nga lashtësia deri më 1455)

a. Personalitete

Antika

- Longari
- Busti i gruas dardane

Mesjeta

- Justiniani i Madh

b. Ngjarje

- Dardanët, harta e mbretërisë

2. Periudha Osmane (XV - 1912)

a. Personalitete

- Idriz Seferi (1847-1927)
- Dom Mikel Tarabulluzi (1868-1933)
- Qamil Bala (1878-1933)
- Sinan Maxherja – hoxhë (1863-1910)
- Murat Bilalli (?-1912)
- Islam Pira
- Ramë Abdyl
- Salih Aga i Gjilanit
- Baftije Seferi (1864-1969)
- Ibrahim Popoci
- Xhelal Beu
- Haxhi Salihi

b. Ngjarje

- Shpërnguljet e shqiptare gjatë gjithë historisë.
- Çlirimi i Gjilanit (më 1843, 21 janar 1881, 26 korrik 1912, 1915, 1945, 1999)
- Lidhja Shqiptare e Prizrenit (1878 – 1881)
- Klubi kombëtar i Gjilanit (1908)

- Kongresi kombëtar i Elbasanit (2-8 shtator 1909) dhe shkolla normale e Elbasanit (1 dhjetor 1909)
 - Beteja e Kaçanikut (30 prill 1910)
3. Luftërat Ballkanike dhe Lufta e Parë Botërore (1912 – 1918)
- a. Personalitete
 - Leo Freundlich (1875 - 1953)
 - b. Ngjarje
 - Pushtimi serb i vitit 1912 dhe ai bullgar i vitit 1915
4. Periudha ndërmjet dy luftërave botërore (1919 – 1939)
- a. Personalitete
 - Lotë Vaku
 - b. Ngjarje
 - Komiteti “Mbrojtja Kombëtare e Kosovës” (1918-1924)
 - Lëvizja e armatosur kaçake në Gjilan (1918-1928)
 - Masakrat e pushtetit serb kundër popullsisë shqiptare (1912-1999)
 - Kolonizimi serb i kosovës respektivisht i Gjilanit dhe Reforma Agrare mes dy luftërave botërore
5. Lufta e Dytë Botërore (1939 – 1945)
- 1) Personalitete
 - Idriz Hajrullahu – Mulla Idriz Gjilani (1901-1949)
 - Xheladin Kurbaliu
 - Esat Berisha (1913-1944)
 - Lazer Berisha
 - Jusuf Bafjtjari – Hoxhë Lipovica (1883-1948)
 - Ymer Myqibaba
 - Isuf Pidiqi
 - Fazli Haxha
 - 2) Ngjarje
 - Lidhja e Dytë e Prizrenit (16-20 shtator 1943 – janar 1944)
 - Lufta e Livoçit (26 prill 1943)
 - Lufta e Kikës (28 qershor 1944)
 - Lufta e Raincës 29 gusht 1944

- Lufta e Myqibabës 30 nëntor 1944
- Beteja e Desivojcës 19 dhjetor 1944
- Masakra e Tivarit (24 mars 1945)
- Sulmi në Gjilan 23 dhjetor 1944

6. Periudha pas Luftës së Dytë Botërore (1946 – 1989)

a. Personalitete

Anëtarët e Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare

- Halim Orana (1914-1947)
- Metush Krasniqi (1927-1986)
- Hasan Alia – Remniku (1913-1951)
- Haki Sermahaj (1914-1948)
- Mustafë Rushiti - Kokaj
- Ibrahim Kelmendi
- Isak Gashi (Brestovci)
- Agush Haziri
- Rexhep Dajkoci
- Rexhep Mala
- Nuhi Berisha
- Zija Shemsiu (1950-1985)
- Rexhep Elmazi
- Vehbi Ibrahim

Intelektual

- Beqir Musliu (1945-1996)
- Xhavit Ahmeti (1952-1996)
- Halil Alidema (1936-1996)
- Sadulla Brestovci (1933-1979)
- Muharrem Shahiqi

Tribun popullor

- Ramiz Cernica (1903-1979)

b. Ngjarje

- Lëvizja Nacional-Demokratike Shqiptare në Anamoravë (1943 - 1951)

- Aksionet e mbledhjes së armëve në Kosovë (1912 – 1999)
 - Demonstratat e 27 nëntorit të vitit 1968
 - Demonstratat e mars-prillit 1981
 - Demonstratat gjithë popullore e shqiptarëve kundër pushtuesit serb (1988 - 1990)
 - Grupet ilegale në Kosovë (1968 - 1999)
7. Periudha për liri, pavarësi dhe demokraci (1990 – 1997)
- a. Personalitete
- Xhevat Qerimi
 - Reshat Ymeri
 - Agim Rashiti
- b. Ngjarje
- Helmimet në komunën e Gjilanit (19 mars 1990)
 - Aksioni i Pajtimit të gjaqeve në Kosovë (1990)
 - Deklarata Kushtetuese e Kuvendit të Kosovës (2 korrik 1990), miratimi i Kushtetutës së Kosovës (7 shtator 1990) dhe Referendumi për shpalljen e pavarësisë së Kosovës (26 deri në 30 shtator 1991)
 - Themelimi dhe kontributi i partive politike gjatë viteve 1990 – 1999
 - Krijimi dhe funksionimi i institucioneve të pavarura të Gjilanit (1992 - 1999)
 - Sistemi i pavarur arsimor, shtëpi – shkolla (1990 - 1999)
 - Themelimi dhe funksionimi i Mbrojtjes Territoriale të komunës së Gjilanit
8. Lufta e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (1997 - 1999)
- a. Personalitete
- Zona Operative e Karadakut
- Abdullah R. Tahiri
 - Hanumshahe A. Zymeri
 - Tefik V. Zymeri
 - Pajazit M. Ahmeti
 - Muharrem R. Ibrahim
 - Besnik V. Maroca

- Alban Sh. Ajeti
- Bashkim Xh. Selishta

Brigada 171 "Kadri Zeka"

- Ibrahim M. Uruqi
- Fadil B. Jakupi
- Sahit B. Baftiu
- Nijazi Sh. Osmani
- Bahtir H. Jahiri
- Ibrahim Q. Pacolli
- Enver Sh. Miftari
- Ibrahim S. Fejzullahu
- Kastriot S. Baftiu
- Mehmedali Sh. Behluli
- Zylfie F. Gashi
- Bahri Xh. Sadiku
- Shahin B. Baftiu
- Blerim M. Ademi
- Fatmir M. Ademi
- Ramadan H. Hyseni
- Shaban H. Hyseni
- Ilmi H. Hyseni
- Afrim I. Gagica
- Naser Q. Azemi
- Sherif S. Sherifi
- Ismet I. Ajeti
- Fadil Sh. Ajeti
- Feim H. Ajeti
- Ismet H. Sadiku
- Ibrahim R. Beqiri
- Mehmetali J. Ajvazi
- Shyqeri Z. Ajvazi
- Bajram Q. Gashi

- Bashkim R. Ramadani
- Bejtush S. Gerbeshi
- Enver A. Pacolli
- Gafurr Q. Hyseni
- Shefki F. Salihu
- Hasan E. Maloku
- Ukshin S. Maloku
- Sabedin S. Hamiti
- Nezir Sh. Shurdhani
- Nusret F. Hajdari
- Avni Q. Arifi

Brigada 153 "Agim Ramadani"

- Agim H. Ramadani
- Arben S. Jusufi
- Urim G. Mehmeti
- Fatos Sh. Limani

Ushtria Çlirimtare për Presheve, Bujanoc e Medvegjë

- Fatmir H. Ibishi
- Arben S. Ramadani
- Shaban R. Ukshini
- Sami N. Ukshini
- Kastriot M. Arifi
- Besim I. Mazrreku

Ushtria Çlirimtare Kombëtare

- Skifter M. Arifi
- Shefik M. Miftari
- Kastriot Vokshi
- Hysni R. Xhemajli

b. Ngjarje

- Demonstratat e studentëve (1 tetor 1997)
- Zona Operative e Karadakut e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës
- Beteja e Zhegocit (15 prill 1999)

- Intervenimi ushtarak i NATO-s në Kosovë (24 mars 1999) dhe hyrja ushtarake e saj në Kosovë respektivisht në Gjilan (12 qershor 1999)
- Dëbimi me dhunë të popullsisë së Gjilanit nga forcat serbe prill 1999
- Masakra në Lladovë (2 prill 1999)
- Masakra e Llovcës (5 prill 1999)
- Masakra në Bresalc (10 prill 1999)
- Masakrat në Llashticë (13-30 prill 1999)
- Masakra në Zhegër (mars 999)
- Të vrarët në Gjilan (mars-prill 1999)

9. Të tjera

a. Ngjarje

- Pllakë ose simbol me emrat e dëshmorëve, martirëve e viktimave në secilin fshat të komunës së Gjilanit, duke përfshirë çdo periudhë historike.
- Simbol për shtetet që kontribuan në çlirimin e Kosovës.
- Simbol për gruan – nënën në avancime të përgjithshme të shqiptarëve.
- Simbol për rolin dhe kontributin e mërgatës shqiptare në procese të lirisë dhe pavarësisë kombëtare.

**BIOGRAFITË E PERSONALITETEVE DHE NGJARJEVE
NGA TERRITORI I KOMUNËS SË GJILANIT DHE TËRËSIA
ETNIKE SHQIPTARE, POR EDHE NGA BOTA**

**KOHA E LASHTË DHE MESJETA (NGA LASHTËSIA DERI MË
1455)**

PERSONALITETE

ANTIKA

LONGARI

Sundoi 231 - 206 p.k dhe ishte mbret ilir i Dardanisë. Longar është mbreti i parë i njohur i dardanëve, pastaj erdhën mbretërit Bato dhe Monun (khs. T. Livi, Ad urbe condita, libri XXXI 28,1 e 2.): ... ex Dardanis Bato Longari filius. Bellum suo nomine Longarus cum Demetrio Philippi patre gesserat (... dhe prej dardanëve Bato, i biri i Longarit. Longari kishte luftuar vetë kundër Demetrit, të atit të Filipit). (Shih po ashtu Krahe Lexicon altillyrischer personennamen, Heidelberg, 1929, f. 62.). Longari ishte në luftë me mbretër të ndryshëm të Maqedonisë, dhe arriti të pushtojë pjesë të saj. Ishte aleat i Peonëve, dhe i liroi ata në mënyrë që të kishte të hapura rrugët drejt Maqedonisë. Influenca e Longarit u rrit, dhe shumë ilirë të tjerë, ndër ta edhe Mbretëria e Ardianëve, u bashkuan me të.

BUSTI I GRUAS DARDANE

U zbulua në fund të shek. XIX në arealin e vendbanimit antik të fshatit Kllokot. Ruhet nga viti 1956 në Muzeun e Kosovës. Busti është i lartë 0,75m me gjerësi të kraharorit 0,55m dhe trashësi 0,15m, punuar prej mermeri të bardhë, ku paraqitet gruaja e veshur me palë (fustan) dhe stolë (pelerinë). Kokën e ka të mbuluar me shami, e cila i bie mbi supe, kurse rreth qafe ka qafore masive me një medaljon masiv në mes dhe dy më të vegjël anash. Shamia, e sidomos qaforja masive me medaljon janë stoli karakteristike e veshjes për territorin dardan dhe element i rëndësishëm për përcaktimin e përkatësisë fisnore. Është vepër e mjeshtërve vendës dhe e punuar para romanizimit përfundimtar të Dardanisë (fundi i shek. II, fillimi i shek. III). Supozohet se ka pasur funksionin e bustit mbivarror. Ky bust, në një formë apo një tjetër, tregon pozitën e gruas në shoqërinë dardane.

MESJETA

JUSTINIANI I MADH

Justiniani (lat.: Flavius Petrus Sabbatius Iustinianus,) zakonisht i njohur si Justiniani I, apo Kisha Ortodokse e njeh si Shën Justiniani i Madh, lindi në Tauresium fshat afër Shkupit të Ilirisë (Dardanisë) rreth viteve 482/483. Ishte Perandor i Bizantit nga viti 527 gjer në vdekjen e tij. Gjatë kohës së sundimit të Justinianit, perandoria bizantine arrin kulmin e lulëzimit në të gjitha lëmenjtë e jetës. Nga pikëpamja ushtarake, Afrika dhe Italia u rimëkëmbën dhe pushteti i perandorisë ishte më i fortë se kurrë më parë. Në anën tjetër, arkitektura po lulëzonte dhe nga kjo kohë kanë mbetur shembujt më të mirë si p.sh.: Hagia Sofia në Konstantinopojë (Stamboll). Historianët siç ishin Prokopiusi dhe Agatia punonin sipas traditës së Herodotit e Thukididit. Gjatë kësaj kohe u krijua edhe Kodeksi i Justinianit (529), i cili u institucionalizua dhe hyri në fuqi rreth viteve 533. Të gjitha këto vepra janë pika kulmore të begatisë bizantine e që janë krijuar në kohën e Justinianit. Përbrenda kishte trazira, siç ishin kryengritja e Nikesë që shpërtheu në janar të 532 në Konstantinopojë. Pas disa çrregullimeve politike, Belisari hyri në Hipodrome me ushtri dhe e shuajti revoltën e “të gjelbërve” dhe “të kaltërve”. Më këtë rast u shkaktua një gjakderdhje dhe qyteti pësoi dëmtime të rënda, mirëpo në anën tjetër, kjo i hapi rrugën Justinianit për zbatimin e programit të tij. Kështu ai, vetëm disa ditë pas revoltës, filloi punimet për ndërtimin e kishës së re, në vend të kishës së dëmtuar rëndë të Shën Sofisë. Në vitin 533, Justiniani ndërmori disa ekspedita të udhëhequra nga Belisari kundër mbretit vandal në Afrikë. Armata që kishte vënë në dispozicion Belisarit përbëhej, përpos 10.000 këmbësorëve, edhe nga më se 5.000 kalorës dhe 3.000 barbarë. Me fitoret e korrura kundër Gelimerit, i cili në fakt kishte mbajtur një pjesë të ushtrisë dhe një pjesë e kishte dorëzuar nën komandën e të vëllait Tata, në ishullin e Sardineve, Belisari ja arriti të pushtonte Karagen për një kohë të shkurtër. Pas kësaj fitoreje, Belisari u kthye së bashku me robërit e zënë në Konstatinopojë, ku Justiniani i la të vendoste për sundimin në Afrikë. Sulmin e gotëve të jugut, Justiani e bëri me zbarkimin në Itali, në vitin 535. Ushtria e udhëhequr nga Belisari nuk hasi në ndonjë qëndresë deri në Palermo dhe më 31 dhjetor hyri në Sirakuzë. Në pjesën tjetër të kohës, ai përparoi me ushtrinë e vet deri në Napol, ku ishin garnizonet e gotëve, të cilët i theu. Në dhjetorin pasues, Belisarin e gjejmë me ushtri të vendosur në Romë, duke u përgatitur për kundërsulmin e gotëve të jugut. Pas një viti rrethimi të Romës me ndihmat e marra nga Justiniani, Belisari vazhdoi marshimin e tij drejt Ravenës, me të njëjtën ushtri. Kështu në maj të vitit 540, bizantinët hyjnë në Ravenë. Justiani

që kishte për qëllim zbatimin e planit të tij, pranoi një mbretëri të Gotëve të jugut në pjesën veriore të Italisë, me qëllim që të siguronte këtë pjesë të perandorisë dhe të qëronte hesapet me perandorinë perse, në jug të kufinjve. Në kohën e Justinianit u ndërtuan kala të reja dhe shumë ekzistuese i rindërtoi. Ndër kështjellat e rindërtuara janë ajo e Shkupit e quajtur Justiniana Prima, e Ulpianës që u quajt Justiniana Sekonda kurse në në Gjilan kishte rindërtuar kalanë e Pogradjës. Vdiq me 13 nëntor apo 14 nëntor, 565 në Konstantinopojë.

NGJARJE

DARDANËT, HARTA E MBRETËRISË

Në shek. IV para Krishtit u formua Mbretëria Dardane, e cila shtrihej në territorin e Kosovës së sotme e të krahinave përreth saj. Kufijtë e saj shtriheshin në veri deri te qyteti i Nishit, kurse në jug deri ne Kukës dhe ne rrjedhën e sipërme te lumit Vardar. Mbreti i parë dardan është Longari. Pas tij erdhën mbretërit Bato dhe Monun. Rolin kryesor ne Mbretëri e luajti fisi i dardaneve. Ne këtë Mbretëri Benin pjese edhe fise te tjera, si galabrët dhe thunatët. Dardania ishte e njohur ne boten e lashte për tokat e saj pjellore, për punimin e arit dhe për përpunimin e prodhimeve blegtorale. I njohur ishte veçanërisht djathi dardan. Mbretëria dardane kishte krijuar një ushtri te fuqishme dhe te organizuar mire. Veçori e luftëtareve dardane ishte se ata hidheshin te gjithë se bashku ne sulm, dhe po kështu, se bashku tërhiqeshin, duke mos lënë ne duart e armikut te plagosurit e tyre.

PERIUDHA OSMANE (XV - 1912)

PERSONALITETE

IDRIZ SEFERI (1847-1927)

Idriz Seferi u lind në mars të vitit 1847 në fshatin malor Sefer, në një familje me tradita patriotike. Ishte bashkëluftëtar dhe prijës i tri gjeneratave luftëtarësh të viseve liridashëse e luftarake të malësisë së Karadakut, të Moravës, të Gollakut dhe të Vardarit. Meqë mungonin shkollat në gjuhën shqipe si pasojë e sunduesit të kohës, mësimet e para i bëri në odën e burrave dhe aty u kalit në frymën kombëtare. Që në moshën 13 vjeçare ai luftoi kundër çetave terroriste serbe e bullgare, ndaj qëllimeve të të cilave nuk mund të pajtohej në asnjë mënyrë. Kundërshtoi dhe luftoi autoritetet lokale osmane dhe, si krah i fuqishëm në vijën e parë të rrezikut, u tregua mjaft aktiv në kohën e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit dhe Lidhjes

Shqiptare të Pejës. Idriz Seferi në korrik të vitit 1907 mori pjesë në asgjësimin e çetës komite serbe të Pasjanit. Ai luajti një rol të rëndësishëm në organizmin dhe mbarëvajtjen e Kuvendit të Ferizajt gjatë korrikut të vitit 1908, i cili rezultoi me ngadhënjimin e Revolucionit Xhonturk. Pas këtij Revolucionit, Idriz Seferi dha ndihmesë të çmuar në emancipimin kombëtar të arsimit dhe shkollës shqipe kudo në vise të tjera të Vilajetit të Kosovës. Politika demagogjike, obskurantiste dhe reaksionare xhonturke, në kauzalitetin e situatës dhe rrethanave nëpër të cilat po kalonin shqiptarët, diktonte në esencë nevojën e autonomisë territoriale dhe administrative të Shqipërisë. Ky program u proklamua jo si doktrinë e vetme e platformës së Rilindjes, por si komponentë e përkohshme dhe e hartuar në simetri me aktualitetin e përgjithshëm shqiptar, ballkanik e më gjerë. Për realizimin e kësaj platforme politike kombëtare, Idriz Seferi jo rastësisht u gjend në krye të udhëheqjes popullore në kryengritjet kundërosmane të viteve 1910 dhe 1912. Në aktivitetin e tij patriotik spikat veçanërisht Beteja e Kaçanikut në Kryengritjen e vitit 1910, ku dolën në pah cilësitë e rralla të karakterit të tij dhe aftësitë drejtuese luftarake, kurse në Kryengritjen e vitit 1912 ishte ndër drejtuesit kryesorë. Në Luftën e Parë Ballkanike, së bashku me vullnetarët e tij, Idriz Seferi luftoi heroikisht në mbrojtje të trupit të atdheut. Pas Pavarësisë së Shqipërisë në kufij të cunuar, ndonëse ishte në moshë të shtyrë, ai nuk pushoi së rezistuari e luftuari pushtuesit serbë e bullgarë. Në ditët e fundit të jetës, Idriz Seferi do të shprehej: "Nuk paska ma vështirë për burrin se sa me vdekë në shtëpi". Kështu, drejtuesi dhe strategu i kryengritjeve për liri dhe pavarësi kombëtare, ndërroi jetë në moshën 80 vjeçare, në mars të vitit 1927, në fshatin Zhegër, ku edhe u varros.

DOM MIKEL TARABULLUZI (1868-1933)

Klerik atdhetar dhe mësues i shkollës së parë shqipe të njohur nga autoritetet në Kosovë. Lindi në Prizren më 1868 dhe u shkollua në Shkodër. Punën e mësuesit të gjuhës shqipe e filloi fshehtas gjatë shërbimit si meshtar në Pejë, për ta vazhduar në Letnicë e Stubëll. Me këmbënguljen e tij, shkolla e Stubllës u njoh si institucion i arsimit shqip më 1 mars 1905. Për shkak të veprimtarisë patriotike Mikeli u ndoq dhe u persekutua prej regjimeve ndryshme antikombetare. Ndjenja e jashtëzakonshme patriotike e beri që ai të shkoje në kembe gjer në Vlorë për të marrë pjesë në solemnitetin madheshtor me rastin e shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë. Si atdhetar i flaktë shqiptar, dom Mikeli u përndoq nga autoritetet osmane dhe u burgos nga xhandarmëria serbe. Mirëpo ndjekjet, torturat e burgimet nuk mundën ta largonin

nga rruga e tij patriotike, te cilen e vazhdoi edhe gjate disa viteve te Mbretërisë Jugosllavisë, ne kushte mjaft te veshtira. Vdiç në vitin 1933.

QAMIL BALA (1878-1933)

Lindi në Gjilan në vitin 1878. Sipas disa të dhënave ishte i biri i Sherif Hoxhës i ardhur nga fshati Strezoc i Kamenicës. Si student i shkollës së Lartë Normale – Pedagogjike në Stamboll, ai kur kalonte pushimet në vendlindje shfrytëzonte momentin që të përhapte idenë kombëtare shqiptare. Gjatë asaj kohe bashkëvendësve u sillte ose u dërgonte libra e gazeta shqipe, që dilnin në Stamboll, Bukuresht, Sofje e vende të tjera, me qëllim që të aftësoheshin në shkrim-lexim shqip dhe në ngritjen e vetëdijes kombëtare. Këtë aktivitet nuk e kishte ndërprerë as sa ishte profesor i gjimnazit në Janinë, Manastir e Selanik. Në vitet '20 ishte pjekur mendimi për të krijuar një shkollë të mesme fetare islame me fizionomi bashkëkohore. Ithtarë të kësaj ideje dhe iniciatore të kësaj ndërmarrjeje u bënë personalitete të shquara të politikës shqiptare të atyre viteve. Me shkatërrimin e Halifatit, ngritja e një shkolle të tillë shtrohej si një çështje emergjente. Grupi i iniciatorëve kryesorë përfaqësohej nga Hfz.Vehbi Dibra, senatori Sali Vuçiterni, intelektualët e shquar Qamil Bala, Mehdi Frashëri, e Ferit Vokopola etj. Medreseja që do të ngrihej synonte të përgatiste klerikë të ditur, të pajisur me njohuri të larta fetare, filozofike e shkencore, në përkatësi me arritjet e arsimit bashkëkohor. Drejtimi i kësaj medreseje iu caktua Qamil Balës. Qamil Bala kishte një përvojë të gjatë pedagogjike si mësues në gjimnazet e Janinës, Selanikut dhe Manastirit, si dhe drejtor i gjimnazit në Jerusalem, drejtor arsimit në Damask e Elbasan. Ai kishte marrë pjesë në Kongresin arsimor të vitit 1922 dhe qe anëtar i Komitetit "Mbrojtja Kombëtare e Kosovës". Këtij personaliteti iu besua drejtimi i Medresesë së Tiranës më 1 mars 1924. Ai paraqiti planin mësimor të kësaj shkolle fetare, ku do të jepeshin lëndët: Kur'ani, Fikhu, gjuha arabe, gjuha shqipe, gjuha frënge, historia e Shqipërisë, gjeografia, shkencat, aritmetika e gjeometria, higjena dhe lëndët e djathtësisë (vizatim, gjimnastikë dhe muzikë). Për nga programi dhe plani mësimor, kjo medrese ishte e barazvlershme me gjimnazet bashkëkohore. Në këtë traditë eci ajo, nga bankat e së cilës dolën klerikë të aftë, studiues, shkrimtarë e deri akademikë. Për çështjen e Kosovës Qamil Bala disa herë ngriti zërin para Lidhjes së Kombeve në Gjenevë. Ishte deputet në qeverinë e Nolit. U amnistua nga mbreti Zog dhe më pas dha një kontribut të çmueshëm në arsimin kombëtar. Vdiç në moshën 55 vjeçare në Tiranë. Kuvendi Popullor i Shqipërisë aprovoi Dekretin e Presidentit, i cili në vitin 1962

Qamil Balës i dha urdhrin “Për veprimtari patriotike”, të klasit të tretë. Ndërsa në vitin 1987 i dha titullin “Mësues i Popullit”.

SINAN MAXHERJA – HOXHË (1863-1910)

Ishte nga luftëtarët më besnikë të Idriz Seferit deri më 1910, kur edhe do ta varnin xhonturqit në Kaçanik. Ndonëse i takonte radhës së ulemave, ai do të binte herët në kontakt me patriotët shqiptarë, për t’u ushqyer e rritur me ndjenja patriotike. Ishte shumë i afërt me Idriz Seferin, saqë thuhet se ishte edhe njëri nga sekretarët personalë jozyrtarë të tij. Mulla Sinan Maxhera lindi në fshatin Maxherë të Karadakut të Preshevës në vitin 1863, nga e ëma Ajetja dhe nga babai Bilalli. Rridhte nga një familje me tradita patriotike. Mësimet e para i mori te hoxha i fshatit, ndërsa medresenë e mesme e mbaroi në Shkup, për ta vazhduar më vonë Fakultetin e Drejtësisë në Stamboll. Ka punuar si hoxhë, në fshatrat Caravajkë, Pogragjë e Dobërçan, dhe aty, nxënësve, përveç lëndëve fetare, u mbante edhe ligjërata me karakter kombëtar. Meqë gëzonte autoritet në popull, mulla Sinani luajti një rol të rëndësishëm edhe në pajtimin e gjaqeve dhe në zhdukjen e hakmarrjes. Mori pjesë në luftën e prillit të vitit 1910, përkrah Idriz Seferit. Për trimërinë e treguar në këtë kryengritje, populli i thuri edhe këngë. Pas shuarjes së kryengritjes, pushteti xhonturk do të organizonte ekspedita ndëshkuese kundër kryengritësve shqiptarë, kështu që mulla Sinani do të arrestohej e të burgosej në Kaçanik. Gjykata ushtarake xhonturke, së bashku me 6 të tjerë, do ta dënonte me vdekje. Mulla Sinani u var në Kaçanik më 7 korrik 1910 dhe u varros në varrezat e vjetra të këtij qyteti. Katër muaj pas vdekjes së mulla Sinanit, gruas së tij i lindi një djalë, të cilit i dhanë emrin Sinan.

MURAT BILALLI (?-1912)

Veprimtar i shquar i Lëvizjes Kombëtare Shqiptare. Lindi në fshatin Bresalc në një familje të njohur luftarake e patriotike. Mori pjesë në kryengritjet e fillimshekullit XX. Me iniciativën e Idrizit edhe Murat Bilalli nga Bresalci ishin paraqitur në komitetin xhonturk në Shkup për tu regjistruar si anëtar të këtij komiteti, ku me këtë rast ishte organizuar një betim me maska që zotoheshin se do t’i kryejnë obligimet e ndërsjella që i kishin marrë U dallua si bashkëluftëtar i ngushtë i Idriz Seferit në kryengritjen e vitit 1910. Pas shuarjes së kryengritjes së vitit 1910 u burgos nga organet e pushtetit osman, duke e lyer me mjaltë dhe gjysmë lakuriq e mbajtën ditë të tëra në diell. U vra më 1912, pas depërtimit të ushtrisë serbe në Kosovë.

ISLAM PIRA

Lindi në fshatin Pozheran te Moravës se Epërme ne vitin 1866. Ishte njeri nder bashkëpunëtorët e ngushtë te Idriz Seferit, prijësit kryesor Lëvizjes Kombëtare Shqiptare te Kazasë se Gjilanit. Pozherani qe njeri nga shume fshatrat e Kosovës, te cilat bene përpjekje te jashtëzakonshme ne suazat e kësaj lëvizjeje për liri dhe pavarësi kombëtare. Ne një rreth te tille edhe Islami u pajis me ide te larta, njerëzore, atdhetare e liridashëse. Kuptohet se ne formimin e personalitetit te Islamit pati ndikim edhe familja e tij, e cila kultivonte tradita patriotike qe nga gjysma e parë të shekullit të kaluar te paraardhësve te tij Salih Pira e Zuke Pira dhe Abdullah Pira - Dulla. Aktivitetin atdhetar Islam Pira e dëshmoi ne bashkëpunim me xhonturqit por vetëm si një etape kalimtare ne rrugën drejt pavarësisë kombëtare. Islami mori pjese gati ne te gjitha aktivitetet organizative e luftarake kundër pushtuesve osmane ne Kazan e Gjilanit si: ne djegien e Sarajishtes, ne Tubimin e Ferizajt me 1908, dhe ne luftërat çlirimtare te viteve 1910-1912, krah për krah me Idriz Seferin dhe patriotet e tjerë. Si arsimdashës qe ishte, Islami qe iniciator dhe organizatori kryesor për ndërtimin e godinës shkollore dhe hapjen e shkollës se pare shqipe ne Pozheran ne vitin 1909 Gjate kohës se Mbretërisë Jugosllave ai ndërtoi një pus për sigurimin e ujit pijshëm për pozheranasit ne vendin e quajtur "Tresava". Islam Pira pati konflikt me mësuesin Ferdo Kish, i cili nën ndikimin e familjes kolonialiste te bashkëshortes u përpoq ta pengonte shkollimin e fëmijëve shqiptare, duke marre ryshfete nga disa prindër për të liruar fëmijët nga obligimi për te vijuan mësimet. Për këtë veprim te tij te mbrapshte, Islam Pira e pati paditur mësuesin, duke kërkuar nga Ministria e Arsimit e Mbretërisë se SKS-se qe ta transferonte nga Pozherani. Megjithatë, edhe përkundër fakteve te Islamit, padia nuk u realizua ngase pushteti i doli krah mësuesit. Islami vdiq ne vitin 1931 nga pasojat e lëndimeve të marra nga një sulm i organizuar nga një kolonialist serb i Budrikës.

RAMË ABDYLI

Lindi ne Pozheran, aty viti në vitin 1852, ne një familje me tradita patriotike. Ramadani ishte i vetmi djalë i Abdylit kurse Abdylit i Xhike Zukes. Feudali familjes Gjinolli te Gjilanit, ia zptoi arat Xhike Zukës së Pozheranit. Xhika për ta mbrojtur e për t'i dale zot pasurisë se vet, ia vret beut dy punëtorë dhe dy pene buaj dhe del ne mal. Ky konflikt dhe fryma e Lëvizjes Kombëtare Shqiptare e zgjoi ndjenjën kombëtare ne këtë familje dhe e forcoi bindjen se duhej vazhduar luftën kundër pushtuesve osmane deri ne fitoren përfundimtare. I lindur ne një familje kryengritëse dhe i rritur ne një rreth me ide te larta patriotike siç ishte Pozherani,

si edhe kontaktet me Hasan Prishtinën, Bajram Currin, Idriz Seferin Bajram Daklanin, Islam Spahiu dhe patriote të tjerë, bene qe Rama te hyje i përgatitur ne ngjarje të mëdha te periudhës se Lëvizjes Kombëtare Shqiptare, si njëri nder organizatoret luftërave lokale, duke e shtri nën ndikimin edhe nder krerët e te gjitha fshatrave te Moravës. Ramadan Abdylit bashke me Islam Piren ishin anëtare te Shtabit luftarak te Idriz Seferit ne Betejën e Kaçanikut dhe ne betejat e tjera kundër ushtrisë se Shefqet Turgut Pashes. Pas përfundimit te luftërave te vitit 1910, Ramë Abdylit burgoset bashke me Kurtesh Kurteshin e Adem Dragobuzhdën dhe dënohet me 101 vjet burg. Pushteti osman ia burgosi edhe 32 anëtare te familjes, kurse pushteti ia dogji shtëpinë, oden, hanin etj. Mirëpo, nen presionin e krerëve te fshatit, te Moravës e te mbare popullit shqiptar dhe nga presioni i qeverive evropiane. Perandoria osmane u detyrua ta zbuste gjendjen e terrorit ne Kosove dhe t'i lironte te burgosurit, si edhe t'ua kompensonte demin e shkaktuar. Ramë Abdylit iu paguan 50 lira turke me te cilat i ndërtoi kullat e reja dhe objektet ndihmese. Shqiptimin e dënimit Rama e kishte pritur gjakftohte dhe pa shqetësim te madh, duke thënë se atë nuk ia kishte shqiptuar Zoti, po insani (njeriu). Ramë Abdylit, pasi lirohet nga burgu, merr pjese edhe ne luftërat e vitit 1912, ndërsa pas këtyre luftërave bashke me trimat e tjerë, ia ktheu pushkën edhe Serbisë. Pas përfundimit te luftërave ballkanike, Ramadan Abdylit me shoke fillon aktivitetin për pajtimin e gjaqeve. Kur pleqëronte Ramë Abdylit thuhej pushka vëllavrasëse nuk dëgjohej me, sepse pajtimin e bënte me ndërgegje te larte. Ramë Abdylit vdiq ne vitin 1921 dhe u varros ne Pozheran Mbretëria Jugosllave, ne marrëveshje me Turqinë ia shpërnguli familjen ne Kurdistan. Atje edhe sot jeton nipi i tij Rama, i cili ne vitin 1997 e vizitoi vendin e te pareve te tij Pozheran.

SALIH AGA I GJILANIT

Lindi në Gjilan. Mori pjesë në tubimin e Pozheranit në festimin e ngadhënjimit të Revolucionit xhonturk më 1908. Bashkëluftëtar i Idriz Seferit mori pjesë në Kryengritjen e vitit 1910. Pas kryengritjes, pushteti osman e dënon me burg së bashku me djemtë e tij. Mori pjesë në zgjedhjet osmane të vitit 1912 si kandidat i opozitës, së bashku me Hamdi Novobërdën u votuan më së shumti në kazanë e Gjilanit si kandidat për parlamentin e Vilajetit të Kosovës. Më 1912, ai mori pjesë në aksionin kundër mydyrit të Hogoshtit që ushtronte dhunë ndaj popullsisë vendase. Mori pjesë aktive në Kryengritjen e Përgjithshme Shqiptare më 1912. Për shkak të veprimtarisë kundër osmane, Fadil Pasha, komandat i ushtrisë osmane, urdhëroi djegien e pasurisë dhe internimin e familjes së tij. Mori pjesë në sulmin për çlirimin e Gjilanit dhe kështu më 26 korrik 1912, në Gjilan të parët hynë grupi

kryengritës të udhëhequr nga Sali Gjilani, që udhëhiqte forcat e Moravës së Poshtme. Pas dështimit të bisedimeve shqiptare osmane në Prishtinë, Sali Gjilani në krye të 5000 kryengritësve udhëtoi për të marrë pjesë në Kuvendin e Ferizajt. Kurse sipas planit të hartuar për çlirimin e Shkupit, Sali Gjilani në krye të 2000 kryengritësve do ta sulmonte Shkupin nga drejtimi i Qyperlisë (Velesit) dhe të hynte në Shkup. Pas kthimit nga Shkupi, në fund të shtatorit të vitit 1912, largoi kajmekamin e kazasë së Gjilanit dhe vendosi pushtetin vendor të Këshillit të Gjilanit në krye me Idriz Seferin. Në bazë të planit për mbrojtjen nga pushtimi serb në tetor të vitit 1912, në krye të 3000 kryengritësve Sali Gjilani vendoset në Ristovc për ta mbrojtur kufirin. Nga sulmi i ushtrisë serbe në Lapërdincë të Bujanocit, me çezë për të kërkuar ndihmë nga shpërthimi i gjyles së topit Sali Gjilani vritet.

BAFTIJE SEFERI (1864-1969)

Lindi ne Stubëll te Poshtme me 1864. Ishte gruaja e dyte e Idriz Seferit. Ishte nena e 12 fëmijëve nga to 7 djem e 5 vajza. Ajo qëndronte se bashku me Idriz Seferin ne beteja dhe luftonte përkrah tij. Mori pjese aktivisht ne betejën e Kaçanikut me një grup grash qe i kishte organizuar vete. Pas betejës se Kaçanikut forcat osmane dogjën fshatrat e Karadakut e veçanërisht fshatin Sefer ku popullsia u detyrua te largohet kurse familjen e Idriz Seferit, garuan e tij dhe te afërmit e internuan ne Prishtine. Bahtije Seferi tregoi heroizëm te larte ne kampin e internimit ne Prishtine. Ajo qëndroi heroikisht neper beteja ne malet e Karadakut. Jetoj 105 vjet deri ne vitin 1969.

IBRAHIM POPOCI

Në fillim të shek. XX qeveria osmane e shtyrë edhe nga Fuqitë e Mëdha filloi përpjekjet për zbatimin e reformave në viset e banuara nga shqiptarët. Këto reforma paralajmëronin copëtimin e territoreve shqiptare dhe preknin drejtpërdrejtë edhe territorin e rrethit të Gjilanit. Prandaj, edhe u kundërshtuan nga shqiptarët me forcën e armës. Në këtë vazhde ka mesi i marsit të vitit 1903, filloi një lëvizje e përgjithshme e shqiptarëve jo vetëm kundër zbatimit të reformave por edhe kundër hapjes së konsullatës ruse në Mitrovicë. Vendosija e konsullatës ruse në këtë trevë nga shqiptarët konsiderohej jo vetëm si një vatër e konfliktit por edhe si një vatër prosllave dhe kundër shqiptare. Në ato ditë të marsit të vitit 1903 kryengritësit shqiptar në mënyrë të organizuar rrethuan Mitrovicën por hasën në qëndresë të ashpër të forcave të mëdha ushtarake osmane, e cila përdori edhe artilerinë e rëndë kundër shqiptarëve. Me oficerët osman ishte edhe konsulli rus Shqerbini, i cili udhëzonte artilerinë për gjuajtje precize në masën e kryengritësve shqiptarë. Gjatë kalimit të lumit Sitnica, ushtria osmane nën

udhëzimet e konsullit rus Shqerbini shtiu me armë drejt shqiptarëve ku vranë e u plagosën më shumë se 200 shqiptarë. Ky veprim i konsullit rus në Mitrovicë i irritoi nizamët shqiptarë të ushtrisë osmane e veçmas rreshterin Ibrahim Halit Popovcin nga fshati Sukë afër Llashticës në kazanë e Gjilanit. Duke qenë i vetëdijshëm se shkaktar i gjakderdhjes ishte konsulli, ai shtiu në te dhe e vrau konsullit rus Grigorie Stepanoviq Shqerbin. Kurse sipas dëshmisë së një qytetari nga Mitrovica, konsulli u vra një shqiptar me emrin Ibrahim Halit Popovci nga Gumnishta, po ashtu fshatë nga kazaja e Gjilanit. Pas këtij atentati Ibrahim Popovci edhe pse i plagosur tentoi të kalonte te kryengritësit shqiptarë, por ushtarët osman e zënë dhe më pas dënohet me burg të përjetshëm, por pas një viti vdes nga torturat në burgun e Shkupit. Për vrasjen e konsullit rus në Mitrovicë shkruante edhe gazeta ruse "Moskovski Vjedemosti", me nr. 93, të datës 20 mars 1903, në të cilën thoshte se, se ai (konsulli rus) kishte hyrë në llogoret e ushtrisë osmane dhe jepte instruksione se si të luftohet kundër shqiptarëve. Prandaj shqiptarët qenë gjithmonë të gatshëm të mbrojnë territorin e tyre me armë në dorë nga çdo rrezik që vinte si nga Perandoria Osmane ashtu edhe nga Fuqitë e Mëdha e sidomos nga Rusia që gjithnjë impononte të realizonte planet pansllave në Ballkan.

XHELAL BEU

Xhelal Beu ishte nga fshati Ternoc i Bujanocit, i biri i nje oficeri osman. Ai shërbeu nga 1 marsi i vitit 1910 deri me 1 mars 1911 si kajmekam i kazasë se Gjilanit. Gjate Kryengritjes se vitit 1910. Ketë kryengritje e kishe organizuar Idriz Seferi me bashkëluftëtar e tij. Por, nen garancionin e Xhelal Beut, kajmekam i kazasë se Gjilanit, qe te mos dënohej me vdekje asnjë shqiptarë u dorëzoi shume vërtetime kryengritësve se nuk kanë qenë në luftë. Kajmekami i Gjilanit, Xhelal Beu, iu kishte ndihmuar shume shqiptareve duke i shpëtuar nga arrestimet dhe nga gjykimi i gjyqeve ushtarake. Për ketë konsulli serb, Rakiq, shkruante se kajmekami iu shpërndante atyre vërtetime zyrtare me ane e te çileve vërtetohej se ata nuk kishin marre pjese ne kryengritje.

HAXHI SALIHI – POGRAGJA

Lindi në Pogradjë të Gjilanit. Medresenë e kreu në fshatin Dobërçan, në të cilën përpos diturive fetare mësoi edhe dituritë natyrore. Shërbeu si imam-hoxhë në fshatin Përlepnicë. S.S. Dallohej për bamirësi për ç'gjë vërtetohet se pos tjerash ndërtoi një urë regjionale mbi lumin Morava, e cila edhe sot quhet "Ura e Haxhi Salihut". Ai ndërtoi edhe një çezme dhe hapi një mulli në fshat. Me mjetet e tij bleu një truall në mes të fshatit për të ndërtuar shkollën fillore (mektebin iptidai) si institucion edukativo-arsimor. Është edhe haxhiu i parë i këtij

fshati. Gjatë viteve 1893-1901 punoi si mësues në mектеbin iptidai të Pogradit. Kishte lidhje të vazhdueshme me Idriz Seferin, sekretarin e tij Mulla Sinan Maxheren dhe krerë të tjerë të Lëvizjes Kombëtare në Gjilan dhe viset përreth. Organizoi pjesëmarrjen e vullnetarëve shqiptarë Kryengritjen e vitit 1910, me të cilët mori pjesë në Betejën e Kaçanikut dhe beteja të tjera në Malësinë e Karadakut. Angazhoi luftëtarët e trevës së Pogradit dhe fshatrave përreth në aksionet e armatosura kundër forcave osmane gjatë Kryengritjes së Përgjithshme të vitit 1912. Në vjeshtë të këtij viti, kur Aleanca Ballkanike i shpalli luftë Perandorisë Osmane, duke e ndjerë rrezikun që po i kanosej viseve shqiptare, S.S. mori pjesë në rekrutimin e shqiptarëve për të mbrojtur trevat verilindore kundër depërtimit të armatave të ushtrisë serbe. Përkrah dhe nën komandën e tij u bashkëngjitën dhjetëra vullnetarë nga trevat e Karadakut për t'i rezistuar Armatës së Tretë të ushtrisë serbe në vijën kufitare të Merdarit. Haxhi Salihu ra heroikisht në Sfirçë në luftimet që zgjatën ndërmjet 14 e 18 tetorit të vitit 1912. Leo Freundlich (1875 - 1953) – Publicist social-demokrat evropian, përkrahës i shqiptarëve. Lindi në Bielsko Biala të Polonisë, atë kohë nën sundimin dhe administrimin e Austro-Hungarisë. Në fund të dekadës së parë të shek. XX jetonte e vepronte në Vjenë. U veçua me shkrimet e mbledhura nga korrespondentët e gazetave evropiane me orientim social-demokrat për ngjarjet tragjike në trevat e banuara me shqiptarë gjatë Luftës së Parë Ballkanike më 1912. Në janar të vitit 1913 botoi përmbledhjen e artikujve gazetaresk me titull "Albaniens Golgotha" (Golgota shqiptare). Në këtë botim ai kritikoi kancelaritë e Fuqive të Mëdha dhe gjithë opinionin evropian për mosangazhimin e tyre për të mbrojtur të drejtave humane të shqiptarëve. Ky publikim në formë broshure jep informacione të argumentuara për aktet e dhunës, krimin, mizorive dhe elementeve konkrete gjenocidi, që armatat e ushtrisë dhe organizatat çetnike serbe kryen mbi popullsinë shqiptare të Anamoravës, Shkupit, Kumanovës, Preshevës, Prishtinës, Ferizajt, Prizrenit, Gjakovës, Lumës dhe viseve të tjera shqiptare gjatë tre muajve të fundit të vitit 1912. Publikimi i tij ngjalli debat në organet parlamentare evropiane, të cilat gjykuan dhunën e terrorin e ushtruar ndaj shqiptarëve prej forcave serbe, por që nuk ndërmorën hapa për evitimin e pasojave të tjera. Në vitin 1930, si konsull nderi i Shqipërisë në Vjenë, L.F. ndihmoi marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me Rajhun gjerman. Përkrahu dhe mbrojt çështjen shqiptare në mekanizmat ndërkombëtar si Lidhja e Kombeve në Gjenevë.

NGJARJE

SHPËRNGULJET E SHQIPTARE GJATË GJITHË HISTORISË

Shqiptarët gjinjë gjatë historisë së saj kanë përjetuar shpërngulje dhe dëbime nga vendbanimet e tyre. Kështu në luftën ruso-osmane, Serbia dhe Mali i Zi i shpërngulën rreth 160 mijë shqiptar. Kështu u spastruan etnikisht 640 vendbanime shqiptare të rrethit të Nishit, të Prokupjes, Leskocit, Vranjës, Kurshumlisë etj. Ata u larguan drejt vilajeteve shqiptare e në Turqi kurse shumica e këtyre të shpërngulurve u vendosën në brendi të Vilajet të Kosovës, e pjesa më e madhe e tyre ishte vendosur në kazanë e Gjilanit. Pas pushtimit të Kosovës nga Serbia në tetor të vitit 1912 ajo filloi me shpërnguljen e shqiptarëve drejt Turqisë. Kështu në nëntor të vitit 1912 në Turqi shpërngulen 8866 shqiptare, në dhjetor 1912 në Turqi shpërngulen 11493 shqiptare, gjatë janarit 1913 shpërngulen 12087 shqiptare, gjatë shkurtit shpërngulen 1288 shqiptare, gjatë marsit shpërngulen 7553 shqiptare, gjatë prillit shpërngulen 6725 shqiptare, gjatë majit shpërngulen 12813 shqiptare, gjatë qershorit shpërngulen 9386 shqiptare, gjatë korrikut shpërngulen 21045 shqiptare, gjatë gushtit shpërngulen 29312 shqiptare, gjatë shtatorit shpërngulen 13380 shqiptare, gjatë tetorit janë shpërngulur 14764 shqiptare, gjatë nëntorit shpërngulen 17313 shqiptare, gjatë dhjetorit shpërngulen 15502 shqiptare. Gjatë janarit të vitit 1914 në Turqi shpërngulen 10182 shqiptare, gjatë shkurtit në Turqi shpërngulen 25060 shqiptare, gjatë Marsit në Turqi shpërngulen 12346 shqiptare, Gjithsej, sipas dokumentit, vetëm në Turqi, janë shpërngulur 239807 persona. Në këto shifer theksohet se nuk hyjnë femijet që ishin nën moshën 6 vjeçare. Gjithashtu, theksohet në këto dokumente, se nëpër Kavalle kanë kaluar edhe 4 mijë familje myslimane, por edhe po aq përmes rruges tokësore. Të gjithë këta persona thuhet se i kanë çuar në Turqi me 395 anije evropiane. Sipas të dhënave të "Komitetit të Kosovës", gjatë prillit të vitit 1914 për në Turqi janë shpërngulur: 6520 shqiptare. gjatë majit për në Turqi janë shpërngulur 15414 shqiptare, gjatë qershorit për në Turqi janë shpërngulur 14821 shqiptare, gjatë korrikut për në Turqi janë shpërngulur 26237 shqiptare. Kurse me kthimin e ushtrisë serbe në vitin 1918, shpërngulja me dhunë e shqiptarëve, pa të drejtë kthimi, ka vazhduar deri në luftën e dytë botërore. Në periudhën e Mbretërisë Jugosllave, ushtria, policia dhe çetnikët serbë i kanë torturuar dhe vrarë popullsinë shqiptare. Nga 1918 deri në 1938, ushtria i ka djegur dhe shkatërruar 320 fshatra shqiptare. Sipas disa të dhënave në periudhën e viteve 1919-1940 në përgjithësi janë dëbuar 255.878 myslimanët nga Mbretëria Jugosllave në Turqi, nga të cilat: Shqiptarët : 215.412; Turqet : 27.884; Boshnjakët : 2.582. Krahas shpërnguljes në Turqi ka ekzistuar edhe

një shpërngulja më të madhe në Shqipëri. Sipas disa të dhënave, vetëm në vitin 1921 nga hapësirat jugosllave në Shqipëri janë shpërngulur rreth 40.000 persona. Përveç Turqisë dhe Shqipërisë, shqiptarët kanë ikur edhe në Evropë dhe në Amerikën Veriore, dhe në këtë mënyrë janë krijuar diaspora shqiptare të shumta në ato vende. Qeveria Jugosllave më 1935 ka mbajtur takime me pesë përfaqësuesit nga pesë ministrinë dhe Shtabi gjeneral e përpiluan projektin "mbi dëbimin e elementit joslav nga Serbia Jugore". Turqia në fillim të 1936 shprehu gatishmërinë për arritjen e një marrëveshjeje formale me Jugosllavinë për transferimin e 200.000 banorë që janë të ngjashëm me mentalitetin turk, ata në Turqi "do të asimiloheshin lehtë". Duke kritikuar politikën afatgjate të dëbimit të shqiptarëve, akademiku dhe politikani serb Vasa Çubrilloviç sugjeroi mënyra për zgjedhjen e "problemit shqiptarë" me pastrime etnike në masë të madhe të Kosovës nga Shqiptarët. Çubrilloviçi më 1937 e bëri projektin e Dëbimi i Shqiptarëve për qeverinë e Stojadinoviçit, që duhej ta ndiqte qeverinë shtetërore. Qeveria e Beogradit ka organizuar formacione paramilitare çetnikët që janë udhëhequr nga Kosta Peçanac, Miliç Krstić, Jovan Babunski, Vasilije Trbic dhe të tjerë, që i kanë organizuar ekspedita dënueses duke kryer dhunë, terror dhe plaçkitje e organizuar. Aktivitetet shtetërore për dëbimin e shqiptarëve kulminoi me nënshkrimin e konventës Jugosllave-turke. Nga 9 deri 11 korrik 1938 në Stamboll u mbaj një varg i takimeve në përgatitjen e marrëveshjes Jugosllavi-Turqi mbi dëbimin e shqiptarëve. Anët kanë rënë dakord që në afat prej gjashtë viteve të zhvendosen 40.000 familje shqiptare nga Kosova, Maqedonia dhe Mali i zi në zona të zbraza Anadollit. Artikulli 2 i konventës ka paraparë ekspatrimin në tërësi të shqiptarëve nga shumë qytete si Prizren, Ferizaj, Prishtinë, Kaçanik, Gjilan, Preshevë, Pejë, Istog, Mitrovicë, Gjakovë, Vushtrri, Drenicë dhe të tjerë. Gjatë pesë viteve të para, nga 1939 deri në 1944, ishte e paraparë që në Turqi të vendosen 25.000 familje shqiptare, dhe në dinamikën në vijim. 4000 familje në 1939, 6000 familje në 1940, 7000 familje në 1941 dhe 1942 si dhe 8000 familje në 1943 dhe 1944. Pas Luftës së Dytë Botërore e deri nga gjysma e viteve 60-të vlerësohet se nga Kosova dhe trojet e tjera etnike shqiptare u shpërngulën për në Turqi rreth 250.000 vetë. Pas vitit 1981, kur e tërë Jugosllavia u ngrit kundër shqiptarëve dhe kërkesave të tyre të drejta për barazi dhe pavarësi, që u shtruan në demonstratat masive të shqiptarëve, pasoi një valë e konsiderueshme e ikjes së tyre, kryesisht të rinjve nga represioni i shtetit policor dhe partiak komunist. APJ-ja, që nga viti 1981 kishte montuar shumë procese politike kundër ushtarëve shqiptarë, me ç'rast kishte burgosur dhe vrarë shumë shqiptarë, të cilët i kthente në arkivole hermetikisht të mbyllura, duke mos u ofruar dëshmi as familjeve e as opinionit për vrasjen e tyre. Pas shpërthimit të

luftës në Jugosllavi në vitin 1991, shumë shtete perëndimore e kushtëzonin hyrjen përmes vizave. Mirëpo, shumë shqiptarë, me familje dhe si individë, vazhdonin të shpërnguleshin në shtetet e tjera evropiane ku ende mundësohej hyrja dhe përmes tyre ilegalisht, hynin në vendet që kishin vënë viza. Shumë të rinj shqiptarë të ndjekur nga autoritetet ushtarake e policore serbe, u strehuan te të afërmit e tyre në Turqi, Shqipëri, Maqedoni dhe në vende të tjera. Më brengosëse u bë atëherë dukuria e shkuarjes së shqiptarëve, sidomos të rinjve, përtej oqeanit: në SHBA, Kanada dhe Australi, meqenëse ekzistonte frika objektive se emigrimi i përkohshëm në këto vende, do të shndërrohej në shkuarje pa kthim. Vala e re e terrorit me pretekst të kërkimit të armëve ishte faktori tjetër në funksion të drejtpërdrejtë të shpërnguljes së shqiptarëve. Në këtë funksion ishte edhe përjashtimi i punëtorëve shqiptarë nga puna, shkatërrimi i bazës ekonomike të Kosovës përmes plaçkitjes së fondeve dhe teknologjisë, taksat dhe dënimi i afaristëve shqiptarë, ndjekja e vazhdueshme e rekrutëve shqiptarë, si dhe okupimi i hapësirave shkollore dhe universitare për nxënësit dhe studentët shqiptarë dhe pengimi i funksionimit të arsimit shqiptar të të gjitha niveleve. Deri në fillimin e luftërave në Jugosllavi dhe përgjithësisht deri në sulmet e Aleancës Veriatlantike mbi caqet serbe (1999), sipas disa vlerësimeve, më se 400.000 shqiptarë nga trojet e tyre të Jugosllavisë, kryesisht nga Kosova, punonin dhe me status të ndryshëm qëndronin në Gjermani (rreth 170.000 ose 45 për qind), në Zvicër (rreth 130.000 ose 30 për qind), ndërsa pjesa tjetër prej 25 për qind, kishte shkuar në vende të tjera: në Suedi (rreth 35.000, kryesisht si azilantë), Austri (rreth 23.000), Belgjikë (rreth 8.000), Francë (rreth 5.000), Danimarkë (rreth 5.000), Itali (rreth 4.000), Norvegji (rreth 4.000), Holandë (rreth 2000), Angli (rreth 2.500), Finlandë (rreth 600), Luksemburg (rreth 200), pastaj në Kroaci (rreth 40.000), Slloveni (rreth 15.000), Shqipëri (rreth 25.000), ndërsa në Beh, deri në vitin 1992, vlerësohej se kishte rreth 30.000 shqiptarë me status të ndryshëm qëndrimi. Në dhjetëvjeçarët e fundit të shek XX, për arsye tashmë të njohura ekonomike dhe politike, shumë shqiptarë emigruan në SHBA, të cilët iu bashkuan diasporës së madhe të hershme dhe arritën madje deri në Alaskë, pastaj në Kanada, Australi e Zelandë të Re.

ÇLIRIMI I GJILANIT (MË 1843, 21 JANAR 1881, 26 KORRIK 1912, 1915, 1945, 1999)

Çlirimi i Gjilanit u bë disa herë gjatë historisë kështu që më 1843 Gjilani u çlirua nga organizimi i kryengritjes së Dervish Carës në vitin 1843, pastaj më 21 janar 1881 ushtria vullnetare e Lidhjes së Prizrenit çliroi Gjilanin nga forcat osmane, po ashtu më 26 korrik

1912 forcat kryengritse nën udhëheqjen e Idriz Seferit kanë vendosur pushtetin vendor pasi u çlirua Gjilani po ashtu nga forcat osmane, kurse më 1915 Gjilani çlirohet duke larguar pushtuesin serb dhe bie nën Austro-Hungarinë dhe Bullgarië kurse përsëri më 1918 pushtohet nga serbët dhe hyjra e forcave naziste e fashiste në Gjilan në prill 1941 qytetaret gjilanas çlirohen nga pushteti i egër serbë. Kurse edhe më 1945 Gjilani çlirohet dhe largohen forcat naziste-fashiste dhe pushtohet nga forcat komuniste jugosllave. Më 3 qershor 1999, Millosheviçi pranoi kushtet e një plani ndërkombëtar paqeje për të ndaluar luftimet. Më 10 qershor Komiteti i Atlantikut të Veriut ratifikoi marrëveshjen dhe pezulloi operacionet ajërore. Më 12 qershor, pasi Millosheviçi pranoi kushtet, misioni i drejtuar nga NATO Kosovo Force (KFOR) filloi të futej në Kosovë. Arritja e forcave të NATO-s, më 11 qershor në afërsi të pozicioneve të UÇK-së në Vrellë, u prit me gëzim dhe u përshëndet me krisma pushkësh. Gjatë ditës së 14 qershorit forcat serbe tërhiqeshin në magjistralen Prishtinë –Gjilan drejt Bujanocit. Për hyrjen në Gjilan, Shtabi i Zonës hartoi planin operativ me urdhër të komandant Rexhës. Pas disa njësive që, komandanti kishte dërguar në qytet dha urdhër për lëvizjen edhe të Shtabit. Sipas planit operativ, më 15 qershor 1999, nga fshati Kishnapole komandant Rexha me njësitin e vet triumfalisht, hyri në qytetin e Gjilanit.

LIDHJA SHQIPTARE E PRIZRENIT (1878 – 1881)

Me humbjen e luftës, Perandoria Osmane u detyrua të nënshkruaj Traktatin e Paqes së Shën Stefanit (3 mars 1878), sipas diktatit të Perandorisë Ruse. Si pasojë e këtij Traktati do të ndryshoheshin kufijtë e Ballkanit e sidomos do të copëtoheshin tokat shqiptare. Përveç shqiptarëve, me vendimet e këtij Traktati nuk u pajtuan Anglia dhe Austro-Hungaria dhe në përgjithësi shtetet perëndimore. Për ta penguar ndikimin rus, u thirr një Kongres i ri për shqyrtimin e Traktatit të Shën Stefanit ndërmjet Fuqive të Mëdha, që u vendos të mbahej në Berlin nga 13 qershori i vitit 1878, ndërsa shqiptarët për tu paraqitur sa më mirë në këtë Kongres thirrën Kuvendin Gjithëkombëtarë më 10 qershor 1878 në Prizren. Në të morën pjesë rreth 300 përfaqësues nga katër vilajetet shqiptare, përfshirë edhe Mehmet Reshitin dhe Salihun nga kazaja e Gjilanit. Në Kuvendin e Lidhjes së Prizrenit u vendos që të formohen edhe tre komisione si Komisioni për Punë të Jashtme, të Brendshme dhe i Financave, ku këtë të fundit e udhëhiqte Sylejman Vokshi, kurse ndihmës i tij ishte Shefik Bej Gillani. Kongresi i Prizrenit nga punimet e tij nxori vendime që kundërshtonin çdo akt ndërkombëtar, i cili copëtonte viset shqiptare. Këto vendime i kishin firmosur edhe gjilanasit. Gjatë gjithë kohës sa i zhvilloi punimet Kongresit i Berlinit, shqiptarët nuk u ndalën së protestuari kundër

padrejtësive që bëheshin nga pushtuesit e tokave të tyre. Kështu me një protestë të datës 26 qershor 1878 që ia dërguan Fuqive të Mëdha në Berlin kundërshtuan vrasjet, grabitjet, çnderimet që kryenin ushtria ruse e bullgare në tokat e pushtuara të Vilajetit të Kosovës e Vilajetit të Manastirit. Me këtë protestë shqiptarët kërkuan nga Kongresi i Berlinit që mos të cenohet integriteti i tokave shqiptare. Në mesin e të nënshkruarve të kësaj proteste ishin edhe përfaqësuesit nga Gjilani si Hyseni, Kadriu dhe Abdurrahmani. Megjithatë, Kongresi i Berlinit mori vendime në dëm të tokave shqiptare. Kështu, vendimin për rregullimin e kufirit të ri ndërmjet Serbisë dhe Perandorisë Osmane ishte caktuar me protokollin nr. XV, më 8 korrik 1878 që i ndau tokat shqiptare, ku prekte indirekt edhe kuzanë e Gjilanit. Kufiri i ri në tokat shqiptare që u paraqit në paragrafin XXXVI të vendimeve të këtij Kongresi niste nga kodrina jugore e Kopaonikut, kreshtat e Maricës dhe Merdar Pllaninës, që formon vijën ndarëse të lumenjve Ibër dhe Sitnica në njërën anë dhe Toplicës në anën tjetër, duke ia lënë Perandorisë Osmane Përpellacin. Në pjesën jugore vazhdon kufiri drejt ujërave të Bërvenikut dhe Medvegjës, ku Medvegja i mbetet Principatës Serbe, pastaj kufiri kalon në Gollak ndërmjet lumenjve Kriva Reka dhe Polanicës, Veternicën dhe Moravën deri në kodrinën e Polanicës. Kufiri shkon edhe më tutje drejt kodrinave të malit Karpina deri në mëngët e Koinskës e të Moravës, ku e kalon këtë lum pran Neradovcit për t'iu bashkuar malit Shën Ilisë mbi Tërgovishte dhe vazhdon pastaj me kufirin me Bullgarinë. Pas përfundimit të punimeve të Kongresit të Berlinit (13 korrik 1878), Serbia, në gusht të vitit 1878, filloi ta zbatoj fazën e dytë e shpërnguljes së shqiptarëve nga sanxhaku i Nishit. Ndihej të madhe për vendosjen e muhaxhirëve kishte dhënë edhe Lidhja Shqiptare e Prizrenit, ku përmes përfaqësuesve të saj, si Hysen Agë Gjilani, ishin strehuar rreth 1.700 familje në Gjilan dhe viset përreth. Për të kundërshtuar vendimet e Kongresit të Berlinit, që copëtoi rënd tokat shqiptare, u organizuan shumë protesta e u hartuan shumë promemorie, të cilat iu drejtuan këtij Kongresi, Fuqive të Mëdha dhe Perandorisë Osmane. Në anën tjetër filloi mbrojtja nga rreziku i copëtimit të tokave shqiptare. Kështu, me njoftimin e 12 gusht 1878, G. v. Chiari që jep për kontin Andrassy mbi lëvizjen e trupave osmane, njofton se në Gjilan ishin mbledhur në stacionet e Gjilanit e Ferizajt prej 20 deri në 200 vetave që ishin të armatosur. Ata grumbulloheshin në Prishtinë, ku do të vepronin kundër forcave serbe. Pas vendosjes së kufijve të rinj në gusht të vitit 1878, në kuzanë e Gjilanit arriti Hysni Pasha (gjeneral kolonel) dhe njoftoi popullsinë e kësaj ane për vijën e re kufitare ndërmjet Serbisë dhe Perandorisë Osmane. Në rrafshin e Moravës dhe Vardarit vepronte edhe çeta e Idriz Seferit. Çeta e tij përbëhej nga mëse 600 luftëtarëve, ku përveç tij udhëhiqej edhe nga Bislim Hogoshti,

Kurtesh Pozherani, Hajdar Bislim Caka, Arif Hyseni etj. Aktivitetet luftarake të tyre arrinin deri në Vrajë e Leskoc kundër forcave serbe. Serbia nuk ishte e kënaqur me territoret e pushtuara dhe më 10 nëntor 1878, gjatë ndërtimit të piramidave në kufirin e ri, serbët kaluan kufirin dhe e pushtuan përkohësisht Ranillukun dhe Klistinën (Kqiq) në kazanë e Gjilanit, ku plaçkitën dhe vranë gra, pleq dhe fëmijë. Me ndërhyrjen e ushtrisë osmane dhe vullnetarëve shqiptarë, ushtria serbe u detyrua të largohet nga këto territore. Idriz Seferi si drejtues çete mbante kontakte me degën e Lidhjes së Prizrenit në Shkup, e sidomos me Abdyl Shkupin. Haptas ai kishte deklaruar se nga Kaçaniku e deri në Bujanoc duke përfshirë edhe kazanë e Gjilanit, ishte në krye të Lëvizjes Kombëtare në këto anë dhe zbatonte vendimet e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit. Çeta e tij i shkaktonte humbje të konsiderueshme armikut në viset shqiptare të pushtuara nga serbët. Përveç kontakteve që kishte me degën e Lidhjes në Shkup, Idriz Seferi bashkërendonte veprimet luftarake me trimat tjerë nga Kumanova, Gjilani, Llapi, Gollaku e deri në Vrajë dhe Leskoc. Për të bashkërenduar sa më mirë forcat ushtarake të Lidhjes së Prizrenit në mbrojtje të tokave shqiptare në kazanë e Gjilanit, për të biseduar me Idriz Seferin në Karadak arritën Sylejman Vokshi, Shuajp Spahiu dhe Abdyl Shkupi. Në bisedë ndërmjet tyre u vendos që Idriz Seferi të operonte në këto treva në mbrojtje për t'i mbrojtur ato nga sulmet serbe. Të gjitha veprimet që ishin kryer nga kjo çetë vinin në bazë të urdhrave nga qendra e Lidhjes në Prizren. Gjatë vitit 1879 dhe në janar të vitit 1880 në mbrojtje të Plavës dhe Gucisë që synonte t'i pushtonte Mali i Zi, shkuan rreth 100 luftëtarë nga kazaja e Gjilanit, e në mesin e tyre ishin Bislim Hogoshti, Agush Azemi e Kurt Ternava. Në anën tjetër më 2 gusht 1880, në Prizren ishte mbajtur mbledhja e Komitetit Qendror të Lidhjes ku merrte pjesë Ali aga, përfaqësues nga kazaja e Gjilanit. Aty u vendos që të pushohen të gjitha gjykatat osmane dhe të ngritën gjyqet e Lidhjes. Kurse, më 10 gusht 1880 Porta e Lartë njoftohet se shqiptarët po formojnë degët e Lidhjes së Prizrenit nëpër qytetet e tyre, kështu që në këtë kohë ishte formuar një degë në kazanë e Gjilanit që udhëhiqej nga Osman beu, Ali aga etj. Në përpjekje të forcimit të Lidhjes, në dhjetor të vitit 1880 nga mbledhja e jashtëzakonshme e kryesisë së Lidhjes së Prizrenit u formua edhe Qeveria e Përkohshme nën udhëheqjen e Ymer Prizrenit. Në fillim të vitit 1881 pasoi çlirimi i shumë qyteteve në Vilajetin e Kosovës. Nga ushtria e Lidhjes të komanduar nga Sylejman Vokshi, i ndihmuar edhe nga Idriz Seferi me bashkëluftëtarët e tij, më 4 janar 1881 u çlirua Shkupi. Kurse studiuesi Ramiz Abdyl thotë se Shkupi ishte çliruar më 4 dhjetor 1880. Në Këshillin Udhëheqës të këtij qyteti emërohet edhe Idriz Seferi. Pas çlirimit të Shkupit dhe qyteteve tjera ushtarët e Lidhjes më 21 janar të vitit 1881, iu drejtuan Gjilanit për ta çliruar. Kështu,

Ali Ibër Neza dhe Mic Sokoli me 1000 luftëtarë e sulmuan Gjilanin. Kurse, Idriz Seferi sulmoi garnizonin ushtarak osman që vinte nga Ferizaj dhe pas një nate luftimesh arritën ta çlirojnë Gjilanin. Pas çlirimit të Gjilanit, forcat e Lidhjes të komanduara nga Sylejman Vokshi u drejtuan drejt Pazarit të Ri, ku me vullnetarët e kazasë së Gjilanit ishte edhe Idriz Seferi. Malet Rogozine ishin të pakalueshme për shkak të borës së madhe dhe Idriz Seferi u kthye në Karadak. Pas çlirimit të Gjilanit, Lidhja i zëvendësoi nëpunësit osmanë me ata shqiptarë. Kurse komitetet lokale u shndërruan në organe të pushtetit. Nga frika e veprimtarisë së Lidhjes Shqiptare të Prizrenit, Perandoria Osmane u detyra të harmonizoj marrëdhëniet me Greqinë dhe nisi ekspeditën drejtë Vilajetit të Kosovës dhe viseve të tjera që ta shtypte Lidhjen. Në krye të 30 batalioneve osmane ishte vënë Dervish Pasha, i cili u ndihmua nga më se gjashtë gjeneral të tjerë osmanë. Më 23 mars 1881, Ibrahim Pasha arreston të gjithë anëtarët e Lidhjes në Shkup. Kurse, më 7 prill 1881, në Shkup arrin Dervish Pasha, ku vendosi shtabin e tij dhe shpalli shtetrrëhimin. Me marrjen e lajmit se Shkupi u ripushtua nga osmanët, Qeveria e Përkohshme krijoi shtabin mbrojtës të udhëhequr nga Sylejman Vokshi. Për mobilizimin e ulët të popullsisë shqiptare në mbrojtje të tokave të tyre ndikuan përveç mjeteve financiare edhe një pjesë e feudalëve shqiptarë, të cilët bëheshin se gjoja po e përkrahin Lidhjen, e nga ana tjetër sabotonin punën e saj. Në mbrojtje të Lidhjes doli Idriz Seferi me luftëtarët nga kazaja e Gjilanit, të cilët marshuan drejt Kaçanikut për të penguar ripushtimin e Vilajetit të Kosovës. Gjilanasit e sulmuan ushtrinë e Dervish Pashës në Grykë të Kaçanikut dhe aty i shkaktuan dëme të konsiderueshme. Me gjithë luftimet e zhvilluara, ushtria osmane arrin në Ferizaj më 7 prill 1881. Për ta ripushtuar kazanë e Gjilanit Dervish Pasha urdhëroi që disa taborre ushtarësh të nisen drejt saj. Kurse, konsulli anglez Blant shkruante në raportin e tij se kazaja e Gjilanit ishte qetësuar nga trazirat dhe më 11 prill 1881 ishte rivendosur administrata osmane. Rezistenca e fundit e ushtrisë së Lidhjes kundër forcave osmane në të cilën mori pjesë edhe Idriz Seferi me bashkëluftëtarët e tij u bë në Slivovë, Shtime, Caralevë, Dule dhe Suharekë. Më 23 prill 1881, Dervish Pasha me 24 batalione hyn në Prizren dhe pushtoi organet e Lidhjes. Nga e gjithë kjo që u tha më sipër, mund të përfundojmë se Gjilani dhe rrethina e tij ishte aktiv në çdo akt dhe veprim të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit në vitet 1878-1881.

KLUBI KOMBËTAR I GJILANIT (1908)

Anëtarët e Lëvizjes Kombëtare filluan punën e tyre duke shfrytëzuar lirinë e proklamuar me Kushtetutë dhe nisën të formonin klube kombëtare kulturore shqiptare. Edhe pse ishte gjendja

e vështirë politike, çarçet patriotike shqiptare filluan shfrytëzimin e pushtetit liberal të regjimit kushtetues për zhvillimin e aktiviteteve kombëtare, si hap i parë ishte hapja e klubeve dhe shkollave në gjuhën shqipe në tërë Shqipërinë duke përfshirë edhe Gjilanin, në të cilin ishte përqendruar veprimtaria kulturore dhe politike e patriotëve shqiptare. Menjëherë pas Revolucionit u ngritën klubet kombëtare që u shtrinë në qytetet e në fshatrat e gjithë Shqipërisë. Pastaj, filloi ngritja e shkollave shqipe, dhënia e mësimit të gjuhës amtare në shkollat e huaja dhe u bënë përpjekje për miratimin e një alfabeti të vetëm për gjuhën shqipe. Klubi i parë i themeluar ishte, klubi "Bashkimi" i Manastirit i cili themelohet me 31 korrik 1908, kurse gjatë muajve gusht-shtator 1908 u hapen shumë klube të reja po thuajse në tërë Shqipërinë duke përfshirë edhe Gjilanin. Në klube merrnin pjesë intelektualë, nëpunës të aparatit shtetëror e mësues shkollash, përfaqësues të borgjezisë qytetare, të prodhuesve e të tregtarëve të vegjël të qytetit e të fshatit, të bejlerëve çifligarë, të oficerëve, si edhe të parisë të lidhur me sunduesin osmanë. Kazaja e Gjilanit nuk mbeti mbrapa nga qytetet tjera të Shqipërisë, sa i përket formimit të klubeve dhe iniciativave për hapjen e shkollave shqipe. Kjo lëvizje që shpërtheu menjëherë pas ngadhënjimit të Revolucionit u zhvillua në tre drejtime kryesore: në përhapjen e mësimit shqip në forma individuale, në çeljen e shkollave të reja shqipe dhe në përpjekjet për futjen e gjuhës shqipe në shkollat e huaja të Shqipërisë. Patriotët shqiptarë u përpoqën në fillim të krijojnë një shkollë kombëtare shqipe të pavarur dhe laike. Edhe pse nuk kishte një program të organizuar e unik. Në këto shkolla mësohej gjuhë amtare e letërsi shqipe, aritmetikë, histori e Shqipërisë, gjeografi, mirëvetija, gjëtrëgonja dhe fetërgonjë. Përveç, këtyre lëndëve mësonin bukurshkrimin, këngën, vizatime, gjuhë të huaj kryesisht turqisht e frëngjisht. Në këtë drejtim kontribut të madh kishte dhënë Hasan Prishtina e Nexhip Draga. Në vjeshtë të vitit 1908, me iniciativën e Hasan Prishtinës ishte mbajtur një takim me krerët e Lëvizjes Kombëtare të kazasë së Gjilanit si: Idriz Seferi, Islam Pira, Sali Kupina etj. Në këtë takim ishte marrë vendim që në kazanë e Gjilanit të hapen tri shkolla në gjuhën shqipe e njëra prej tyre të hapej në Pozheran, kurse dy të tjetra në Gjilan dhe shkolla në gjuhën shqipe që ekzistonte më herët në Stubëll të Epërme, e cila daton nga vitit 1846 dhe e legalizuar në vitin 1905 të financuar nga qeveria austro-hungareze dhe mësues i kësaj shkolle ishte Dom Mikel Tarabulluzi nga Prizreni, i cili ishte edhe prift i famullisë së Stubllës.. Në këtë takim kishin biseduar, se si t'i hapin shkollat në gjuhën shqipe. Islam Pira ishte deklaruar se do ta ndërtonte shkollën në Pozheran, kurse, Sali Kupina e të tjerë pranuan ta ndihmojnë në ndërtimin e saj. Këto shkolla punonin me alfabet latin.

KONGRESI KOMBËTAR I ELBASANIT (2-8 SHTATOR 1909) DHE SHKOLLA NORMALE E ELBASANIT (1 DHJETOR 1909)

Pas zgjedhjes së alfabetit shqip u vendos që të plotësohen kërkesa për mësuës. Kështu në Kongresin e Elbasanit që u mbajt më 2 deri më 8 shtator 1909, u vendos të hapet shkolla normale e Elbasanit, e cila filloi punën më 1 dhjetor 1909. Në vitin e parë shkollor në normale morën pjesë nxënës nga të gjitha anët e atdheut dhe në mesin e 50 nxënësve të Kosovës, 5 nxënës ishin nga kazaja e Gjilanit. Këta nxënës ishin Shyqyri Malushi, Qamil Zeneli, Nevzad Sherifi, Adem dhe Beqir Sadiku. Nxënësit nga Kosova e së bashku me ta edhe nga Gjilani shkuan në Elbasan me financimin e Hasan Prishtinës.

BETEJA E KAÇANIKUT (30 PRILL 1910)

Betejë ndërmjet kryengritësve shqiptarë të krahinave juglindore të Vilajetit të Kosovës nën udhëheqjen e Idriz Seferit dhe forcave të ushtrisë osmane të komanduara nga gjenerali Shefqet Turgut pasha. Forcat osmane prej repartesh të zgjedhura lëvizëse të Stambollit, Anadollit dhe Edrenesë, përbëheshin prej 16.000 këmbësorësh, 600 kalorësish, 64 topash, 120 mitralozash etj. Ato filluan në Kosovë operacionin për shtypjen e kryengritjes shqiptare. Forcat kryengritëse në Grykën e Kaçanikut përbëheshin nga rreth 3.000 luftëtarësh të armatosur lehtë. Beteja nisi më 30 prill. Forcat osmane të nisura nga Ferizaj dhe Shkupi iu afruan pozicioneve mbrojtëse të kryengritësve dhe u hodhën në sulm. Për dy-tri ditë rresht u zhvilluan luftime të ashpra, që, në shumë pika, kaluan në përleshje trup me trup. Më pas kryengritësit u detyruan të lënë Grykën e Kaçanikut, por e vazhduan qëndresën në grupe të vogla në malësinë e Karadakut, në Moravë, në Preshevë, në Gjilan, në Bujanoc etj., deri më 6 maj 1910.

LUFTËRAT BALLKANIKE DHE LUFTA E PARË BOTËRORE (1912 – 1918)

PERSONALITETE

LEO FREUNDLICH (1875 - 1953)

Leo Freundlich (1875 - 1953) – Publicist social-demokrat evropian, përkrahës i shqiptarëve. Lindi në Bielsko Biala të Polonisë, atë kohë nën sundimin dhe administrimin e Austro-Hungarisë. Në fund të dekadës së parë të shek. XX jetonte e vepronte në Vjenë. U veçua me

shkrimet e mbledhura nga korrespondentët e gazetave evropiane me orientim social-demokrat për ngjarjet tragjike në trevat e banuara me shqiptarë gjatë Luftës së Parë Ballkanike më 1912. Në janar të vitit 1913 botoi përmbledhjen e artikujve gazetaresk me titull "Albaniens Golgotha" (Golgota shqiptare). Në këtë botim ai kritikoi kancelaritë e Fuqive të Mëdha dhe gjithë opinionin evropian për mosangazhimin e tyre për të mbrojtur të drejtave humane të shqiptarëve. Ky publikim në formë broshure jep informacione të argumentuara për aktet e dhunës, krimit, mizorive dhe elementeve konkrete gjenocidi, që armatat e ushtrisë dhe organizatat çetnike serbe kryen mbi popullsinë shqiptare të Anamoravës, Shkupit, Kumanovës, Preshevës, Prishtinës, Ferizajt, Prizrenit, Gjakovës, Lumës dhe viseve të tjera shqiptare gjatë tre muajve të fundit të vitit 1912. Publikimi i tij ngjalli debat në organet parlamentare evropiane, të cilat gjykuan dhunën e terrorin e ushtruar ndaj shqiptarëve prej forcave serbe, por që nuk ndërmorën hapa për evitimin e pasojave të tjera. Në vitin 1930, si konsull nderi i Shqipërisë në Vjenë, L.F. ndihmoi marrëdhëniet tregtare të Shqipërisë me Rajhun gjerman. Përkrahu dhe mbrojtë çështjen shqiptare në mekanizmat ndërkombëtar si Lidhja e Kombeve në Gjenevë.

NGJARJE

PUSHTIMI SERB I VITIT 1912 DHE AI BULLGAR I VITIT 1915

Në tetor të vitit 1912 ushtria serbe filloi pushtimin e Kosovës. Vullnetarët e Gjilanit nën udhëheqjen e Idriz Seferit i bënë rezistencë pushtuesit të ri, Serbisë. Forcat e udhëhequra nga Idriz Seferi pas luftimesh të ashpra, sidomos në Sfirçë të Gjilanit dhe në Novosellë të Bujanocit, u tërhoqën pjesërisht në drejtim të Kumanovës dhe pjesërisht në drejtim të Gjilanit. Luftime me forcat serbe ka pasur edhe në Tërmoc e Rahovicë të Preshevës e sidomos në Grykën e Konçulit, të cilën serbët arritën ta fusin në dorë më 21 tetor 1912 duke siguruar depërtimin në drejtim të Gjilanit. Më 22 tetor ushtria serbe pasi që kishte thyer kufirin në Merdar kishte depërtuar deri në Prishtinë. Ndërsa në Gjilan, më 24 tetor 1912, forcat serbe hyjnë pa hasur në rezistencë njësitë e ushtrisë së rregullt serbe që kishin ardhur nga Prishtina. Në këtë mënyrë, për Gjilanin sikur edhe në tërë Kosovën, përfundon një sundim shekullor osman dhe fillon një sundim tjetër i huaj, dhe më i egër. Gjatë Luftës së Parë botërore 1914-1918, pjesa më e madhe e Kosovës u pushtua nga forcat ushtarake austro-hungareze, kurse Gjilani me rrethinë u zaptua nga forcat ushtarake bullgare. Gjilani u pushtua nga forcat ushtarake bullgare më 21 tetor 1914 si edhe Kumanova e Shkupi, me ç'rast ushtrisë serbe iu ndërpre lidhja me jugun, me trupat aleate greke. Kjo do ta detyrojë ushtrinë serbe që të fillojë

largimin e saj drejt Shqipërisë për t'i shpëtuar asgjësimit. Pushtuesit bullgarë shtypën me forcë popullsinë në zonën që e kishin okupuar dhe, njëherazi, shfrytëzuan begatitë e këtyre viseve. Reprezaljet dhe krimet sidomos mbi shqiptarët ishin të përditshme. Banorët e kësaj ane plaçkiteshin nga ushtria dhe administrata bullgare, gjobitjet ishin dukuri e përditshme. Më rëndë e goditi popullsinë rekuizimi i pasurive nga pushtuesit. Banorët ,veçançrisht të rinjtë e kësaj ane mobilizoheshin me dhunë dhe dërgoheshin në ndërtimin e hekurudhës Veles-Prilep dhe Gostivar-Kërçovë, në ndërtimin e rrugëve të ndryshme për nevoja ushtarake të Bullgarisë si dhe dërgoheshin në frontet e luftës prej nga shumica e tyre nuk u kthyen kurrë. Në fillim të tetorit të vitit 1918, në prag të përfundimit të Luftës së Parë Botërore, forcat ushtarake franceze dhe serbe, të cilat kishin shpërthyer Frontin e Selanikut, me shpejtësi do të depërtojnë nga Maqedonia edhe në Kosovë. Të parat në Gjilan e rrethinë hynë forcat franceze e pas tyre ato serbe. Forcat franceze vendosën pushtetin civil në Kosovë. Po kështu vepruan edhe në Gjilan, duke vënë nënprefektin, postëkomandat ushtarake dhe administratën e përkohshme policore. Pas largimit të forcave franceze më 1918, Gjilani mbetet nën pushtimin serb.

PERIUDHA NDËRMJET DY LUFTËRAVE BOTËRORE (1919 – 1939)

PERSONALITETE

LOTË VAKU

Lindi më 1895, në Poliçkë (Kamenicë) dhe vinte nga një familje atdhetare. Familja e Lotë Vaku dhunshëm u shpërngulën nga Sanxhaku i Nishit gjatë vitit 1877/1878. Deri sa Lotë Vaku kryente shërbimin ushtarak në ushtrinë e Perandorisë Osmane tokat shqiptare filluan të pushtoheshin nga ushtria serbe. Pas shpërthimit të Luftës së Parë Ballkanike u largua nga ushtria osmane dhe u kthye në vendlindje ku gjeti të vrarë vëllanë e tij Dulhaun dhe të shkatërruar tërë lagjen e tij nga forcat serbe. Nga ky moment Lotë Vaku vendosi të luftojë kundër Serbisë dhe regjimit të tij. Deri më 1924 Lotë Vaku bëri jetë kaçake dhe luftoi për të ndalur mizoritë serbe që i bënte ushtria serbe në këto anë. Gjatë Luftës së Parë Botërore, në vjeshtë të vitit 1916, Lotë Vaku së bashku me kushërinjtë e tij vendosën të vrasin vojvodët serb si: Koica Maroca, Rade Miladini të Kolloleqit, Gjorgje Lipovica dhe Stojmenin e Huruglicës për tu hakmarrë për vëllanë e vrarë, për vrasjen e shumë shqiptarë tjerë dhe për

grabitjet e vajzave shqiptare. Fillimisht vranë vojvodën Koica Papoviqin-Marovcën, që kishte grabitur Ajshen, Hamiden e shumë vajza tjera të pafajshme shqiptare. Pastaj vranë edhe Stojmenin e Huruglicës dhe shumë çetnik të tjerë. Lotë Vaku deri në vitin 1924, jetoi në ilegalitet të thellë. Në vitin 1924 deri më 1941 së bashkë me familjen e tij jetoi në Shqipëri. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore (më 1941) dhe me ardhjen e pushtuesve të rinj edhe në Moravë, Lotë Vaku thehet në vendlindje dhe vazhdon aktivitetin politik e luftarak. Lotë Vaku mori pjesë në taborin e Mulla Idriz Gjilanit. Kurse në Kuvendin e Zarbicës që u mbajt në vitin 1944, u zgjodh anëtar i Shtabit Drejtues të Rezistencës Shqiptare në Kosovën Lindore. Mori pjesë edhe në luftën për çlirimin e Gjilanit. Pas dështimit të luftës së Gjilanit Lotë Vaku me bashkëluftëtarë kaluan prapë në ilegalitet. Në vitin 1947, Lotë Vaku vullnetarisht u paraqit dhe u dorëzua në organeve komunale komuniste. Lotë Vaku dënohet me 12 vjet burg të rëndë por i mbajti vetëm 9 vjet burg. Në gusht të vitit 1962, Lotë Vaku vdes në shtëpinë e tij në Velekincë të Gjilanit.

NGJARJE

KOMITETI "MBROJTJA KOMBËTARE E KOSOVËS" (1918-1924)

Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës" u themelua në ilegalitet të plotë më 1 maj 1918 dhe më 7 nëntor 1918 u vendos përfundimisht në Shkodër nga figurat të shquara atdhetare si: Bajram Curri, Hoxha Kadri Prishtina, Sali Nivica, Hasan Prishtina, Bedri Pejani, Qamil Bala, Sali Rama, Hafiz Ismet Dibra etj. Qëllimi parësor i kësaj organizate politike kombëtare ishte mbrotjtja e shtetit të pavarur shqiptar, për demokratizimin e tij, për çlirimin e Kosovës dhe të viseve të tjera shqiptare të Jugosllavisë, që ishin të shkëputura padrejhtësisht më 1913 dhe për bashkimin e tyre me Shqipërinë. Komiteti "Mbrotjtja Kombëtare e Kosovës", me seli në Shkodër, ishte i orientuar se përveç punës programore të fillonte përgatitjet për çlirimin e Kosovës nga pushtuesit sllav. Por ky angazhim duhet të pasoi pas të gjitha përpjekjeve për njohjen ndërkombëtare të Kosovës si territor i Shqipërisë dhe të përmirësoj gabimet që ishte bërë me rastin e caktimit të kufijve në vitin 1913. Nëse të gjitha këto nuk do të jepnin fruta, atëherë ata kishin vendosur se duhej ndërmar edhe aksione ushtarake. Për këtë qëllim anëtarët e Komitetit kishin përgatitur "Programin e përgjithshëm të kryengritjes në Kosovë më 1919". Ky program me 16 pikat që kishte duhet të jetë plotësim i programit themeltar të Komitetit të 1 majit 1918 dhe përpilues të saj ishin oficerët e njohur e me përvojë: Ali Shefqeti, Hysni Curri, Ibrahim Gjakova etj. por orientimin politik ia kishte dhënë vetë Hoxhë Kadria. Sikurse në programet e mëparshme politike edhe

në këtë dominonte fryma kombëtare e demokratike e Komitetit. Në të gjitha pikat shpreheshin qartë parimet themelore politike e ushtarake të forcave kryengritëse. Në nenet 1, 2, 3, dhe 4 thuhej se kryengritësve shqiptar u ndalohej rreptësisht dhunimi, plaçkitja, djegia e shtëpive, kishave e ndërtesave të tjera si dhe vrasja e robërve të luftës. Ky Komitet ka vepruar edhe në Gjilan.

LËVIZJA E ARMATOSUR KAÇAKE NË GJILAN (1918-1928)

Lëvizja Kaçake, sipas veprimeve të çetave, ishte e ndarë në 16 zona operative. Gjilani dhe Karadaku bënin pjesë në zonën e trembëdhjetë me udhëheqësit më të njohur të çetave, si: Lotë Vaku, Xheladin Limani (Xhel Guri), Ali Nekoshtaku, Behxhet Runica etj. Kryengritja u shua në qershor – korrik 1919, por rezistenca me pushkë në dorë e Lëvizjes Kaçake ndër male vazhdoi edhe më tutje. Vlenë të përmendim se në këtë zonë operative, udhëheqës i autorizuar nga Komiteti i Mbrojtjes së Kosovës dhe përgjegjës i zonave të Prishtinës, të Llapit, të Ferizajt, të Karadakut, të Gostivarit e të Pazarit të Ri ka qenë i famshmi Ibush Vuçitërnia, i njohur në popull si Ibush Aga, i cili ka qenë njëkohësisht edhe anëtar i kryesisë së Komitetit për Mbrojtjen e Kosovës në Shkodër. Zona e Karadakut – Gjilanit bashkë me atë të Ferizajt përbënin një lidhje natyrore me zonën operative të Shkupit, Tetovë-Gostivarit e deri tek ajo e Dibrës dhe e Manastirit. Këtë lidhje e dëshmon edhe rasti kur më 20 qershor 1920, Hasan Prishtina, nën përcjellje të Azem Bejtës, udhëtoi për në Sofje të Bullgarisë për të koordinuar bashkëveprimin me Komitetin e VMRO-s, me qendër në Sofje për rezistencë të përbashkët në luftë kundër pushtetit okupues serb, e ku zona në fjalë luajti një rol të rëndësishëm. Në popull nuk është paraqitur Hasani, por ai ishte i shoqëruar nga Azem Bejta, i cili e siguroi shkuarjen e tij në Sofje, ku qëndroi prej 5-7 qershor 1920. Nga ky konsultim, pas kthimit nga Sofja e Bullgarisë pasoi Kuvendi i Lëvizjes Kaçake në Murgull të Llapit, i mbajtur më 17-20 qershor 1920, në të cilin nga zona e Gjilanit – Karadakut, mori pjesë Xhel Guri e Lotë Vaku, në përcjellje të të cilëve ishte çeta e Xhelë Gurit. Në këtë çetë pat marrë pjesë edhe kaçaku i vitit 1912, Sali Staneci, të cilit në tetor 1912, ushtria serbe ia pati rrëmbyer familjen dhe e kushtëzoi që të dorëzohet. Saliu u dorëzua, por tani regjimi serb e kushtëzoi që të ndërrojë edhe fenë edhe emrin, i cili për të shpëtuar familjen pranon të ndërrojë fenë dhe emrin nga Sali në Savë, ndaj shokët e vet në shpoti, e quanin Sali Sava, i cili nuk e lëshoi kurrë pushkën nga dora në luftë kundër pushtetit okupues serb deri më 1927 kur i humb çdo gjurmë. Çetës së tij, më 1918, i bashkohet edhe Jusuf Baftjari alias Hoxhë Lipovica, i cili pasi vrau udhëheqësin e njësitit xhandar serb, që ia masakroi familjen, qëndroi

në mal deri më 1921, kur dorëzohet dhe dënohet me 20 vite burg të rendë, nga të cilët 13 vite i mbanë. Duhet përmendur edhe konfliktin e grupit të kaçakëve të armatosur, të udhëhequr nga Jakup Deda i Gjilanit dhe Jusuf Kajolli i Gjylekarit, me okupatorin bullgar në Gjilan më 1918. Konflikti filloi pas një mosmarrëveshje me bullgarët dhe pas një lufte të ashpër dhe të pabarabartë, gjatë natës, të rrethuar në një shtëpi afër qendrës, pasi digjet shtëpia, mbetën të vrarë Jakup Deda dhe Jusuf Kajolli me 5-6 kaçakë të tjerë, disa i shpëtuan rrethimit. Pas vitit 1923 në territorin e Gjilanit ka vepruar edhe kaçaku Xhumë Mirashi, i cili ishte bashkëpunëtor i Lil Begracës, që nuk shkoi në Turqi, por veproi në terrenin e Gjilanit deri më 1927, kur në Livoçin e Poshtëm në një betejë me xhandarë serbë pasi vrau një kapllar serb, u plagos rëndë dhe nga kjo plagë edhe vdiq. Lëvizja Nacionalçlirimtare Kaçake në Anamoravë u zhvillua në kuadër të Lëvizjes Kaçake në Kosovë. Ajo, pra luftoi kundër zgjedhës robëruese të okupatorit dhe formave të tij shtypëse, si Reformës Agrare e kolonizuese dhe shpërnguljes për Turqi e gjetiu, luftoi kundër dhunës e masakrimeve serbe, pra luftoi për çlirim kombëtar.

MASAKRAT E PUSHTETIT SERB KUNDËR POPULLSISË SHQIPTARE (1912-1999)

Edhe gjatë depërtimit të forcave serbe në sanxhakun e Nishit të vitit 1877/1878 u bënë masakra të shumta mbi popullsisë shqiptare të këtyre territoreve. Pastaj pushtimi serb i Gjilanit në vitin 1912 u shoqërua me masakër, sidomos në fshatrat e Gjilanit. Për mizoritë serbe në Gjilan e rrethinë, shtypi i huaj por edhe ai serb, përfaqësitë diplomatike të Austro – Hungarisë në Serbi mblodhën mjaft të dhëna për reprezaljet e pushteti serb. Kështu, konsulli i Shkupit e bënte me dije Vjenën për aktet e dhunimit të grave shqiptare (të fesë katolike) në fshatin Letnicë dhe Shosharë të anës së Gjilanit. Gazeta londineze Daily Telegraph botoi korrespondencën nga Vjena për masakrat në fshatrat Shoshare (afër Shkupit) Letnicë, Vërban, Sefer, Lubishtë, Gjylekar, Selishtë etj. Terrori, dhuna e gjenocidi që u zhvillua mbi shqiptarët e Gjilanit dhe rrethinës përveç Luftës së Parë dhe ndërmjet dy luftërave botërore ajo vazhdoi edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Masat e egra që ndërmori Qeveria dhe ushtria e Jugosllavisë së vjetër ndaj shqiptarëve në prag dhe gjatë Luftës së Prillit të vitit 1941, dhe masakrat që kreu Lëvizja Çetnike e Drazha Mihajloviqit, si dhe masakrat dhe gjenocidi që eskaloj e që zbatuan njësitet e UNÇJ-së në prag të çlirimit të Kosovës nga fashizmi dhe në muajt e parë të vendosjes e të konsolidimit të pushtetit komunist në Gjilan dhe rrethinë janë të papara. Luftës së Prillit u keqësua edhe më shumë pozita e popullit shqiptare dhe në trevën e Gjilanit. Edhe në zonën pushtuese bullgare të Kosovës keqtrajtimit, torturat e masakrat

çetnike, në aleancë me bullgarët, filluan që nga viti 1941 me vendosjen e pushtetit bullgar në këto anë. Nuk mund të mos përmenden keqtrajtimet, krimet, rrahjet e vrasjet në Topanicë, Tërnavë, Tërnoc, Pogragjë, Zhegër, Remnik etj. Pushtuesi bullgar në kuadër të të cilit merrte pjesë në një masë edhe elementi serbomalazez, duke e pranuar edhe kombësinë bullgare si bullgarë të Moravës (Moravskite bullgari). Një masakër tjetër çetnikët e kryen në xhaminë e Preshevës më 17 shtator 1943, ku nën udhëheqjen e malaziasit Jagosh Janjeviqit nga Reka e Ternavës dhe Zafireviq Deniqit, të maskuar, hynë në qytet dhe hodhën bomba nga dritarja në xhami gjatë kohës kur besimtarët po falnin taravit. Në këtë akt shovinist e gjenocidal vdiqën 4 shqiptarë (Lutë Mehmeti, Rexhep Demi, Ramiz Agushi dhe Tafë Tërnavë) e u plagosën 32 të tjerë. Për krime u dalluan sidomos Brigada VIII e Preshevës, Brigada XII e Bujanocit, Aradha Partizane e Shkupit, Brigada XVI, XVII dhe XVIII Maqedone, Brigada e Bokës, Brigada e Pirotit, disa njësite të Brigadave Partizane të Kosovës, etj. Brigada XVI Maqedonase, e komanduar nga Gllisha Sharanoviqi, prej 6 tetorit deri më 14 nëntor 1944 në përfundim të Shkupit likuidoi rreth 200 shqiptarë nën pretekstin se kishin qenë në shërbim të okupatorit. Në bazë të disa të dhënave në terren gjatë nëntorit dhe dhjetorit të vitit 1944 dhe në fillim të vitit 1945, në territorin e Anamoravës u vranë dhe u masakruan afër 8.000 shqiptarë, për ç'gjë kjo anë mbanë rekord të zi në krahasim me pjesët e tjera të Kosovës. Kështu në këtë kohë në Çarr u vranë 23 shqiptarë, në Shipashnicë 8, në Hogosht 6, në Sllubicë 11, në Pogragjë 5, në Dobërçan 4, në Kopernicë 3, në Inatoc 3, në Dobrosin 2, në Përlepnicë 22, në Busavatë 8, në Malishevë 17, në Gosponicë 29, në Gare 2, në Makresh 24, në Llashticë 23, në Stanoc 4, në Preshevë 600, në Gjilan me fshatrat përreth afër 1.000, në Vruçec 2, në Livoç të Poshtëm 9, në Livoç të Epërm 12, në Tërpezp 5, në Koretin 3, në Rogaçicë 2, në Sfirçë 23, në Tugjec 5, në Gjyrishec 3, në Lisockë 6, në Shahiq 2, në Dazhdincë 2, në Sopot 75, në Kërstiq 2, në Topanicë 2, në Tërstenë 3, në Pozharan 23, në Konçul 10, në Bukurocë 13, në Bozhec-Rekali 3, në Marec 23, në Rubovc 4, në Lluçan 13, në Miratoc 15, në Tërnavë 10, në Allashec 4, në Izvor 2 etj. Masakrat serbe vazhduan edhe më vonë përgjatë gjithë kohës së sundimit serb por ato më të mëdha u bënë prill deri në maj të vitit 1999 si në Bresalc, Zhegër, Lashticë, Lladovë, Llofcë etj.

KOLONIZIMI SERB I KOSOVËS RESPEKTIVISHT I GJILANIT DHE REFORMA AGRARE MES DY LUFTËRAVE BOTËRORE

Kolonizimi i Kosovë me banorë joshqiptarë, kryesisht me serbë, ishte një proces i realizuar me plan nga qeveria beogradase në periudhën mes dy luftërave botërore. Kolonizimi ka

filluar menjëherë pasi Rrafshi i Kosovës u bë pjesë e Mbretërisë së Serbisë dhe pjesë të Rrafshit të Dukagjinit u bënë pjesë e Mbretërisë të Malit të Zi në Luftën e Parë Ballkanike të viti 1912 dhe ka vazhduar gjatë periudhës së Mbretërisë së Jugosllavisë, nga viti 1918 deri 1941. Kolonizimi i Kosovës ka pasur të theksuar notën nacionale, dhe sipas këtij nacionalizmi, "elementi jokombëtar" (shqiptarët) është dashur të zëvendësohet me „elementin kombëtar serbët dhe malazezët. Mes viteve 1912 dhe 1941, në Kosovë janë vendosur mes 60.000 dhe 65.000 kolonë. Më shumë se 90% e numrit të përgjithshëm të kolonëve e përbënin serbët nga vende të ndryshme të Jugosllavisë duke përfshirë malazezët. Krahas kolonizimit serb të Kosovës, ka vazhduar edhe procesi i dëbimit të shqiptarëve nga Kosova si dhe reforma agrare. Qëllimi i reformës agrare ishte likuidimi i lidhjeve feudale dhe krijimin e kushteve për zhvillim e kapitalizmit, gjersa kolonizimi kishte synim ndërrimin e hartës demografike të Kosovës, në dobi të serbëve. Kjo reformë agrare kishte edhe aspektin etno-fetar, pasi që pronat e ish pronarëve myslimanë, kryesisht kaluan në duart e serbëve ortodoksë. Kolonizimi i Kosovës kryesisht trajtohet si projekt i dështuar, pasi nuk kënaqi as shtetin, as kolonët, e as vendasit. Rezultatet e hartës së re etnike u pavleftësuan gjatë Luftës së Dytë Botërore, kur Kosova iu bashku Shqipërisë, e shumica e kolonëve u dëbuar mbrapa në Serbi e në Mal të Zi. Pas mbramit të luftës, disa kolonëve iu ndalua kthimi në Kosovë. Mes viteve 1919 dhe 1927 në Kosovë janë themeluar 245 vendbanime serbe. Vetëm në vjeshtën e 1931 në anën e Dukagjinit janë vendosur 1'400 familje nga Mal i zi: janë ndërtuar shtëpi tipike dhe iu është ndarë më shumë 20.000 ha tokë mes rrugës Prizren–Gjakovë–Pejë dhe lumi Drin. Për kolonizatorët janë ndërtuar 11'273 shtëpi në Kosovë deri në fund të vitit 1935. Nga viti 1936 ka filluar vala e re e marrjes së tokës nga shqiptarët në rrethinat kufitare, ku atyre iu lejua vetëm 0.4 hektarë për familje , gjersa familjet kolonizatorë mesatarisht kanë pasur nga 8 hektarë tokë. Pushteti në këtë mënyrë ka provuar të shkatërroj bazën e ekzistencës së shqiptarëve dhe i ka detyruara ata në emigrim, e cila e ka rritur edhe më shumë disponimi anti-qeveritar te shqiptarët. Serbizimi i Kosovës ka vazhduar deri në vitin 1941 dhe kjo mënyrë janë formuar shumë enklava serbe në Kosovë, duke përfshirë: Fushë Kosova, Obiliqi, Hercegovë, Orloviç, Devet Jugoviçat, Lazarevo, Gornji Svračak, Donji Svračak, Jezero, Lug, Novo Rujce, Staro Gracko etj. Kolonitë e reja janë themeluar kryesisht në afërsi të rrugës kryesore, e cila është nga jugu deri në veri të Kosovës. Ka ekzistuar qëllimi që vullnetarët luftarak të vendosen në pika të rëndësishme strategjike, kryesisht në fushën e Dukagjinit, Drenicë, qarkun dojrana i maleshka. Deri në vitin 1939 janë vendosur rreth 54'000 kolonizator, nga të cilët 49'000 Serb (duke përfshirë

edhe Malazezë), rreth 4'500 Kroatë dhe rreth 150 Sllovenë. Si pasojë e dëbimit shumëvjeçar të shqiptarëve dhe vendosjes së serbëve dhe malazezëve, ka ardhur deri te ndryshimeve të theksuara të strukturës etnike të banorëve. Gjithashtu, pasi që janë nënshtruar masat e dhunshme të marrëdhënies ndërmjet grupeve etnike janë bërë shumë të tensionuar, sidomos në mes kolonizatorëve vendas shqipe dhe serbe, e cila kishte pasojë në thellimin konfliktin serbo-shqiptarë. Pas përfundimit të luftës më 1945, qeveria e Jugosllavisë Demokratike Federative të gjithë kolonizatorëve iu ka ndaluar kthimin e tyre në Kosovë, sepse ato konsiderohen si eksponentët e politikës serbomadhe paraluftës, prej së cilës regjimi i ri distancohej. Në mars 1945 qeveria e re federale ka sjell të ashtuquajturën *Vendim nr. 153* e cila të gjithë kolonizatorëve përkohësisht ua ndalon kthimin në vendi e tyre të mëparshëm të banimit. Qeveria e re qysh në fillimin e gushtit 1945 kanë adoptuar Ligjin për revidimin e marrëdhënies kolonizuese, i cili për kolonizatorët ka parashikuar kompensim të caktuar në Vojvodinë, nga ku ata u dëbuan në masë gjermanët nën danubian. Në shtator të vitit të njëjtë rreth 3'352 „ish kolonizatorëve” kanë fituar të drejtë kthimi në Kosovë, gjersa 306 kolonizatorëve, të cilën kanë humbur të drejtën e kthimit, janë devijuar në Vojvodinë. Sipas shënimeve statistikore, në rrethinën e Gjilanit prej vitit 1921-1937 ishin kolonizuar 1.497 familje me 7.947 banorë (7.647 serbë, 263 kroatë dhe 6 sllovenë). Kolonët sllavë u vendosën në këto vendbanime të komunës së Gjilanit: Bresalc, Bukovik, Capar, Gjilan, Livoç i Epërm, Livoç i Poshtëm, Llashticë, Malishevë, Pogradjë, Përlepnicë, Ponesh, Stublinë, Velekincë, Verbicë e Kmetocit, Dobërçan, Zhegër etj.

LUFTA E DYTË BOTËRORE (1939 – 1945)

PERSONALITETE

IDRIZ HAJRULLAHU – MULLA IDRIZ GJILANI (1901-1949)

Mulla Idriz Gjilani lindi më 4 qershor 1901, në Velekincë të komunës së Gjilanit. Mësimet fillestare i ndoqi në mejtepin e Cernicës, të cilin e mbaroi në vitin 1911 për të vazhduar studimet e mesme në medresenë "Atik" në Gjilan. Pas një ndërprerjeje të shkollës më 1926 arriti të diplomoj. Në moshën 25 vjeçare bëhet imam dhe merr titullin "Mulla". Shërbeu në detyrën e Imamit në Karadak e në Hogosht të komunës së Dardanës. Më 1941 u zgjodh në postin e Bashvajizit në Ulema-mexhlisin e Kuvendit fetar e arsimor të Vakëfit të Shkupit. Në edukimin e tij fetar u nis nga disa parime nga Kurani dhe hadithet që përcaktonin vlerat e arsimit, të kulturës dhe të edukatës : "Pa shkollim - thotë ai, - nuk ka as fe të mirëfilltë".

"Nxënësit tonë nuk duhet të mësojnë më vetëm për leximin e Kuranit, por edhe për njohjen e mjeshtërisë së shkrimit. Nxënësit tonë duhet t'i nisim në rrugën për ta njohur islamin dhe jo për ta prezantuar si diçka statike", "S'ka fe pa atdhe", "Të ndihmojmë njëri-tjetrin me fjalë, me penë, me pasuri, të duhemi si vëllezër", "Pa një atdhe të lirë feja nuk mund të mbahet kurrë, nuk mund të ushtrohet", "Lexoni te mualimë të urtë sa e mirë dhe sa e kuptueshme është feja islame, kur shpjegohet shqip, në gjuhën e Zotit për shqiptarët". Gjatë kohës si hoxhë dhe bashvaiz zhvilloi një veprimtari intensive në fushën e edukimit fetar me frymë atdhetare. Hapi mejtepin e Pidiçit për mësimin e djemve dhe të vajzave, organizoi ilegalisht mësimin e shkrim-leximit me alfabetin e gjuhës shqipe, futi mësimin shqip në medresenë "Atik", ushqeu mirëkuptimin dhe bashkëpunimin vëllazëror me bazë kombëtare shqiptare në popullsinë myslimane e katolike të zonës së Karadakut. Kur qe mësimdhënës në tre mejtepe njëkohësisht, shfrytëzoi sistemin monitor: përgatiti nxënësit më të mirë dhe me moshë më të madhe për ta zëvendësuar kur ai mungonte. Në prill të vitit 1937, në kushte ilegaliteti, themeloi në Arllat të Drenicës Organizatën e Rinisë Përparimtare "Drita" të Kosovës. Aktivitetet e tij fetare nuk dalloheshin nga ato atdhetare e humane. Kudo, kurdo e me këdo ato ishin të pranishme. Mulla Idrizi ishte kundër shpërnguljes së shqiptarëve. Në funksion të kësaj bindjeje atdhetare e humane ai programonte në xhami, në konaqe, në kuvende e deri në ceremonitë e vdekjes. Në formë kushtrimi ai thërriste: "Jemi përgjegjës për varret e prindërve tanë para Zotit dhe para kombit. Nuk guxojmë të heqim dorë prej tyre t'i lëmë të shkreta për t'i lavruar derrat e naçalnikëve sllavë! Jo vetëm në Turqi, por as në Shqipëri nuk bën të shkojmë. Zoti në Kur'an na ka bërë përgjegjës për vatanin dhe kombin!" Mulla Idrizi printe në aksionet për ndërtimin e urave, rrugëve, çesmeve, mejtepeve, xhamive, mirëmbajtjes së varrezave, të cilat i shikonte si mjete dëshmuese të bashkimit të popullsisë shqiptare. Uniforma e ndihmoi për të maskuar aktivitetin e tij patriotik. Mulla Idriz Gjilani ishte një "rilindës" në kuptimin e vërtetë të fjalës në kushtet që kalonte Kosova. Në kohën kur Mulla Idriz Gjilani ushtronte detyrën e bashvaizit, numri i nxënësve të "Atik medresesë" të Gjilanit arriti në 734, nga të cilët 326 ishin femra. Po ashtu i organizoi shkollat lëvizëse me mësues shtetitës. Vetëm në zonën e Gjilanit u hapën 39 shkolla të tilla fetare, që zgjuan te brezi i ri ndjenjat fetare dhe ndërgjegjën kombëtare. Ishte intelektual i kohës, i cili zotëronte shumë gjuhë orientale, gjë që e mundësoi të njihet me arritjet shkencore të kohës, në fushën e fizikës, kimisë, mjekësisë, astronomisë, etj. Botoi punimet fetare "Lindja e pejgamberit", dhe "Vllazëria Islame", të cilat përshkoheshin nga mesazhi i paqes, vllazërimi, bashkimit kombëtar, etj. Nga prilli 1941 Mulla Idriz Gjilani iu kushtua plotësisht veprimtarisë politike.

Si hoxhë me forcën e Zotit, si mësues me forcën e fjalës, si luftëtar me forcën e armës, si komandant me besnikërinë e ushtarit, ai luftoi për unitetin territorial të trevave shqiptare, luftoi kundër gjenocidit serb e bullgar, kundër komunizmit. Në qershor të 1944 drejtoi betejën e Kikës, ku shqiptarët e udhëhequr prej tij dolën fitimtarë kundër ushtrisë sllavo-komuniste. Veprimtaria e Mulla Idriz Gjilani është heroike. E tillë është edhe periudha 1944-1949 . Mulla Idriz Gjilani mori pjesë edhe në çlrimin e Gjilanit në dhjetor të vitit 1945. Pas rënies në duart e OZN-ës Mulla Idriz Gjilani ishte turturuar shumë sa që ishte dëzuar me benzin ndërmjet datës 25-26 nëntorit të vitit 1949. Kurse eshtrat e tij kurr nuk janë gjetë.

XHELADIN KURBALIU

Xheladin Kurbaliu lindi me 1907 në fshatin Kurbali të Karadakut të Presheves, në një familje të varfer, por me traditë të njohura për qendresë kundër pushtuesve të huaj. Pas Luftës së Parë Botërore familja e tij për shkak të ekonomike u shpërngul dhe u vendos në Preshevë. Për të siguruar ekzistencën e familjes Xheladin Kurbaliu u detyrua të punësohej në minierën e kromit në fshatin Llojan të Kumanovës. Ra në kontakt me komunistët e kësaj ane dhe para Luftës së Dytë Botërore u anëtarësua në Partinë Komuniste të Jugosllavise (PKJ). Pas pushtimit të Mbretërisë Jugosllave me 1941 nga forcat e Boshtit Qendror dhe pas caktimit të zonave okupuese, territori i Presheves mbeti nën sundimin e Bullgarisë fashiste. Ai e kundërshtoi hapas pushtetin bullgar dhe u angazhua që të gjitha trojet etnike shqiptare të bashkoheshin me Shqipërinë, pra edhe Presheva me rrethine. Për këtë arsye u detyrua të lëshojë Presheven dhe vazhdojë veprimtarinë në Gjilan ku ishin kushtet më të mira për aktivitet patriotik, sepse Gjilani ishte në zonën okupuese italiane që iu kishte bashkuar shtetit shqiptar. Meqë ishte nën ndikimin e ideve komuniste dhe anëtar i PK-së në Gjilan, u lidh me komunistët dhe antifashistët ku me 1942 u zgjodh sekretar i Komitetit të Rrethit të PKJ-së. Me rastin e formimit të Aradhes së Parë Partizane Shqiptare të Kosovës "Zejnel Hajdini" në Ramjan të Vitisë, me 27 shtator 1942 u zgjodh komandant i parë i saj. Në kohën kur po përfaqësohej Shtabi i Aradhes për të kryer një aksion në Minierën e kromit në Llojan me 21 tetor 1942, së bashku me një pjesë të Aradhes së Vrajes që komandohej nga Zhivojin Nikoliq Berka, e që ishte shpartalluar me parë nga forcat bullgare, ai nuk u pajtua që në krye të shtabit të Perbashkët të Aradhes të vie komandanti serb, sic u pajtua anëtarët e tjerë të Shtabit të Aradhes. Kështu filloi konflikti i tij me vijën politike të PKJ-së. Ishte i dëshpëruar për faktin se atij iu kundërvu edhe udhëheqja shqiptare e Aradhes "Zejnel Hajdini" në mesin e të cilëve edhe Fadil Hoxha e Kurtesh Agushi. Pas këtij aksioni tërhiqet dhe vepron në prapavi. Për një

kohe strehohet ne Kulle te Kufces se Poshtme. Xheladin Kurbaliu, edhe pse me ide komuniste ishte nder ata komuniste te pakte shqiptare qe me kohe e kuptoi dhe e kundërshtoi politiken hegjemoniste, ekspansioniste e aneksioniste te PKJ-se ndaj trojeve etnike shqiptare te kamufluar permes internacionalizmit proletar. Pas kapitullimit te Bullgarise fashiste ne shtator te vitit 1944 Xheladin Kurbaliu se bashku me prijesis e nacionalizmit shqiptar te kesaj treve organizoi mbrojtjen e kufijve etnike nga depertimi i cetnikeve dhe partizaneve serbo-maqedono-malazez, Pas terheqjes se forcave bullgare nga Presheva ai urdheroi ngritjen e flamurit shqiptar ne Xhamine e Presheves duke simbolizuar dhe vertetuar keshtu perkatesine shqiptare te kesaj treve si dhe duke ua bere me dije miqve dhe armique se regjioni i Presheves ka qenë dhe gjithnje do te mbetet treve shqiptare. Pas depertimit te njesiteve serbo-bulgare dhe maqedone partizane ne territorin e Gjilanit, Xheladini e kundërshtoi haptas vendosjen e pushtetit jugosllav. Me te gjitha forcat jo vetem qe i kundërshtoi masakrat e gjenocidin që e bënë njesitet partizane dhe organet e pushtetit komunist mbi popullin shqiptar, por ai edhe vete luftoi aktivisht kunder tyre derisa u vra se bashku me 3 shoke ne tradheti nga bashkepunetoret e OZN ne shkurt te vitit 1946 ne fshatin Mucibabe te Karadakut.

ESAT BERISHA (1913-1944)

U lind në Gjilan më 14 prill 1913 në një familje me tradita patriotike. Shkollën fillore Esati e regjistroi më 1922 dhe e kreu më 1926 në Gjilan në gjuhën serbe. Në vitin shkollor 1927 – 1928 regjistrohet në Medresenë e Madhe "Kral Aleksandri" të Shkupit, të cilën e kryen me sukses më 1935. Në Medrese pati fatin të njihet me shumë intelektual e patriotë të kohës. Menjëherë pas mbarimit të medresesë regjistrohet në fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit në vitin shkollor 1935/1936. Pas fillimit të luftës së Dytë Botërore u detyrua t'i ndërpres studimet, ndërsa më 1942 u regjistrua në Universitetin e Zagrebit, ku edhe u diplomua në mars të vitit 1943. Gjatë studimeve sa ishte në Beograd u angazhua në Lëvizjen e Rinisë Përparimtare të Kosovës, e cila ishte e organizuar dhe funksiononte përmes Organizatës "Kosmet". Kundërshtoi publikisht planin e pushtetit jugosllav për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi. Më 1937 ishte njëri ndër shumë studentë të Kosovës që nënshkroi Proklamatën kundër shpërnguljes së shqiptarëve me dhunë për në Turqi në bazë të marrëveshjes që Jugosllavia e kishte nënshkruar me Turqinë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore Esat Berisha u angazhua në jetën politike si veprimtar për çështje të konsolidimit të shtetit shqiptar dhe të përfshirjes së të gjitha trojeve etnike brenda kufijve të Shqipërisë. Si intelektual Esati bashkëpunoi me shumë gazeta e revista të kohës që dilnin në gjuhën

shqipe gjatë Luftës së Dytë Botërore. Interesimet dhe shkrimet e tij ishin të angazhuara dhe preknin fushën kulturo-arsimore dhe politiko-juridike të jetës dhe shtetit shqiptar. Me këtë rast po veçojmë artikujt "veprimtaria e arsimtarëve në Gjilan" të botuar në gazetën "Lidhja e Prizrenit" të datës 2 prill 1944 dhe "Shqipëria në letërsinë serbe" të datës 9 prill 1944. Esat Berisha udhëhoqi tubimin e organizuar me nëpunësit e rininë që shërbenin në administratën e nënprefekturës së Gjilanit më 1941. Si i ri u mor edhe me sport, sidomos me futboll. Luante në klubin sportiv "Bashkimi" të Gjilanit së bashku me Xheladin Kurbaliun, Abdullah Preshevë, Selim Selimin, etj. Ishte edhe anëtar i Këshillit Drejtues të këtij klubi. Meqë me profesion ishte jurist, gjatë Luftës së Dytë Botërore ai punoi një kohë si gjyqtar i Gjyqit Paqtues për Nënnprefekturën e Gjilanit. Esat Berisha së bashku me Mehmet Devajën ishte delegat i Gjilanit në Kuvendin Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Në këtë Kuvend u zgjodh edhe anëtar i Komitetit Qendror. Kur me propozimin e Tahir Zajmit Kuvendi Themelues i Lidhjes së Dytë të Prizrenit proklamoi bashkimin e Kosovës, Dibrës, Tetovës, Strugës, Ulqinit dhe Tivarit me Shqipërinë si dhe të qarkut të Kosovës (Mitrovica, Vushtrria dhe Podujeva) që i takonte zonës së pushtimit gjerman, avokati Esat Berisha në cilësinë e delegatit të Gjilanit kërkon nga Kuvendi që të ndërhynte për rishikimin e vijës kufitare me bullgarinë fashiste duke u angazhuar që brenda kufijve të Shqipërisë të përfshihen trevat shqiptare që ndodheshin nën pushtimin bullgar. Me rastin e riorganizimit të Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit nga ana e Xhafer Devës, në korrik të vitit 1944, Esat Berisha caktohet përgjegjës për dikasterin e transportit. Pas 17 nëntorit 1944 kur shumica e anëtarëve të Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit vendosën të lëshonin vendin, Esat Berisha u gjend në mesin e atyre që nuk deshtën të largohen nga Kosova. Pothuaj të gjithë ata që mbetën në Kosovë ose që kaluan në Shqipëri u ekzekutuan nga ana e organeve të pushtetit serb, i cili u vendos në Kosovë në fund të Luftës së Dytë Botërore. Menjëherë pas depërtimit në Gjilan të njësiteve të UNÇJ-së dhe të forcave të ushtrisë bullgare, si dhe me konsolidimin e pushtetit komunist filloi riaktivizimi i elementeve proçetnike sebo-malazeze, të cilët shfrytëzuan momentin për të realizuar qëllimet e tyre për likuidimin fizik të shqiptarëve, sidomos të atyre më me autoritet dhe të atyre që kishin mbrojtur dhe mbronin interesat kombëtare shqiptare. Ata veçmas i likuidonin intelektualët dhe patriotët shqiptarë. Kësisoj brenda një kohe të shkurtër u mbushën burgjet përplot shqiptarë dhe filloi likuidimi i tyre pa kurrfarë procedure gjyqësore. Organet e OZN-së Esatin e arrestuan më 17 dhjetor 1944, ndërsa e pushkatuan të nesërmen më 18 dhjetor 1944 në mënyrën më mizore me të vetmin "faj" se kishte qenë anëtar i Komitetit Qendror të Lidhjes II të Prizrenit. Më

vonë ia vrasin edhe babanë - Ymerin, pa kurrfarë gjyqi, ndërsa vëllaun Hamdiun, ia denojnë me burg.

LAZER BERISHA

Lindi në fshatin Terzijaj të Gjilanit, në fund të shekullit XIX-të, rreth vitit 1890. Babai i tij, Munishi, Lazrin dhe djalin tjetër, Nduen, i lë nën përkujdesjen e Kishën së Stullës për t'u shkolluar dhe për të qenë në shërbim të Zotit. Lazer Berisha, një pjesë të shkollimit e kreu në Shkup. Pastaj në Shkodër mbarojnë shkollimin e mesëm prej nga transferohet në Romë, shkaku i zotësisë së mëdha në mësim. Në Itali, mbaroni studimet teologjike dhe, në Kosovë kthehet i diplomuar. Pas pushtimit italian, ministri i arsimit, Ernest Koliqi, duke e njohur së afërmi Lazër Berishën, e emëron profesor gjimnazi në Prishtinë dhe Prizren, ku shërben mes viteve 1941 – 1944. Lazër Berisha ishte dhe pjesmarrës i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe pjesë e Kryesisë së punës. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, një brigadë partizane e drejtuar nga Shefqet Peçi, e ekzekuton në Prizren dhe ende nuk i dihet varri.

JUSUF BAFJTJARI – HOXHË LIPOVICA (1883-1948)

Lindi më 1883, në Lipovicë (Gjilan). Luftëtar i shquar kundër vendsojes së pushtetit komunist në Kosovë. Bashkëpunëtor dhe bashkëlufiëtarë i Idriz Hajrullahit – Mulla Idrizit. Njëri komandantët e njërive vullnetare në mbrojtje të kufirit të Kosovës Lindore. Kundërshtoi okupimin fashist bullgar të një pjese të Rrethit të Gjilanit. Në maj 1941, Hoxhë Lipovica, formoi njësitin e tij të rezistencës, në krye të të cilit qëndroi me armë në dorë në mbrojtje të jetës dhe pasurisë së popullatës shqiptare të kësaj ane nga keqpërdoruesit bullgarë dhe bashkëpunëtorët e tyre serbë. Pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste (9 shtator 1944), konform urdhëresës së KQ të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, për mbrojtjen e kufirit nga sulmet partizano-çetnike, Hoxhë Lipovica, u caktua njëri ndër komandantët e zonave mbrojtëse të kufirit në vijën hekurudhore Kumanovë-Preshevë-Bujanoc. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe vendosjes së pushtetit komunist në Kosovë, Hoxhë Lipovica së bashku me disa bashkëlufiëtarë, për një kohë do të qëndrojnë të fshehur në malet e Karadakut. Mori pjesë në Kongresin e Kopilakës më 15 e 16 gusht 1945, të organizuar nga Komitetit Qëndror i LNDSh-s dhe Shtabit të Rezistencës. Pas aksioneve të shumta ushtarako-policore jugosllave, duke i parë të gjitha mundësitë e mbyllura për të vazhduar rezistencën, pas mëse dy vjet qëndrimi në ilegalitet, më 20 shkurt të vitit 1947 dorëzohet me dy djemtë e tij dhe disa bashkëlufiëtarë para organeve shtetërore. Burgoset dhe me aktgjykimin e datës 23 prill 1948,

të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Hoxhë Lipovica dënohet me vdekje, pushkatim dhe ekzekutohet. Djemtë e tij Selimi u dënua me 17 vjet dhe Qazimi me 14 vjet burg të rëndë.

YMER MYQIBABA

Ishte nga Myqibaba e komunës së Gjilanit mori pjesë në mbrojtjen e kufirit lindor të Shqipërisë për të penguar depërtimin e forcave qetnike partizane serbe e maqedona. Ishte njëri nga udhëheqësit kryesor të betejës së Myqibabës që u zhvillua më 30 nëntor 1944, ku u vranë me dhjetra vullnetar. Në mesin e të plagosurve ishte edhe vetë Ymer Myqibaba, i cili kishte marrë plagë në në anën e majtë nën kraharorë. Komandanti Ymer Saqipi – Myçybaba i plagosur u transferua në fshtin Kokaj, te proi i Kokajve, ku pas ishte me plagë vdekjepruese ndërroi jetë dhe u vorros në varrezat e Mëhallës së poshtme të Kokajve.

ISUF PIDIQI

Sipas bashkëfshatarëve më të vjetër dhe fafesisit të tij mendohet se ka lindur rreth vitit 1883/4. Rrjedh nga një familje e pasur, ngase Isufi në moshë të re merrej me tregti, sidomos tregti të drunjve të përpunuar ose gjysmë përpunuar të cilët shërbenin për ndërtim të hekurudhave. Gjithashtu ka pas një dyqan nga i cili tërë Karadaku është furnizuar me gjëra elementare si kripë dhe vaj guri (petrolej). Si tregtar ka vizituar Shkupin, por edhe Selanikun. Ishte bashkëluftëtar i Idriz Seferit, Mulla Idris Gjilanit, dhe Xheladin Kurbalisë. Gjatë kohës së LNÇ-së fshatrat e Karadaku mbetën nën sundimin bullgar, e të cilët ushtronin tortura të tmerrshme ndaj asaj popullate, kurse Isuf Pidiqi disa herë ka ndërhyrë tek eprorët bullgare për t' i ndalur këto tortura ndaj popullatës së pafajshme. Kështu në rastin e fshatit Goden, ku një anëtar i familjes Ibrahimit e kishin sulmuar një patrollë bullgare dhe e vrau një bullgar dhe ia mori pushkën. Për këtë sulm i tërë fshati maltretohet rëndë dhe pa ndërprerë me të vetmin arsytim që të gjendet pushka e grabitur. Për ta sjell pushkën e grabitur Isuf bisedoi me eprorët bullgar, kurse dorëzanë e len të birin Esatin në Shtab në Pasjan, sepse pushka e grabitur gjendje në pjesën e okupimit Italian.. Pas qëndrimit në paraburgim Esati, pas afër 24 orëve, babai tij Isufi e sjell pushkën, kurse të birin ia lirojnë, por edhe torturat në fshatin Goden pushojnë. Për këso raste Isufi ka depërtuar edhe në Komandën më të lartë të ushtrisë bullgare në Shkup. Po ashtu Isufi ka depërtuar me qerre me kuaj të ngarkuar me ushqim të kafshëve (sanë) dhe ka hyrë në Garnizoni ushtarak dhe ka kontaktuar me eprorët më të lartë dhe ka kërkuar që mos të bëhet zullum në fshatrat ku bullgarët sundonin. Në vitin 1945 pas largimit të pushtuesit bullgar, çetat çetnike partizane filluan dhunën ndaj popullatën shqiptare dhe çdo ditë pushkatonin dhe bënë tortura më

mizore në popullsisë shqiptare. Më 6 janarit 1945 Isuf Pidiqit i vije një thirrje për t' u lajmëruar në Zhegër në (Shtab), gjoja për bisedë. Në mbrëmje Isufi e dërgon nipin Ejupin që ta thërras Fazli Zahirin dhe i thot se kjo është hera e fundit që të angazhoj. Pasi vjen Fazliu ata biseduan ndërmjet vete por nuk dihet epilogu i asaj bisede. Isufi parandiente se diçka do të ndodhte, sepse thoshte se nesër e kam një thirrje për të shkuar në Zhegër, por dora e shkaut nuk mund t' i bie shpullë Isuf Pidiqit. Të nesërmen më 7 janar 1945 Isufi shkon në Zhegër (Shtab) dhe i sheh çetnikët serb duke vallëzuar, për festën e Ditës së Kërshëndellave Ortokse. Isufi mbyllet në një hapësirë ku ishin të renditura pushkët dhe pas një kontrolli që ia bën të gjitha pushkëve e gjen një pushkë me tre fishek e të cilët i shkrep në turmën e cila ishte duke vallëzuar dhe i vret dy çetnik dhe një e plagos. Isufi tentoi të ikte, por para objektit të vjetër të shkollës nga shumë rafalë të çetnike serbe dhe shqipfolësve Isufi mbetet i vdekur. Kufoma e tij nuk dërgohet për varrim në fshatin e tij Pidiq, por hidhet në mbeturina në periferi të Zhegrës e cila kufomë qëndroi aty disa ditë, por pas një traume që pësoi një fëmijë serb, atëherë groposet dhe eshtrat e tij nuk janë gjetur asnjëherë edhe përkundër përpjekjeve të familjarëve në vitin 2000 e të cilët nuk patën suksese, sepse kishte kaluar gjashtë dekada nga vrasja e tij. Pas vrasjes së Isufit një ekspeditë ushtarako-policore shkon në fshatin Pidiq dhe ia djeg shtëpinë në tërësi, kurse familjen i burgosin së bashku edhe me fëmijën gjashtë muajsh të bijën Nexhmien, kurse i biri Murati ishte 3 ose 4 vjeçar. E tërë familja qëndroi në burg për 3 apo 6 muaj.

FAZLI HAXHA

Fazli Dauti, I njohur në popull si Fazli Haxha, u lind në fshatin Haxhaj të Grykës së Karadakut, në dhjetëvjetëshin e parë të shekullit XX. Pjesë e një familjeje atdhetare, Fazli Haxha ishte brumosur dhe frymëzuar nga trimëritë e të parëve. Ai i kishte të freskëta betejat e idriz Seferit, ku babi dhe axhallarët e tij kishin qenë ushtarë të tij. Pas pushtimit serb, Fazliu një kohë do jetë pjesë e Lëvizjes Kaçake në Karadak. Pas pushtimit bullgar, kthehet në shtëpi. Por, duke mos u pajtuar me represaliet e ushtrisë bullgare ndaj popullatës vendase, bashkë me Isuf Pidiqin e Fazli Seferin arrijnë për të shkuar deri në Shkup, te Komanda bullgare ku e paraqesin gjendjen e rëndë dhe sjelljen e dhunshme të ushtarëve bullgarë ndaj fshatrave shqiptare të Grykës së Karadakut. Kjo ankesë e organizuar, pati sukses dhe, popullata shqiptare e kësaj pjese të Kosovës u kursye nga dhuna e shfrenuar e bullgarëve, e cila nxitej kryesisht përmes serbëve të Zhegrës, Pasjanit e Remnikut. Me tërheqjen e bullgarëve mobilizohen në mbrojtjen e kufijve etnikë. Ishte pjesë e shtabit të komandës së brigadës së

Grykës së Karadakut, e cila udhëhiqej nga Hajdin Kurexha , selia e së cilës ishte në fshatin Mateç dhe për tre muaj bënë rezistencë të pathyeshme ndaj forcave partizane përgjatë vijës së hekurudhës Preshevë – Shkup. Brigadat maqedone asnjëherë nuk arritën ta thejnë këtë rezistencë në këtë pjesë të Karadakut. Por, më pas, përvidhen dhe hyjnë në Kosovë nga Bllaca e Kaçaniku. Gjatë viteve nën regjimin komunist, Fazli Haxha do të merret kryesisht me veprimtari humanitare, evitim të ngatërresave, palhëve dhe gjaqeve nëpër Karadak, veprimtari të cilën e ushtroi deri në fund të jetës së tij.

NGJARJE

LIDHJA E DYTË E PRIZRENIT (16-20 SHTATOR 1943 – JANAR 1944)

Pas kapitullimit të Italisë, forcat e djathta nacionaliste të Kosovës për të mbrojtur interesat kombëtare nga depërtimi dhe kthimi i pushtetit jugosllav formuan organizatën politiko ushtarake, Lidhja II e Prizrenit, Kuvendi Themelues i të cilës u mbajt më 16 shtator në Prizren. Midis 42 delegatëve, që morën pjesë në Kuvendin Themelues të Lidhjes II të Prizrenit (më 16-19 shtator 1943), nga nënprefektura e Gjilanit qenë Mehmet Devaja dhe Esat Berisha. Esat Berisha u zgjodh edhe anëtar i KQ të Lidhjes II të Prizrenit, ndërsa në Kuvendin Kombëtar të Tiranës (në tetor 1943) Gjilanin dhe rrethinën e përfaqësuan: Mexhit Gjilani, Haqif Tetova, Esat Berisha, Sejd Budrika, Ramiz Halimi-Cernica, Jakup Karaçeva, Hafez Kallaba, Mumin Jakupi, Zek Imeri, Muhamet Sheh Pasha etj. Në Gjilan vepronte edhe Komiteti i rrethit të Lidhjes II të Prizrenit, që më 14 gusht 1944 kishte këtë përbërje: Mehmet Gjilani, Iljaz Gjinolli, Sylejman Ashkiu, Kapiten Bajram Hoxha dhe Mehmet Okllapi. Më 1944 funksiononte edhe Komiteti i Kosovës për Rrethin e Gjilanit, me në krye Sejd Budrika deputet i Jugosllavisë së vjetër, ndërsa arkëtar ishte Ramush Osmani. Gjermania dhe qeveria shqiptare, përveç forcave të tjera ushtarake parashikonin të ngrinin edhe “forcat kreshike”, të formuara nga krerët bajraktarë me njerëzit që ishin nën ndikimin e tyre. “Forcat kreshnike” të ushtrisë ishin ato fuqi vullnetare, të gatshme për t’u paraqitur kur të kërkoheshin nën drejtimin e krerëve me influencë. Vullnetarët e territorit të nënprefekturës së Gjilanit ruajtën kufirin me Serbinë kuislinge edhe pas kapitullimit të Italisë fashiste, por tani pa pagesë. Riorganizimi i këtyre forcave u bë në prill të vitit 1944, kur Komanda e Sektorit Ushtarak të Prizrenit urdhëroi formimin fuqive kreshnike në tërë Kosovën. Fuqitë kreshnike ishin të organizuara sipas modelit të ushtrisë së rregullt, por kuadri komandues ishte civil. Mbrojtja e kufijve të shtetit shqiptar ishte kompetencë e Lidhjes II të Prizrenit. Vija kufitare e verilindjes, që shtrihej prej Karadakut të Gjilanit e deri në skajet e kufijve të Mitrovicës, ishte

nën komandën e kolonel Fuat Dibrës (Fuat Xhaferaj), komandant i Regjimentit IV të Prishtinës,¹¹⁰ i cili në maj të vitit 1944 mori komandën e operacionit për ruajtjen e vijës kufitare. Forcat e komanduara nga Fuat Dibra përbëheshin prej dy batalioneve, një baterie, tre topave dhe disa mortajave. Forcat vullnetare të njohura me emrin fuqitë kreshnike, të vendosura përgjatë kufirit të Serbisë kuislinge, në territorin e nënprefekturës së Gjilanit, u organizuan sipas modelit të ushtrisë së rregullt. Kështu, një kompani kreshnikësh kishte 100 vetë, prej të cilëve zgjidhej një komandant, dy zëvendëskomandantë, katër kapterë dhe 10 tetarë. Katër kompani përbënin një batalion. Komunitat e mëdha formonin secila nga një batalion, ndërsa dy komuna të vogla formonin një batalion. Komuna e Hogoshtit, njëra ndër komunitat më të mëdha të nënprefekturës në zonën kufitare, formoi pesë kompani që udhëhiqeshin nga pesë komandantë dhe një komandant batalioni. Komandant i kompanisë I ka qenë Idriz Rama i Hogoshtit i kompanisë II Hysen Brahimi i Zhujës, i kompanisë III Rexhep Jashari i Poliçkës, i kompanisë IV Islam Zuka i Desivojcës, i asaj të V Sylë Selimi i Hogoshtit, ndërsa komandant batalioni u zgjodh Sylë Kopernica. Edhe komuna e Rogaçicës kishte një batalion, të përbërë prej pesë kompanive.¹¹⁴ Komandant i kompanisë I Zylfi Murati i Rogaçicës, II Metë Nuredini i Shipashnicës, III Selim Genga i Karaçevës së Epërme, IV Sylejman Çarri, V Ban Kranidelli, komandant batalioni u zgjodh Sadri Misini i Shipashnicës. Ndërsa komuna e Kamenicës dhe e Ropotovës, si komuna të vogla, formuan së bashku një batalion që komandohej nga Mehmet Rama i Topanicës.

LUFTA E LIVOÇIT (26 PRILL 1943)

Me 23 prill 1943 aradhja partizane arriti ne Zhegoc, ndërsa me 25 prill 1943 ne Kishnapole dhe Sllakoc të Jerlive. Shtabi i aradhes kishte vendosur që natën e 25 dhe 26 prillit të vitit 1943 te kalonte prej Kishnapole ne Gjilan dhe te dilte ne mal mbi fshatin Malisheve me qellim qe prej andej te dërgonte korrierët në Gjilan për t'u lidhur me Komitetin e rrethit. Mirëpo, meqë personi qe kishte ardhur për ta drejtuar aradhen ne Gjilan nuk e dinte rrugën. Aradhja u vendos në malet e Jabuqve ne mes te Poneshit dhe Livoçit të Epërm. Prej andej Shtabi i aradhes dërgoi ne Gjilan Sami Pejën dhe Jusuf Bajraktarin qe me anën e Vehbi Rexhepit do te lidheshin me anëtarët e Komitetit. Kjo detyre u krye me sukses. Por, aradhja qe diktuar nga armiku dhe ne mëngjesin e 26 prillit te vitit 1943 u rrethua te Jabuqte e Livoçit te Epërm nga ushtria italiane që përbehej ne fillim prej disa qindra vetash, ndërsa me pas prej me tepër se 2.000 vetave, te cilëve u printe komandanti karabinierëve. Në aradhë kishte vetëm 30 luftëtare te armatosur. Se bashku me forcat ushtarake italiane gjendej edhe një

numër i madh milicësh vullnetare dhe fshatare të mashtruar, të cilët i kishin mobilizuar duke u thënë se do të luftonin kundër partizaneve të ardhur nga Serbia. U përhapen edhe lajme se gjoja të rrethuarit janë çetnike, të cilët kishin ardhur për të bërë masakër mbi popullsinë shqiptare të kësaj treve. Vullnetaret udhëhiqeshin nga Mulla Idrizi dhe Ndue Pepa. Pas një luftimi të shkurtër vritet zëvendës komisar i aradhes, Musa Zajmi, dhe plagoset Nexhmedin Nixha. Ndërkaq, Komiteti i rrethit, kur mësoi gjendjen e vështirë në të cilën ndodhej aradhja, ndërmoi masa për ta ndihmuar atë. Për këtë krahas Komitetit të rrethit dhe komunisteve ndihmuan edhe njerëzit me ndikim dhe simpatizantët e Lëvizjes Nacionalçlirimtare. Kështu, përveç Hasan Dylgjerit, Vesel Rexhepit, Vehbi Rexhepit një ndihme të madhe dhëne edhe Rifat Berisha, nënprefekt i Gjilanit, Ramadan Jusufi, kryetar i komunës së Bresalcit, Ramiz Cernica, udhëheqës i vullnetareve të Cernicës etj. Pas kësaj, aradhja, duke marrë me vete kufomën e Musait dhe Nexhmedinin e plagosur u tërhoq në drejtim të Poneshit, që ishte një orë larg ngjarjes në fshatin Livoç i Epërm. Partizanet bashkë me disa fshatare e varrosen Musa Zajmin në varrezat e Muhaxhereve, ndërsa Nexhmedin Nixhen e strehoi për ta shëruar Maliq Malisheva, i cili në fillim qiti pushkë kundër aradhes, por pasi mori vesh se ishin partizane u tërhoq dhe u përpoq t'u ndihmoje. Pas varrimit të Musait, aradhja u nis në drejtim të Gadishit.

LUFTA E KIKËS (28 QERSHOR 1944)

Sulmi i parë i forcave çetnike nga Divizioni i 22-të serb të UNÇJ-se, në drejtim të Gollakut filloj me 28 qershor 1944 kur një grup 500-600 vetash të mobilizuar nga Toplica, Vranjaj, Leskovci sulmuan në drejtim të Kikës e Velegllavës me të vetmin qëllim për të depërtuar në drejtim të Gjilanit, por ata hasën në qëndresë të ashpër të Mbrojtjes Kombëtare e Tokave të Liruara-Zona italiane sipas ndrajes sipas okupimit Gjermane, Italiane dhe Bullgare me 16 qershor 1941 në Vjenë të Austrisë të cilat kishin moral të pathyeshëm meqë ishin në pozicione më të forta në mbrojtjen e trojeve të tyre etnike. Forcat e ushtrisë së rregulltë dhe fuqisë kreshnike filluan luftën. Gjatë luftës që vazhdoi 12 orë dhe betejës me datë 29 qershor 1944 grupet komuniste serbe, u shpartalluan me humbje. Kjo ndeshje me bandat komuniste u prit me manifestime simpatike nga populli. Aty u vra kapter Abdi Gjoka, nga Mati, Anëtar i Komitetit Komunal të Lidhjes II të Prizrenit, Bajram Poliçka e tjerëve. Sipas disa të dhenave nga raporti i frontit nga Limon Staneci forcat armike të brigadës së 13-të të divizionit 22 serb pësuan humbje katastrofale, kishin 200 të vrarë, 131 të zënë robër në mesin e të cilëve edhe 5 femra. Edhe forcat vullnetare patën humbje, kishin 17 të vrarë, nga të cilët 2 oficerë dhe

shumë të plagosur por, kjo fitore rriti moralin e guximin tek forcat vullnetare që i dilnin në mbrojtje kufirit.

LUFTA E RAINCËS 29 GUSHT 1944

Pas kapitullimit të Bullgarisë fashiste, më 9 shtator 1944, forcat e rezistencës kombëtare, sipas urdhërësës së KQ të Lidhja e Dytë e Prizrenit, në viset e çliruara, u themeluan organet politiko-ushtarake edhe për nënprefekturën e Preshevës. Nënprefekt u zgjodh Limon Staneci, komandant i xhandarmerisë Ali Staneci, kurse komandant i forcave të rezistencës u zgjodh Ibrahim Kelmendi. Filloi mobilizimi i vullnetarëve dhe u caktuan komandat e zonave mbrojtëse, në vijën hekurudhore Kumanovë-Preshevë Bujanoc, të udhëhequr nga njerëzit me ndikim si Xheladin Kurbalia, Hoxhë Lipovica, Sylë Hotla etj.pas largimit të ushtrisë së Boshtit Qendror, forcat partizane filluan të drejtohen nga Kosova. Njëra nga betejat që u zhvilluan ndërmjet forcave çetnike partizane dhe forcave vullnetare shqiptare qe edhe Beteja e Rekës Raincës, që njihet si luftë për mbrojtje të etnisë shqiptare dhe u zhvillua më 29 gusht 1944, Ditën e Bajramit, për mbrojtjen ndaj sulmit të forcave serbo-bullgare. Hoxhë Lipovica, në muajin shtator 1944, i është besuar detyra e komandantit të trupave vullnetare-balliste në luftë kundër partizanëve në frontin e Preshevës dhe atë në sektorin Raincë- Corroticë, ku edhe ishte aktiv në luftë, dhe ku më 9 shtator 1944-në ditën e bajramit, në atë sektor janë vra mbi 100 partizanë dhe janë zënë rob 206 të tjerë.

LUFTA E MYQIBABËS 30 NËNTOR 1944

Më 30 nëntor të viti 1944, Brigada e XVI Maqedone mobilizoi qindra veta prej Gjilanit, në Pisjan e në Zhegër kaluan lumin Morava e Binçes dhe para orës nëntë të mëngjesit iu ofruan Muqybabës. Nga Shtabi i Brigadës XVI, komanduar nga Glisha Sharanoviq, trupat e kësaj Brigade janë zhvilluar disa runde bisedimesh në mes te Ymer Myqybabës dhe të dërguarëve serb të Pasjanit. Ata kishin kërkuar leje me kalu gjëja se për Preshevë. Kjo kërkesë e tyre nuk u pranua dhe ne ora 10-të filloi sulmi i tyre. Forcat shqiptare në Myqybabë sipas të dhënave nuk kalonion mbi 120, dhe gjat ditës këtij numri iu shtuan edhe disa vetë, pasi që kishin dëgjuar të shtënat. Partizanët u zbrapsën katër herë dhe u ndoqën deri në Pisjan. Numri i tyre vinte e shtohet duke u shtuar me serb të fshatërave të Anamoravës. Në betejë u plagos komandanti i forcave shqiptare Ymer Myqybaba, i cili përherë ishte në krahun e mbrojtjes së popullatës civile, edhe të serbëve të Pasjanit gjatë pushtimit italo-bullgar dhe, ku shumë kishte të plagosur tjerë e të vvarë. Pas largimit të Ymer Myqybabës i plagosur rëndë vdes nga plagët disa ditë më vonë në fshatin Kokaj.

BETEJA E DESIVOJCËS 19 DHJETOR 1944

Një pjesë e Brigadës e XVII Maqedone marshojë në drejtim të Desivojcës, me 19 dhjetor 1944. Bataljoni i parë që duhej të shkonte në drejtim të Çarrit, do të jetë ndarë në Rogoçicë te vendi i çuajtur Katushnicë. Me këtë marshim drejtë Çarrit, brigada e fuste si në darë tërë Malësinë e Gollakut. Bataljoni i tretë u nisët në drejtim të Vruçevcit dhe i dyti në drejtim të Desivojcës. Luftëtarët që organizuan rezistencën kundër kësaj brigade ishin: Shefki Bunjaku, Aziz Surdulli, Sylë Zarbica, Muharrem Fejza, Dulah Hajra, Hysen Zhuja dhe të gjithë desivojcasit me fshatrat e kësaj treve. Veprimet e dhunës dhe të krimeve Brigada XVII Maqedonase i ka filluar porsa ka arritur në Lajciq te shtëpia e Rexhë Kamberit ku, në livadhet pranë tij të gjitha stogjet dhe çardakët e sanëve i djegin, por paniku më i madhë në popull u krijua kur i dogjën shtëpitë e Aziz Surdullit. Në këtë kohë një numër i konsiderueshëm bashkëluftëtarësh të Shtabit të Mbrojtjes Kombëtare, të prirë nga Mulla Idrizi, nisët prej thellësive të bjeshkëve drejt lagjeve të Desivojcës. Luftëtarët e Mulla Idrizit, të cilëve iu printe Azizi, Shefkiu, Sylë dhe Muharremi po atë natë vlerësuan se nuk i kanë mundësitë për ta shpartalluar dhe thyer Brigadën XVII Maqedonase. Më 20 dhjetor 1944, Sylë Zarbica me bashkëluftëtarët e vetë prej Gagicëve vërsulën kunder partizano-çetnikëve te kodra e Zhigollëve. Ndihmë të veçantë Sylës nga ana e jugut i ka ofruar Riza Lam Shkodra, i cili tregohet trim i pakompromis. Ndihma i kanë ardhur nga të gjitha lagjet e Desivojcës. Ndërkaq Batalioni që kishte shkuar në drejtim të Çarrit sulmohet nga luftëtarët e Muharrem Fejzës dhe të Fazli Ramadanit Novosellës. Muharrem Fejza me bashkëluftëtarët e vetë arrin ta shpartallojë plotësisht këtë Batalion, duke i shkaktuar humbje katastrofike. Kjo brigadë përjeton humbje të mëdha nga sulmet që i bëjnë: Sylë Zarbinca nga Lindja, Riza Shkodra nga jugu, Aziz Surdulli nga Veriu trimat e lagjeve Koman e Bunjak, dhe sulmet e Muharrem Fejzës në Çarr. Pas shkatërrimit të kësaj brigade luftëtarët shqiptar marshuan drejt Gjilanit për të çliruar atë dhe u ndalën në fshatin Përlepnicë.

MASAKRA E TIVARIT (24 MARS 1945)

Masakra e Tivarit është emërtimi për vrasjen masive të një numri të madh të civilëve shqiptarë të Kosovës në Tivar, të kryer nga njësitë partizane jugosllave (divizioni i 46-të serb dhe brigada e 10-të malazeze) në pranverën e vitit 1945, në fund të Luftës së Dytë Botërore. Viktimat ishin kryesisht shqiptarë nga Kosova, të cilët ishin rekrutuar nga Ushtria Nacionalçlirimtare e Jugosllavisë, që të përdoren në luftën kundër forcave gjermane dhe forcave të tjera të boshtit, që ishin duke u tërhequr nga Ballkani. Shqiptarët marshuan

nga Prizreni drejt Tivarit në tri grupe të ndryshme. Pothuajse të gjithë anëtarët e grupit tjetër të cilët nëpërmjet Shqipërisë arritën në Tivar ishin vranë nga rojet malazeze. Llogaritjet e numrit të viktimave ndryshojnë nga 400–450 sipas informatave zyrtare partizane dhe 1500–2000 sipas historianët shqiptarë. Pikë mbledhja e këtyre ushtarëve u caktua Prizreni, deri ku ata u drejtuan nga oficer shqiptarë. Në Prizren të gjithë ushtarët shqiptarët u çarmatosen me arsyetimin se do të lodheshin nga rruga dhe se kur të mbërrinin në front do të pajiseshin me armë moderne angleze. Nga Prizreni shqiptarët u nisën fillimisht për në Mal të Zi të ndarë në tri grupe. Grupi i parë prej 3,700 vetash u nis më 24 Mars 1945. Grupi i dytë me 4,700 vetë u nis me 26 mars dhe marshoj për katër ditë në vijën Prizren-Zhur-Kukës-Puk-Shkodër-Tivar. Ushtarët gjatë rrugës u rrahën apo në disa raste edhe u vranë kur dilnin nga kolona për ta shuar etjen. Kur kolona mbërriti në Tivar, ndodhi një konflikt në mes katër shqiptarëve dhe rojave, të cilët shtinë dhe vranë dy shqiptarë. Masa e zënë në grackë mes maleve të larta dhe detit u shtri për tokë, ndërkohë që ajo hapësirë ishte vënë në shënjestër të pushkëve dhe mitralozave që ishin vendosur në çdo qoshe të rrugëve, në dritare dhe në tarraca të shtëpive, e në shkëmbinj e kodra përreth. Më pas turma urdhërohet të ngitet dhe drejtohet drejt ndërtesë “Monopoli i duhanit” ku filluan të shtënat. Organet e pushtetit ushtarak në Gjilan mobilizuan një numër të konsiderueshëm të të rinjve për njësitet partizane, të cilët përmes Prizrenit e Shkodrës u dërguan në Tivar. Një pjesë e tyre u likuiduan gjatë rrugës e një pjesë jo vetëm që e përjetuan masakrën e Tivarit, por edhe vdiqën atje në fillim të prillit të vitit 1945.

SULMI NË GJILAN 23 DHJETOR 1944

Pas shkatërrimit të brigadës Maqedone në betejën e Desivojcës luftëtarët shqiptar marshuan drejt Gjilanit dhe u ndalën në fshatin Përlepnice. Thuhet se aty u bënë shumë polemika mbi sulmin për ose jo, mbi qytetin e Gjilanit. Thuhet se Mulla Idrizi ishte kundër sulmit mbi Gjilan, ndërsa pro sulmit ishin Sylë Zarinca, Muharrem Fejza Shefki Desivojca etj. Sulmi në Gjilan filloi më 23 dhjetor 1944. Sulmi mbi Gjilan u bë në tri drejtime, nga Stanishori, Koretishta dhe Malisheva. Gjilani bie në duart e luftëtarëve shqiptar, me prejashtim të ndërtesës së OZN-ës. Çetniko-partizanëve iu vjen në ndihmë Batalioni i II i Brigadës së V kosovare. Pas arritjes së këtij batalioni shumë më rëndë të armatosur, luftëtarët shqiptar fillojnë të tërhiqen nga qyteti dhe shpërndahen nëpër shtëpitë e veta, me prejashtim të udhëheqësve të kësaj rezistence. Shefki Desivojca vritet në luftë në Gjilan me pushkë në dorë, ndërsa Mulla Idrizi, Sylë Zarinca dhe Muharrem Fejza kalojnë në ilegalitet deri sa vriten nga forcat e OZN-ës. Pas rimarrjes së qytetit të Gjilanit nga çetniko-partizanët, u bënë

maskara të mëdha, nuk u kursye askush, as fëmijë, as gra, as pleq. Ka zëra që thonë se u masakruan deri në 8000 persona, ndonjë hulmutim i saktë mendoj që nuk është bërë kurrë. Mendohet që nga gjilanasit e vjetër (vendas) në Gjilan, në sajë të këtyre masakrave kanë mbijetuar shumë pak.

PERIUDHA PAS LUFTËS SË DYTË BOTËRORE (1946 – 1989)

PERSONALITETE

ANËTARËT E LËVIZJES NACIONAL DEMOKRATIKE SHQIPTARE

HALIM ORANA (1914-1947)

Lindi më 1914, në Gjilan. Shkollën fillore e kryeu në Gjilan, kurse në vitin shkollor 1926/27, u regjistrua në shkollën e mesme (normale) në Banja Llukë të Bosnjës dhe Hercegovinës. U angazhuar si aktor në teatrin e qytetit ku studionte. Kurse, shkollën normale e vazhdoi në Shkup, dhe e përfundoi më 1932. Punoi si mësues në fshatrat: Binçë, Sllatinë etj. Nga viti 1936 deri më 1941 vendoset me vendbanim në Vellika Klladusha të Bosnjës, ku punon si mësues. Pas shkatërrimit të Jugosllavisë nga forcat nazi-fashiste, vendoset në Zagreb. Pas kapitullimit të Italisë (shtator 1943), Qeveria shqiptare e Tiranës, Halim Orana e emëron përfaqësues të Shqipërisë në Shtetin e Pavarur Kroat me seli në Zagreb. Me hyrjen e forcave partizane në Zagreb, ai arrestohet, por lirohet menjëherë në mungesë të fakteve. Arrestimi i tij i dytë bëhet më 1946, në Beograd, nga e sjellin në Ferizaj, por prapë lirohet në mungesë faktesh për veprimtari antishtetërore. Në maj të vitit 1946 vendoset në Shkup dhe pas takimit me shumë intelektualë fillojnë përgatitjet për Kongresin e IV të LNDSH (Lëvizjes Nacional Demokratike Shqiptare), i cili u mbajt më 1 qershor 1946. Në këtë Kongres, Halim Orana u zgjodh kryetar i Kongresit dhe ky Kongres e zgjodhi kryetar të Komitetit Qendror të LNDSH me seli në Shkup. Pas disa muajsh aktiviteti, organet shtetërore jugosllave zbulojnë veprimtarinë e Komitetit dhe i burgosin anëtarët e tij. Më 10 shkurt 1947, në Zagreb burgoset edhe Halim Orana dhe dërgohet në burgun ushtarak të Beogradit. Kurse sipas aktgjykimin nr. 293/47, të datës 30 shtator 1947, nga Gjykata Ushtarake e Beogradit dënohet me vdekje nën akuzën për veprimtari në Lëvizjen Nacional-Demokratike Shqiptare dhe si udhëheqës i saj. Pas një kohe në fshehtësi dhe pa u njoftuar familja ishte bërë ekzekutimi i tij.

METUSH KRASNIQI (1927-1986)

Lindi më 19 gusht 1928 në fshatin Dajkoc të Komunës së Kamenicës (Dardanës). Shkollën fillore respektivisht katër klasat e para i kreu në gjuhën serbe në fshatin Hodanoc, ndërsa katër klasët tjera gjatë viteve 1942-1946 i kreu në Gjilan në gjuhën shqipe. Gjatë viteve 1947-1949 kreu një kurs pedagogjik në Pejë dhe Gjakovë, ndërsa në vitin 1950 diplomoi në Shkollën Normale të Gjakovës. Në vitin 1950-1951 filloi punën si mësues në shkollën fillore në Shipashnicë të Epërme. I frymëzuar nga veprimtarët e LNDSH, në Shipashnicë së bashku me kolegët e vet themeloi organizatën ilegale "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë". Autoritetet e arsimit vetëm një vit më vonë Metush Krasniqin e transferojnë në shkollën fillore të Strezovcit fshat ky në komunë të Dardanës. Aty punoi një vit dhe u transferua në Hogosht, ku e gjeti arsimtarin e gjuhës shqipe Ndue Nekajn dhe Hogoshti e mirëpriti ngrohtësisht ardhjen e tij. Pas një viti Metush Krasniqin e transferuan në shkollën fillore të Muçivërcit dhe në vitin shkollor 1955/1956 me vendimin e organeve arsimore të Rrethit të Dardanes (ish-Kamenicë), shkolla 8 klasëshe e Muçivërcit me gjithë arsimtarët dhe mjetet mësimore bartet në Roganë dhe për çudi po me atë vendim Metush Krasniqin e emëruan drejtor të shkollës në këtë fshat. Në vitin 1957 pas ndjekjeve dhe burgosjeve detyrohet të shpërngulet në Shkup. Atje krahas punës në arsim me një përkushtim të veçantë vepron në organizatën "Partia Revolucionare..." Në nëntor të vitit 1958 Metush Krasniqin do ta burgosin dhe e dënuan me 18 vjet burg të rëndë prej të cilave i mbanë vetëm 8 vite. Pas daljes nga burgu Metush Krasniqi i kaloi disa vite në fshatin e lindjes në Dajkoc. I entuziazmuar nga hovi që kishte marrë shkollimi, Metush Krasniqi më pas do të regjistrohet në Fakultetin Juridik në Prishtinë, dhe në vitin 1970 u punësua në shkollën e mesme teknike "19 Nëntori" në Prishtinë. Mirëpo, Metushin as këtu nuk e lanë të punoj qetë. Me një vendim të Dushan Ristiqt - Kryetar i KK të LKJ të Prishtinës dhe të kryeudbashit në Gjilan Aleksandar Cana Periq, Metush Krasniqin e larguan nga procesi edukativo-arsimor. Meqë atdhetari ynë Metush Krasniqi gëzonte një autoritet të madh në mesin e rinisë shkollore dhe universitare në Kosovë e në Maqedoni, ai kishte formuar një rreth të gjerë shokësh besnik, ishin ata si : Hasan Dermaku, Rexhep Mala e Skënder Kastrati, Njazi Korça nga Gëmica, Kadri Zeka nga Poliçka, Ethem e Fehmi Bajrami nga Malisheva e Gjilanit ; Rexhep Elmazi e Rafet Bajrami nga Gjilani ; Jusuf Gërvalla, Zeqir Gërvallën e Sabri Novosellën në Prishtinë, Shefqet Jasharin e shumë të tjerë. Në vitin 1976 Metush Krasniqi vihet në krye të Organizatës "Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës dhe e Viseve tjera Shqiptare në Jugosllavi" LNÇKVSHJ. Gjatë atyre viteve bënë përpjekje për bashkimin e të gjitha grupeve ilegale në

një organizatë të fuqishme. Metush Krasniqi gjatë viteve të 80-ta punoi në ilegalitet të thellë, por megjithatë UDB-a përmes informatoreve shqiptar, dinte për aktivitetin e Metushit dhe më 4 nëntor 1981 sërish burgoset, torturohet rëndë nga udbashi i Anamoravës Selim Brosha e shume të tjerë. Pas katër muaj lirohet në gjendje të rëndë shëndetësore. Më 4 nëntor 1985 Metush Krasniqi sërish burgoset dhe gjatë shtatë muaj e pesëmbëdhjetë ditëve sa e mbajtën në burgjet e Prishtinës e të Mitrovicës, rrahet e torturohet në mënyrat më mizore. Pasi ishte i dërmuar për vdekje UDB-a më 16 qershor 1986 e liron nga burgu dhe më 15 tetor 1986 duke mos pasur shërim ndërroi jetë. Varrimi i tij u bë në fshatin e lindjes në Dajkoc.

HASAN ALIA – REMNIKU (1913-1951)

Lindi më 1913 në Remnik (Viti). Deri në fillimin e Luftës së Dytë Botërore merrej me bujqësi. Me fillimin e Luftës së Dytë Botërore (1941), lumi Morava ndante zonën bullgare nga ajo italiane, kurse Remniku dhe shumë fshatra të Karadakut mbetën në zonën bullgare. Në shtator të vitit 1941 fshati Remnik rrethohet nga forcat bullgare dhe Hasan Remniku shpëton dhe largohet në Partesh që i takonte zonës italiane. Punoi si polic dhe truporjë i kryetarit të Parteshit Ramiz Cernicës. Pas masakrës që bënë forcat bullgare dhe popullsia lokale serbe në Remnik Hasan Remniku filloi të sulmoj këto forca dhe keqbërësit lokal serb. Gjatë viteve 1942 dhe 1943 vrau serb lokal që ishin bashkëpunëtor të pushtetit bullgar dhe që ushtronin dhunë në popullsinë shqiptare të zonës pushtuese bullgare. Hasan Remniku mori pjesë edhe në luftën e Preshevës më 1944 kundër forcave të LNÇJ-së. Pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore dhe hyrjes së forcave të UNÇJ, Hasan Remniku nuk u pajtua me gjendjen e krijuar. Mori pjesë edhe në përpjekjet për çlirimin e Gjilanit në dhjetor të vitit 1944. Pas dështimit të çlirimit të Gjilanit Hasan Remniku dorëzohet dhe burgoset. Pas liritimit nga burgu nuk iu bashkua asnjë grupi politik - ushtarak. Duke parë padrejtësitë që bënte pushteti jugosllav ndaj shqiptare, Hasan Remniku vendosi të bashkëpunoj me KQ të LNDSH-s. Ndihmoi në formimin e komiteteve të LNDSH-së në Anamoravë. Pas zbulimit të veprimtarisë së LNDSH (1947) dhe burgosjes së anëtarëve të saj në Shkup, Gjilan dhe Ferizaj, Hasan Remniku kaloi në ilegalitet të thellë ngase kërkohet vazhdimisht nga OZNA. Hasan Remniku gjente strehë nëpër fshatrat e Anamoravës si në Remnik, Lubishtë, Smirë, Livoç i Epërm, Bresalc, Gadish, Ponesh etj. Në këto kushte tenton të largohet në drejtim të Shqipërisë. Më 6 tetor 1951, Hasan Remniku me grupin e tij nisjet për në Shqipëri. Pasi kaloi lumin Lumbardh afër Prizrenit, më 10 tetor 1951 bien në pritë të forcave serbe dhe vritet me shokët e tij. Kështu pas vrasjes së tyre, më 11 tetor 1951, trupat e tyre të vdekur ekspozohen

në Viti, kurse më 12 deri 14 tetor 1951 ekspozohen edhe në Gjilan. E gjithë kjo bëhej që tek shqiptarët të mbjellin tmerr dhe pasiguri. Varri nuk i dihet.

HAKI SERMAXHAJ (1914-1948)

Mulla Haki ef. Sermaxhaj lindi më 14 tetor 1914 në fshatin Hogosht , komuna e Dardanës (Kamenicë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Medresenë e filloi në Gjilan dhe e përfundoi në Shkup. Një kohë punoi si mësues feje në Gjilan. Edhe Mulla Hakiu sikurse edhe shumë atdhetar të tjerë duke e parë se vendi i tij po grabitej nga okupuesi shekullor, ai angazhohej për të mbrojtur trojet shqiptare. Ishte organizator i mbrojtjes së kufirit të Kosovës Lindore, anëtarë i Komitetit Qarkor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit për nënprefekturën e Gjilanit. Më 1945 i bashkëngjitet Lëvizjes së NDSH-së dhe zgjidhet Kryetar i Komitetit Qarkor të ONDSH-së të kësaj nënprefekturë dhe anëtarë i KQ të ONDSH-së në Shkup. Poashtu Mulla Haki ef. Sermaxhaj ishte pjesëmarrës i Kongresit të Katërtë të ONDSH-së që u mbajt në Shkup më 1 qershor 1946. Me zbulimin e veprimtarisë së ONDSH-së, zbulohej edhe veprimtaria atdhetare e Mulla Haki ef. Sermaxhajt. Arrestohet më 13 tetor 1946. Në procesin gjyqësor të Gjilanit iu shqiptua dënimi prej 20 vitesh burg të rëndë. Në burgun e Mitrovicës së Sremit ku ishte dërgua për të mbajtur burgun, nga maltretimet e mëdha që pati nga gardianet dhe nga kushtet tejet të vështira, atdhetari vdes me 27 mars 1948 nga tuberkulozi, vetëm pas 8-9 muajve qëndrimi në spitalin e Burgut të Mitrovicës së Sremit. U varros nga shokët e burgut në varrezat e Burgut të Mitrovicës së Sremit.

MUSTAFË RUSHITI - KOKAJ

Lindi më 1931 në fshatin Kokaj (Gjilan). Në nëntor të vitit 1944, në moshën 17 vjeçare u bashkua me njësitet partizane të brigadave shqiptare që kaluan nëpër Kokaj dhe u vendos në Tiranë. Deri më 1947, kreu një kurs ushtarak dhe gjimnazin ku u kualifikua për mësues. Në fund të vitit 1947 kthehet në Kosovë dhe fillon punën si mësues. Punoi në Uglar, Lubishtë dhe Remnik. U martua me Rabijen nga Remniku. Pushteti komunist jugosllav pas Luftës së Dytë Botërore, për shqiptarët u bë i padurueshëm, kështu që Mustafë Kokaj. nuk punoi gjatë në arsim dhe vendosi që me armë ta kundërshtoj këtë pushtet. Meqenëse OZNA e përcillte veprimtarinë e tij dhe sidomos pas vrasjes së dy policëve serb në shtëpinë e tij, më 6 qershor të vitit 1951 detyrohet të largohet në mal dhe u bashkua me grupin e Hasan Remnikut. Vazhdimisht kërkohet nga sigurimi jugosllav. Mustafë Kokaj qëndori i fshehur në fshatin Lubishtë të Vitisë pastaj në fshatrat Rahovicë dhe Strezovc të Preshevës dhe në vjeshtë të vitit 1951 vendosi të kthehet në kullën e tij në Kokaj. Duke parë rrezikun që vinte nga

pushteti serb edhe për familjet që strehonin dhe duke parë se rrethi ngushtohej së bashku me Hasan Remnikun dhe shokët tjerë më 6 tetor 1951 vendosën të shkojnë për Shqipëri. Më 10 tetor 1951, duke kaluar lumin Bistrica të Prizrenit binë në pritë të forcave serbe dhe vritet i tërë grupi i Hasan Alisë në mesin e tyre gjendej edhe Mustafë Kokaj. me gruan e tij Rabijen që ishte shtatzënë. Kështu pas vrasjes së tyre, më 11 tetor 1951, trupat e tyre të vdekur ekspozohen në Viti, kurse më 12 deri 14 tetor 1951 ekspozohen edhe në Gjilan. E gjithë kjo bëhej që tek shqiptarët të mbjellin tmerr dhe pasiguri. Varri nuk i dihet.

IBRAHIM KELMENDI

Lindi më 16 prill të vitit 1916 në Preshevë. Ishte antikomunist dhe shkrimtar shqiptar. Pas mbarimit të shkollës fillore në Preshevë, Ibrahim vendos të studiojë në gjimnazin e medreses në Shkup. Studimet universitare për histori i filloi në Beograd. Megjithëse nxënës i shkëlqyer në gjimnazin e Shkupit, dëshira e tij për historinë e luftërave ballkanike dukej se po daravitej nën peshën e falsifikimeve. Pa disa kërkesave të rreshtura largohet nga Beogradidhe fiton të drejtën për të vazhduar studimet për histori në Universitetin e njohur të Peruxhës në Itali.

Ibrahim Kelmendi u rradhit tek Balli Kombëtar, i cili në këto momente të vështira kërkon ti gjendet sa ma pranë Preshevës. Krahu më krahu me nacionalistët e tjerë të Ballit, mori pjesë në betejat të ndryshme si në Preshevë, Gjilan, Budrikë, Bujanoc. Si anëtarë i Komitetit Qendror të Ballit Kombëtar për Kosovë pas përforcimit të mbrojtjes kufitare të trojeve etnike, prof. Kelmendi do të kalojë me instruksionet e tija në Karadak e Sharr, do të ndihmojë Mulla Idriz Gjilani e Xhemë Gostivarin, do të marrë pjesë në betejën e Ferizajit me rininë Nacionaliste së bashku me prof. Luan Gashin e Abdyl Hencin e nacionalistët e tjerë. Ibrahim Kelmendit pas Luftës Dytë Botërorengë pushteti serb dhe maqedon i vihen bashkarisht në ndjekje të tij dhe ballistëve tjerë. Ai dhe bashkëluftëtarët e tij, në krye me Sylë Hotlen për të mos ngritur pushkën mes vëllezërëve të një gjuhe dhe të një gjaku, si prof. Ibrahim Kelmendi me urdhër të Organizatës së Ballit Kombëtar, e lë atdheun, në kampet e refugjatëve politik në Greqi. Disa vite më vonë më 1953, i plotësohet kërkesa dhe shkon në Australi ku menjëherë falë aftësive të tij fillon punën si pedagog në njërin prej gjimnazeve të Melburnit. Si emigrant ai, merret me studime për etnogjezën shqiptare, hulumton nëpër biblioteka, shkruan dhe boton mjaft punime me vlerë si në shtypin vendas ashtu edhe në atë të shqiptarëve të diasporës. Vdiq më 24 janar të vitit 1979 në Melburn të Australisë.

ISAK GASHI (BRESTOVCI)

Isak Sherif Brestovci apo Isak Gashi lindi në Gjilan rreth vitit 1909 apo 1910. Ishte 34 apo 35 vjeçar Babai i tij Sherifi se bashku me te vëllanë Behlulin humben diku ne lufte dhe nuk u kthyen ma. Isaku mbetet pa baba në moshën 3 ose 4 vjeçare nen përkujdesjen e xhaxhait te tij Osman Brestovcit. Ishte i martuar me Nuriyen bijën e Halit Caushit, te rritur si "fëmije për shpirt kurse ajo ishte ne te vërtete e bija e Ibush Pllanes. Isaku ishte i arsimuar, kishte te kryer Medresenë e Gazi Isa Beut ne Shkup. Ishte njohës i mire gjuhës italiane. Me 1941 kundërshton emërimin e Janko Haslit kolon slloven nga Tankosiqi (Dardania), për kryetar komune nga ana e gjermaneve. Intervenon te Xhafer Deva ne Mitrovice dhe kërkon largimin e Haslit nga ky post dhe ia arrin qëllimit. Isak Sherif Brestovci, duke pare rrezikun qe i kanosej Gjilanit te mbetet nen sundimin serb. Qeverinë kuislinge te Nediqit (zone nen okupimin gjerman) shkon shpejt te Xhafer Deva ne Mitrovice dhe e njofton se Gjilani gjendet ne rrezik te mbetet nen Serbi, e lut atë te vije ne Gjilan dhe te ndikojte te gjermanet qe Gjilani te mbetet në Zonën italiane, respektivisht ne pjesën e tokave shqiptare, nen sundimin italian. Pra, Isaku është shkaktar qe Gjilani te mbetet nen Shqipëri. Xhafer Deva e përmirëson gjendjen që nga qershori i vitit 1941, e deri me 16. 11.1944 ka qëndruar ne postin e sekretarit te Bashkime se qytetit te Gjilanit. Para lufte dallohej ne përhapjen e ideve kombëtare ne Kosove. Ishte anëtar i Organizatës se Rinise Përparimtare. Drita te formuar me 1 prill 1937 ne Arllat te Drenicës. Gjate Luftës se Dyte Botërore, ishte nen ndikimin e ideve antifashiste dhe te ai vërehej një doze e bashkëpunimit si me nënprefektin e Gjilanit, Rifat Berishën, por edhe me komunistet gjilanas, si bie fjala me Vesel e Vehbi Rexhepi, me te cilët Isaku kishte lidhje miqësore. Nga fundi i vitit 1942, nënprefekti Rifat Berisha, ne vend te Esat Berishës e që ishte i angazhuar ne shume detyra te rëndësishme, për udhëheqës te seksionit te Partisë Fashiste Shqiptare, për Nënprefektore te Gjilanit emëron Isakun. Isaku ishte delegat ne Kuvendin Themelues te Lidhjes se Dyte te Prizrenit ne shtator 1943. Pas hyrjes se komunisteve ne Gjilan, me 16 11 1944, kurse ata me 17 11 1944 organizojnë miting ne qytet, i vetmi reagon ashpër, duke dale ne foltore i paftuar, kundërshton hyrjen e komunisteve ne Gjilan reagon kundër përdhosjes se flamurit kombëtar. Pasi qe atë e hedhë ne toke një serb gjilanas nga familja e Neshiqve, Gjura Neshiqi. Po atë dite, ne mbrëmje, arrestohet, brenda natës apo te nesërmen nder te paret ekzekutohet, menjëherë pas kryetarit te Bashkime se Gjilanit Mustafa Natikut.

AGUSH HAZIRI

Agush Mehmeti apo Haziri u lind në maj 1920 në fshatin Bresalc, në një familje me tradita patriotike. Meqë mungonin shkollat në gjuhën shqipe si pasojë e sundesit të kohës, mësimet e para i zhvilloi në odën e burrave dhe aty u kalit në frymën kombëtare. Si shumë të tjerë, si i ri edhe ky mori pjesë në mbrojtjen e tokave shqiptare, që vazhdimisht rrezikoheshin nga okupatorë të ndryshëm dhe shumë shpesh dilnin në Kikë me bashkëfshatarët e tij, për të ndalë turrin e komitave që tentonin të hynin në këto anë. Pastaj merret ushtar në Suboticë, i cili pas një kohe të shkurtër operohet nga zorra e verbër dhe udhëzohet nga spitali që të vazhdoj detyrën në njësi, mirëpo ai ndërroi kahjen dhe largohet për në shtëpi. Një kohë të gjatë edhe pse u kërkua, vazhdoi të rri fshehurazi dhe nuk lajmërohej fare. Gjatë Luftës së Dytë Botërore bashkë me 3 vëllezër dhe 5 kushërinj dhe shumë bashkëluftëtarë të tjerë u rreshtuan me forcat demokratike. U angazhua si ushtar i rregullt i Ushtrisë Shqiptare, në Regjimentin e IV-të, në Prishtinë. Mori pjesë në rrethinën e aradhes partizane "Emin Duraku" në malet e Livoçit, nga të cilat luftime mbeti i vrarë Musa Zajmi. Po të njëjtit më 2 dhjetor 1944 morën pjesë në sulmin për çlirimin e Ferizajit, ku nga forcat serbe në qendër të tij vritet Daut Rexhë Haziri. Më 23 dhe 24 dhjetor 1944 mori pjesë në formacionet e Molla Idriz Gjilanit në sulmin për çlirimin e Gjilanit nga forcat serbe. Pas përfundimit të luftës së Dytë Botërore arrestohet dhe dërgohet në Srem të Vojvodinës, kinse për të mbrojtur kufinj të Jugosllavisë, ku qëndroi deri më 1947. Pasi kthehet nga Serbia, si atdhetar me traditë familjare bie në kontakt me shokët e veprimtarisë patriotike, bashkë me Ramadan Bejtën dhe vëllain tij Ibush Haziri, formojnë grupin diversant të LNDSh-së të përbërë prej 30 anëtarësh, shumë nga ta nga bashkëfshatarë. Agush Haziri me urdhër të Hasan Alisë së bashku me shokë, organizojnë prerjen e shtyllave të telefonit në fshatin Shillovë, me qëllim paralizimin e lidhjeve të organeve okupuese të Gjilanit me Serbinë. Për këtë vepër u maltretuan mizorisht shillovasit deri sa u zbulua grupi dhe arrestohen. Prokurori i kohës Zekoviq, ngritë aktakuzën dhe organizon gjykim publik për "kontrarevolucionarë", ndaj të cilëve turma serbe kërkonte dënim me vdekje. Dy nga ta Agush Haziri dhe Ramadan Bejta dënohen me vdekje-pushkatim, mbi të cilët u ngarkohet edhe një vrasje, të cilët në bashkëveprim me Hasan Remnikun kishin vrarë Petar Markoviqin, sekretar i PKJ për rrethin e Shillovës dhe Malishevës. Një ditë para pushkatimit, në prill të vitit 1950, Agush Haziri falë shkathtësive që posedonte arrin të thejë burgun e Gjilanit dhe me pranga niset drejt lumit Dobrusha, arrinë deri në fund të Korotishtës, ku me përdorimin e gurëve këput një hallkë të vargojve që kishte në këmbë dhe arrinë në Bresalc. Në ditët në vijim burgoset Latif Haziri, i cili mbahet në burg për rreth tre muaj. Bresalci mbahej për 6

javë i kontrolluar. UDB-ja premtoi shuma të mëdha parash për ata që do të kapnin apo do të vrisnin Agushin. Pas shtatë dite gruaja dhe motra arrijnë që t'ia këpusin të gjitha prangat. Për një kohë ai u strehua në shtëpinë e Kadri Uruçit nga Bresalci, që ndau një dhomë të vogël, të cilën e përgatiti brenda natës që të mos hetohet. Mirëpo, në atë hapësirë nuk jetohet prandaj kërkoi nga ta, që ta nxjerrin në mal dhe ta takojnë me Hasan Alinë, të cilin takim e bëri të mundur Naman Qarroli nga Bresalci në shtëpinë e vjetër të vëllezërve Haziri. Pas më shumë se tetë muajsh qëndrimi në male, më 9/10 tetor 1951 bien në kurth diku në luginën e lumit Bistrica dhe vriten Agush Haziri, gruaja e tij Qibrije Alidemi Haziri, Hasan Alia, mësuesi Mustafë Kokaj me bashkëshorten Rabijen. Pasi vriten ekspozohen në Qendrën e Tregut në Prizren, pastaj në Tregun e Vitisë dhe në fund transferohen në qendër të Gjilanit, trupat e të cilëve ekspozohen për tri ditë rresht para sheshit të "Lama e Miellit" (Shtëpia e Mallrave) në Gjilan, me qëllim që të shërbejnë si shembuj për t'i frikësuar qytetarët e kësaj treve shqiptare, trupat e të cilëve ua humbin gjurmët.

REXHEP DAJKOCI

Lindi më 31 korrik 1909, në Dajkoc të Kamenicës. Më 1927 shpërngulet në Shqipëri, kurse më 1941 kthehet prapë dhe vendoset në Gjilan. Ka fundi i vitit 1944, si plotë të tjerë edhe Rexhep Dajkoci mobilizohet në radhët e Brigatës së VII-të të Ushtrisë Nacional-çlirimtare të Kosovës. Në brigadë qëndroi deri më 2 shtator të vitit 1945. Më 1946 anëtarësohet në LNDSH (Lëvizja Nacional-Demokratike Shqiptare). Ai zgjedhet kryetar i Komitetit të rrethit të LNDSH-së për Gjilan. Rexhep Dajkoci ishte i angazhuar të formonte komitete nëpër fshatrat e Kamenicës, Vitisë dhe Gjilanit. Më 25 korrik të vitit 1946, ftohet delegat në Kongresin e Blinajës. Edhe pse mbajtja e Kongresit ishte zbuluar nga UDB-ja, Rexhep Dajkoci nuk u zbulua. Pas zbulimit të Komitetit Qendror në korrik të vitit 1946, u zbulua edhe Rexhep Dajkoci, i cili u arrestua më 21 tetor 1946 dhe u mbajt në burgun e Ferizajit pastaj të Gjilanit. Në shkurt të vitit 1947, gjykata e qarkut në Gjilan e dënoi me 15 vjet burg. Burgun e mbajti në Mitrovicë të Stremit. Edhe pas lirimit nga burgu ishte nën përcjellen e UDB-së serbe, sepse ai vazhdonte veprimtarinë ilegale kundër shtetit jugosllav. Vdiq në Gjilan.

MARK GASHI

Lindi në fshatin Zhegër të Gjilanit me 23 mars 1912. Ishte i akuzuari i dyte i grupit të Metush Krasniqit. Pseudonimi i tij ishte "Iljaz". Jetonte dhe punonte në Presheve. Kishte të mbaruar

shkollën Normale dhe me profesion ishte mësues. U arrestua me 1 nëntor 1958. Po ashtu edhe Marko Gashi, nga Gjykata e Qarkut në Gjilan më 7 mars 1959, iu shqiptua një dënim i rëndë prej 10 viteve burg të rëndë. Akuzohej se kishte kryer vepra penale që binin në kundërshtim me Ligjin Penal të Jugosllavisë. Akuzohej në bazë të nenit 117, paragrafi 2, lidhur me nenet 100 dhe 101, paragrafi 1, të ligjit penal jugosllav. Në këtë proces gjyqësor ai njëkohësisht e humb edhe drejtën e votës, të drejtën e realizimit dhe të kryerjes së funksioneve zgjedhore në organizata dhe në shoqata shoqërore për 2 vite.

PERSONALITETE NGA LËVIZJA ILEGALE

KADRI ZEKA (1953-1982)

Kadri Zeka lindi më 25 prill të vitit 1953 në fshatin Poliçkë, Komuna e Dardanës. Shkollën fillore e mbaroi në Desivojë. Meqë më 1968 familja e tij u shpërngul në Gjilan. Shkollën e mesme e mbaroi në Gjilan. Më 1972 regjistrohet në Fakultetin Juridik, në Prishtinë, dega e gazetarisë. Më 1973 Kadri Zeka ishte pjesë e organizatës "Grupi revolucionar". Ishte në një celulë me Rexhep Malën, Hilmi Ramadanin dhe Hydajet Hysenin, që ishin shokët e tij të pandashëm. Fillimisht Kadri Zeka ka qenë anëtar i celulës, kurse pas arrestimeve të vitit 1974 dhe 1975 të anëtarëve të Grupit Revolucionar, Kadri Zekës kalon në Komitetin Drejtues (që ishte organi më i lartë i Organizatës), në këtë cilësi ka qenë deri në fund të jetës së tij. Ndërkohë punoi si gazetar në Radio Prishtinë. Kadri Zeka ka qenë i suksesshëm në zgjerimin e radhëve dhe për këtë qëllim ka shkuar të punojë e të jetojë për një kohë në Malësinë e Gollakut, (Punoi si mësues në Gmicë të Dardanës). Ka mbajtur lidhje të fshehta me Rexhep Malën e shokë të tjerë, edhe gjatë qëndrimit të tyre në burg. Pas gjurmimeve sistematike të UDB-së aty kah marsi i vitit 1978 hetohet veprimtaria e tij. Fillimisht Kadri Zeka shkon për disa javë në Turqi, por meqë nuk kishte ndonjë risi kthehet prapë në Kosovë. Pastaj Kadri Zeka shkon në Zvicër, në qytetin St. Gallen, ku ndihmohet nga anëtarët e Organizatës si Hasan Mala, Kadri Abdullahu, etj. Përmes veprimtarisë së tij patriotike dhe të bashkëveprimtarëve në mërgim, me angazhimet e tij u mundua gjatë gjithë kohës të bashkonte, në kërkim të të drejtave kombëtare dhe lirisë së trojeve shqiptare nën pushtim. Gjatë dekadave të kaluara, qysh nga vitet e rinisë së hershme si në Kosovë, ashtu edhe në ekzil në Gjermani, edhe pse e dinte se 24 orë ishte nën vëzhgimin e UDB-së, ai nuk u thye kurrë dhe nuk hoqi dorë asnjëherë nga ideali i tij patriotik. Për veprimtarinë atdhetare në diasporë, më të njohurit ishin Kadri Zeka dhe Vëllezërit Gërvalla. Ata për asnjë moment nuk hoqën dorë nga ideat e tyre atdhetare deri në fund të jetës së tyre, e cila përfundoi nga një

atentat i organizuar nga UDB-ja më 17 janar të vitit 1982, duke lënë të vdekur Bardhoshin dhe Kadri Zekën, kurse Jusufin të plagosur rënd, i cili vdiq në orët e hershme të mëngjesit në spitalin e Heilbronnit të Gjermanisë. Kurse eshtrat e Kadri Zekës u kthyen në atdhe në vitin 2002 dhe pushojnë në varrezat e dëshmorëve në Gjilan.

REXHEP MALA

Lindi më 29 mars 1951, në fshatin Hogosht (Kamenicë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje; ndërsa të mesmen në gjimnazin "Zenel Hajdini" e filloi në Gjilan. Si nxënës i vitit të tretë u burgos dhe u dënua me një muaj burg për kundërvajtje. Ishte në radhët e para të organizimit të demonstratave të vitit 1968 në Gjilan për çka edhe u dënua. Një vit më vonë për shkak të veprimtarisë ilegale u përjashtua nga gjimnazi i Gjilanit, për tu regjistruar pastaj në gjimnazin "Skënderbeu" të Preshevës ku kreu maturën. Në vitin 1970, punoi si mësues në Marec të Prishtinës. Gjatë vitit 1970/71 u regjistrua në fakultetin ekonomik në Prishtinë. Si veprimtar ilegal pas vitit të parë kaloi kufirit për në Shqipëri. Pas kthimit në Kosovë u gjykua për kundërvajtje në Gjilan dhe u dënua përsëri me 1 muaj burg. Për një kohë kaloi në disa shtete perëndimore si në Francë, Itali, Gjermani etj. Në vitin 1974, u burgos si pjesëtarë i Grupit Revolucionar të cilën e udhëhiqte Adem Demaçi. Pas 9 muaj hetimesh të mundimshme u dënua me 9 vjet burg. Burgun e vuajti në burgjet më të rënda si në Prishtinë, Mitrovicë, në Shtip, Prizren, Mostar etj. Nga burgu u lirua më 1983. Asnjëherë nuk u pajtua me gjendjen në Kosovë deri sa ra heroikisht në përleshje të armatosur me forcat policore të Jugosllavisë së bashku me shokun e tij të idealit Nuhi Berishën më 12 janar të vitit 1984 në lagjen Kodra e Trimave në Prishtinë.

NUHI BERISHA

Lindi më 3 tetor 1961 në Svirçë të Dardanës (Kamenicë). Shkollën fillore e kreu në vendlindje, gjimnazin në Gjilan, ndërsa Fakultetin juridik dhe të Kulturës fizike i vijoi në Prishtinë. Ishte nxënës dhe student i shkëlqyshëm. Nuhiu kishte vizion të çartë për të ardhmen e Kosovës dhe guximin e duhur për të vepruar kundër regjimit të atëhershë qysh nga bankat e shkollës së mesme. Ndërsa si student me iniciativën e Rexhep Malës dhe të bashkëveprimtarëve të tjerë formohet Komiteti i Studentëve në kuadër të Grupit Revolucionar, i cili do ti shërbejë Lëvizjes çlirimtare të shqiptarëve si bërthamë e parë për lëvizjen e pranverës studentore të 1981-it. Rexhep Mala dhe Nuhi Berisha provuan të vihen në themelet e një organizimi të lëvizjes çlirimtare, që vepronte në kontunitet, kurse me 1973 filluan veprimtarin e tij në botimin e gazetës "Zëri i Kosovës". Nuhi Berisha dhe Rexhep Mala në

mesnatën e 11 e 12 janarit të vitit 1984 ranë heroikisht gjatë përleshjes me forcat policore serbe në Kodrën e Trimave në Prishtinë. Nga rënia Rexhep Malës e Nuhi Berishës- gjatë përleshjes me forcat policore serbe, në Kodrën e Trimave në Prishtinë, natën ndërmjet 11 e 12 janarit të vitit 1984, ranë heroikisht Rexhep Mala e Nuhi Berisha.

ZIJA SHEMSIU (1950-1985)

Lindi në vitin 1950 në Përlepnicë të Gjilanit. Ishte veprimtar politik. Zija Shemsiu ishte anëtarë i organiztës ilegale Lëvizja për Republikën Socialiste Shqiptare, e cila veç aktiviteteve propagandistike kishte filluar që nga Perëndimi të sillte armatim. Zija Shemsiu ishte organizator i blerjes dhe transportit të armëve nga Perëndimi në Kosovë. Më 9 tetor të vitit 1983, kur Zija Shemsiu dhe bashkëpunëtori i tij Sami Kurteshi nga Gjilani u arrestuan në afërsi të Beogradit, te këta dy veprimtarë u gjet armatim kryesisht i destinuar për kryerjen e aksioneve diversante, të cilat janë veprimet e para luftarake parapërgatitore për kryengritje të përgjithshme në vendet e pushtuara. Ky armatim përbëhej nga një automatik italian i kalibrit 9 mm, një pistoletë Browning e kalibrit 9 mm, një pistoletë Walther, një revolver Smith & Wesson i kalibrit 38 special, 1.000 fishekë, si dhe sasi të konsiderueshme të eksplozivit plastik. Gjithashtu edhe armatimi i gjetur nga policia serbe në shtëpinë e familjes Shemsiu, si dhe ai i cili ishte shpërndarë, kryesisht ishte armatim i të njëjtit lloj. Arrestimi edhe i tetë anëtarëve të tjerë të këtij rrjeti (pesë nga familja Shemsiu) dhe dënimi i tyre me burg të rëndë, e gjymtoi në masë të madhe lëvizjen ilegale të asaj kohe, si dhe e ndërpreu nismën e organizimit ushtarak të popullatës shqiptare. Vritet në 5 maj 1985 në burgun e Beogradit.

REXHEP ELMAZI

Lindi më 3 janar të vitit 1938 në Gjilan. Rrjedh nga një familje e varfër por bujare, e cila pas një zullumi të madh të serbëve në Malishevë të Gjilanit, u detyrua të shpërngulet nga fshati në qytet më qëllim të shpërnguljes së mëtejme për në Turqi. Mirëpo, falë dashurisë për vendin e vet dhe ndikimit të intelektualëve të kohës ndërron mendjen dhe nuk shpërngulet në Turqi. Rexhepi shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan. Mëqë nuk kishte kushte për shkollim, ai detyrohet të punon si përkthyes, por aktivisht merret me shkrime letrare dhe me veprimtari patriotike. Në hezin më të madh të rankoviqizmit, më 28 nëntor 1963, në shtëpinë e Hysen Dacit, në Mitrovicë, bashkë me babën e tij, Hamdi Dacin, pastaj me Mustafa Venharin, Ramadan Shalën, Kadri Kusarin, Sylë Shalën, Din Spahinë, Fazli Graiçevcin, Rexhep Elmazin, Xhyllie Radoniqin e Bedri Çollakun (përveç Hysenit e meje, të gjithë të

tjerët të ndjerë), themeluan Lëvizjen revolucionare për bashkimin e shqiptarëve. Punimet e tij të para u botuan në revistën "Zëri i rinisë" e pastaj edhe në "Jeta e Re" dhe në të gjitha gazetat e revistat shqipe, që botoheshin në atë kohë në Jugosllavi. Veprimtarisë së tij ilegale patriotike i ranë në gjurmë dhe e burgosën në vitin 1964 dhe e denojnë me 9 vjet burg. Pas rënies së politikës deskriminuese ndaj shqiptarëve të Alekandër Rankoviqit, Rexhep Elmazi lirohet nga burgu. Për nder të tij një shkollë fillore mban emrin e tij "Rexhep Elmazi". Pas burgut Rexhep Elmazi kryen Fakultetin filozofik-drejtimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe në vitin 1975, por për shkak të "njollave" në biografinë e tij ai detyrohet të punon si përkthyes. Meqë pushteti i atëhershëm Rexhep Elmazin e konsideronte si personalitet të rrezikshëm për regjimin, atij i kurdisen plot kurtha dhe më 16 maj të vitit 1978 vritet. Rexhep Elmazi kishte ndikim të madh tek dashamirët e krijimtarisë letrare në Gjilan, dhe disa penda të njohura të letërsisë shqipe e konsiderojnë si baba të letërsisë për Gjilan dhe Anamoravë. Me studimin "Poezia e Rexhep Elmazit", 2008, studim me të cilën edhe magjistroi në letërsi mr. Tahir Arifi, profesor i letërsisë në Univerzitetin e Prishtinës. Ka shkruar mjaft, por shkrimet e tij janë asgjësuar nga bastisjet e shumta që janë bërë në shtëpinë e tij.

VEHBI IBRAHIMI

Vehbi Ibrahimimi ka lindur me 23 maj 1938 në fshatin Uglar të rrethit të Gjilanit. Pas përfundoi shkollën fillores në fshatin Uglar, Vehbiu e vazhdoi shkollën në fshatin Malisheve. Shkollën e Mesme profesionale të Mekanikut të Makinerisë e kreu në Tuzëll të Bosnjës dhe menjëherë u regjistrua në Fakultetin e Xehetarisë po në këtë vend, ku edhe pat punuar një kohë jo të gjatë, për t'u kthyer prapë në vendlindje, ku fillimisht e hapi një dyqan të vogël për shërbime fshatarësisë së Uglarit, cilin, pas tre muajsh dhe fillimisht u përpoq të punoj si fotograf, pasi që nuk mundi të gjente punë në profesionin për të cilin ishte aftësuar si mekanik. Ai punësohet në Kombinatin e Tekstilit në Gjilan, por jo në profesionin e tij si mekanik, por si punëtor i thjeshtë. Në Kombinatin u njoh me shumë të rinj që edhe ata kishin ndjenja patriotike për atdheun e robëruar e të copëtuar shqiptar. Vehbiu erdh me ide që ta krijon një organizatë politike, mundësisht legale, çka ishte e pamundur atëherë për rrethanat që ekzistonin. Andej ky me disa shokë formuan Shoqatën kulturore, cilën e pagëzuan me emrin: Shoqëria demokratike « Ismail Qemali » ndërsa anëtarët e saj veten e quanin « Qemalista ». Ata përpiluan edhe një lloj Programi sa për sy e faqe për okupatorët duke thënë se kjo është shoqatë kulturore, artistike, demokratike që nuk i qe nuk i cenon ligjet e rendit socialist dhe bile për të mbuluar gjurmët, fillimisht patën përgatitur një shfaqje teatrale të cilën e dhanë në

Kombinat para punëtorëve dhe në disa shkolla fillore. Rolin kryesor në edukimin dhe përcaktimin e tij në rrugë të drejte kombëtare ka qenë njohja dhe bashkëpunimi i tij i ngushtë me Metush Krasniqin, nga i cili mësoi shumë gjëra me rëndësi. Në fillim të Qershorit të vitit 1969 kur Vehbiu u detyrua ta lëshoi Kosovën dhe ilegalisht kaloi fillimisht në Austri, e pas tri vjet qëndrimi atje, të shkojë në Bruksel të Belgjikës ku jetoi me familje. Pas vendosjes në Austri, Vehbiu filloi të angazhohet duke marrë kontakte me njerëzit që gjendeshin të punësuar në Austri me statusin e “përkohshëm”, mirëpo shumica prej tyre ishin punëtor të thjeshtë dhe nuk merreshin me politike. Sidoqoftë, brenda pak kohësh ky arriti të krijojë një rreth bukur të gjere anëtarësh, në organizatën Shoqëria demokrate shqiptare me emrin Ismail Qemajli. Kështu Udb-a jugosllave ishte në dijeni të plote sepse i kishte infiltruar njerëzit e vet në këtë rreth politik. Me 1972 Udb-a jugosllave angazhoi një atentator me origjinë nga Japonia për ta vra Vehbiun në prag të mbajtjes së Kuvendit të Partisë të kësaj organizate i cili u mbajti me 1 maj 1971 në Austri. Atentati dështoi pasi që Policia austriake u alarmua nga njerëz të rrethit të ngushtë të Vehbiut dhe atentatori u arrestua dhe pasi pranoi se ka qenë i dërguar nga Shërbimi Sekret Shtetëror të Jugosllavisë, ky atentator pas pak kohësh që u mbajti në hetuesi, u përzu nga shteti austriak me ndalëse hyrje në këtë shtet për 20 vjet të plota. Vehbiu ndërkohë u lidh edhe me veprimtari të tjerë të çështjes kombëtare që vepronin në shtete të ndryshme të Evropës. U arritje marrëveshja për bashkimin e katër rrymave politike kosovare në mërgim në një organizatë të vetme dhe ashtu me 18 qershor 1977 në Bruksel të Belgjikës u nënshkrua Marrëveshja e bashkimit të Besëlidhjes kombëtare demokratike shqiptare, Lidhjes së Vardarit, Lidhjes së Prizrenit – Dega në Francë dhe shoqërisë demokratike shqiptare “Ismail Qemali” dhe nga ky bashkim i dale nga kjo Mbledhje u organizua dhe u mbajti kongresi i parë i kësaj organizate të bashkuare e cila fillimisht u quajt: Organizata kosovare revolucionare nacional demokratike shqiptare, që pas dy vitesh të merr prapë emrin e parë: Besëlidhja kombëtare demokratike shqiptare. Ishte në balle të demonstratave antijugosllave që nga 10 qershori 1978 kur Besëlidhja shqiptare organizoi demonstratën e parë antijugosllave në Shtutgart të Gjermanisë. Në Kongresin e Dytë të BKDSH, mbajtur me 14 e 15 prill 1979 në Frankfurt të Gjermanisë Vehbiu zgjidhet për Nënkryetar të Komitetit Qendror të BKDSH dhe Ndihmës-komandant i Këshillit Ushtarak “Mbrojtja e Shqipërisë etnike”, i cili Këshill vepronte në kuadrin e kësaj Besëlidhje. Në këtë funksion, Vehbiu ka krye detyra me rëndësi të veçantë të natyrës politiko-ushtarake. Vehbi Ibrahimit u vra me 10 tetor 1981 në Bruksel. Me 1 prill 2001, ku pas 20 vitesh eshtrat e Vehbi Ibrahimit i sollën dhe e varrosën në vendlindjen e tij.

INTELEKTUAL

BEQIR MUSLIU (1945-1996)

Lindi në Gjilan, Kosovë në vitin 1945. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në Gjilan, ndërsa fakultetin filozofik drejtimi i gjuhës dhe letërsisë shqipe në Prishtinë. Po në këtë kohë Beqir Musliu filloi të merret edhe me shkrime letrare. Në fillim me poezi e pastaj edhe me tregime, romane, drama e kritika letrare dhe dramaturgjike. Mënyra e të shkruarit dhe metaforat e simbolet e përdorura në shkrimet e tij, atë menjëherë e renditën në rangun e shkrimtarëve me një perspektivë të theksuar. Punimi i parë iu botua në revistën letrare "Jeta e Re" të cilën e udhëhiqte Esat Mekuli. Po kjo revistë, tri vite më vonë, në vitin 1965, ia botoi edhe librin e parë. Shkrimet e Beqir Musliut janë të një niveli të lartë dhe përdorin me mjeshtri të madhe metaforat dhe simbolet, andaj mund të quhet edhe shkrimtar i simboleve. Puna e tij kryesisht ka të bëjë me gazetari, publicistikë dhe redaktim të revistave. Së pari punoi si gazetar e redaktor në revistën "Zëri i rinisë", e pastaj edhe në "Fjala" të Prishtinës. Së bashku me disa krijues, sa ishte student, nxori dhe redaktoi revistën letrare "Plejada", e cila arriti të botohet vetëm deri në numrin 6, sepse pushteti jugosllav, duke parë ndikimin e krijimtarisë letrare në masën e gjerë, nuk e financoi dhe e shantazhi për të mos u botuar. Më vonë Beqir Musliu ishte anëtar i redaksisë, e një kohë edhe redaktor në revistën "Jeta e Re". Beqir Musliu është prezantuar thuaja në të gjitha antologjitë e shkrimtarëve shqiptarë të kohës së tij e më vonë. Punimet e tij janë përkthyer në gjuhën frënge, angleze, spanjolle, italiane, arabe, gjermane, hungareze, rumune, turke, sllovaqe, maqedonase, sllovene, serbe dhe kroate. Vdiq më 24. 06. 1996, në Prishtinë dhe u varros në Gjilan.

XHAVIT AHMETI (1952-1996)

Prof. dr. Xhavit Ahmeti lindi më 25 tetor të vitit 1952 në fshatin Përlepnice të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa Normalen në Gjilan. Studioi kiminë në Universitetin e Sarajevës dhe në Fakultetin e Shkencave Matematikore Natyrore (FSHMN) të Universitetit të Prishtinës, ndërsa studimet pasuniversitare i kreu në Fakultetin e Shkencave Matematike-Natyrore të Universitetit të Zagrebit, në Degën e Kimisë -Drejtimi: Metodët fizike në kimi, të cilat i mbaroi me sukses të lartë. Punimin e magjistraturës me titull: "Reaksionet e esterit dimetilik të CO (II) protoporfirinës IX në tretësia protikë me imidozaolë, piridinë dhe derivate të piridinës" e ka punuar në Universitetin e Zagrebit dhe e ka mbrojtur më 1981, kurse doktoratën me titull: "Kinetika dhe mekanizmi i reaksioneve të disa komplekseve të profirinave me metale kalimtare në tretësia protikë e aprotikë, polarë e

jopolarë" e ka mbrojtur po ashtu në Zagreb më 1985. Prof. Xhavit Ahmeti ka punuar në vitin shkollor 1975/76 në Akademinë Pedagogjike "Skënderbeu" në Gjilan në cilësinë e profesorit të kimisë, ndërsa që nga viti shkollor 1975/76 ka punuar në Seksionin e Kimisë të FSHMN-së dhe ka ligjësuar lëndën Kimia analitike instrumentale dhe ka udhëhequr ushtrimet e Kimisë për studentët e mjekësisë, stomatologjisë e studentët e fizikës. Që nga viti 1986 ai ka ligjësuar lëndën Kimi e përgjithshme. Pas dëbimit me dhunë nga objektet universitare të studentëve e mësimdhënësve shqiptarë, dr. Xhavit Ahmeti, mbajti për studentët e Degës Fizikë-Kimi të SHLP të Prishtinës ligjëratat në lëndën Kimia e përgjithshme dhe inorganike. Krahas punës edukative-arsimore, dr. Xhavit Ahmeti është shquar me punën shkencore-hulumtuese. Ai ka punuar në nëntë projekte shkencore-hulumtuese, ndërsa si absolvent ka qenë i angazhuar në projektin ndërkombëtar të UNDP. Dr. Xhavit Ahmeti ka bërë një punë të frytshme shkencore. Me punimet dhe kumtesat e tij ai është paraqitur, si autor dhe koautor, në shumë revista, simpoziume dhe tubime shkencore. Ai ka botuar 24 punime shkencore, 27 kumtesa, në nëntë projekte ishte autor ose koautor, ndërsa mori pjesë edhe në përgatitjen e 7 teksteve shkollore që nga niveli i ulët e deri tek ai universitar. Punimet e tij shkencore-hulumtuese janë botuar në revista e buletine të ndryshme shkencore e profesionale. Një pjesë të rezultateve të tij shkencore, prof. dr. Xhavit Ahmeti i ka kumtuar në simpoziume, konferenca e kongrese me karakter ndërkombëtar. Prof. dr. Xhavit Ahmeti ishte një veprimtar i dalluar në lëvizjen për pavarësinë e Republikës së Kosovës. Ai ishte një nga aktivistët e shquar për organizimin e Referendumit për pavarësi të Republikës së Kosovës më 1991 dhe u dënua për këtë shkak me dy muaj burg. Në zgjedhjet e para presidenciale e parlamentare të Kosovës prof. dr. Xhavit Ahmeti u zgjodh deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës. Në Kuvendin II të LDK-së më 1994 ai u zgjodh anëtar i Këshillit të Përgjithshëm të LDK-së. Për disa vite prof. dr. Xhavit Ahmeti ishte këshilltar për arsim i kryetarit të Republikës së Kosovës dr. Ibrahim Rugova dhe njëri nga organizatorët e sistemit të arsimit të pavarur të Kosovës. Ai ishte anëtar i delegacionit të Kosovës në negociatat që u zhvilluan atëherë në Itali me palën serbe për arsimin shqip dhe u caktua nga kryetari Rugova anëtar i grupit të Kosovës për implementimin e marrëveshjes, e cila nuk u realizua kurrë. Dr. Xhavit Ahmeti ndërroi jetë tragjikisht më 21 nëntor të vitit 1996, derisa po shkonte në një takim zyrtarë në Beograd.

HALIL ALIDEMA (1936-1996)

Halil Alidema lindi më 15 mars 1936 në një familje të madhe patriotike, në Pozheran (komunë e Vitisë). Halili ishte nxënës i shkëlqyer dhe qysh në shkollimin e ulët, përveç

talentit mësimorë, ai shfaqti edhe talentin dhe prirjet për aktivitete të lira në muzikë, art dhe gjimnastikë. Me kalimin e kohës në periudhën e rinisë, Halili lëshoi shtat, u burrërua dhe filloi të hyjë në fazën e pjekurisë. Horizonti i tij i dijes vazhdimisht po zgjerohej. Atij tani nuk do t'i interesojë vetëm mësimi si shumë shokëve të tjerë, por filloi të interesohej për "punë më të mëdha", sepse atë e brente brenga dhe shqetësimi i çështjes së pazgjidhur kombëtare. Tek Halili bie në sy një pakënaqësi, një revoltë dhe një rebelim kundër sistemit pushtues të atëhershëm monist të partizanëve serboçetnik. Familja e tij do të etiketohet si familje e anatemuar "armiqësore". Fati i këtyllë do ta përcjellë Halilin pothuaj gjatë gjithë jetës edhe gjatë shkollimit edhe gjatë shërbimit të tij si mësues në universitet. Gjatë shkollimit të mesëm, në vitet e 1957-58, Halili shpreh pakënaqësinë kundër sistemit titist dhe simpatinë ndaj shtetit shqiptar, ndaj bashkë me shokët e shkollës Bardhyl Nushin, Xhemajl Lalën e Nakije Nushin tenton të kalojnë kufirin për në Shqipëri, por nuk kanë sukses, sepse kapen nga udhëbërës serbë dhe arrestohen. Më pastaj ai i vuan 6 muaj burg në burgun e Gjilanit. Halili pasi kreu Normalen, bashkë me Teuta Kryeziu që ishte gruaja e tij, karrierën e tyre të mësuesisë e filluan në fshatin e largët malor, në Firajë të komunës së Shtërpçës. Pastaj kthehet në Pozheran ku punësohen si mësime në shkollën 8-vjeçare. Këtu, e gjallëruan jetën kulturore të shkollës, të fshatit dhe të rrethit të tij; gëzonin përkrahje e respekt nga nxënësit edhe nga të gjithë banorët. Halili këtu ishte edhe më i fortë edhe më i përkrahur, kështu që kjo shkollë lulëzonte në çdo aspekt dhe ishte shembull jo vetëm për shkollat e komunës së Vitit, por për të gjitha shkollat e rajonit të Anamoravës. Mirëpo, këto suksese të Halilit, u ranë shpejt në sy punëtorëve të UDB-së jugosllave. Halili përcillej në çdo hap, ndaj me ndikimin dhe përkrahjen e shokut të shkollës Qerim Gashit, për t'i ikur përcjelljes së udhëbërës, bashkë me Teutën, më 1962 u punësuan në shkollën 8-vjeçare të Malishevës, asokohe komunë në vete. Halili me përkrahjen e shokëve dhe ndihmën konkrete të akademik Ali Hadrit, filloi punën në administratën e Fakultetit Filozofik në Prishtinë. Këtu ai zgjeroi rrethin e shokëve e miqve të vet, jo vetëm ndër punonjësit e administratës së Fakultetit, por edhe ndër profesorë e ligjërues, duke gëzuar respekt e autoritet të madh si njeri i fjalës e i besës, si njeri guximtar dhe i vendosur. Për këtë arsye, ai u nxit të fillojë studimet në fakultetin e Drejtësisë, të cilat i kreu me sukses. Edhe punën në administratën e Filozofikut e kryente me saktësi e përgjegjësi të lartë. Ai gëzonte autoritet edhe te një numër i madh i studentëve të mbarë Universitetit të Prishtinës, te të cilët do të ketë ndikim dhe frymëzim në demonstratat e vitit 1968, e veçanërisht në ato të vitit 1981 të Pranverës së Madhe Studentore, për të cilat do të dënohet 11 vjet burg të rëndë si udhëheqës i "Grupit të intelektualëve shqiptarë", bashkë

me Ukshin Hotin, Ekrem Kryeziun, Shemsi Reçicën, Mentor Kaçin, Hilmi Ratkocerin etj. Viti 1968, Halilin e gjeti student të Fakultetit të Drejtësisë, të cilin e mbaroi në vitin 1973. Nën ndikimin e profesor Ali Hadrit, Halili i filloi studimet pasuniversitare dhe më 1978 magjistroi në shkencat historike me temën: “Paqa e Shën Stefanit dhe Ballkani”. Në fakultetin Filozofik nuk u lejua të punonte si kuadër mësimor, sepse për pushtetin serbosllav politikisht ishte i papërshtatshëm, ndaj ishte gjithnjë i ndjekur dhe i përcjellur nën hetime të rrepta nga shërbime sekrete serbe. Ndërkaq, teza e doktoraturës e përgatitur me titull: “Fuqitë e Mëdha dhe Ballkani”, për shkak të arrestimit dhe dënimit me 11 vjet burg, prej të cilave i mbajti 5 vjet, mbeti pa u realizuar. Viti 1981 Halilin përsëri e gjeti në ballë të demonstratave të studentëve. Veprimtaria politike, patriotike e shkencore e Halil Alidemës nuk pushoi as në burgjet e Prishtinës, Mitrovicës, Beogradit apo edhe te Pozharevcit, por përkundrazi shtoi dhe forcoi moralin kombëtar të tij. Halil Alidemën e shohim të marrë pjesë aktive edhe në Lëvizjen Gjithëpopullore për Pajtimin e Gjaqeve, Plagëve dhe Ngatërresave, që filloi punën e vet me 2 shkurt 1990 me iniciativën e rinisë studentore e të një grupi intelektualësh të prirë nga profesor Anton Çeta. Halili në fillim ishte pjesëmarrës në themelimin e LDK-së, e udhëhequr nga dr. Ibrahim Rugova. Mirëpo duke mos u pajtuar me politikën e tij paqësore, ai themeloi partinë e Unitetit Kombëtar – UNIKOMB-in, në krye të së cilës qëndroi më vite të tëra derisa ishte gjallë. Veprimtaria politike e Halilit në Kosovë po vështirësohej shumë. Gjendja politike ishte e papërbalueshme. Qëndrimi në Kosovë ishte i rrezikshëm. Atij i rrezikohej edhe jeta nga terrori e dhuna shtetërore ushtarako-policore të Millosheviçit . Halili u shtrëngua që veprimtarinë e tij politike dhe organizative ta vazhdojë jashtë Kosovës në ekzil. Fillimisht, më 1992 kaloi në Maqedoni te disa shokë në Shkup, të cilët e përkrahnin moralisht dhe politikisht, por edhe materialisht. Pas një kohe kaloi kufirin shqiptaromaqedon, u vendos në Shqipëri, në Tiranë, ku si kryetar i UNIKOMB-it zhvilloi aktivitete të intensifikuara në shumë fusha. Ishte organizues i stërvitjes së guerilës së UÇK-së, si diplomat, politikan e orator. Ishte pjesëmarrës në Konferencën e Maltës, që u mbajt në janar të vitit 1993, ku morën pjesë delegacionet e më shumë se 30 vendeve të Mesdheut me temën: “Për paqe, demokraci dhe bashkëpunim”. Në mënyrë të denjë, me një oratori të rrallë e me argumente dhe fakte bindëse, e përfaqësoi Republikën e Kosovës. Madje, në të kthyer nga ky takim, Halili i dha një intervistë RTSH-së më 17 janar 1993 me titull “Kosova dëshmon”, si dëshmi të kësaj interviste konkrete, autori i saj e posedon në fondin e arkivit personal. Halili u bë pararendës i UÇK-së. Ai u mor me organizimin dhe vendosjen e ushtarëve shqiptarë nga Kosova në disa qendra stërvitore në Shqipëri, duke u emëruar komandant i parë i grupeve të

njësiteve guerile, që do të vinin nga trojet shqiptare për t'u stërvitur në Shqipëri. Halili bënte edhe sigurimin e kuadrit të oficerëve, pedagogëve e ushtarakëve, në organizimin ushtarak të gueriljes, siguronte mjete financiare për teknikën luftarake e uniformat. Në vitin 1995 e 1996 u bë një punë shumë e rëndësishme, kur ai arriti me sukses të krijojë baza stërvitore në Shqipëri, në Palestrën Sportive "Partizani" në Tiranë, ku udhëheqës i grupit stërvitor ishte me pseudonimin "Agron Ligata", pastaj Qendra e Shkollës së Bashkuar të Oficerëve "Skënderbeu" (Tiranë), njëra nga këto baza, ku nën Komandën e Shtabit Operativ janë stërvitur edhe Komandantët Legjendar të UÇK-së – Adem Jashari e Zahir Pajaziti.

SADULLA BRESTOVCI (1933-1979)

Intelektual, historian i dalluar. Sadullah Brestovci lindi në Gjilan më 13.10.1933, rridhte prej një familje të varfër e punëtore. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, kurse Normalen në Gjakovë në vitet 1952-1953. Fakultetin Filozofik, grupi i Historisë e kreu me plotë sukses në vitin shkollor 1958 -1959 në Beograd. Aso kohe kishte nevojë të madhe për mësues dhe profesor. Ai në fillim filloi të punoi në gjimnazin e Gjilanit e pastaj në Shkollën Normale të Gjilanit, në vitet 1959-60, në cilësinë e profesorit të historisë, ku punoi deri në vitin 1962. Një kohë ishte drejtor i Shkollës së Mesme Ekonomike, kurse gjatë viteve 1965-66 kthehet përsëri në Shkollën Normale të Gjilanit. Në shtator të vitit 1966, Sadullah Brestovci, filloi të punoj në Prishtinë në Shkollën Normale "Milladin Popoviq". Aftësia dhe vullneti që kishte për njohuri edhe më të gjëra, për tu futur edhe më thellë në shkencën e historisë, u regjistrua në studimet pasuniversitare në Fakultetin Filozofik të Beogradit, në vitin 1967, grupi i Historisë, Në studimet pasuniversitare në Beograd ishte ndër studentët më të dalluar, ku flet edhe mesatarja e provimeve të dhëna 8.40. Në vitin 1968, Sadullah Brestovcin e gjejmë asistentë të historisë në Institutin Albanologjik të Prishtinës. Gjatë kësaj kohe kishte bërë studime të shumta shkencore, rreth temës së magjistraturës " marrëdhëniet serbo – shqiptare prej Tanzimatit e Naçertanisë së Ilia Garashaninit gjerë te lufta serbo-turke e viteve 1876-1878". Sadullah Brestovci ishte njohës i arkivave rreth çështjeve shqiptaro-serbo- malazeze të shekullit XIX dhe fillim shekullit XX. Duke e shikuar në mënyrë kritike punën shkencore të profesorit të nderuar konsideroj se, edhe pse pati një jetë të shkurtër shkencore dhjetë vjeçare, bëri shumë që të ndriçoj e sistemoj disa procese, që shikuar në sferën e interesit të përgjithshëm hapi rrugën për të hyrë aty ku më së shumti ndihej nevoja e historisë kombëtare. E në veçanti të gjeneratave të reja të cilët kishin njohuri krejt të mangëta për tre popujt që historikisht janë ballafaquar me probleme, nga njëherë edhe të skajshme, që kishin si

përfundim denigrimin, shkatërrimin, asimilimin etj. Trajtimi i çështjeve, duke paraqitur dokumentet arkivistike, paralelisht paraqesin vizion të qartësuar rreth konceptcionit dhe pragmatizmit në shtjellimin problemor të aspekteve retrospektive që mundësojnë krijimin e një pasqyre sa më reale shkencore. Puna e tij shkencore shihet edhe në studimet e bëra, gjegjësisht paraqitja e tij në simpoziume, kongrese etj, psh. në vitin 1975 në Kongresin e Tretë Intrenacional për Evropën Juglindore në Bukuresht si dhe në Konferencën e shtatë të Historianëve të Jugosllavisë në Novi Sad më 1977 me kumtesën “Lëvizja Nacionalçlirimtare Shqiptare dhe Serbia në 60-të vjetshin e shekullit XIX”. Po ashtu në Konferencën mbi 100 vjetorin e LSHP - së mori pjesë me temën “Mbi disa momente të Marrëdhënieve shqiptaro-serbe gjatë kohës së Lidhjes së Prizrenit”, dhe në Shqipëri po ashtu me rastin e 100 vjetorit me temën “Lidhja Shqiptare e Prizrenit dhe popullsia serbe e Kosovës”. Shikuar në relacionin e kohës, sidomos kumtesat për LSHP - në shënojnë një hap të ri në ndriçimin e kësaj ngjarje të madhe historike, ku Sadullahu me potencialin intelektual vuri në pah dhe nxori në dritë raportet shqiptaro -serbe gjatë gjysmës së dytë të shekullit XIX dhe ndikimi i saj në zhvillimin e ngjarjeve të mëtuqjeshme. Veprimtaria e mr. Sadullah Berestovcit ishte shumëdimensionale, e bujshme, profesionale, relativisht nga të tjerët e pastudiuar, e pahulumtuar, pra paraqitet pothuajse, krejt e re, që ngjallë kritika sa të nevojshme, aq edhe ndihmëse për shkencën e historisë. Opusi i tij i gjerë, puna e palodhshme në Institutin Albanologjik, më vonë detyra e shefit të degës së historisë, si dhe sekretar i revistës “Gjurmime Albanologjike”- seria e shkencave historike paraqesin një kompleks që ridimensionuan shkencën si tersi, e në veçanti i dhanë formë të re historisë si një disiplinë shumë e rëndësishme për shkencën tonë. Se sa bëri punë intelektuale e shkencore, mund të shihet edhe vargu i madh i studimeve, gjithnjë duke pasur mbështetje profesionale e historike siç janë : “Marrëdhëniet shqiptaro-serbe-malazeae gjatë viteve 1839-1856” në “Gjurmime Albanologjike”- seria e shkencave historike II Prishtinë 1972, “Lëvizja Kombëtare Shqiptare dhe marrëdhëniet shqiptaro-serbe –malazeze gjatë krizës lindore më 1875 - 1878” në “Kosova”, nr.3, Prishtinë 1974; pastaj “Lëvizja Kombëtare Shqiptare në vitet 60-70 të shek.XIX në dritën e burimeve arkivore serbe”, “Gjurmime Albanologjike”- seria e shkencave historike III, 1973, Prishtinë; “Memorandumi i një të panjohuri mbi politikën që duhej ta ndiqte Serbia ndër shqiptarët”, në “Gjurmime Albanologjike”- seria e shkencave historike III, 1973, Prishtinë; “Disa momente të marrëdhënieve shqiptaro – serbe - malazeze në fund të viteve 50-të dhe fillim të viteve 60 – të të shek. XIX”, “Gjurmime Albanologjike”- seria e shkencave historike IV-V/1974-1975, Prishtinë; “Qëndrimi i Serbisë ndaj Shqiptarëve

dhe Lëvizjes së tyre Kombëtare të viteve 1862 – 68 ", në "Gjurmime Albanologjike"- seria e shkencave historike VI,1976, Prishtinë; " Shembulli i shkëlqyeshëm i qëndrimit të drejtë të Haxhi Ymer Prizrenit" në "Rilindja", 13-14 maj 1978, Prishtinë. Më 1973, pas një pune disa vjeçare mr. Sadullah Brestovci i ofroi për botim, studimin e shkruar "Marrëdhëniet shqiptaro-serbe të viteve 1830-76-78 ",instituti Albanologjik. Mirëpo, ky studim, libër nuk arriti të botohet siç thuhet, për shkak të mjeteve financiare. Mr. Sadullah Brestovci vdiq më 1979.

MUHARREM SHAHIQI

Lindi më 1927 në fshatin Gjyrishec të komunës së Dardanës (ish Kamenicës) në Kosovë. Shkollën fillore e kreu në Gjilan, të mesmen me korrespondencë e kreu në Prizren dhe Beograd. Ka punuar si mësues në fshatra të Dardanës, ndërsa më së shumti është marrë me aktrim. U largua nga Gjilani në drejtim të Shkupit për të iu ikur arrestimit të UDB ngase ishte djali i Lamë Shahiqit. Teatri i Kombësive në Shkup, është themeluar nga dy aktorë gjilanas. Në Shkup ekzistonte Teatri i amatorëve i formuar nga Muharem Shahiqi, Mark Marku dhe Zija Berisha, aktorë shqiptarë. Këta dy artistë kosovarë kanë qenë të përndjekur nga UDB-a e serbe e Kosovës. Mu për këtë, ata kishin zgjedhur rrugën e ikjes nga ky qytet dhe ishin vendosur në Shkup për punuar. Muharrem Shahiqi, ishte aktor i Teatrit të Gjilanit, ku në vitin 1976 është kthyer nga Shkupi me kërkesë të udhëheqësisë së atëhershme të Gjilanit për të formuar Teatrin e Qytetit të Gjilanit. Në Gjilan ka punuar si regjisor në Teatrin e qytetit. Ka interpretuar dhe ka bërë regjinë e shumë dramave, komedive dhe ka luajtur edhe në seri televizive e filma artistik. Pos aktrimit është marrë edhe me shkrime letrare. Vdiq në Gjilan në vitin 1997.

TRIBUN POPULLOR

RAMIZ CERNICA (1903-1979)

Ramiz Cernica u lind në vitin 1903 në familjen Hoxha në fshatin Cernicë, familje me vlera kombëtare. Asokohe shkollimi u selektivizua, kurse ai nuk pati mundësi shkollimi. Megjithëkëtë, si autodidakt mësoi shkrim leximin, që e avancoi edhe më shumë gjatë shërbimit ushtarak prej tetëmbëdhjetëmuajve në qytetin e Vukovarit, ku falë avancimit shkollor, por edhe njohurive ushtarake, që posedonte gjatë shërbimit, i besohej detyra e komandantit të togut. Në këtë drejtim angazhohej edhe gjatë shërbimit në xhandarmëri në Kumanovë, ku qëndroi 8 muaj, kurse në vitin 1933 kreu një kurs për drejtimin e makinës shirëse. Ramiz Cernica inkadrohej në Lëvizjen Kombëtare në vitet e njëzeta të shekullit

XX. Ndërkaç, në vitet e tridhjeta zgjidhej kryetar i Komunës së Parteshit. Sa qëndroi në këtë post vazhdimisht kundërshtonte padrejtësitë, shtypjen e popullit shqiptar, duke luftuar për të drejtat kombëtare. Me ngulm kundërshtonte kolonizimin e Kosovës si dhe shpërnguljen e dhunshme të shqiptarëve për në Turqi. Për shkak të qëndrimeve të tij kombëtare burgosej nga pushteti serb. Gjatë viteve 1941-43, kur rajoni i Gjilanit ishte në autoritetin Italian, ushtroi detyrën e kryetarit të Parteshit. Në prill të vitit 1943 shpëtoi Aradhën Partizane Shqiptare në krye me Fadil Hoxhën, e cila u rrethua nga italianët në malet e fshatit Livoç i Epërm. Në vjeshtën e vitit 1943, pas kapitullimit të Italisë shkoi si delegat në formimin e Asamblesë së Qeverisë së Shtetit Shqiptar në Tiranë, që ishte një besim i madh ndaj tij. Udhëheqja e LNÇ-së Ramiz Cernicës i afroi të marrë pjesë në Konferencën e Bujanit, por ky nuk e pranoi ofertën . Pas hyrjes së brigadave partizane më 16 nëntor 1944 në Gjilan, Ramizi burgosej, dy herë, por shpejt lirohej. Në korrik të vitit 1945, Ramizi si delegat i rrethit të Gjilanit mori pjesë në Konferencë të Prizrenit, ku edhe formalisht po zyrtarizohej aneksimi i Kosovës nga ana e Serbisë. Në këtë konferencë kërkoi dhe e mori fjalën edhe Ramiz Cernica. Me këtë rast guxoi që haptas të deklarojë se është kundër aneksimit të Kosovës nga ana e Serbisë, duke shprehur njëkohësisht vullnetin e popullit të Kosovës për bashkim me Shqipërinë. Kjo paraqitje e Ramizit në këtë konferencë shkaktoi një tollovi dhe një tërbim të egër të udhëheqësve të “Kosmetit”, sidomos të Ali Shukriut, kështu që Ramizit ia ndërprejnë fjalën dhe kryesia e punës dha një pushim, sepse u pa se pas Ramizit, të inkurajuar nga fjala e tij, i ngrenë duart për të marrë fjalën edhe ca delegatë të tjerë. Ky deklaram i hapur e i guximshëm i kushtoi shumë shtrenjtë Ramizit. Pas pak ditësh pushteti antishqiptar në Gjilan e dënoi me 20 vjet burg të rëndë. Ramiz Cernica frymëzuesi i mijëra shqiptarëve, që ishin bërë barrikada të gjalla para pushtuesve serbë, ishte fanari ndriçues i rrugës së lavdishme për çlirim e pavarësi.

NGJARJE

LËVIZJA NACIONAL-DEMORAKTIKE SHQIPTARAE NË ANAMORAVË

Në këto rrethana të reja të krijuara (1945), Kosova dhe shqiptarët fituan një status inferior në krahasim me republikat dhe me popujt e tjerë të Jugosllavisë. Nga një formë e hapët e luftës, ata u detyruan të kalojnë në ilegalitet dhe të formojnë organizata ilegale politike patriotike shqiptare për bashkimin e trojeve shqiptare. Një ndër këto organizata ishte Lëvizja Nacional Demokratike Shqiptare (LNDSH) në Kosovë, Maqedoni dhe në vise të tjera shqiptare në Jugosllavi. Pas hyrjes në Gjilan dhe në Ferizaj me 16 e 17 nëntor të vitit 1944, të ushtrisë

nacional çlirimtare e Jugosllavisë , fillon një etapë e re e zhvillimit të pakënaqësisë së popullit me pushtetin e ri popullor komunist. Me paraqitjen e LNDSH-së, për shqiptarët e Kosovës në përgjithësi dhe të Anamoravës në veçanti, fillon një etapë e re në lëvizjen për çlirim dhe bashkim kombëtar. Komiteti Qendror i LNDSH-së në Shkup u formua në prill të vitit 1945 dhe veprimtarin e vet e zhvilloi në Kosovë dhe Maqedoni. Gjatë tërë kohës komiteti i Shkupit ishte shumë aktiv ngase mbante lidhje edhe me përfaqësuesit e huaj në Shkup si me përfaqësitë angleze, amerikane, franceze, turke etj. Rol me rëndësi të veçantë në KQ të Shkupit patën Gjon Serreqi, Azem Morana dhe gjilanasit si Halim Orana, Haki Sermaxhaj e Hamdi Berisha etj. Kongresi IV i LNDSH-së u caktua të mbahet në kushte edhe më të pavolitshme se ai i pari që u mbajt në Kopilaçë. Në ndërkohë u zbuluan dhe u arrestuan anëtarët e KQ të ONDSH-së në Prizren. Kjo ndikoi që, në çështjen e organizimit të merren masa urgjente. Në kongres morën pjesë vetëm 12 delegatë. Nga ky kongres doli një udhëheqësi e re e LNDSH-së. Kryetar u zgjodh Halim Orana nga Gjilani, Qemajl Skenderi u zgjodh zëvendës-kryetar dhe Azem Morana, sekretar i organizatës, ndërsa anëtarë të KQ të LNDSH-së u propozuan dhe u zgjodhën Hamdi Berisha, Mehmet Bushi, Hysen Rudi, Januz Balla, Mahmut Dumani, Hasan Bilalli, Myderriz Haki Efendi Sermaxhaj, Osman Cani dhe Mitat Tershana. Në fillim të vitit 1946, me gjithë angazhimin e forcave të mëdha ushtarake dhe organeve të ndjekjes, me gjithë dhunën, vrasjet, burgosjet, aktiviteti politiko-ushtarak i Lëvizjes nuk u shua, por përkundrazi, vazhdoi luftën për lirin e tokave shqiptare në kushte të reja të riorganizimit. U zgjerua rrjeti organizativ i KQ të ONDSH-së, në Shkup, me formimin e komiteteve të reja në Kosovë e Maqedoni, duke u shndërruar në lëvizje masive. Në pranverë të vitit 1946, në Gjilan u formua Komiteti i Rrethit të ONDSH-së, i cili në mënyrë të drejtpërdrejtë ishte i lidhur me Komitetin Qendror të ONDSH-së në Shkup. Anëtarë të Komitetit Qarkor të Gjilanit ishin: Myderriz Haki Taib Efendiu, Hamdi Berisha, Maliq Sahit Çollaku, Mumin Jakupi, Ramadan Agushi, Jakup Malisheva, Arif Salihu-Rogaçica, Mulla Riza Osmani dhe Destan S. Budrika. Nga radhët e kësaj kryesie, dy ishin edhe anëtar të KQ të ONDSH-së në Shkup si: Myderriz Haki Taib Efendiu dhe Hamdi Mulla Ymer Berisha. Grupi i fundit i LNDSH ishte i Hasan Aliu – Remnikut që u shua në vitin 1951.

AKSIONET E MBLEDHJES SË ARMËVE NË KOSOVË (1912 – 1999)

Pas pushtimit të Kosovës në tetor të vitit 1912 forcat serbe filluan aksionet për mbledhjen e armëve që popullsia shqiptare të jetë e pa armatosur që të mos mund të organizoj kryengritje

kundër ushtrisë serbe. Disa nga aksionet e armëve që ka organizuar qeveria serbe kundër shqiptarëve ishte edhe aksioni i mbledhjes së armëve në dimër të vitit 1956 me arsyetim se shqiptarët kinse po përgatiten për kryengritje të armatosur dhe bashkim me Shqipërinë. Në këtë aksion duhej të përgjigjeshin të gjithë familjet shqiptare dhe të jepnin së paku një armë. Përveç armëve ata bënin edhe torturime ndaj popullsisë shqiptare ku burrat i futnin në lumë në temperatura të ftohta të dimrit. Po ashtu aksionet për mbledhjen e armëve nuk pushuan. Një aksion i tillë u organizua edhe në vitet e 90 – ta, ku policia serbe bënte mbledhjen e armëve nëpër shtëpi dhe pronarët e tyre i i maltretonte dhe i rrahte deri për vdekje.

DEMONSTRATAT E 27 NËNTORIT TË VITIT 1968

Rinia studentore dhe intelektualët vjen në shprehje pas vitit 1966. Ajo e kishte kuptuar se dallonte shumë nga ajo rini botërore, ngase kjo kishte synime, detyra dhe obligime të qarta lirishtetërore, nga ajo që ndodhnin në botë. Duke i hetuar dhe duke i parë se sa të robëruar dhe të maltretuar ishin, po ajo rini mori mbi vete obligimin më të madh por edhe më dinjitoz, për të organizuar dhe për të dalë në ballë të tyre, duke i organizuar demonstratat e vitit 1968, që do të shënojnë një kohë të rëndësishme në historinë e Kosovës. Grupi politik i demonstratave i kishte dhënë për detyrë Asllan Kastratit që merrej me organizimin e tyre në Gjilan e rrethinë. Ai, me 10 nëntor 1968, udhëton për Gjilan dhe takohet me Rexhep Malën, Fatmir Salihun dhe Irfan Shaqirin. Që nga ajo ditë, në mes studentëve që kishin marrë përsipër që të organizonin demonstratën, ata pothuaj do të takohen për çdo ditë, dhe në shtëpi të ndryshme. Kur lindi nevoja se duhet të shkruhen parullat, ata siguruan një bunker, që gjendej në afërsi të shtëpisë së Fatmir Salihut. Për herë të fundit ata u takuan me 26 nëntor 1968, dhe në këtë mbledhje u caktuan të gjitha detyrat dhe me përpikërinë më të madhe çdo gjë u përgatitë dhe ishte e gatshme për ditën e nesërme festive siç e quante Rexhep Mala. Demonstrata ishte paraparë të fillonin në ora 12 e 5 minuta, duke filluar nga shkolla e Mesme ekonomike për të vazhduar në drejtimin e stacionit të autobusëve. Sipas të dhënave që japin organizatorët thuhet, se në demonstratat e Gjilanit me rrethinë morën pjesë mbi 2000 veta. Personat që nuk kishin mundur të organizonin demonstratën në lokalitetet e veta, kishin nxituar që t'iu bashkëngjiteshin demonstratës në qytetin e Gjilanit. Aty do të vinin njerëz nga Vitia, Kamenica, Kaçaniku, Presheva, Bujanoci e nga jo tjetër. Nga organizatorët të cilët kishin marrë përsipër organizimin e demonstratave kuptohet se me një kujdes dhe me një vigjilencë përcillej çdo gjë që ndodhte ato ditë në Gjilan, sepse çdo lëvizje ishte nën survejim. Në krye të demonstratave ndodheshin organizatorët e tyre. Për ta bartë flamurin kombëtar shqiptar ishte caktuar vasha trime Vahide

Hoxha nga fshati Cerrmicë e Gjilanit, ndërsa flamurin jugosllav ishte caktuar që ta mbante Mehmet Emini. Si në qendrat tjera të Kosovës ku ishte vendos që të mbahen demonstrata, ashtu edhe në Gjilan u mor qëndrimi që të shkruhen dhe të shpalosën të njëjtat parulla. Në rrugët e Gjilanit, demonstruesit brohoritën këto parulla: “Duam Vetëvendosje”, “Duam Universitet”, “Duam kushtetutë”, “Kushtetutë-Republikë” etj. Edhe pse organet e sigurimit dhe aktivist të shumtë të LKJ-së u munduan që të qetësonin masën e tubuar, ata nuk ia dolën. Kur demonstruesit në mënyrë paqësore parakalonin rrugës duke brohoritur parullat e lartpërmendura, policia ndërhyri, duke përdorur shkopinj gome dhe dhunë, edhe demonstruesit gjilanas nuk qëndruan duarkryq. Për guximin e treguar u dalluan sidomos studentët e nxënësit si : Ilmi Ramadani, Vahide Hoxha, Zija Shemsiu, Fetije Bajrami, Mynivere Kastrati, Vildane Ahmeti, Fazli Abdullahu, Xhavit Dërmaku, Njazi Korça, Shemsedin Kastrati etj. Demonstrata zgjati katër orë dhe mund të thuhet se sukcesi ishte i plotë. Pasi se u përfundua me demonstrimet, pjesa dërmuese e organizatorëve vazhduan rrugën për Prishtinë, për t’iu bashkuar shokëve të tyre në demonstrata. Për angazhimin, organizimin dhe pjesëmarrjen në demonstrata, hetuesit e udhësët filluan të gurmajnë organizatorët dhe pjesëmarrësit. Shumë veta u arrestuan e shumë nga ata u dënuan, por politika jugosllave si gjithmonë ishte e kujdesshme me një qëllim të caktuar, që në opinionin ndërkombëtar nuk donte të zgjonte kureshtjen ngase ajo vazhdimisht thoshte se punën me forcat burokratike e kishte përfunduar më 1966 (në Plenumin e Brionëve). Për pjesëmarrjen në demonstrata, në Gjilan do të dënohen: I. Irfan Shaqiri, (nxënës) dhe Beqir Qerimi (student) nga Përlepница, me nga 1 vit burg, ndërsa, me procedurë të shpejt, gjykatësi për kundërvajtje i KK të Gjilanit, u shqiptoi dënimet: Fatmir F. Salihu prej 30, Rexhep Malës prej 25 dhe Ahmet Hotit prej 20 ditësh burg.

DEMONSTRATAT E MARS-PRILLIT 1981

Demonstratat e studentëve shqiptarë në Kosovë u organizuan dhe filluan më 11 mars 1981. Po atë natë duke filluar që nga instancat më të ulëta e deri në ato më të larta, që nga krahinat, republikat e deri në federatë, që nga organizatat bazë e deri në Komitetin Qendror të LKJ-së u mbledhën dhe diskutuan për ngjarjet në Kosovë. Të gjithë nxitonin se kush më parë të propozojë masat më drakoniane, se kush të parashtojë planet më shtypëse e më anti-humane ndaj atyre që morën pjesë në demonstrata. Me shpërthimin e demonstratave të studentëve të Universitetit të Kosovës, edhe një herë u vërtetua se e tërë kjo ishte një revoltë e akumuluar ndër breza shekuj me radhë, duke kaluar nga veprimtaria e organizatave dhe e grupeve ilegale, që ishin sakrifikuar, në kërkesa të hapura dhe legale. Studentët e atij brezi u gjakosën,

dolën përballë armatës jugosllave vetëm me forcën e shpirtit shqiptar. Rezistenca e tyre u parapriu të gjitha çështjeve të pazgjidhura etnike, për të cilat u njoftua bota në vitet që pasuan. Rinia shqiptare në Jugosllavi zbuloi jo vetëm gjendjen kritike të popullit të vet, por edhe konfliktin që ekzistonte i mbuluar në shkallë universale historike njerëzore dhe kombëtare në Ballkan. Në mënyrë ciklike studentët e populli, në forma të ndryshme, nëpër dekada shprehën e manifestuan pakënaqësinë e tyre. Dhe, mbeti i vetmi popull që më së shumti u ballafaqua me kërkesën legjitime për liri dhe pavarësi, si një çështje e drejtë historike, e krijuar në ciklin kohor të padrejtësive historike. Ata, dy dekada para përfundimit të këtij mileniumi do të kërkonin vetëm atë që u takonte - të drejtën e tyre, kërkonin që kjo pjesë e robëruar të fitonte lirinë e merituar. Kjo kërkesë shteteve të botës do t'u trokasë në ndërgjegje si një vonesë historike. Vetëm pesë ditë pas, më 1 e më 2 prill, me kërkesat e demonstruesve u solidarizua i gjithë populli. Sipas të dhënave zyrtare të asaj kohe gjatë këtyre demonstratave pati 9 të vrarë dhe 15 të plagosur, ndërsa forcat e policisë serbe patën 2 të vrarë dhe 17 të plagosur. Në këto demonstrata populli i Kosovës u ngrit si një trup i vetëm dhe zbrazti tërë pezmin, tërë revoltën dhe tërë urrejtjen e vet kundër shtypjes, shfrytëzimit, padrejtësisë dhe represionit të përjetuar gjatë dekadave të robërisë në Jugosllavi. Ato zgjatën gjatë gjithë pranverës së vitit 1981 dhe konsiderohet se ishin demonstratat më të mëdha në Gadishullin Ballkanik dhe në Evropën Lindore pas Luftës së Dytë Botërore. Në to, në forma të ndryshme mori pjesë i gjithë populli shqiptar. Demonstratat e vitit 1981 ishin referendumi më i suksesshëm dhe më bindës i nënshkruar me gjakun e popullit tonë. Në kërkesat e demonstratave të Gjilanit në pranverën e vitit '81 dominuan parullat për "Kosovën-Republikë". Këtë e argumentojnë edhe parullat e tjera, siç ishin: "Kosova kosovarëve", "Duam Republikë", "Republikë kushtetutë, ja me hatër ja me luftë", "E duam flamurin kombëtar", "Duam bashkimin e trojeve shqiptare" e të tjera. Këtyre kërkesave të ligjshme të popullit shqiptar udhëheqja jugosllave iu përgjigj me zjarr e me hekur. Pas ngjarjeve të 11 marsit, nuk shkoi gjatë më 2 prill 1981 Beogradi shpalli gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë dhe ndaloi qarkullimin e mbi dy vetave së bashku në vende publike. Ndërpreu mësimin në shkollat fillore, në ato të mesme dhe në universitet. Mbylli konviktet e studentëve dhe të nxënësve në Prishtinë. Në ditët në vijim vazhduan demonstratat studentore në tërë Kosovën. Pas këtyre demonstratave, organet e pushtetit dhjetë ditë para afatit urdhëruan përfundimin e ligjëratave në Universitet. U ndërpre qarkullimi i postës dhe të gjitha lidhjet telefonike. Patrullat e policisë dhe ato ushtarake kontrollonin të gjithë kalimtarët dhe automjetet në komunikacion.

Kështu, Kosovën e izoluan nga pjesët e tjera të ish-Jugosllavisë, duke bërë përpjekje që të shkëputnin çdo lidhje të saj me botën.

DEMONSTRATAT GJITHË POPULLORE E SHQIPTARËVE KUNDËR SERBISË (1988 - 1990)

Protestat dhe grevat e minatorëve ishin shpreje e vullnetit kundër ndryshimeve kushtetuese që përgatiste Serbia për ndryshimin e kushtetutës së KSA të Kosovës. Gjithashtu ishin kundërshtime ndaj reagimit të ashtuquajturave mitingje të solidaritetit të serbëve, ku kërkonin armë për të luftuar kundër shqiptarëve. Këto protesta ishin vazhdim i tubimeve të 17-21 nëntor të vitit 1988, ku demonstruesit, kryesisht punëtorë kishin dale në rrugë me parulla për të ruajtur autonominë e vitit 1974. Tubimi i parë i Minatorëve u mbajt në minierën e Stan-Tërgut më 4 shkurt 1989, morën pjesë rreth 2500 punëtorë. Minatorët ishin kundër amendamenteve të reja serbe ngase nuk ishin në harmoni me Kushtetutën e vitit 1974. Më 20 shkurt të vitit 1989, shpërthyen demonstratat e shqiptarëve kundër heqjes së Autonomisë së KSA të Kosovës në kuadër të RS të Serbisë. Në krye të demonstratave dolën minatorët e kompleksit industrial të Trepçës në Mitrovicë. Rreth 1500 punëtorë nisen grevën e urisë në galeritë e thella të Minierës së Stan-Tërgut. Minatorët iu përmajtën parimit "Një për të gjithë, të gjithë për një". Kërkonin dorëheqjen e tre udhëheqësve partiak të Kosovës. Këshilli i grevist përpiloi edhe dhjetë kërkesa, ku përfshihej mosndryshimi i Kushtetutës së vitit 1974, ndërprerja e politikës shoviniste dhe hegjemoniste serbe ndaj shqiptarëve, një kërkesë kishte të bënte edhe iniciativën për fillimin e Aksionit për pajtimin e gjaqeve si dhe kërkesa që çështja e Kosovës të diskutohej në Këshillin e Sigurimit të OKB-së. Greva zgjati deri më 28 shkurt 1989. Ajo përfundoi me hospitalizimin e 180 minatorëve dhe me manipulimin kinse të dorëheqjes së Rrahman Morinës, Ali Shukriut dhe Hysamedin Azemit, vetëm ky i fundit dha dorëheqje. Pas ndërprerjes së grevës në Kosovë u vendos gjendja e jashtëzakonshme dhe ora policore. Kosova mbahej nën presionin e policisë dhe ushtrisë jugosllave. Për kundër grevave dhe demonstratave e protestave të shumta të popullit të Kosovës, pushteti serb më 23 mars 1989, nën gjendjen e jashtëzakonshme dhe nën rrethim ushtarak, aprovoi amendamente për ndërrimin e Kushtetutës së vitit 1974. Me grevat dhe kërkesat që i bënë Minatorët, u solidarizua i tërë populli shqiptarë. Megjithatë, pas kësaj filloi marrja e masave represive ndaj popullit shqiptar të Kosovës. Filloi largimi në mënyrë masive nga puna, burgosja dhe vrasja e njerëzve të pafajshëm. Trajtimin e të burgosurve politikë prej vitit 1981 e këndej e kishin edhe dy grupe intelektualësh shqiptarë, që u përfshinë me masën policore "izolim". Kjo u

zbatua nëpër burgjet e Kosovës dhe të Serbisë së bashku me ritualin e keqtrajtimit sikur edhe ndaj të burgosurve të tjerë. Për sa i përket numrit të saktë të grupit të parë të izoluarve pas 81-shit, fatkeqësisht, nuk ka të dhëna. Kjo dihet për grupin e fundit të izoluarve, për ata të marsit të vitit 1989, kur me këtë masë ishin përfshirë 237 veta. Nga komuna e Gjilanit ishin në izolim këta persona: Basri Musmurati, Avdi Limani, Ali Mehmeti, Begzat Osmani, Fejzullah Fejzullahu, Fazli Abdullahu, Fatmir Salihu, Hydajet Hyseni, Ilmi Ramadani, Nijazi Korça, Riza Latifi, Sabri Bunjaku, Sadri Sherifi, Sami Hoxha, Shaip Ismaili, Shemsi Syla, Ismet Ramadani, Rrahim Azemi, etj. Masa e izolimit në të vërtetë ishte një masë ndëshkuese ndaj intelektualëve për të cilët dyshohej se ishin ose mund të bëheshin armiq të pushtetit. Me një ndërmarrje të tillë policore, që e kishte urdhëruar sekretari i SPB-së së Kosovës (J. K.), ishin privuar nga liria "intelektualët e rrezikshëm", duke i mbajtur me muaj të tërë në arrest, pa prova të fajësisë së tyre politike. Sekretari krahinor, duke i shfrytëzuar kompetencat, kishte urdhëruar që këta persona të dërgoheshin në vendqëndrime të caktuar jashtë Kosovës.

GRUPET ILEGALE NË KOSOVË (1968 - 1999)

Pas Luftës së Dytë Botërore, Kosova dhe viset tjera shqiptare, jo vetëm që u penguan për t'u bashkuar me shqipërinë, ashtu siç ishte vendosur në konferencën e Bujanit (31 dhjetor 1943-1 e 2 janar 1944), por ngjau ajo më e keqja, këto troje etnike shqiptare u rripushtuan dhe u ndanë në katër copëza brenda federatës jugosllave të AVNOJ-it :Kosovë, pjesët etnike shqiptare në Maqedoni, në Serbi dhe në Mal të Zi. Populli shqiptar ndonëse s'u pajtua asnjëherë me këtë gjendje, u organizua në forma të ndryshme legale e ilegale për të sendërtuar aspiratën e vet historike çlirimin e trojeve shqiptare që mbetën nën sundimin jugosllavë(lexo-serbosllavë) dhe bashkimin e tyre me shtetin amë-Shqipërinë. Veprimtaritë politike-kombëtare ilegale të shqiptarëve në Kosovë gjatë viteve 1945-1999 janë përshkuar nëpër gjashtë faza organizative: Faza e parë, e organizimeve politike-kombëtare ilegale përfshinë periudhën nga fundviti 1944 e deri në vitin 1950 dhe përkufizohet kryesisht me veprimtarinë e Lëvizjes Nacional-Demokratike Shqiptare (LNDSH). Drejtues të LNDSH-së ishin:Halim Spahija, prof. Ymer Berisha, Tahir Deda, Marije Shllaku, Gjon Serreçi, At Bernard Llupi, Adem Gllavica, Ukë Sadiku, kapiten Hysni Rudi, Ajet Gërguri, Luan Gashi, Ibrahim Fehmiu, Qemal Skënderi, Halim Orana, Hamdi Berisha, Prof. Ibrahim Kelmendi, Hysen Tërpeza, Ejup Binaku etj. Faza e dytë, përfshinë kohën në mes viteve 1950-1958 dhe në popull kjo periudhë deri në vitin 1966 quhej „koha e Rankoviqit“. Brenda këtyre viteve organizimet ilegale qenë të shumëllojshme si:vazhdimësia e veprimeve të LNDSH-së nga

grupe me emërtime tjera, "informbyroistët", organizimi i grupimeve të ndryshme nga Sigurimi shqiptarë, kundërshtimi i rekuizitave "otkupit", Kundërshtimi i asimilimit të sshqiptarëve në turq dhe luftimi i marrveshjes xhentelmene Tito-Qyprili 1953 për shpërnguljen e shqiptarëve në Turq, luftimi në forma shantazhuese të kolektivizimit, Aksioni i Armëve etj. Përfaqësues të këtyre grupimeve ishin: Xhavit Gafuri, Hasan Jashari, Shaban Dërguti, Hafëz Jakupi, Bitër Dehalla, Sefer Elezkurtaj, Hajdar Bytyqi, Bie Vokshi, Fetah Bogiqi, Sami Peja, Sali Kelmendi, Konstandin Vasilaca (oficer i armatës shqiptare), Hajrullah Gorani, Ramiz Osmani, Xhemil Fluku, Ramadan Rexha, Ali Aliu, Omer Qerkezi, Sabit Kapiti, Mehmet Gega, Rexhep Abdullahu, Nysret Nivokazi, Emin Fazliu, Njazi Maloku (Procesi i Prizrenit) Enver Dukagjini, Adem Demaçi, Muhamed Brovina, Hidë Dobruna. Faza e tretë, përfshinte kohën në mes të viteve 1958-1968 dhe kjo periudhë karakterizohet me formimin e organizatave ilegale, të cilat do të artikullojnë koncepte të reja politike e kombëtare. Në vitin 1958 atdhetari Metush Krasniqi formoi organizatën: "Partia Revolucionare për Bashkimin e Tokave Shqiptare me Shtetin Amë" (PRBTSHSHA); Në vitin 1960-61 atdhetarët Kadri Halimi dhe Ali Aliu formuan organizatën: "Komiteti Revolucionar për Bashkimin e Trojeve Shqiptare në Jugosllavi-me Shqipërinë" (KRBTSJSH); Në vitin 1963-64 Simboli i qëndresës shqiptare Adem Demaçi formoi "Lëvizjen Revolucionare për Bashkimin e Shqiptarëve" (LRBSH) dhe në kuadër të saj kanë vepruar Komiteti i Prishtinës, i Pejës, i Gjakovës. Në vitet 1964-68 veproi grupi i studentëve (sipas platformës së LRBSH-së) të drejtuar nga studenti Osman Dumoshi. Ky grup ishte organizatore e demonstratave të 27 nëntorit 1968. Faza e katërt, përfshinë periudhën 1969-1981 dhe mund të thuhet se është faza e lulëzimit të veprimtarive ilegale në Kosovë...Grupet ilegale më të njohur që e karakterizojnë këtë periudhë janë: Grupi Revolucionar i formuar në vitin 1972 nga Kadri Osmani, Xhafer Shatri... (K. Osmani fillimisht në nëntor 1969 kishte organizuar shpërndajen e një pamfleti, me anë të së cilës ka manifestuar suksesin e demonstratave të vitit 1968 dhe për këtë veprim denohet me 10 muaj burg); Grupi MLK (1976-78), OMLK (1978) vazhduese të „Grupit revolucionar“, të drejtuar nga Mehmet Hajrizi, Hydajet Hyseni, Kadri Zeka, Rexhep Mala... (Në vitin 1978 Kadri Zeka emigron në Zvicërr); Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës" (1975) i kryesuar nga Adem Demaçi dhe grupi i Adem Rukiqit; Partia Komuniste Marksiste-Leniniste e Shqiptarëve në Jugosllavi-PKMLSHJ (1977. . .) i drejtuar nga Avdullah Prapashtica; Beslidhja Kombëtare Demokratike Shqiptare (1977...) e drejtuar nga Emin Fazlia alias Emil Kastrioti me seli në Gjermani; Fronti i Kuq Popullor-FKP (1978. . .) i drejtuar nga Ibrahim Kelmendi i emigruar

në vitin 1976 në Gjermani; Lëvizja Nacional-Çlirimtare e Kosovës dhe të Viseve tjetra Shqiptare në Jugosllavi (LNÇKVSHJ (1978-shkurt 1982) të drejtuar nga Metush Krasniqi, Jusuf Gërvalla dhe Sabri Novosella. (Në dhjetor 1979 Jusuf Gërvalla emigron në Gjermani ndërsa Sabri Novosella në Turqi). Gjatë viteve 1980-81 në Kosovë me programin e LNÇKVSHJ-së sipas udhëzimeve të Jusuf Gërvallës ka vepruar Komiteti i Deçanit i drejtuar nga Ismail Haradinaj, Hasan Ukëhaxhaj, Jashar Salihu, Xhavit Hoxha. . . dhe Komiteti i Drenasit i drejtuar nga Bajram Gashi. Faza e pestë e Lëvizjes Ilegale në Kosovë dhe në viset tjera shqiptare, fillon me demonstratat e pranverës së vitit 1981 dhe përfundon në vitin 1990, atëkohë kur nis fundi i shpërbërjes së Perandorisë jugosllave të AVNOJI-it. Bartëse e organizimeve ilegale ishte Lëvizja për Republikën e Shqiptarëve në Jugosllavi-LRSHJ, e cila u themelua me 17 shkurt 1982 pas shkrirjes së tri organizatave ilegale:LNÇKVSHJ-OMLK-PKMLSHJ në këtë organizëm. Në vitin 1986 LRSHJ merr emrin:Lëvizja Popullore për Republikën e Kosovës dhe në kuadër të saj kanë vepruar një sërë grupimesh të vogla me emërtime të ndryshme, të cilat synonin me çdo çmim jetësimin e Republikës së Kosovës. Dejtuesit e ilegales në periudhën 1981-1990 në Kosovë dhe në perëndim ishin:Jakup Krasniqi, Hydajet Hyseni, Gani Koci, Mehmet Hajrizi, Bajram Kosumi, Ali Lajçi, Gani Krasniqi, Nezir Myrtaj, Fazli Veliu, Ali Ahmeti, Hysen Gega, Bajram Bahtiri, Emin Fazliu alias Emil Kastrioti, Kastriot Haxhirexha, Fehmi Lladrovci, Ismet Begolli, Emrush Xhemajli, Shaban Shala, Halil Alidema, Mr. Ukshin Hoti, Mentor Kaçi, Kadri Osmani, Nuhi Berisha, Regjep Mala, Xhavit Haliti, Xhafer Shatri, Elmi Zeka, Gafurr Adili, Hasan Mala, Agim Sylejmani, Xhavit Haziri, Saime Isufi, Abdullah Prapashtica, Meriman Braha, Martin Çuni, Bislim Elshani, Afrim Morina, Sejdi Gega, Bardhyl Mahmuti, Afrim Zhitia, Fahri Fazliu, Fadil Vata, Zija Shemsiu, Ibrahim Kelmendi, Bajrush Xhemajli, Hajdin Abazi, Fatmir Brajshori, Emin Krasniqi, Sejdi Veseli, Adem Grabovci, Enver Topalli, Halit Naxhaku, Gafurr Elshani, Muhamet Kelmendi, Tahir Hani, Pajazit Jashari, Fadil Lepaja, Januz Musliu, Ramë Buja, Ahmet Haxhiu, Ibish Neziri, Xhabir Morina, Rafi Halili, Ibrahim Shala, Berat Luzha, Ramadan Avdiu, Xhemajl Fetahu, Sherif Konjufca, Bajram Ajeti, Raif Çela, Shemsi Veseli, Petrit Duraku, Ahmet Isufi, Beqir Beqa, Bashkim Mazreku, Behadin Hallaqi, Nysret Pllana, Sadri Ramabaja, Azem Sylja, Akile Dedinca, Nesimi Elshani, Ali Ajeti, Gursel Sylejmani. Faza e gjashtë (1991-1999) është faza më kulminante e organizimeve politiko-ushtarake në Kosovë. . . dhe në historinë më të re të saj me të drejt cilësohet si periudha e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës(UÇK-së). Bazamenti i UÇK-së u bë Lëvizja

Popullore për Republikën e Kosovës(LPRK)e cila në vitin 1993 u emërtua si Lëvizja Popullore e Kosovës(LPK).

PERIUDHA PËR LIRI, PAVARËSI DHE DEMOKRACI

PERSONALITETE

XHEVAT QERIMI

Lindi me 9 nëntor 1965 në Tërpezë të Vitisë, i cili u edukua dhe arsimua me frymëzimin e ideale kombëtare. Radhitet në një ndër përkrahësit e parë të Demonstratave popullore të pranverës së vitit 1981, duke vazhduar të kalitet dhe duke patur simpati dhe admirim të veçantë për të gjithë njerëzit e lëvizjes çlirimtare. Në nëntori të vitit 1985 Xhevati, u organizua në radhët e Organizatës ilegale, Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës (LPRK-ës,) në luftë kundër pushtuesit e regjimit serb për çlirimin e Kosovës e të viseve të saja e bashkimin e tyre me Shqipërinë. Ishte i durueshëm, i qetë e i sinqertë tej mase i matur e shumë i arsyeshëm, solidar me shokët veprimtarë e familjet e tyre në nevojë, i dashur për shokë e shoqe, e për njerëzit e gjeneratave të ndryshme, kishte një simpati të veçant për të burgosurit politik dhe familjet e tyre, shumë trim e i guximshëm, plot energji e me një vullnet të pathyeshëm, organizator i pa zëvendësueshëm e aksionist i radhëve të para, shumë i zëshëm në luftën e drejtë çlirimtare. Xhevati ishte shumë i vendosur që me çdo kusht e çdo sakrificë të ruhej vazhdimësia e luftës së nisur, në veçanëti të mos ndalej dhe të mos ndërpritej puna dhe organizimi ilegal në kuadër të Lëvizjes Popullore për Republikën e Kosovës(LPRK-ës). Zbulimi i shoqeve dhe shokëve, nga organet e UDB-ës jugosllave,dhe burgosja e tyre, të organizuar në kuadrin e LPRK-ës në mars të vitit 1986, në opinion i njohor, si Grupi i Gjilanit (Anamoravës) dhe Grupi i Podujevës (Llapit) dhe kalimi i një pjese të tyre në ilegalitet ishte një goditje e rëndë për të gjithë LPRK-ën. Tashmë, radhët e LPRK-së kishte lind nevoja e organizimit. Më 24 dhe 25 nëntor 1986 Këshillin Drejtues të LPRK-ës në nivel Rrethi – Gjilan, Kamenicë dhe Viti me kryesues: Xhevat Qerimi, Irfan Musmurati dhe Ismet Sylejmani Me fillimin e ndryshimeve kushtetuese dhe suspendimin e asaj pak autonomie që kishte Kosova, u krijua situatë e re në organizimin, drejtimin dhe udhëheqjen e protestave, grevave dhe demonstratave nga LPRK dhe udhëheqja e sajë si në nivelin Qëndrorë në Prishtinë e në shumë qytete tjera të Kosovës, poashtu edhe në nivel Rrethi Xhevati ishte gjithnjë duke prirë e duke qëndruar gjithmon në ballë të tyre. Zhvillimi i demonstratës gjithëpopullore, me 27 Mars të vitit 1989 e organizuar nga Këshilli Drejtues i

LPRK-ës dhe anëtarësia e gjerë në nivel të Rrethit – Gjilan, Kamenicë, dhe Viti u bë nën udhëheqjen e drejtpërdrejtë të Xhevat Qerimit, e duke vazhduar më pas edhe me organizimin e marrjen pjesë edhe në shumë demonstrata, protesta e veprimtari të tjera si në rrethin tonë e githkund ku paraqitej nevoja. Vdiq në një aksident automobilistik në fshatin Radivojc të Vitisë në vitin 1993.

RESHAT YMERI

Lindi në Gjilan në vitin 1962. Më 29 janari të vitit 1990, në demonstratat që u organizuan në Gjilan u qëllua për vdekje nga policia serbe, demonstruesi shqiptar, qytetari i Gjilanit, Reshat Ymeri. Pjesëmarrja masive e popullit shqiptar në demonstratë, ishte tregues i qartë për Serbinë pushtuese, se në Kosovë po krijoheshin rrethana të tjera dhe të reja. Ishte tregues i qartë se në udhëheqje kishte ardhur një gjeneratë e re, vazhduese besnike e idealeve të mëdha e liridashëse të heronjve Kadri Zeka, Rexhep Mala, Nuhi Berisha, Zija Shemsiu dhe të shokëve të tyre të gjallë që ishin burgosur dhe po dergjeshin burgjeve nëpër ish-Jugosllavi. Natën e 19 Janarit Këshilli i Rrethit të LPRK-së për Gjilan, Viti dhe Kamenicë, janë shpërndarë Trakte të LPRK-së që ishin derguar nga udhëheqja qendrore për shpërndarje, Trakt që i drejtohej popullit shqiptarë dhe opinionit të jashtëm, me rastin e mbajtjes së Kongresit të 14 të Jashtëzakonshëm të LKJ-së. Ky dokument politik ilegal kombëtar, ishte materiali që iu gjet në xhep, pas vrasjes nga policia pushtuese serbe të Reshat Ymerit, të cilin nga vendi i vrasjes e dërguan deri tek ambulanca afër stadiumit, vëllezërit Zeqir e Ali Rrahmani, dhe Nexharije Bajrami, dhe prej ambulancës e morri ndihma e shpejtë me shofer Riza Nezirin, i cili me gjithë pengesat e mëdha policore, bëri gjithçka që ishte e mundur për ta derguar sa më shpejtë në spitalin e Prishtinës, por pa sukses demonstruesi Reshat Ymeri, nuk kishte mundur të përballonte plagët e marra nga plumbat e pushkëve të pushtuesit.

AGIM RASHITI

Lindi në vitin 1963 në fshatin Dragancë të Gjilanit. Merrej me boks. Më 27 mars 1989 në Kosovë në përgjithësi dhe në Gjilan në veçanti, ishte totalisht gjithçka ndryshe. Populli shqiptar i gjendur nën pushtimin serbo-jugosllav, jetonte momentet e tij nga më të vështirat dhe nga më të rëndat. I ndihmuar dhe përkrahur nga struktura të caktuara federative, më 23 marës të vitit 1989, bëri me dhunë ndryshimet kushtetuese, e njohur në popull si kushtetuta e tankeve shqiptare. Më 27 mars 1989 në Gjilan, u organizua demonstrata kundër aneksimit të Autonomisë së Kosovës, në të cilën u vra Agim Rashiti. Në oborrin e spitalit regional të Gjilanit, serbët e goditën për vdekje, dhe aty pranë njerëzve që kuroheshin nga smundje të

ndryshme njerëzore. Neve anëtarëve të Këshillit të Rrethit të LPRK-s që kishim organizuar demonstratën e 27 Marsit, vrasja e demonstruesit shqiptar, Agim Rashiti, e goditi shumë, por rënia herike e kampionit të të rinjve të boksit kosovar, ishte mobilizim i madh për popullin shqiptar dhe lëvizjen ilegale politike, ishte mobilizim i madh i rinisë e cila po pergaditej te merrte mbi supet e saj flakën e luftës për liri.

NGJARJE

HELMIMET NË KOMUNËN E GJILANIT (19 MARS 1990)

Procesi i diferencimit dhe presioni i shtetit serb ndaj arsimit shqip në fillim të viteve nëntëdhjetë të shekullit të kaluar, mori dimensione të reja. Ndërsa, vazhdonte burgosja, presioni, dhe tendenca e ndryshimit të plan-programeve në veçanti lëndëve që kishin të bënin me elementin nacional shqiptar. Përpjekjet e vazhdueshme të Serbisë për kontrolluar arsimin shqip, nuk patën sukses. Pushteti serb nuk zgjedh mjete për të realizuar projektet anishqiptarëve. Në anën tjetër arsimit dhe shkollat shqipe bëhen bazament i fuqishëm organizimi, kundërshtimi e qëndrese politike. Pasi pushteti serb dështoi të impononte sistemin arsimor serb në Kosovë, ai mori masa më perfide duke helmuar mbi 7.000 nxënës shqiptar që nga entet parashkollore e deri te arsimit universitar. Kështu, më 22 mars 1990, Shërbimit Sekret serb, vë në funksion helmën "Sarin" në 13 qytete të Kosovës, duke përfshirë edhe Gjilanit. Pas helmimit, u zhvillua një luftë e ashpër mediatike e propagandistike, ku Serbia jo vetëm që mohonte veprimin, po e vlerësonte atë si propagandë e "aktrim" të nxënësve shqiptarë. Nga raporti i shoqatës "Mjekët pa Kufij" vërtetohet decidivisht se: në Kosovë ka pasur helmim të nxënësve shqiptarë. Raportin e kishte nënshkruar dr. Bernard Kushner, kryetar i Shoqatës Mjekët pa Kufij. Ky akt, sipas konventave ndërkombëtare ishte akt gjenocidal. Meqë Serbia kishte raporte të mira me shtetet perëndimore, tentoi që rastin ta minimizoj për motive politike. Në shkollat e Gjilanit, më 22 mars 1990, ishin helmuar rreth 263 nxënës shqiptarë, kryesisht vajza. Ndërsa numri i përgjithshëm në komunën e Gjilanit arrin në 444 të identifikuar. Sh.f. "Abaz Ajeti" 83 nxënës, Sh.m. "Boro e Ramizi" 128, Sh.m. "Zenel Hajdini" 145 nxënës, ShLP "Skënderbeu" 17 student, të tjerë 71 persona.

LËVIZJA PËR PAJTIMIN E GJAQEVE NË KOSOVË (1990)

Më 1990, Lëvizje e Pajtimit të Gjaqeve, u përhap gjithandej trevave, komunave e fshatrave të mbarë Kosovës, duke themeluar këshilla pajtimesh regjionale e komunale. Lëvizjes Gjithëpopullore të Pajtimit të Gjaqeve në Gjilan e Anamoravë i parapriu Parlamenti Rinor që

udhëhoqi Nexhat Buzuku. Në Kuvendin e mbajtur, më 18 mars 1990, në shtëpinë e veteranit të arsimit Reshat Shaqiri-Hoxha, me pjesëmarrjen e intelektualëve, studentëve e profesorëve, pleqnarëve e hoxhallarëve, u themelua Këshilli i Pajtimimit të Anamoravës, në krye me Mehmet Halimin. Këshilli i Pajtimimit pati përkrahjen e pa kursyer të mësuesve dhe të veprimtarëve politik, si dhe të një numri të madh djemsh e vajzash, nxënës e studentë, priftë, hoxhallarë, të cilët punuan pa reshtur fshat në fshat të Anamoravës. Pajtimet e gjaqeve mbyllën shumë varre, plagë e ngatërresa dhe evituan shumë hasmëri ndër vëllazërore. Ky këshill qendror, u degëzua pastaj sipas hierarkisë në këshilla komunale të Vitisë dhe të Dardanës e që u mbështet edhe në themelimin e këshillave të pajtimimit të Bashkësive lokale e deri tek këshillat e fshatrave e të lagjeve. Këta këshilla, në krye me Këshillin Qendror për Anamoravë, veprimtarinë e tyre të pajtimimit e shtrinë në Moravë të Epërme me Karadak e Malësi të Zhegocit, në fshatrat e Moravës së Poshtme me Gallap e deri në Moravicë-Bujanoc, Preshevë, Kumanovë. Në këtë drejtim, këto këshilla me veprimtarët e tyre e me krushqit pajtimtarë, korrën suksese të shënuara, duke bërë afër 400 pajtime. Prej tyre 169 gjaqe, 72 plagë e 87 ngatërresa, e një numër të konsideruar konfliktesh e mosmarrëveshjesh ndërvëllazërore. Gjatë pajtimeve me automjetet e tyre na erdhën në ndihmë të përhershme Zeqirja Dauti, Jahi Zubaku e Irfan Haki Sermaxhaj e shumë vullnetarë të tjerë. Për t'u afirmuar e kurorëzuar këto suksese u organizuan dhe u mbajtën shumë tubime pajtimesh, si: në Roganë u organizua më 25 mars 1990, të cilin e organizoi Parlamenti Rinor. Ceremoninë e Pajtimimit e udhëhoqën Nexhat Buzuku, Don Lush Gjergji e Mehmetali Rexhepi në Karaçevë të Epërme u mbajt më 30 prill 1990, njëri ndër tubimet më të mëdha në Anamoravë, ku morën pjesë rreth 250.000 qytetarë, në Zhegoc, në Selishtë, Çenar Çeshme, në Bresalc, Llabjan e Krilevë e tubime të tjera. Pajtimtarët shpeshherë u penguan nga policia serbe, siç ndodhi në Selishtë të Karadikut, ku u arrestuan e u rrahën organizatorët e tubimit, pronari i shtëpisë dhe u torturuan falësit e gjakut, sepse pajtimi i gjaqeve e uniteti kombëtar, e pengonte regjimin të pushtetit serb.

DEKLARATA KUSHTETUESE E KUVENDIT TË KOSOVËS (2 KORRIK 1990), MIRATIMI I KUSHTETUTËS SË KOSOVËS (7 SHTATOR 1990) DHE REFERENDUMI PËR SHPALLJEN E PAVARËSISË SË KOSOVËS (26 DERI NË 30 SHTATOR 1991)

Shuarja e autonomisë po shënonte fillimin e serbizimit të Kosovës dhe në të njëjtën kohë paraqiste hyrje në një periudhë tepër të rëndë për shqiptarët të cilët po trajtoheshin, jo vetëm

si qytetarë të rendit të dytë, por edhe po u nënshtroheshin torturave sistematike nga regjimi kriminal serb. Në situatën e rëndë politike në Kosovë, delegatët e Kuvendit të Kosovës, më 2 korrik të vitit 1990, miratuan publikisht dhe atë para Kuvendit të Kosovës, Deklaratën Kushtetuese, me të cilën Kosova u shpall njësi e veçantë në kuadër të federatës së atëhershme jugosllave. Ky ishte një akt historik i pritur moti dhe që shprehte aspiratat shekullore të popullit të Kosovës për mëvetësi shtetërore e territoriale nga Serbia. Më 7 shtator të vitit 1990, të njëjtët delegatë nxorën aktin më të lartë juridik - Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe me këtë ata edhe formalisht Kosovën e shpallën Republikë. Por, Serbia, pas shpalljes së Deklaratës Kushtetuese vendosi gjendjen e jashtëzakonshme në Kosovë, duke suprimuar me forcën e tankeve të gjitha institucionet e Kosovës, duke filluar nga Kuvendi e Këshilli Ekzekutiv i tij dhe deri tek të gjitha institucionet e tjera shkencore, arsimore e kulturore. Më 26 deri në 30 shtator 1991, në Kosovë u organizua dhe u mbajt Referendum. Në Gjilan Referendumin e organizuan degët e partive politike, të cilat funksiononin, ndërsa Komisionin Komunal për Zbatimin e Referendumit me vendim 01. nr. 11/91 e themeloi më 24.9.1991, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, nënshkruar nga nënkryetari Bejtullah Ismaili. Kuvendin Komunal e përbënin shqiptarët, që ishin përjashtuar më parë nga Kuvendi zyrtar i pushtetit të atëhershëm.

THEMELIMI DHE KONTRIBUTI I PARTIVE POLITIKE GJATË VITEVE 1990 – 1999

Në rrethana të një presioni të paparë pas suspendimit të autonomisë së Kosovës më 1989, filloi procesi i pluralizmit dhe me këtë edhe vetë organizimi i subjektit politik shqiptar për t'i bërë ballë pushtetit okupues serb. Në këtë kuadër filloi procesi i bashkimit të shqiptarëve që si rezultat pati krijimin e institucioneve të pavarura, të cilat më pas do të bëhen bazë e pushtetit të ardhshëm. Në këto kushte shqiptarët, që ishin anëtarë të Lidhjes Komuniste të Jugosllavisë, filluan t'i hedhin librezat dhe gradualisht të rreshtohen në subjektet e reja politike, që formoheshin në Kosovë. Struktura e këtyre njerëzve filloi të bashkohet, gati pa përjashtime, edhe me ish të dënuarit politikë, të cilët shpeshherë i kishin denoncuar. Në Gjilan të parët që u larguan nga Lidhja Komuniste e Jugosllavisë, duke i dorëzuar librezat partiake në shkurt 1990, qenë punëtorët e Kombinatit të Tekstilit të Gjilanit. Në këto rrethana u krijuan dy pole të kundërta: forca e pushtetit policor serbo-jugosllav dhe forca e organizuar të popullit të Kosovës. Këto rrethana të reja të krijuara në Kosovë e gjetën edhe Gjilanin me rrethinë të gatshëm për të filluar një jetë të re politiko-shoqërore. Në Gjilan më nuk mendohej

të jetohej me Serbinë, as të kërkoheshin të drejta në kuadër të saj, por thjeshtë organizimi politik forcohej rreth një platforme të përbashkët për liri e demokraci. Pas themelimit të Lidhjes Demokratike të Kosovës në dhjetor të vitit 1989, në Prishtinë si një subjekt i parë politik në Kosovë, shpejt u formuan edhe degët e saj nëpër komuna. Kështu, më 4 mars 1990, në Gjilan ishte formuar këshilli nismëtar i Degës së LDK-së, kurse më 15 prill 1990, u mbajt Kuvendi Themelues i Degës që për kryetar u zgjodh Musa Qerimin. Më 31 tetor 1990, u mbajt Kuvendi i Parë Zgjedhor i Degës së LDK-së ku forumet partiake u zgjodhën me më shumë kandidatë, ndërkaq kryetar u zgjodh Basri Musmurati. Brenda një periudhe kohore jo të gjatë, në Gjilan u formuan edhe degët e partive tjera të Kosovës si: Dega e Partisë Parlamentare të Kosovës, Dega e Partisë Fshatare e Kosovës, Dega e Partisë Shqiptare Demokristiane e Kosovës, Dega e Partisë Socialdemokrate e Kosovës, Dega e Partisë Nacional- Demokrate Shqiptare dhe Dega e UIKOMB-it. Më 15 prill 1990 në Gjilan u formua Forumi Demokratik si organi i përbashkët i subjekteve politike, të cilin e përbënin kryetarët e tyre: Musa Qerimi, Sabri Tahiri, Fatmir Salihu, Xhemajl Xhemajli, Dalip Dalipi dhe Faik Shkodra. Duke parë bashkëpunimin në nivel të këtyre subjekteve dhe gatishmërinë për t'u organizuar në një front të përbashkët për demokraci e liri, pushteti serb, i cili udhëhiqte me të gjitha institucionet në komunë, ushtronte dhunë, jo vetëm mbi udhëheqësit e zgjedhur në mënyrë demokratike dhe anëtarët e këtyre partive. Partitë politike sidomos LDK-ja dhe institucionet komunale të Gjilanit bashkëpunonin në të gjitha sferat e angazhimit politik dhe institucional edhe me subjektet e komunave tjera si me Vitinë, Kamenicën, Ferizajn e Prishtinën. Gjilani, si qendër kulturore, ekonomike dhe administrative e Anamoravës, luante një rol të rëndësishëm në komunikim me Preshevën, Bujanovcin, Medvegjën dhe Kumanovën, komuna këto me popullatë shqiptare. Në Preshevë në vitet 90 të shekullit XX funksiononin dy parti politike të shqiptarëve: Partia për Veprim Demokratik dhe Partia Demokratike Shqiptare, të cilat ndonjë herë edhe nuk mund të koordinonin veprimet e tyre të përbashkëta. Partitë politike, të cilat vepronin në Gjilan shpesh ndikuan që punët e këtyre dy subjekteve të koordinoheshin më mirë ndërmjet veti. Këto dy parti kishin të organizuar degët e tyre në Preshevë, në Bujanoc dhe në Medvegjë. Gjithherë, kur kishte ndonjë aktivitet me rëndësi politike në Gjilan, apo ndonjë aktivitet kulturor, ftoheshin edhe udhëheqësit e këtyre partive. Degët e partive politike në Gjilan krijuan forumin me emrin *Subjektet e Bashkuara Politike* dhe haptas dolën në mbështetje të plotë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ndodhi në një tubim të mbajtur, 22 qershor 1998 në shkollën fillore "Selami Hallaçi" në Gjilan, ku Abdullah Tahiri ftoi partitë politike dhe popullin të rreshtohen në

Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Më pas vazhdoj dhe eskaloj përballja e armatosur e UÇK-së me forcat policore e ushtarake serbe deri në fitoren e plotë në qershor të vitit 1999.

KRIJIMI DHE FUNKSIONIMI I INSTITUCIONEVE TË PËRKOHËSHME TË GJILANIT (1992 - 1999)

Ngase pushteti serb kishte uzurpuar të gjitha institucionet politike, administrative, kulturore, arsimore e shëndetësore dhe kishte përzënë me dhunë të punësuarit shqiptarë, këtyre të fundit nuk u mbeti tjetër, përveç organizimit politik, të bënë edhe një organizim të pavarur institucional të tyre. Ky organizim i pavarur në Kosovë, që nga Serbia quhej organizim ilegal, filloi të funksionojë dhe të japë rezultate të konsiderueshme gjatë gjithë kësaj periudhe. Më 26 deri në 30 shtator 1991, në Kosovë u organizua dhe u mbajt Referendum, ku populli u deklarua për shtet të vetin. Në Gjilan Referendumin e organizuan degët e partive politike, të cilat funksiononin, ndërsa Komisionin Komunal për Zbatimin e Referendumit me vendim 01. nr. 11/91 e themeloi më 24.9.1991, Kuvendi i Komunës së Gjilanit, nënshkruar nga nënkryetari Bejtullah Ismaili. Kuvendin Komunal e përbënin shqiptarët, që ishin përjashtuar më parë nga Kuvendi zyrtar i pushtetit të atëhershëm. Ndërkaq, më 24 maj të vitit 1992, u mbajtën zgjedhjet e para të lira parlamentare dhe presidenciale. Në këto zgjedhje President i Republikës së Kosovës u zgjodh Ibrahim Rugova, ndërsa deputetë nga komuna e Gjilanit u zgjodhën: Basri Musmurati, Fehmi Rexhepi, Hydajet Hyseni, Xhavit Ahmeti, e Zenun Pajaziti. Qeveria që e udhëhiqte Bujar Bukoshi si kryeministër, vepronin jashtë Kosovës si në Tiranë, në Gjermani në Zvicër etj. Konform organizimit qendror, edhe nëpër komuna filloi të bëhej një lloj organizimi institucional me formimin e këshillave komunalë. Degët e partive politike të Gjilanit në krye me LDK-në, në mungesë të institucioneve të mirëfillta që nga viti 1990 e tutje formuan këshillat komunale si organe të pushtetit vendor, të cilat komunikonin me organet qendrore në nivel të Kosovës që ekzistonin në Prishtinë: Kështu u krijuan këshillat komunale: Këshilli Komunal për Financim (kryetar Enver Muji), i cili kishte për detyrë të grumbullonte mjete financiare nga qytetarët për të financuar arsimin, shëndetësinë, kulturën etj. Më parë ky këshill quhej Këshilli për Vetëfinancim, kryetar i të cilit ishte zgjedhur Musa Musliu; Këshilli Komunal i Arsimit (kryetar Ymer Halimi) që më parë kishte funksionuar me emrin Lidhja e Arsimitarëve Shqiptarë, i cili kishte për detyrë të organizonte dhe të udhëhiqte procesin edukativo arsimor në nivel të komunës; Këshilli Komunal për Shëndetësi (kryetar Xhavit Hajdari), i cili organizonte funksionimin e shëndetësisë në komunë; Këshilli Komunal për Evitimin e Dukurive Negative (kryetar Halil Bllaca), i cili

kishte për detyrë të merrej dhe t'i zgjidhte kontestet e ndryshme pronësore juridike, ngatërresat e mosmarrëveshjet e ndryshme ndërmjet qytetarëve (në një farë mënyre ky Këshill luante rolin e gjykatave); Këshilli Komunal për Rini dhe Sport (kryetar Hasan Bunjaku); Këshilli Komunal për Bujqësi (kryetar Zija Isufi). Këshilli për Informim (Sabit Rrustemi - kryetar) Këta këshilla, ndonëse pa objekte institucionale shtetërore, punonin në objekte private, të cilat i liruan qytetarët vullnetarisht. Roli i tyre ka qenë i madh gjatë gjithë viteve 90 të shekullit të kaluar në organizimin e jetës institucionale në komunë.

SISTEMI I PAVARUR ARSIMOR, SHTËPITË SHKOLLA (1990 - 1999)

Pas largimit nga objektet shkollore ishtitucionet e Republikës së Kosovës u organizuan për vazhdimin e arsimit në objekte private të quajtura shtëpitë – shkolla. Kështu në bazë të vetëorganizimit të sistemit arsimor kriza u përballua, ngase të gjitha nivelet e arsimit e vazhduan punën në kushte shumë të vështira. Gjatë kësaj periudhe arsimtarët shqiptarë punuan pa paga ose me paga minimale. Largimi nga objektet shkollore dhe kalimi në shtëpi-shkolla ishte një akt i paparë në historinë e njerzimit. Viti shkollor 1991/92 ishte vendosur të fillonte më 1 shtator, por organet e dhunshme serbe nuk lejuan dhe afati u shty për 1 tetor. Në datën e caktuar para shkollave tubohen nxënës, arsimtarë, prindër e studentë. Në oborrin e shkollave protestohej ndaj policëve, nxënësve dhe arsimtarëve serbë, të cilët nuk lejonin zhvillimin e mësimin të nxënësve shqiptarë në objektet shkollore duke i ofenduar dhe gjuajtur me gurë, shishe e sende tjera. Të ndodhur në pozitë edhe më të vështirë, aktivistë, prindër e nxënës u mobilizuan edhe kësaj radhe dhe për një kohë të shkurtër shumë qytetarë ofruan shtëpitë e tyre për t'i adaptuar në shkolla që të vazhdojë procesi mësimor me planprogramet në gjuhën shqipe. Ky proces kërkonte angazhimin e Ministrisë së Arsimit, Lidhjes së Arsimtarëve Shqiptar “Naim Frashëri”, arsimtarëve, nxënësve dhe vetë prindërve kudo në Kosovë, por edhe në komunën e Gjilanit. Numri i saktë i shtëpive – shkolla në komunën e Gjilanit nuk dihet për faktin se pronarët e këtyre shkollave ndiqeshin dhe kërcënoheshin nga pushteti i atëhershëm. Një pjesë e këtyre shtëpive kishte shërbyer një kohë të shkurtër për shkaqe sigurie, pasi që duhej t'u ndërrohej vendi kur kishte të dhëna se përcillej nga sigurimi. Në shumë raste vetë nxënësit e një klase caktonin shtëpinë, ku do të mbahej mësimi dhe të nesërmen e merrnin arsimtarin dhe e dërgonin në vendin e caktuar. Njerëzit kompetent të Drejtorisë së Arsimit lidhur me këtë periudhë deklarojnë se nuk posedojnë të dhënat e asaj kohe, duke u arsyetuar se dy-tri herë i kanë konfiskuar organet e sigurimit. Ndonëse ishte një ndër lagjet më të varfëra, lagjia Kodra e Dëshmorëve ndër të parat u paraqit vullnetarisht që

të sigurojë shtëpitë – shkolla për cilëndo shkollë të qytetit. Fal angazhimit dhe organizimit të mirë në këtë lagje u vendos shkolla e mesme “ Boro e Ramizi”, së cilës Këshilli i profesorëve vendosi t’ia ndërrojë emrin në “ Arbëria”. “Në sigurimin e lokaleve për mësim na ndihmuan edhe aktivistët e lagjeve. Shkollës sonë ia kishin caktuar Bashkinë Lokale 2, të qytetit, e njohur si nëndega më aktive e LDK-së. Kryetari i kësaj nëndege, Xhymshit Osmani dhe veprimtari Hetem Kosumi, kishin siguruar 18 lokale për mësim dhe zyrën për drejtori në shtëpinë e Naser Morinës. Pas masovizimit të luftës (1999), pothuaj, të gjitha lokalet, ku është mbajtur mësimi u dogjën nga paramilitarët dhe vendësit serbë. Shumë pronarë të shtëpive –shkolla janë torturuar nga organet e dhunshme serbe. Përkundër vështirësive e mungesës së kushteve elementare që mësimi të organizohej normalisht, prapëseprapë asnjë shkollë në fillim të nëntëdhjetave nuk e ndërpreu mësimin. Shumica prej tyre vazhdonin mësimin në shtëpi – shkolla. Në shkollat fillore të qytetit si “Abaz Ajetit”, “Musa Zajmit” dhe “Selami Hallaqi”, ishin vendosur disa shkolla fillore e të mesme. Në këto rethana me vendimin e organeve drejtuese arsimore të atëhershme themelohet Shkolla Fillore “Rexhep Elmazi”. Nga nevojat e domosdoshme që kishte arsimit në Gjilan e rrethinë më 1994, themelohet Shkolla e Mesme e Mjekësisë “Dr.Asllan Elezi”. Ajo fillimisht kishte tri paralele, ndërsa në vitin shkollor 1998/99, kishte 27 paralele, disa prej tyre e zhvilluan mësimin në Pozheran dhe në Dardanë. Të gjitha përpjektjet e pushtetit serb për ta vënë nën kontroll arsimin dhe shkollën shqipe dështuan dhe kështu arsimit dhe shkolla shqipe gjatë viteve të 90-ta ashtu si gjithë populli i Kosovës e sfiduan me sukses këtë pushtet.

THEMELIMI DHE FUNKSIONIMI I MBROJTJES TERRITORIALE TË KOMUNËS SË GJILANIT

Nuk kishte munguar vullneti i shqiptarëve për t’i dalë zot Kosovës e për ta çliruar nga Serbia. Qeveria e cila udhëhiqej nga kryeministri Bujar Bukoshi jepte premtimin se Forcat e Armatosura të Republikës së Kosovës (FARK-u) do t’i ketë armët më moderne që do të përdoren në luftën për çlirimin e Kosovës. Për këtë arsye u krijua Ministria e Mbrojtjes, Shtabi i Përgjithshëm dhe Shtabet e Mbrojtjes Territoriale nëpër komuna të Kosovës. Njerëzit që u kyçën në këto struktura ushtarake nuk u kyçën me hamendje, po as prej naiviteti, por me bindje e vullnet dhe me besim të plotë në institucionet tona. Tanimë në komunën e Gjilanit nuk kishte asnjë vendbanim, qytet, fashat e lagje të vogla që nuk kishte një organizim për vetëmbrojtje. Të gjithë ishim në pritje, në ankth e rrezik permanent për zbulim, dekonspirim e arrestim nga forcat policore e ushtarake, e armët për t’u mbrojtur nuk kishin askund. Nazmi

Musa- komandant Shtabi i Mbrojtjes Territorial për komunën e Gjilanit Sali Hasani-zëvendës i komandantit të shtabit Fehmi Mahmuti-ndihmës i komandanti për çështje moralo-politike Shefqet Ismaili-oficer i lartë i karrierës ushtarake, ndihmës i komandantit për mësim Halit Zuzaku-oficer i lartë i karrierës ushtarake, ndihmës i komandantit për artileri (i planifikuar ne rrethana luftime) Sabit Zymberi -ndihmës i komandantit për ndërlidhje Agim Salihu - zëvendës i ndihmës të komandantit për ndërlidhje Shaqir Rustemi- ndihmës i komandantit për siguri Nehat Ramadani-ndihmës i komandantit për siguri Hevzi Maliqi- ndihmës i komandantit për logjistikë Xhavit Hajdari-ndihmës i komandantit për shëndetësi Ukshin Zajmi-ndihmës i komandantit për punë operative Sali Mustafa-ndihmës i komandantit për punë operative Fadil Kajtazi-ndihmës i komandantit për zbulim dhe kundërzbulim Sabit Rustemi-ndihmës i komandantit informim (zëdhënës) Lirije Kajtazi-ndihmëse e komandantit për informim Musa Qerimi-ndihmës i komandantit për strehim të zhvendosurve nga zonat e luftës Shefik Surdull-shef i sektorit për punë administrative Bejtush Isufi -shef i zyrës së prokurorisë ushtarake Halit Zymberi-shef i sektorit për sigurim dhe përcjellje të personave në detyrë Xhelal Salihu-Sektor i sigurim dhe përcjellje Xhemail Hyseni-kryeshef i financave.

LUFTA E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS (1997 – 1999)

PERSONALITETE

ZONA OPERATIVE E KARADAKUT

ABDULLAH R. TAHIRI

Abdullah Tahiri lindi më 2 shtator 1956 në Malishevë të Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në Malishevë të Gjilanit kurse të mesmen e filloi në Gjilan dhe në vitin 1975 dhe largohet për “veprimtari armiqësore” kundër shtetit ku e përfundoi në Bujanoc. Studimet i filloi në Fakultetin e Bujqësisë në Prishtinë, por nuk i mbaroi sepse ishte njëri ndër organizatorët e Demonstratave të Pranverës së vitit 1981. Kështu më 11 mars 1981, Abdullah Tahiri përmbyti tabakun e ushqimit dhe ky akt shënon fillimin e demonstratave të vitit 1981. Më 1 dhe 2 prill 1981, kur filluan demonstratat tjera që ishin të organizuara mirë dhe hapur u kërkua Kosova Republikë, ndërsa rol të rëndësishëm në organizimin e tyre kishte edhe Abdullah Tahiri. Demonstratat në Prishtinë Abdullah Tahiri i organizoi së bashku me Gani Kocin, Bajram Kosumin e shumë të tjerë. Abdullah Tahiri ka qenë aktiv edhe në kryesinë e Unionit të Subjekteve Politike të Gjilanit (USPGJ). Në mbledhjen e mbajtur më 15 qershor

1998, në shkollën fillore "Selami Hallaqi". Në fjalimin e tij të njohur, Abdullah Tahiri kërkoi publikisht përkrahjen për UÇK-në dhe kërkoi që të gjithë t'i bashkoheshin UÇK-së. Për veprimtarinë atdhetare të Abdullah Tahirit ishte njoftuar edhe policia serbe dhe më 15 gusht 1998, u arrestua së bashku me Ahmet Demirin, si themelues të UÇK-së në Zonën e Operative të Karadakut. U dënua më 4 vite burgim me disa të tjerë. Pastaj nga burgu i Gjilanit u transferua burgun e Dubravës nga i cili nuk u kthye më. Tani pushon në varrezat e dëshmorëve në Gjilan.

HANUMSHAHE A. ABDULLAHU – ZYMBERI

Lindi në vitin 1962 në Gjilan në një familje me traditë patriotike e humanitare. Hanumshahja rrjedh nga një familje të mëhallës së Musajve të Busavatës, e cila kah viti 1890-1900 shpërngulet në Gjilan. Hanumshahja ishte nxënëse e dalluar e edhe studente e dalluar. Ajo me sukses kreu fakultetin Filozofik, Dega e gjuhës dhe letërsisë shqipe. Në shkollën fillore "Rexhep Elamzi" punoi si arsimtare e pastaj edhe drejtoreshë e kësaj shkolle në Gjilan. Si studente e Universitetit të Prishtinës, aktivizohet në Lëvizjen studentore për të kërkuar më shumë liri dhe të drejta për shqiptarët. Hanumshahja u dallua edhe në Aksionin e Pajtimit të Gjaqeve. Me bashkëshortin e sajë prof. Tefik Zymerin nga Vërbica e Zhegocit në pranverë të 1999, u bashkohen radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës-Zonës së Karadakut. Më 15 prill 1999, duke kryer një detyrë të Shtabit Operativ të Zonës së Karadakut të UÇK-së, vriten në Betejën e Zhegocit nga forcat policore e ushtarake serbe, të cilat e kishin rrethuar Zhegocin e Vërbicën.

TEFIK V. ZYMBERI

Lindi në Verbicë të Zhegocit, me 21 dhjetor 1960. Ende pa u uluar në bankat e shkollës, Tefiku ishte këmbëngulës që t'ia fillonte shkollës me heret se bashkëmoshatarët e tij. Në shtatorin e vitit shkollor 1967, ulet në bankat e fillores në vendlindje, në Vërbicë. Tefiku dallohej nga nxënësit e tjerë për nga zgjuarsia, sepse ende pa hyrë në shkollë, kishte mësuar alfabetin. Pra, që nga klasa e parë e deri në mbarim të shkollës fillore të gjitha notat i kishte pesa. Për suksesin e shkëlqyeshëm ishte shpërblyer me mirënjohje si nxënësi më i dalluar në shkollë. Që në këtë moshë i interesonin më shumë letërsia shqipe, historia dhe gjeografia. Pasi kreu shkollën fillore, ai u rexhistrua në gjimnazin 'Zenel Hajdini', në Gjilan, Drejtimi Gjuhësor. Ç'prej shkollës së mesme kishte kuptuar se ndaj popullit shqiptar bëhej padrejtësi e programuar, dhe heret zgjohet urrejtja e tij ndaj pushtetit. Pas kryerjes së shkollës së mesme, dëshira e tij dhe e familjes ishte që t'a vazhdonte shkollimin edhe pse familja e tij varej vetëm

prej një pensioni të vogël, mirëpo, babai i tij i kishte premtuar: 'Gjithë pensionin do ta jap që ti të shkollohesh dhe të bëhesh i ditur'. Shpirti i tij u përshkua nga ngazëllimi, kur u sigurua se do ta vazhdonte shkollimin. Kështu ai regjistrohet në Fakultetin Filozofik, Dega Letërsi dhe Gjuhë Shqipe në vitin 1979. Në vitin, 1986 detyrohet ta kryej shërbimin ushtarak në Nish. Edhe pse e kishte kryer fakultetin, shumë vite nuk punoj në profesionin e tij. Në këtë periudhë kur edhe në Kosovë filluan të frynin erëra të 'procesave demokratike', Tefiku iu mundësua vetëm në malësi ta kapte ditarin e mësuesisë, në fshatin e tij të lindjes, në vitet 1990-1995. Nga viti, 1995 do të punojë në shkollën fillore "Vatra e Diturisë" të Livoçit të Epërm, në paralelën e ndarë në Pasjak, fshat në periferi të Gjilanit. Në vitin, 1993 martohet me Hanumshahe Abdullahun. Tefik Zymberin së bashku me Hanumshahen në pranverë të 1999, u bashkohen radhëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës të Zonës Operative të Karadakut. Ku u flijuat të dytë së bashku për Kosovën me 15 prill 1999 në Betejën e Zhegotit.

PAJAZIT M. AHMETI

Lindi më 7 Qershor të vitit 1971 në fshatin Zhegot. Ndjenjat e tij fetare bënë që ai të përcaktohet për të kryer mësimet në Medresenë "Alaudin" në Prishtinë, të cilën e kreu më sukses. Studimet nuk arriti t'i vazhdojë pasi që vitet e njohura 1989-1990 ishin vite të demonstratave për Pajazitin dhe bashkëmoshatarët e tij. Më 1990 u mobilizua dhunshëm në armatën jugosllave, në Mostar, prej nga arratiset pas pesë muajsh, duke mos dashur në asnjë mënyrë t'i shërbejë ushtrisë armike. Një kohë u fsheh, por në Shtator 1994 u kap nga policia serbe dhe u burgos me ç' rast u dërgua në Burgun Ushtarak të Nishit. Për shtatë muaj sa kishte qëndruar në burg, nga pasojat e torturave që organet represive serbe kishin ushtruar kundër tij, Pajaziti kishte humbur 15 kilogramë. Pas lirimit nga burgu i vetmi preokupim i tij ishte lufta e armatosur kundër pushtuesit, duke qenë thellë i bindur se nuk kishte alternativë tjetër për të fituar lirinë dhe për ta çliruar atdheun nga kthetrat e robërisë. Andaj nga kanale të fshehta, së bashku me disa kushërinj, arrin të blejnë armatimin. Bashkëpunëtorin dhe bashkëveprimtarin më të ngushtë të tij kishte pikërisht djalin e axhës së tij, Faik Ahmetin. Në maj të vitit 1998, Pajaziti dhe Faiku vënë kontaktet e para me grupin e Abdullah Tahirit, përmes shokut të Faikut, Fatmir Halilit dhe bashkëluftëtarit të tij Skënder Azemit. Ata shkëmbejnë armatim, me ç' rast Pajaziti e Faiku ua japin një sasi të madhe fishekësh, dhe duke iu precizuar veprimet e mëtejme, që duhej të ndërmerreshin në të ardhmen. Në këtë kohë vë kontakte edhe me Ahmet Isufin e Shemsi Sylën, të cilët bënin përpjekje për

të organizuar Zonën Operative të Karadakut të UÇK-së. Pas këtyre kontakteve, shtëpitë e Pajazitit, Faikut dhe tërë lagja e tyre bëhen baza të forta të luftëtarëve të UÇK-së, që depërtonin nga zona në zonë. Luftëtarët e UÇK-së që duhej të kalonin nga Drenica e Neredimja për në Llap, Gollak, Karadak dhe anasjelltas patjetër duhej të kalonin nëpër konakun e Pajazit Ahmetit, i cili me bashkëluftëtarët e tij ndodhte që me net të tëra të përcillte e siguronte pandërprerë rrugën deri në destinacionin e caktuar të luftëtarëve e eprorëve të lartë të UÇK-së si komandantët: Remi, Shukri Buja, Adem Shehu, e të tjerë. Komanda e ZOK-ut, duke analizuar të gjitha rrethanat e volitshme që kishte krijuar Pajaziti me bashkëfamiljarë e bashkëfshatarë në Zhegoc dhe rrethinë tij, vendos që të dislokohej pikërisht në shtëpitë e Pajaziti, Faikut dhe kushërinjve të tyre në Lagjen e Ahmetajve. Me që ishte fillimi i ristrukturimit të Zonës Operative të Karadakut, të gjitha veprimet dhe koordinimi i aktiviteteve ndërldidhej pashmangshëm me Pajazit Ahmetin. Më 15 prill 1999, në agun e tij fillojnë luftimet e ashpra në mes Forcave Çlirimtare të UÇK-së dhe makinerisë vrastare serbe që kishin mësyre Malësinë heroike të Zhegocit nga të gjitha anët. Ashtu siç ishte nisur i pari në Luftën e Ferizajit më 1944 Gjyshi i Pajazitit, ashtu u nis i nipi Pajaziti, t'u dal për ballë fallangave sllave, që kishin depërtuar deri në Hanet e Zhegocit. Pas një lufte të ashpër, në distancë shumë të afërt dhe atë në një pritë të befasishme, bie Pajazit Ahmeti. Pajaziti u varros afër vendit të rënies. U rivarros, më 17 shtator të vitit 1999 me nderime të larta ushtarake, në përcjellje të mijëra qytetarëve nga të gjitha anët e Kosovës në "Varrezat e Dëshmorëve të Kombit", në Gjilan. Në oborrin e Bibliotekës komunale Fan S. Noli është vendosur busti i tij dhe i bashkëluftëtarit, Alban Ajeti.

MUHARREM R. IBRAHIMI

Lindi në një familje 9 anëtarëshe qytetare, prej nënës Xhemile dhe babait Raifit, familje kjo që ka prejardhjen prej fshatit Ivajë të Rrethit të Leskocit, e cila ishte shpërngulur me dhunë qysh në vitin 1878. Shkollimin fillor dhe të mesëm i kreu në vendlindje gjegjësisht në Gjilan. Qysh si fëmijë kishte shprehur dëshirën të bëhej ushtarak. Babai i tij Raifi, duke e parë dëshirën e tij të madhe dhe i vetëdijshëm se edhe shqiptarëve iu nevojiten ushtarakët, e dërgoi në Akademinë Ushtarake, dega e Këmbësoresë, të cilën me sukses e kreu në Beograd dhe në Sarajevë. Karrierën e tij prej ushtaraku e filloi në Maribor të Sllovenisë. Ishte shumë i dëshiruar dhe i respektuar nga ushtarët shqiptarë që e kryenin shërbimin ushtarak atje. Muharremi, vazhdimisht i këshillonte ushtarët që të mos bien nën provokimet e armikut dhe iu ndihmonte. Ishte shumë i adhuruar edhe prej qytetarëve shqiptarë që punonin dhe jetonin

atje, për çka ishte vazhdimisht edhe nën përcjellje të Sigurimit Ushtarak. Me fillimin e shpartallimit të Jugosllavisë dhe fillimin e luftës në Slloveni, Muharrem Ibrahim i dërgohet në Murska Sobota dhe Shëntil, ku i kurdiset një pritë, në të cilën plagoset më datën 28 Qershor 1991. Sllovenët i afrojnë dezertim, por për shkak të sigurisë së ushtarëve të tjerë shqiptarë, nuk pranoi që të dezertojë. Pas shërimit, më 1992 vazhdon në Trebinje e mandej transferohet me shërbim në Mitrovicën e Kosovës. Muharremi, i pa kënaqur me padrejtësitë ndaj shqiptarëve, vendosë që ta braktisë Armatën, por me insistimin e aktivistëve lokal: Halit Zymberit dhe Nazmi Musës, vazhdon punën me shumë vështirësi. Në Mitrovicë, ishte i përcjellë dhe i provokuar nga kolegët dhe ushtarët serb. Më 1997, transferohet në Ferizaj, ku e merr gradën ushtarake "Major". Me fillimin e luftës në Drenicë, ai shprehë gatishmërinë që të kyçet në luftë, por udhëzohet që për shkak të nevojave të atëhershme, të qëndrojë deri sa është e mundur. Përmes shokëve shumë të besueshëm: Halit Zymberit e Hasan Agushit, Zonës Operative të Nerodimjes i jepet informatat për kazermën e Ferizajt, pozitat, planet, potencialin ushtarak, armatimin etj. Detyra e tij ishte që të alarmonte në rast nevojë përmes një lidhje shumë sekrete, të cilët ishin të gatshëm edhe ta evakuonin në një vend të caktuar. Më 3 Qershor, i jepet urdhri që të shkojë në luftë kundër shqiptarëve! Muharremi, këtë e refuzon kategorikisht, me arsyetimin se duhej ta shëronte djalin e sëmurë! Me mbarimin e shërimit të djalit të vogël ai jep dorheqje, me arsyetimin se duhet të qëndroj pranë djalit. Me 23 mars Gruan dhe dy fëmijët e tij i dërgon në Turqi. Gruan e porositi që të kujdeset për fëmijët, me që edhe ajo e dinte për qëllimet e tija! Më 25 Mars 1999, njoftohet se ka ardhur koha që të shkojë në luftë, në radhë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Në radhë të UÇK-së, përmes Elhami Bajramit, kyçet bashkë me shokët: Afrim Myrtaj, Rexhep Jahiun, Bekim Murtezin, Sami Ahmetin dhe të tjerë. Si ushtarak profesionist, punon në stërvitjen e ushtarëve të rinj dhe ngritjen e moralit të ushtarëve, ku u emërua Shef i Shtabit të Zonës. Ofensiva e 15 Prillit, të vitit 1999, në Malësinë e Zhegocit, i detyron që të tërhiqen në fshatin Marec, ku edhe aty ballafaqohen me një sulm tjetër masiv të makinerisë ushtarake – policore serbe. Në vijën e parë të frontit, qëllohet nga një granatë, ku merr lëndime në këmbë dhe në shpatull. Pas dy ditëve të plagëve, më 21 Prill 1999, në odën e Halil Canollit, në fshatin Marec, ndërron jetë dhe varroset në afërsi të varrezave të vjetra të kësaj familjeje. Prej atje, më 19 Shtator 1999, eshtrat e tij barten dhe rivarrosën në Varrezat e Dëshmorëve në Gjilan.

BESNIK V. MAROCA

Lindi në Kamenicë më 10 tetor 1975 , emër ky që pushka dhe rezistenca e Besnik Marocës (nofka "SYLA") dhe bashkëluftëtarëve të tij e kthyen në Dardanë. Rrjedh nga një familje me traditë të pasur atdhetare të cilën e karakterizon një e kaluar e lavdijshme përballë shumë shkelësve të mëhershëm Osman, atyre serbë e së fundi për ta vulosur me gjak fjalën LIRI, pas-ardhësi i Ramës, Xhaferit e Zeqir Marocës të cilët ishin Kaçak dhe bashkëluftëtar të denjë të Mulla Idriz Gjilanit bashk me Haki Efendinë e Muharrem Fejzën nga Hogoshti. Besniku ishte në perendim me punë të përkohshme, pas disa aksioneve të njësiteve të UÇK-së në Kosovë Ai u kthye në atdhe, që nga maji i vitit 1998 filloj aktivitetin e tij me bartje të armatimit nga Presheva në Zllash, e nga korriku i vitit 1998, radhitet në radhët e çlirimtarëve, aty gjen luftetarët; Ahmet Isufi, Florim Ramabaja, Shemsi Sylja, Milaim Nimani dhe Lulzim Leci. Fillimisht Besniku kryente punë të depoistit dhe rëndom ishte edhe vozitës. Besnik Maroca dhe shume bashkeluftetarë te tij pikerisht ne lagjen e Haxhollëve në Bullaj të Marecit, pas një lufte të rreptë përballë forcave ushtarake armike, Besniku po i printe në tërheqje një njësi të Zonës për të dalur nga rethimi i hordhive qetnike, strategjia e tij arriti ta çajë rrethimin por Besniku pasi nuk i shef disa bashkëluftetarë afer vetes, sërish hynë në rrethim për t'i nxjerrur të tjerët por kësaj radhe hyri në altar in e Lirisë për të mbetur gjithmonë i pavdekshëm. Besnik Veli Maroca ra heroikisht me 21 prill 1999 si pjesëtar i UÇK-së, Zona Operative e Karadakut.

ALBAN SH. AJETI

Lindi më 5 shtator 1978 në Gjilan, kurse jetoi në Vërbicë të Zhegocit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në një pikë tjetër të frontit, pas një luftë me armikun Alban Ajeti bie në altar in e lirisë më 15 prill 1999.

BASHKIM XH. SELISHTA

Lindi më 15 janar 1974 në Kranidell të Kamenicës, kurse jetoi dhe veprroi në Gjilan. Si shumë djemë e vajza të reja edhe Bashkimi iu bashkëngjit radhëve të UÇK-së, Zonës Operative të Karadakut. Një rrjet i gjerë organizatorësh përgjegjës për njësi vepronte për masivizimin dhe

shtimin e radhëve të UÇK-së në qytet dhe në rrethe. Për lagjen e tij të Zabelit & Sahit Agës ishte përgjegjës Bashkim Selishta. Më 2 korrik 1999, Bashkim Selishta bie dëshmorë.

BRIGADA 171 "KADRI ZEKA"

IBRAHIM M. URUQI

Lindi më 25 gusht 1968 në Bresalc të Gjilanit. Që në tetëvjeçare ishte i angazhuar në veprimtarinë kombëtare. Vazhdoi aktivitetin politik edhe gjatë viteve të 90. Në fillim të majit 1998, në mesin e grupit të dërguar në Shqipëri për t'u stërvitur dhe për të sjellë armë dhe që bënin përpjekje për një organizim ushtarak ishte edhe Ibrahim Uruqi. Ky grup, me tu kthyer nga Shqipëria arrestohet dhe pas gjyqit, ku dënohen me disa vite burg, lirohet deri në hyrjen në fuqi të vendimit. Pas daljes, nga burgu, një pjesë e këtyre, ku bënte pjesë edhe Ibrahim Uruqi-Hushi, do të angazhohen në luftë. Në ditët e para të krijimit të Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së iu bashkua Ibrahim. Ibrahim Uruqi (Hushi), ishte një ushtarak i lindur. Ai po i printe kolonës kur u ndesh përballë me armikun, në shkëmbim të të shtënave bie në fushën e nderit. Ibrahim Uruqi bie në betejën e Marecit më 21 prill 1999.

FADIL B. JAKUPI

Lindi më 15 korrik 1974, në Livoç të Epërm, komuna e Gjilanit. Shkollimin fillor e përfundoi në vendlindje në shkollën fillore "Musa Zajmi" paralelja e ndarë në Livoç të Epërm kurse të mesmen në Bujqësi. Edhe Fadili në mosh të re iu bashkua UÇK – së. Fillimisht zhvilloi aktivitetet ushtarake në Zonën Operative të Llapit të UÇK – së dhe me krijimin e Zonës Operative të Karadakut ai kthehet në këtë zonë dhe mori pjesë në të gjitha betejat e kësaj zone. Fadili bie në altarin e lirisë më 5 korrik 1999 në fshatin Livoç i Epërm.

SAHIT B. BAFTIU

Lindi më 1952, në Zhegoc. Në vendlindje e kreu shkollën fillore, të mesmen në Lipjan, kurse Fakultetin e Bujqësisë, në Prishtinë. Punoi si profesor. Sahiti nuk i gjykoj demonstratat e studentëve të vitit 1981. Ai me guxim i mbrojti simbolet kombëtare. Ai me një mbledhje me guxim iu kundërvu kryepolicit serb, Bogdanoviq dhe e sulmoi politikën kriminale të Beogradit ndaj shqiptarëve. Sahiti asnjëherë nuk ishte pajtuar me regjimin komunist të asaj kohe, të cilin e kishte kundërshtuar sa herë që kishte pasur rast. Vazhdimisht e ngrinte zërin ndaj padrejtësive që i bëheshin popullit shqiptar. Për këtë arsye, regjimi i kohës e kishte halë në sy profesorin e Bujqësisë, Sahit Baftiun, të cilin e përcillte këmba-këmbës. Ai ishte një

profesor i shkëlqyer në punën e tij me nxënës. Atyre nuk u përcillte vetëm mësimet nga agronomia, por kujdesej që tek brezi i ri të transmetonte edhe mesazhin e lirisë dhe pavarësisë së Kosovës. Në vitet e vështira për arsimin shqip, atij u desh të angazhohej edhe në tregti të vogël, si nevojë për ekzistencë familjare. Kur e përfundonte punën me ditat, hidhej në treg. Nuk dëshironte të bëhej barrë e askujt. Donte të jetonte nga djersa e tij. Por, kuptohet se arsimit dhe atdheu ishin detyrat e tij parësore dhe atyre u përkushtohej me tërë qenien e vetë. Ai e përkrahte UÇK-në. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut, në Zhegoc, që ishte vendlindja e tij, Sahit Baftiu u bashkua dhe i kreu të gjitha detyrat që iu ngarkuan nga Shtabi. Më 15 prill 1999, forca të shumta të ushtrisë, policisë dhe paramilitarëve serbë kishin ndërmarrë një ofensivë të madhe në drejtim të fshatit Zhegoc, ku ishte selia e Zonës Operative të Karadakut dhe ku po strehohej edhe një numër i konsiderueshëm i popullsisë civile. Të premtën e 16 prillit, Sahit Baftiu bie në altarën e lirisë, bashkë me djalin e tij, Kastriotin, vëllaun Shahinin dhe dhëndrin Bahriun, gjysmë kilometri larg fshatit Plitkoviq, në Malësinë e Zhegocit, e cila përherë ka qenë vatër e rezistencës ndaj armikut. Ata u vranë nga forcat serbe, në pjesën jugore të fshatit, tek vendi i quajtur "Lugu i Demës". Trupi i tij tani prehet në Kodrën e Dëshmorëve në Gjilan, në paqe të plotë, mes dëshmorëve të tjerë të atdheut.

NIJAZI SH. OSMANI

Lindi më 18 janar 1964 në fshatin Gadish të Gjilanit, shkollën fillore e kreu në vendlindje kurse të mesmen në Gjilan. Me krijimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai iu bashkohej djemve dhe vajzave të lirisë. Nëpërmjet eprorëve të lartë të Zonës Operative të Nerodimes vendosen kontaktet edhe me këtë zonë. Pikë koordinimi të këtij kontakti caktohet në Malësinë e Zhegocit dhe Verbicës. Njëri ndër koordinatorët përgjegjës të kësaj pike ishte edhe Nijazi Osmani. Një rrjet i gjerë organizatorësh përgjegjës për njësi vepronte për masivizimin dhe shtimin e radhëve të UÇK-së në qytet dhe në rrethe. Në fshatin Gadish e Kishnapole ishte Nijazi Osmani. Kurse më 15 prill 1999, në betejën e Zhegocit, në luftë me forcat serbe dhe në mbrojtje të jetës së banorëve ra Nijazi Osmani.

BAHTIR H. JAHIRI

Lindi më 1 maj 1975 në Verbicë të Zhegocit të komunës së Gjilanit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje kurse të mesmen në Gjilan dhe fakultetin e Edukatës sportive në Prishtinë. Punoi si mësimdhënës në vendlindjen e tij në Verbicë. Me themelimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së Bahtiri iu bashkohet radhëve të UÇK-së. Mori pjesë në betejën e

Zhegotit kurse në betejën e Marecit në luftë kundër ushtrisë serbe më 21 prill 1999 ra në fushën e betejës në Marec.

IBRAHIM Q. PACOLLI

Lindi më 18 tetor 1960 në Kmetoc të Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. mori pjesë në betejën e Zhegotit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Pas betejës së Zhegotit forcat e UÇK – së grumbullohen në Marec, kurse forcat serbe fillojnë ofensivën në Malësinë e Marecit e cila zhvillohet më 21 prill 1999, në këtë betejë vritet edhe Ibrahim Pacolli.

ENVER SH. MIFTARI

Lindi më 14. 5. 1974 në Verbicë të Zhegotit. Shkollën fillore e kreu në vendlindje, ndërsa të mesmen e vazhdoi në Prishtinë në shkollën teknike “28 Nëntori”. Enveri ishte shumë i angazhuar. Me fillimin e luftës në Kosovë u inkuadrua në radhët e UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut emrin e ri të luftës “Bardhi”. Me të dëgjuar se në fshatin Zllash të Marecit kishte filluar edhe stërvitjet për ata që donin t’i bashkoheshin luftës kundër forcave okupatore serbe ai në janar të vitit 1998 shkoi atje dhe qysh nga ajo ditë iu bashkohet radhëve të UÇK-së. Pas përfundimit të stërvitjeve ushtarake në Zllash, ai u vendos në fshatin e tij në Verbicë. Më 15 prill të vitit 1999 ishte pjesëmarrës i betejës së Zhegotit, ndërkohë më 17 prill 1999 ishte pjesëmarrës në betejën e Marecit. Pas këtyre betejave Enverit i shtohet morali dhe nga komanda emërohet në detyrë speciale në vijën Marec, Verbicë, Zhegoc, Kishnapole. Enveri ishte njeri që nuk fliste dhe mbante një heshtje burrërore. Ishte i ri por lufta dhe morali i luftës e kishte bërë si burrë me pjekuri para kohe. Në atë mëngjes të hershëm të 8 qershorit 1999 forcat serbe ia mësyn vendit ku ishin të vendosura njësit e UÇK-së, në mesin e tyre edhe Enveri. Pasi i vëren forcat serbe, Enveri hapi zjarr në drejtim të tyre, duke u shkaktuar humbje dhe njëkohësisht alarmoi bashkëluftëtarët për rrezikun dhe me një mençuri krijoi korridorin për tërheqje. Në luftim e sipër Enveri plagoset në këmbë dhe pasi i jep vetes ndihmën e parë e lidh plagën dhe ashtu vazhdon betejën kundër forcave serbe duke shkrepur rafalët një pas një dhe nga një kënd tjetër, ku pas një lufte të madhe nga një distancë Enveri goditet edhe një herë nga snajperistët serbë, me ç’rast edhe bie heroikisht në altarin e lirisë. Ra në krye të detyrës në Verbicë në Lagjen “Avdiu” ku edhe ishin të vendosura njësit e UÇK-së për një kohë të pacaktuar. Qëndresa e Enverit-Bardhit për të rezistuar dhe përgjigjur ballë për ballë me forcat armike i pengoi që ato t’u afrohen pozicioneve të UÇK-së. Sulmet e

armikut ishin të ashpra në drejtim të pozicionit dhe pikës mbrojtëse që mbronte Bardhi. Falë rezistencës dhe heroizmit të tij, për ta mbrojtur një mjeke dhe bashkëlufëtarët e tij ai u qëllua me snajper dhe u plagos në këmbë. Më 8 qershor 1999 u bë varrimi i Enverit me nderime të larta të ushtarëve dhe të afërmeve që ishin në fshatin Verbicë. Komanda e ZOK-ut më 17 shtator 1999 organizoi rivarrimin e Enverit dhe të gjithë dëshmorëve në varrezat e dëshmorëve në Gjilan. Në vendin e rënies, në Lagjen e "Avdiu" në Verbicë është ngritur përmendorja. Pllaka në përkujtim të këtij dëshmori është ngritur dhe të varrezat e Lagjes "Ismaili" ku ka qenë i varrosur. Për Enverin ka shkruar shtypi ditor, javor dhe janë shkruar edhe libra, si dhe janë mbajtur akademi përkujtimore.

IBRAHIM S. FEJZULLAHU

Pjesëtar i Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së. Lindi më 06 maj 1967. Ibrahim Fejzullahu ishte ndër të parët në organizimin e luftës në kuadër të zonës operative të Karadakut të UÇK-së që vepronte në njësitin për furnizim të armëve të zonave Llap e Karadak. Ibrahim kishte marrë pjesë në shumë aksione për furnizimin e armëve në vitin 1998-1999. Bie dëshmorë më 29 maj 1999 në krye të detyrës. Në luftën e UÇPMB-së, brigada 113 e merrë emrin e dëshmorit të kombit Ibrahim Fejzullahu.

KASTRIOT S. BAFTIU

Kastriot Baftiu u lind më 24 nëntor 1983 në Prishtinë. Prindërit e tij, Sahiti e Hyrija e kishin të parin fëmijë. Shkollën fillore e kryen në Gjilan, kurse të mesmen e vazhdoi në gjimnazin "Zenel Hajdini", të cilin nuk arriti ta përfundojë për shkak të rethanave të luftes. Pas fillimit të bombardimeve të NATO-s mbi caqet ushtarake serbe, familja e Kastriotit u largua nga qyteti i Gjilanit dhe u vendos në fshat, në malësinë e Zhegovcit. Ky ishte edhe momenti kur ai, megjithëse fare i ri në moshë, së bashku me të atin, Sahitin, u inkadrua në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Atij iu caktua detyra e vëzhgimit të terrenit gjatë natës, detyrë të cilën e kryen me disiplinë. Gjashtëmbëdhjetë prilli i vitit 1999 ishte dita e fundit e jetës tokësore për Kastriot Baftiun. Në këtë ditë ai ra për lirinë e Kosovës, nga plagët e marra në një pritje të organizuar nga forcat e armikut, në malësinë e Zhegovcit. Në atë moment bien edhe i ati, Sahiti. Varrimi i Kastriotit u bë në varrezat e fshatit, më 17 shtator të vitit 1999. Rivarrimi i tij u bë në varrezat e dëshmorëve në Kodrën e Dëshmorëve në Gjilan.

MEHMEDALI SH. BEHLULI

Lindi më 18 qershor 1976 në fshatin Dobërqan të Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Mehmedaliu vritet më 5 gusht të vitit 1999.

ZYLFIJE F. GASHI

Lindi më 5 korrik 1979 në fshatin Tërbufc të Lipjanit, me që fshati i saj i lindjes nuk shkollë ajo u detyra të kryej shkollën në Sllovi e Akllap. Më vonë në fshatin Tërbufc u hap shkolla katër klashe ajo e kreu shkollën në Tërbufc. Por më vonë Zylfija e ndërpreu shkollimin. Tërbufci si fshat i vogël dhe në rrëzë të Malësisë së Zhegocit kishte pozitë strategjike. Për shkak të pozitës së mirë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Zona e Operative e Karadakut vendosi të operoj edhe në këtë fshat. Ndihej të madhe UÇK – së i dha familja e Zylfijes. Shtëpia e saj u bë bazë e sigurt për ushtarët e UÇK – së. Nga kjo pikë bëheshin ndërlikimet ndërmjet zonave si me atë të Drenicës, Nerodimes, Llapit etj. Nga vera e vitit 1998, e gjithë familja e Zylfijes ishte nën shërbimin e UÇK-së. Zylfije Gashi ishte angazhuar në informim. Por ajo dëshironte të armatosej dhe të luftoj me ushtrinë serbe. Kurse në ofensivën e Betejës së Zhegocit ajo vritet më 16 prill 1999 në fshatin Tërbufc të Lipjanit.

BAHRI XH. SADIKU

Lindi më 31 maj 1969 në fshatin Zhegoc të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Bahri Sadiku bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Zhegoc.

SHAHIN B. BAFTIU

Lindi më 28 gusht 1959 në fshatin Zhegoc të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Shahin Baftiu bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Zhegoc.

BLERIM M. ADEMI

Lindi më 31 maj 1979 në fshatin Bresalc të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Blerim Ademi bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

FATMIR M. ADEMI

Lindi më 5 korrik 1966 në fshatin Bresalc të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Fatmir Ademi bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

RAMADAN H. HYSENI

Lindi më 20 shkurt 1954 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Ramadan Hyseni bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

SHABAN H. HYSENI

Lindi më 20 shkurt 1970 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Shaban Hyseni bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

ILMI H. HYSENI

Lindi më 10 qershor 1966 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999,

ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Ilmi Hyseni bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

AFRIMI GAGICA

Lindi më 23 mars 1969 në Gjilan. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Kurse vritet më 10 korrik 1999 në Gjilan.

NASER Q. AZEMI

Lindi më 16 shkurt 1967 në Gjilan. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Kurse vritet më 10 korrik 1999 në Gjilan.

SHERIF S. SHERIFI

Lindi më 7 maj 1943 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Sherif Sherifi bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

ISMET I. AJETI

Lindi më 29 mars 1941 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

FADIL SH. AJETI

Lindi më 5 dhjetor 1977 në fshatin Verbicë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbicë të Zhegocit.

FEIM H. AJETI

Lindi më 21 maj 1983 në fshatin Verbiçë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbiçë të Zhegocit.

ISMET H. SADIKU

Lindi më 25 korrik 1956 në fshatin Verbiçë e Zhegocit të komunsë së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbiçë të Zhegocit.

IBRAHIM R. BEQIRI

Lindi më 22 nëntor 1975 në fshatin Smallushë të komunës së Lipjanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbiçë të Zhegocit.

MEHMETALI J. AJVAZI

Lindi më 1 maj 1975 në fshatin Livoç i Epërm të komunsë së Gjilanit. Shkollimin e kreu në vendlindje në shkollën fillore "Musa Zajmi" paralelja e ndarë në Livoç të Epërm. Kurse shkollimin e mesëm në Gjilan. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Pasi ishte angazhuar për të kryer disa detyra, ai vritet më 16 prill 1999 në Suharekë.

SHYQERI Z. AJVAZI

Lindi më 30 shtator 1962 në fshatin Livoç i Epërm të komunsë së Gjilanit. Shkollimin e kreu në vendlindje në shkollën fillore "Musa Zajmi" paralelja e ndarë në Livoç të Epërm. Kurse shkollimin e mesëm në Gjilan. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i

bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Pasi ishte angazhuar për të kryer disa detyra, ai vritet më 16 prill 1999 në Suharekë.

BAJRAM Q. GASHI

Lindi më 15 dhjetor 1965 në fshatin Sllovi të komunës së Lipjanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në fshatin Sllovi të Lipjanit.

BASHKIM R. RAMADANI

Lindi më 24 nëntor 1982 në fshatin Verbiçë e Zhegocit të komunës së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbiçë të Zhegocit.

BEJTUSH S. GERBESHI

Lindi më 10 prill 1967 në fshatin Sllovi të komunës së Lipjanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në fshatin Sllovi të Lipjanit.

ENVER A. PACOLLI

Lindi më 13 mars 1971 në fshatin Marec të komunës së Prishtinës. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në Verbiçë të Zhegocit.

GAFURR Q. HYSENI

Lindi në fshatin Sllovi të komunës së Lipjanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit

serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Në këtë betejë bie në altarin e lirisë më 15 prill 1999 në fshatin Sllovi të Lipjanit.

SHEFKI F. SALIHU

Lindi më 22 shkurt 1950 në fshatin Zhegoc të komunës së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Në betejën e Zhegocit që u zhvillua më 15 prill 1999, ndërmjet ushtrisë serbe dhe forcave të UÇK – së të Zonës Operative të Karadakut. Ra në altarin e lirisë më 3 qershor 1999 në fshatin Sllovi të Lipjanit.

HASAN E. MALOKU

Lindi më 23 qershor 1967 në fshatin Selishtë të komunës së Gjilanit. Ishte i angazhuar në Zonën Operative të Karadakut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me breshëri plumash u vra më 8 maj të vitit 1999, në malet e fshatit Ostrovicë të Preshevës, përderisa po vinin nga Maqedonia drejt vendlindjes së tyre.

UKSHIN S. MALOKU

Lindi më 1 janar 1972 në fshatin Selishtë të komunës së Gjilanit. Ishte i angazhuar në Zonën Operative të Karadakut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me breshëri plumash u vra më 8 maj të vitit 1999, në malet e fshatit Ostrovicë të Preshevës, përderisa po vinin nga Maqedonia drejt vendlindjes së tyre.

SABEDIN S. HAMITI

Lindi më 10 tetor 1957 në fshatin Goden të komunës së Gjilanit. Ishte i angazhuar në Zonën Operative të Karadakut të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me breshëri plumash u vra më 8 maj të vitit 1999, në malet e fshatit Ostrovicë të Preshevës, përderisa po vinin nga Maqedonia drejt vendlindjes së tyre.

NEZIR SH. SHURDHANI

Lindi më 15 korrik 1952 në fshatin Poliçk të Kamenicës. Jetoj në Gjilan. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Kurse vritet më 22 qershor 1999 në Gjilan.

NUSRET F. HAJDARI

Lindi më 10 tetor 1968 në fshatin Miresh (Dobërqan) të komunës së Gjilanit. Kryente detyrën e imamit në xhaminë e Mireshit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Gjatë tërheqjes së forcave serbe nga Kosova për në Serbi dhe më 13 qershor 1999, u ndalën në Miresh dhe e vrasin hoxhën në xhaminë e fshatit.

AVNI Q. ARIFI

Lindi më 1 gusht 1968 në fshatin Cernicë të komunës së Gjilanit. Me formimin e Zonës Operative të Karadakut të UÇK-së ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës për të luftuar kundër okupatorit serb. Vritet më 30 qershor 1999 në fshatin Slivov të komunës së Prishtinës.

BRIGADA 153 "AGIM RAMADANI"

AGIM H. RAMADANI

Lindi në fshatin Zhegër të komunës së Gjilanit, më 3 maj të vitit 1963. Shkollimin filor e kreu në vendlindje, të mesmen shkollën teknike në Gjilan në vitin 1980, ndërsa Akademinë ushtarake-drejtimi i komunikacionit në Zagreb të Kroacisë. Me poezi dhe pikturë është marrë që nga shkollimi i mesëm. Përderisa poezitë e tij, sa ishte gjallë i mbetën të shpërndara nëpër revista të ndryshme e në dorëshkrim, si piktor organizoi ekspozita kolektive e personale në Kroaci, ku punoi si ushtarak e në Zvicër, ku jetoi si emigrant politik, mëqë me fillimin e luftës në Kroaci, ai braktisi Armatën Jugosllave ku punonte si oficer. Në vitin 1998 pranohet antarë nderi në Akademinë Evropiane të Arteve. Ndonëse kishte të rregulluar statusin e emigrantit, Agim Ramadani në vitin 1998, iu përgjigj thirrjes së atdheut dhe u inkuadrua në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, duke lënë në Zvicërr tre fëmijë dhe gruan. Gjatë luftës u dëshmuua si strateg i lartë dhe udhëheqës i dashur për ushtarët. Ishte njëri ndër hartuesit e planit për thyerrjen e kufirit shqiptaro-shqiptar, gjë të cilën edhe e bëri bashkë me shokët e vet. Ishte i pari që shkuli gurin-piramidën-kufitare në Koshare. Në muajin prill të vitit 1999, brigada 138 "Agim Ramadani" vuri në zbatim planin ushtarak për mposhtjen e mbrojtjes së kufirit ndërmjet dy pjesëve të tokës etnike shqiptare, Kosovës dhe Shqipërisë politike, me qëllim të heqjes së këtij kufiri. Të gjitha parapërgatitjet për këtë sulm ishin bërë me kohë. Sipas planit strategjik, kufiri duhej të thyhej në Koshare. Ndër ata qindra luftëtarë të lirisë, të cilëve u takoi nderi dhe lavdia për ta thyer këtë kufi. Ato ditë prilli, në zonat rreth

Koshares u zhvilluan beteja të ashpra dhe vendimtare për fatin e luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sepse, nga aty duhej të fillonte kapitullimi dhe tërheqja e forcave të pushtuesit serb nga Kosova. Betejat u fituan dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës triumfoi mbi armikun. Kosharja, Rrasa e Koshares, Rrasa e Zogut dhe toponime të tjera të kësaj zone kufitare, tashmë janë bërë sinonime të betejës për heqjen e kufirit dhe ribashkimin e tokave shqiptare, por edhe sinonim i lavdisë dhe i heroizmit të trimave të UÇK-së. Këta trima ia kishin mësyre këtij kufiri, të vendosur për ta hequr atë. Pas thyerrjes së këtij kufiri, në pjesën e Kosovës, tek vendi i quajtur Rrasa e Zogut, ai ra heroikisht duke mos vdekur kurrë. Njihet me emrin konspirativ-Katana. Llogaritet si një nga heronjtë më të njohur të historisë së re shqiptare. Kjo ishte e mbeti fitorja më e madhe dhe më e lavdishme e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, të udhëhequra nga Agimi dhe dëshmorët të tjerë të kombit shqiptar. Triumfi i luftëtarëve nga mbarë trojet e Kosovës, të bashkuar në Brigadën 138, në krye të së cilës ishte komandanti Agim Ramadani, bëri që të shembet njëherë e përgjithmonë muri qindravjeçar i vënë në mes të Kosovës dhe Shqipërisë. Dhe, sa herë vijnë përvjetorët e dëshmorëve, gjithmonë do të përkujtohen e do të nderohen ndër shqiptarë, si dita kur në frontin e luftës ranë heroikisht Agim Ramadani, Salih Çekaj e shumë të tjerë. Në Gjilan para Teatrit Kombëtar i është ngritur një shtatore, në të cilën janë komponuar të gjitha elementet artistike dhe luftarake të Agim Ramadani-Katanës. Është përfaqësuar në disa leksikone dhe antologji të shkrimtarëve shqiptarë, të botuara pas vitit 2000. Agimi ia pas vetes tre pasardhës, djemtë Jetonin dhe Edonin, si dhe vajzën Laurinën.

ARBEN S. JUSUFI

Lindi më 24 maj 1976 në fshatin Cernicë të komunës së Gjilanit. Me fillimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb, ai i bashkohet UÇK-së. Ai bëhet pjesë e Brigadës 138 "Agim Ramadani" të Zonës Operative të Dukagjinit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ra në altarin e lirisë në vitin 1999.

URIM G. MEHMETI

Lindi në fshatin Cernicë të komunës së Gjilanit. Me fillimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb, ai i bashkohet UÇK-së. Ai bëhet pjesë e Brigadës 138 "Agim Ramadani" të Zonës Operative të Dukagjinit të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Ra në altarin e lirisë në vitin 1999.

FATOS SH. LIMANI

Lindi më 8 janar të vitit 1978, në Prishtinë, në një familje atdhetare me prejardhje nga fshati Pogragjë i komunës së Gjilanit. Prindërit e tij, Shefqeti e Hylkia, kishin treguar një përkushtim të madh prindëror ndaj fëmijëve të tyre, Leonorës, Fatosit, Mimosës e Kastriotit. Ata kishin arritur të krijojnë një çerdhe të shëndetshme, me ngrohtësi e me edukatë të mirë familjare. Një shkëlqim të veçantë në këtë çerdhe, bënte gazi, hareja dhe ylli i saj, Fatosi. Fatos Limani, shkollën fillore e kreu në Prishtinë, me sukses të dalluar. Sukses të dalluar arrin edhe në shkollën e mesme teknike “28 Nëntori”, të kryeqytetit. Siç ishte i mirë në mësim dhe i afërt e i sjellshëm me shokët, gjatë shkollimit fillor e të mesëm, i tillë ishte edhe gjatë kohës sa studioi në degën e arkitekturës në Fakultetin e Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës. I regjistruar në këtë degë, në vitin akademik 1996/97, ai i dha provimet në afatet e parapara, duke arritur deri në vitin e tretë të studimeve. Krahas studimit dhe ngritjes profesionale, Fatosi nuk qëndroi anash as ndaj zhvillimeve politike në Kosovë, në kohën kur faktor i kthesës së tyre ishte bërë rinia studentore. Veprim të angazhuar dëshmoi sidomos në kohën e lëvizjes studentore, në vjeshtë të vitit 1997. Me rastin e protestës së 1 tetorit 1997, Fatosi kishte testuar forcën e vet fizike në përballjen me militarët serbë. Në këtë kohë ai ishte bërë një ndër veprimtarët e shquar të lëvizjes studentore, e cila mori përsipër barrën për prishjen e gjendjes së status kuosë së krijuar nën robëri, duke e dinamizuar rezistencën përballë pushtuesit dhe duke paralajmëruar uraganin e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Shpërthimi i luftës së armatosur dhe dalja në skenë e UÇK-së, fillimisht në Drenicë dhe pastaj edhe në zonat e tjera të Kosovës, në zemrën e Fatosit shtoi edhe më tepër vullmin e dashurisë për lirinë e atdheut. Në këtë kohë, ai kishte shfaqur interesim të hapët për Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës dhe uniformën e saj. Duke qenë në kontakt me një rreth të caktuar shokësh, sidomos me koordinatorin e njësiteve të formacionit gueril BIA, Muhamet Ahmeti, në këtë kohë u inkuadrua në njërin prej njësiteve guerile të qytetit të Prishtinës. Si pjesëtar i njësitit gueril G-2 të BIA-s, Fatosi kreu aksione të shumta, në pjesën e qytetit të Prishtinës ku veproi ky njësit, duke dëshmuar shkathtësi dhe gatishmëri të lartë për sakrificë. Ndër aksionet e tij të kësaj kohe ishte edhe fotografimi nga një largësi e caktuar, si dhe skicimi i pozicionit të kazermës së ushtrisë serbe në Prishtinë, në janar të vitit 1999. Po ashtu, ai bëri edhe vëzhgimin e terrenit, siguroi shpërndarjen e gazetës ilegale të kohës “Çlirimi” etj. Pas fillimit të bombardimit të NATO-s mbi caqet ushtarake serbe, pushtuesi serb ndërmori fushatën kundër shqiptarëve për spastrimin etnik të Kosovës. Kjo fushatë e kishte përfshirë edhe familjen e Fatosit në Prishtinë. Më 31 mars të vitit 1999, ai së bashku me motrën,

Leonorën dhe me vëllanë, Kastriotin, ishte në mesin e popullatës civile që po dëbohej nga Kosova. Pas rrugës së gjatë, të kaluar kryesisht në këmbë, të nesërmen arriti në Kukës, prej nga duhej të vazhdonte për në Fier. Rrugës për në Fier, në rastin e parë të kontaktit me pjesëtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, në fshatin Kalimash, Fatosi u nda nga motra e nga vëllai, si dhe nga bashkudhëtarët e tjerë për t'iu bashkuar radhëve të kësaj ushtrie. Ai u paraqit në qendrën mobilizuese të UÇK-së në Kalimash. Në Kalimash, Fatosi u radhit në njësinë e komanduar nga eprori Binak Gashi të Brigadës 138 të UÇK-së, e cila më vonë do të emërtohet me emrin e komandantit të saj dëshmor, Agim Ramadani. Aty bëri stërvitjet dhe aftësimin e nevojshëm ushtarak, para se të shkonte në vijën e frontit. Në muajin prill të vitit 1999, brigada 138 "Agim Ramadani" vuri në zbatim planin ushtarak për mposhtjen e mbrojtjes së kufirit ndërmjet dy pjesëve të tokës etnike shqiptare, Kosovës dhe Shqipërisë politike, me qëllim të heqjes së këtij kufiri. Të gjitha parapërgatitjet për këtë sulm ishin bërë me kohë. Sipas planit strategjik, kufiri duhej të thyhej në Koshare. Ndër ata qindra luftëtarë të lirisë, të cilëve u takoi nderi dhe lavdia për ta thyer këtë kufi, ishte edhe Fatos Limani. Ato ditë prilli, në zonat rreth Koshares u zhvilluan beteja të ashpra dhe vendimtare për fatin e luftës çlirimtare të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare e Kosovës, sepse, nga aty duhej të fillonte kapitullimi dhe tërheqja e forcave të pushtuesit serb nga Kosova. Betejat u fituan dhe Ushtria Çlirimtare e Kosovës triumfoi mbi armikun. Kosharja, Rrasa e Koshares, Rrasa e Zogut dhe toponime të tjera të kësaj ish-zone kufitare, tashmë janë bërë sinonime të betejës për heqjen e kufirit dhe ribashkimin e tokave shqiptare, por edhe sinonim i lavdisë dhe i heroizmit të trimave të UÇK-së. Këta trima ia kishin mësyre këtij kufiri, të vendosur për ta hequr atë, qoftë edhe me çmimin e jetës së tyre. Këtë çmim e paguan shumë dëshmorë të lirisë, duke i shtuar gjymtyrët e atdheut e duke i zgjatur jetën atij. Ndër ta edhe dëshmori Fatos Limani, i cili ra në fushën e nderit, më 19 prill të vitit 1999, te Rrasa e Koshares. Trupat e këtyre dëshmorëve ishin varrosur si të paidentifikuar në varrezat e qytetit të Bajram Currit. Pas përfundimit të luftës, në gusht të vitit 1999, ata u rivarrosën në Koshare. Tre vjet më vonë, në gusht të vitit 2002, u bë rizhvarrimi i trupave të këtyre trupave, të cilët u dërguan në morgun e Rahovecit. Identifikimi i trupit të dëshmorit Fatos Limani u bë në dhjetor të vitit 2002. Sipas konstatimit të analizave të ADN-së, ai kishte rënë nga plagë armësh të zjarrit, të marra në gjoks. Rivarrimi i këtij dëshmori u bë më 16 janar të vitit 2003, në Varrezat e Dëshmorëve në Prishtinë, me ceremoni nderimi. Në shenjë mirënjohjeje e përjetësimi, një rrugë e Prishtinës është emërtuar me emrin e dëshmorit Fatos Limani. Ndërsa, në fshatin Pogragjë të Gjilanit është lokalizuar vendi ku do të ngrihet përmendorja e tij.

USHTRIA ÇLIRIMTARE PËR PRESHEVË, BUJANOC E MEDVEGJË

FATMIR H. IBISHI

Lindi më 10.10.1964 në fshatin Uglarë të Gjilanit. Fatmiri kreu shkollën fillore Emin Duraku në Uglarë në vitin 1998 kur në Kosovë kishte shpërthye lufta Fatmiri kthehet nga perëndimi në vendlindje dhe menjëherë kyçet në njësitet guerile të UÇK-së në Zonën Operative të Karadakut në pikën e Zhegocit në brigadën 171 Kadri Zeka. Në fillimin të luftës së UÇPMB-së Fatmiri ishte ndër të parët në themelimin e sajë. Ra heroikisht më 26. 02. 2000.

ARBEN S. RAMADANI

Lindi me 01. 06. 1981. U rreshtua në Zonën Operative të Preshevës Brigada 113. Arben Ramadani ishte një ndër të parët në pregaditjen e luftës së UÇPMB-së. Ishte aktiv në furnizimin dhe ruajtjen e armatimit. Pas luftës së UÇK-së menjëherë u radhit në organizimin e luftës në Zonës Operative të Preshevës ku mori pjesë në shumë detyra për strehimin dhe ruajtjen e armëve që më vonë doti shërbenin luftëtarëve të UÇPMB-së. Arbeni shërbeu në kuadër të Brigadës 113 Ibrahim Fejzullahu. Ra heroikisht më 19. 05. 2000.

SHABAN R. UKSHINI

Komandat Terri lindi me 10.11.1969 ishte pjesë e Zonës Operative të Preshevës Brigada 113. Shabani ishte një ndër themeluesit e parë të UÇPMB-së ishte aktiv edhe gjat përgaditjeve për luftë, mori pjesë edhe në sigurimin e armatimit dhe strehimit të tijë në luftën e UÇPMB-së mori pjesë që nga fillimi ishte pjesëmarrës i shumë betejave të Shoshajës, Bukocit, Rahovicës. Si komandant udhëhoqi në pikën e Bukocit batalionin e II-të Brigadës 113 Ibrahim Fejzullahu udhëhoqi edhe betejën e fundit të Rahovicës të 12 majit 2001. Ra heroikisht me 14 maj 2001 së bashku me Komandant Delta, Kasriot Arifi dhe Sami Ukshinin.

SAMI N. UKSHINI

Lindi me 23.12.1978 Zona Operative e Preshevës Brigada 113. Sami Ukshini ishte luftëtarë në brigadën 113 Ibrahim Fejzullahu mori pjesë në shumë beteja të luftës si në Shoshajë, Caravajkë, Bukoc dhe në Rahovicë ishte në njësitin për intervenim të shpejtë në kuadër të Zona Operative e Preshevës dhe si polic ushtarak. Ra në betejë më 14. 05. 2001.

KASTRIOT M. ARIFI

Lindi me 10.03.1976 Zona Operative e Preshevës Brigada 113 Kasrioti erdhi dhe u radhit si luftëtarë në brigadën 113 Ibrahim Fejzullahu në dhjetor të vitit 2000 fillimisht shërbeu në pikën e Muaxherës në kuadër të batalionit të I-rë brigada 113. Më vonë sistemohet në policinë ushtarake në kuadër të Zonës Operative të Preshevës si dhe në njësitin për intervenim të shpejt në kuadër të Zonës Operative të Preshevës, Kasrioti merr pjesë në shumë beteja në atë të Caravajkës të marsit 2001 dhe në fund të Rahovicës në maj 2001. Ra heroikisht më 14. 05. 2001.

BESIM I. MAZRREKU

Lindur 23. 01. 1981, u rreshtua në Zonën Operative të Çarrit Brigada 114. Besim Mazdreku u radhit në radhët e UÇPMB-së më 15. 01. 2001 në Zonën Operative të Çarrit në Brigadën 114 edhe Besimi ishte aktiv në betejat që u zhvilluan në Zonën Operative të Çarrit me nderë kreu detyrat deri në ditën e rënjes së tij. Ra heroikisht më 17. 04. 2001.

USHTRIA ÇLIRIMTARE KOMBËTARE

SKIFTER M. ARIFI

Lindi më 1 janar 1976 në Gjilan, një familje patriotike, atdhetare, kombëtare që ishte brumosur qysh në vegjëli, se si nderohet e mbrohet atdheu dhe si vdiset për atdheun. Skifteri në rinin e tij të hershme ishte i dalluar, ishte me plot guxim e frymzim. Në moshë të re që ishte, tek Skifteri vërehej një vetë besim dhe një trimëri e rrallë që ishte shëndruar si një vullkan në shpirtin e zemrën e tij e në trupin e tij të njom, po dhe Zoti i madh i kishte dhuruar plot shëndet dhe një rritje disi më të gjallë se moshatarët e tij. Shkollën fillore dhe të mesmën e kreu në vendlindjen e tij në Gjilan me sukses shembullore. Me fillimin e luftës së Kosovës në vitin 1999 , Skifteri lajmrohet vullnetar me plot dëshirë dhe rradhitet në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës. Kështu Skifteri ju bashkangjiti Zonës Operative të Dukagjinit në Brigadën 134 “ Bedri Shala”, që në këtë brigad kishte dhënë një rezultat të lart, gjatë luftës së tij titanike në të cilën kontriboi fuqishëm për çlirimin e Kosovës dhe ishte i gatshëm në çdo moment e çast dhe të jap dhe jetën për lirinë e Kosoves nënë. Çlirimi i Kosovës nga serbo-malazese për Skifterin ishte ideali i tij i përhershëm, se ishte i bindur se fitorja është në anën e çlirimtarve, se e ndjente ai fitoren në çdo hap të tij, se liria sot është më afër se dje e thoshte mos të lëm për neser, aksionet e filluara do rrezatojn me fitore më të fuqishme, e neser do të bëhet vonë. Për kontributin e tij madhor që kishte dhënë i madhi Skifter Arifi, Ushtria

Çlirimtare e Kosovës i kishte dhën besimin dhe e kishin emruar epror të Shtabit të UÇK-së. Këtë detyrë Skifteri e kreu me plot sukses dhe me përgjegjësi të lartë e devotshmëri. Pas çlirimit të Kosovës, Skifteri është angazhuar dhe është mobilizuar si në luftë e në liri dhe mori përsëri detyra të rëndësishme dhe u rreshtua në Trupat Mbrojtëse të Kosovës, në Zonën Operative të Dukagjinit dhe më pas u inkuadrua në Gardën e Kosovës. Kështu vazhdoi punën në zonën e gjashtë të TMK-së, në Gjilan. Me fillimin e luftës në Luginën e Preshevës, e me formimin e UÇPMB-së ai ishte angazhuar në celulat e para. Skifter Arifi, ishte në ballë të detyrës së tij fisnike në ndihm dhe organizim të bartjeve të ushqimit dhe armëve që duhej furnizuar atë pjesë të Kosovës Lindore gjatë luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanovcit. Me mbarimin e Luftës së Luginës së Preshevës Skifteri nuk ishte i kënaqur me lirinë me rezultatet e saja, se mbeti ajo pjesë e Serbisë. Në shkurtin e marsin e vitit 2001 pa hezitim vendosi dhe në mbrëmje bisedon me prindërit e tij. Ju tregon atyre se dua të shkoj atje dhe thekson se unë do të jap kontributin tim atje në Iliridë, se atdheu digjet flakë nga hordhit maqedonase-sllave. Në ballë të kolonës me flamurin luftarak të Brigadës 171 "Kadri Zeka" në dorë, Skifter Arifi dhe ushtarët dhe Komanda e Shtabit të ZOK-ut të UÇK-së, bëjnë foton e fundit me uniformë luftarake të UÇK-së, para nisjes për në manifestimin gjithkombëtarë në Prishtinë. Skifteri mobilizohet në Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare në brigadën "113 Ismet Jashari" në Sllupçan ku dhe atje ishin shkuar nga katër anët ku gjindeshin shqiptar që nga Tropoja, e Drenica, Dukagjini, Karadaku, Lllapi e Gollaku, për ti dal zot këti vatani e për të ndal njëherë e përgjithmon ato sulme të një pasnjishme, që sulmonte pa rreshtur fshatrat e vendbanimet shqiptare e ajo ishte ushtria vullgare maqedonase me tër potencialin shkatrues që e kishte. Skifter Arifi ra heroikisht në betejë në Sllupçan të Maqedonisë në emblemë të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare. Por më 10 qershor të vitit 2001 duke u ballafaquar në një distancë shumë të afërt me forcat sllavo maqedonase goditet nga një plumb nga armiku dhe bie dëshmor Skifter Arifi.

SHEFIK M. MIFTARI

Lindi në Verbicë të Zhegocit të komunës së Gjilanit. Ishte ushtarak shqiptar, dëshmor i luftës në Maqedoni. Shefik u kishte bashkuar forcave shqiptare të Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare që luftonin edhe më tutje pas çlirimit të Kosovës për lirin e shqiptarëve në territoret e administruara nga Maqedonia. U vra në vitin 2001 në Sllupqan të Maqedonisë.

KASTRIOT VOKSHI

Lindi më 17 dhjetor 1984 në Gjilan. Kastrioti mbaroi vetëm shkollën fillore dhe nga kushtet e vështira e ndërpreu shkollimin. Ishte rritur në frymën atëdhetare. Ai në moshë të re i ndihmoi UÇK-së në Kosovë dhe me mbarimin e luftës në Kosovë, ai u radhit në UÇPMB në moshën 15 vjeçare ku si komandant Muhamet Rrobelin (Rrebeli). Ai më 26 tetor 2000 ishte ushtar i UÇPMB-së ku me një besnikri dhe trimëri i kreu të gjitha detyrat e ushtarit. Me përfundimin e luftës në UÇPMB, ai më 08 qershor 2001 rradhitet menjëher në rradhët e Ushtrisë Çlirimtare Kombëtare në Ilirid në Maqedoni në brigadën Ismet JAshari si njësi intervenuese, ku si komandant kishte Maliq Ndrecaj. Me përfundimin e luftës në Maqedoni, ai vazhdoi përsëri luftën duke shtegtuar nëpër beteja të reja, kështu gjendet në luftën e katërt në Armatën kombtare shqiptare, por tash i kalitur i fort trim dhe me përvojë. Ai kreu shumë aksione barti armatim, municion, uniforma dhe mobilizoi shokët e liris. Ai tash më u bë i njohur me aksionet e tij me nofkën Qingji. Në ato vende u egërsua, kështu që regjimi Sllavomaqedonas e ndjek hap pas hapi bashk me disa kolonizator shqipfolës sllavomaqedonas. Pas shumë aksioneve të bëra me trimëri që ato përshkruhen në komunikatën e 19 të Frontit për bashkim kombtar shqiptar - Armata kombtare shqiptare, Shtabi zonës nr. 2 dhe nr. 3 . Lufta i hyri në gjak për Shqipërin e Bashkuar dhe nuk kishte të ndalur, ku u tregua tepër vendosur, besnik e trim dhe e dashti lirinë e popullit më tepër se Vetvetën deri sa vdiq për të u ringjallur bashk me ribashkimin e Shqipërisë. Pas shumë aksioneve rradha i vie aksionit fatal ku Kastrioti Vokshi (Qingji) bashk me shokët Badri Ramën dhe Nexhdet Ramën marrin përsipër detyrën për likujdimin e Ljube Boshkovskit, Ministër i punëve të brendshme të Maqedonis ku ky ishte aksion historik i kësaj Guerilje në krye me Qingjin. Më 14 shtator 2002 në Qollopek pas mesnate, mbas një përrleshje me forcat Sllavomaqedone, ku flitet se kishte edhe Shqiptar, vritet Kastriot Vokshi (Qingji) bie heroikisht për të mos vdekur kurr, kurse plagosen Bedri Rama dhe Nexhdet Rama. Që të dy të plagosurit zihen rob, transferohen në burgun e Idrizovës dhe denohen me 14 vite burg.

HYSNI R. XHEMAJLI

Lindi në fshatin Verbicë e Zhegotit të komunës së Gjilanit. Me fillimin e luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, për çlirimin e Kosovës nga pushtuesi serb, ai i bashkohet Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Me fillimin e luftës në Maqedoni të udhëhequr nga Ushtria Çlirimtare Kombëtare ai i bashkohet edhe kësaj ushtrie për çlirimin e tokave shqiptare që gjenden nën sundimin maqedonas. Vritet në vitin 2001 në Maqedoni.

NGJARJE

DEMONSTRATAT E STUDENTËVE (1 TETOR 1997)

Në muajin shkurt të vitit 1997 u mbajt Kuvendi Zgjedhor i Unionit të Pavarur të Studentëve të Universitetit të Prishtinës. Në këtë kuvend që u mbajt më 4 shkurt 1997, Bujar Dugolli u zgjedh kryetar i Unionit të Pavarur të Studenteve të Universitetit të Prishtinës (UPSUP). Menjëherë pas konstituimit të Kryesisë së UPSUP-së, me një përkushtim të madh filluam realizimin e ideve programore. Më 9 shtator 1997 u themelua Këshilli për Organizimin e Protestave (KOP), në shkallë të Universitetit. Këshilli Organizativ u përbë prej 5 studentëve dhe 4 profesorëve (Ejup Statovci, Bujar Dugolli, Muhamet Mavraj, Driton Lajçi, Albin Kurti, Milot Cakaj, Fetah Jagxhiu, Hajrullah Koliqi dhe Ahmet Gecaj). Më pas u konstituuan edhe nënkëshillat nëpër çdo institucion të arsimit të lartë, në përbërje prej tre studentëve dhe dy profesorëve. Gjashtë ditë më vonë, pra më 15 shtator, Këshilli Organizativ u mbledh dhe e hartoi Platformën për Protesta. Hartimi i kësaj platforme u bë në një atmosferë të konsoliduar, me përkushtim dhe në mënyrë mjaft inteligjente. Të mobilizuar fizikisht dhe shpirtërisht, të brumosur me këtë ide kryeneçe për rrethanat e atëhershme, por historike për nga qëllimi, ne studentët e UP-së në bashkëpunim të ngushtë me profesorët tanë të nderuar të asaj kohe, të cilët, mbi të gjitha, veç dijes, vunë në shërbim të shkollës shqipe edhe qenien e tyre fizike. Këshilli Organizativ i Protestave (KOP) mori vendim dhe e njoftoi opinionin e gjerë (të brendshëm dhe të jashtëm) që më 1 tetor 1997, në ditën e fillimit të vitit të ri akademik 1997/98, të fillojnë protestat. Rreth 5.000 studentë dhe rreth 500 profesorë ishin në organizim në forma të ndryshme dhe secili kishte nga një detyrë. Shenjat dalluese me stemën e UP-së ishin dërguar në selitë e unioneve për t'i tërhequr mbi 27 000 studentë. Para orës 9:00 të mëngjesit të ditës së 1 tetorit 1997 filluan të grumbulloheshin me mijëra e mijëra studentë, profesorë e qytetarë nga e gjithë Kosova në lagjen "Velania", ku edhe do të mbahej demonstrata. Marshin e demonstrimit filloi në orën 10:00. Megjithatë, forca të shumta policore serbe e kishin rrethuar Velaninë, e nuk lejoheshin të zbrisnim në qytet. Protesta e 1 tetorit u shtyp me dhunën më brutale. Plagosje, arrestime, maltretime të shumta ndodhen atë ditë. Pavarësisht nga intervenimi dhe pasojat, protesta e arriti qëllimin e vet, ajo përmbante shumë mesazhe. Mesazhi i parë i dërgohej drejtpërdrejt regjimit serb. Atij i bëhej me dije se studentët shqiptarë të Kosovës ishin gjallë dhe ishin të vendosur të mos pajtoheshin me politikën okupuese-nënshtruese serbe.

ZONA OPERATIVE E KARADAKUT E USHTRISË ÇLIRIMTARE TË KOSOVËS

Ushtria Çlirimtare e Kosovës ishte forca politike dhe ushtarake e popullit shqiptar të Kosovës e cila publikisht doli më 28 nëntor 1997. Në anën tjetër organizimi i Zonës së Karadakut, kishte edhe specifikat. ZOK – u në juglindje kufizohet me Maqedoninë, në verilindje me Serbinë, në veri me Zonën Operative të Llapit, në veriperëndim dhe jugperëndim me zonën Operative të Nerodimes. Në territorin e përgjegjësisë së ZOK-ut ishin të përfshira katër qendra Gjilanin, Vitinë, Dardanën (Kamenicën) dhe Artanën (Novobërdën). Ndër të parët, që vunë kontaktet me SHP të UÇK-së, ishte Abdullah Tahiri. Me përshkallëzimin e Luftës Çlirimtare, Abdullah Tahiri u angazhua për organizimin e UÇK-së në Gjilan dhe në Anamoravë. Ai në maj të vitit 1998, bën lidhjen e parë të tij me Shtabin e Përgjithshëm. Ky aktivitet i ngjeshur i Abdullah Tahirit u hetua edhe nga pushtuesi. E arrestojnë dhe e dënojnë me 4 vjet burg. Më 18 qershor 1998, nga Shtabi i Përgjithshëm, koordinatori për organizimin e Nënzonës caktohet Ahmet Isufi. Në korrik të vitit 1998, vendoset nga koordinatori që vendi i pozicionimit të Shtabit të jetë Mareci. Në dokumentet dhe aktet e arkivit të SHP të UÇK-së, si datë e konsolidimit me strukturë udhëheqëse e Shtabit të Zonës Operative të Karadakut është 8 nëntori 1998 në Zllash. Në këtë takim vendoset që të formohet Brigada 171 “Kadri Zeka” që vepronte në territorin Marecit, Malësisë së Zhegocit dhe Gjilanit. Më 1 mars 1999, mbahet mbledhja e Shtabit, ku bëhet mbulimi i të gjithë sektorëve të paraparë me rregullore të SHP të UÇK-së. Më, 4 prill 1999, Shtabi i Zonës merr vendim për të formuar edhe dy brigada, Brigada 172 “Isa Kastrati”. Kjo brigadë zonë të përgjegjësisë ka territorin e komunës së Dardanës; Brigada 173 “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, dhe zonë të përgjegjësisë ka komunën e Vitisë. Në Malësinë e Zhegocit, së pari u angazhuan përgjegjësit e njësiteve dhe, menjëherë pas kësaj, me një urdhër të komandantit të shtabit, një pjesë e Shtabit të Zonës dhe Brigata 171 “Kadri Zeka”. Në këtë kohë u intensifikua veprimtaria e të gjithë aktivistëve në Gjilan dhe në Viti për të furnizuar me sa më shumë material luftarak ushtarët e Brigadës 171, si dhe për t’i ngjeshur radhët e organizimit në kuadër të sektorit të logjistikës. Kjo shtrirje dhe ky mobilizim, shkaktoi edhe reagimin e armikut, i cili u alarmua duke filluar përgatitjet intensive për një ofensivë kundër forcave të UÇK-së. Së pari armiku ndërmoi disa aksione, duke granatuar disa shtëpi që ishin baza të UÇK-së në Gjilan dhe në rrethinë. Për të gjitha këto plane të armikut për të dhënë direktivat për përgatitjen e operacionit për përballje me forcat serbe ishte njoftuar komandanti i zonës, dhe për këtë, ai disa ditë qëndroi në Zhegoc. Në Betejën e Marecit u përfshinë në luftime dy zona operative: Zona Operative e

Llapit me Brigadën 153 dhe Zona Operative e Karadakut me Brigadat 171,172 dhe 173. Forcat serbe, duke shfrytëzuar motin e lig dhe me mjegull, në mëngjesin e datës së 18 prillit të vitit 1999, filluan ofensivën në shumë drejtime, duke u përpjekur që të rrethojnë plotësisht brigadat e UÇK-së. Forcat serbe, pozicioneve të UÇK-së ua mësynë nga të katër anët. Më, 12 e 13 qershor 1999, në selinë e Shtabit në Kishnapole mbahet takimi me Shtabin e Zonës dhe përfaqësuesit e pushtetit civil, të cilët për dy ditë radhazi bënë përgatitjen e strukturës së pushtetit civil në Gjilan. Arritja e forcave të NATO-s, më 11 qershor në afërsi të pozicioneve të UÇK-së në Vrellë, u prit me gëzim dhe u përshëndet me krisma pushkësh. Gjatë ditës së 14 qershorit forcat serbe tërhiqeshin në magjistralen Prishtine – Gjilan drejt Bujanocit. Për hyrjen në Gjilan, Shtabi i Zonës hartoi planin operativ. Pas disa njësive që, komandanti kishte dërguar në qytet dha urdhër për lëvizjen edhe të Shtabit. Sipas planit operativ, më 15 qershor 1999, nga fshati Kishnapole njësitet e ZOK triumfalisht hyjnë në qytetin e Gjilanit.

BETEJA E ZHEGOCIT (15 PRILL 1999)

Aktiviteti i forcave të UÇK-së, dhe rezistenca masive e popullit në rajonin e Gjilanit ndikuan që forcat serbe të ndërmarrin ofensivë në Malësinë e Zhegocit dhe në tërë hapësirën e komunës së Gjilanit. Ushtria e Serbisë po planifikonte që me një goditje të rrufeshme e të fshehtë të koduar me emrin „patkoi”, të kryente sulmin me tërë arsenalin e vet me një numër mbi 12 000 ushtarë ,policë ,paramilitarë drejtë pozicioneve të ushtrisë çlirimtare dhe malësisë së Zhegocit. Forca serbe me armatim të të gjitha llojeve, në agun e 15 prillit, ia mësynë Malësinë së Zhegocit, ku po zbatonin një rrethim të hekurt, në këto drejtime: Prej pjesës veriore respektivisht Mramorit dhe Kishnicës në drejtim të Zhegocit; Nga pjesa lindore gjegjësisht nga Llabjani, Parallova, Bresalci, Poneshi, Nga pjesa Jugore – Gadish, Kishnapole, Sllakoc, Nga pjesa veriperëndimore, prej Sllavisë, Okllapit në drejtim të Zhegocit, Drejtimi që shpie për në fshatin Plitkoviç tutje për Gadime e Smallush dhe malësia në këtë drejtim ende s’ ishte bllokuar tërësisht. Nga ushtarët pjesëtarë të UÇK-së në terren dhe nga vëzhguesit e njësive të ngarkuara për këtë aktivitet në pozicione luftarake, informohet Komanda e ZOK-ut dhe Brigada 171, “Kadri Zeka” për lëvizjet e armikut në drejtim të Zhegocit. Pas marrjes së njoftimeve se forcat serbe e kanë filluar ofensivën ushtarake, bëhet konsolidimi dhe rikonfirmimi i hierarkisë ushtarake nga komandanti i zonës, konsolidimi i Shtabit të ZOK-ut dhe komanda e Shtabi i Brigadës “171, “Kadri Zeka”, ngarkohet me detyra shtesë, përgatitet plani i evakuimit të popullit, përcaktohen njësitë për intervenim dhe ato, të cilat do të merren ekskluzivisht me bartjen dhe strehimin e njerëzve që

në këtë mëngjes i kishte kapluar frika e hakmarrjes serbe. Në ndarje të detyrave pasi nga drejtimi i fshatit Sllovi prej vëzhguesve të UÇK-së ishte pikasur synimi se njësit e ushtrisë serbe po ia mësynin Slovisë, Tërbofcit, tutje për lagjen Zhegoc i Poshtëm (lagja Baftiu) vendi, ku gjendej Shtabi i ZOK-ut. Lagja e Pajazit Ahmetit, me të pranuar këtë informacion nga Komanda e Brigadës është urdhëruar që komandanti i njësitit vëzhgues të Brigadës 171 „Kadri Zeka” me një numër të pjesëtarëve të njësisë të depërtojë në drejtim të fshatit Sllovi, me qëllim të mbledhjes së informacioneve më të sakta, arsenalin luftarak të armikut - numrin e tankeve dhe mjeteve të tjera të motorizuara, autobлиндave, drejtimin e lëvizjes, numrin e topave, numrin e përafërt të ushtarëve dhe pjesëtarëve të tjerë të forcave serbe, për t’iu kundërvënë depërtimit të mëtejshëm të forcave serbe. Informata të ngjashme për lëvizjen e forcave të armikut në Shtabin e ZOK-ut dhe në Komandën e Brigadës përcilleshin nga secila pikë dhe njoftohej se nga të gjitha drejtimet kishte filluar lëvizja drejt pozicioneve të njësiteve të UÇK-së. Me qëllim forcimin e pozicioneve dhe me detyra të caktuara si përforcim në pikën e vendosur tek lagja e Kurdijajve ishte nisur Nijazi Miftari-Miloti, atë deri afër Haneve të Zhegocit me makinë e përcjellë Pajazit Ahmeti, i cili për habinë e të gjithëve, atë ditë ka qenë më i gatshmi për sprovën që po e ofronte momenti. Me vendimin e Shtabit të Brigadës 171 “Kadri Zeka”, dhe me urdhër të Komandës e në mbështetje të Shtabit të ZOK-ut dhe Komandant-Rexhës janë përcaktuar pikat vrojtuese dhe pozitat mbrojtëse të fortifikimit dhe hapjes së istikameve për një qëndresë dhe për ballafaqim frontal me forcat serbe. Sipas Pozicioneve komandant në pikat e vijës mbrojtëse ishin të caktuar : Në Lagjen e Kurdijajve ishte Genti alias –Bujar Nevzadi, këtë pikë shumë shpesh e ka vizituar komanda e ZOK-ut dhe e Brigadës 171, sikur kishin parandjenjën se nga kjo pjesë do të depërtonin forcat serbe, Në pozicionin rezervë të planifikuar për këtë njësi komandonte me sukses të plotë Nijazi Miftari-Miloti, Në Lagjen e Alibabajve të Verbicës së Zhegocit, lagje kjo përballë Parallovës, Komandant i njësisë ishte eprori në rezerv –Shaban Beqiri, Në Lagjen e Ibushajve të Verbicës së Zhegocit komandant ishte Remzi Hajrullahu, Në pikën Bisak ,Abdurrahman Ramadani-Uka, Njësisë së vëzhgimit-Komandant Ahmet Aliu-Astriti, Njësia për lagjen Zhegoc i Epërm, Komandant njësie i caktuar ka qenë Ilaz Ahmeti –Koci i ndihmuar nga Zenuni si pjesë civile, Në Lagjen Zhegoc i Poshtëm, komandant njësie ishte Sahit Baftiu në këtë njësitë të kësaj Lagje si përforcim ishin Isuf Azemi-Skifteri dhe Jakup Musliu-Musi, Në lagjen e Bilinicëve të Verbicës së Zhegocit, komandant i emëruar ishte Naser Ahmeti-Celi, Në lagjen e Hashanëve dhe lagjet perreth komandant i emëruar ishte –Enver Miftari. Të gjitha këto njësi ishin njësi taktike me numër të vogël të ushtarëve, mobile, fleksibile të

përgatitura për luftë guerile, njësi këto të cilat e mbulonin terrenin nga Zhegocit i Epërm në Lagjen e Kurdijajve, Lagjen e Alibabëve, Ibushajve Bilinicëve, duke e vëzhguar ka mundur një territor me horizont mjaft të madh sepse pozicionet i kanë mundësuar me pas qasje vizuale në hapësirat, të cilat çonin në drejtim të pozicioneve dhe Shtabit të ZOK-ut. Aty rreth orës 9:00 të mëngjesit, te vendi i quajtur Te Hanet e Zhegocit, kanë filluar përleshjet ndërmjet të forcave serbe dhe Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, eprori Pajazit Ahmet –Paja dhe Afrim Myrtaj ishin nisur me xhip të ngarkuar me detyrë ushtarake për në njësitin, i cili gjendej me pozicione tek lagja e Kurdijajve. Mirëpo nuk kanë arritur deri te kjo njësi, ngase te shtëpitë e para veç kishin depërtuar njësitet e forcave serbe. Me të arritur afër shtëpive, serbët hapin zjarr të befasishtëm, fillon përleshja dhe ne luftim e sipër goditet për vdekje Eprori i UÇK-së, Pajazit Ahmeti-Paja dhe plagoset rëndë, merr rreth 9 plagë Afrim Myrtaj-Agroni, i cili tërhiqet dhe i hetuar nga njësitit i lagjes së Kurdijajve, ku i jepet ndihma e parë, i ndalet gjakderdhja dhe tërhiqet në drejtim të shkollës së Zhegocit tutje në drejtim të Spitalit Ushtarak i vendosur në shtëpinë e Sami Ahmetit. Në të njëjtën kohë po zhvilloheshin luftime në të gjitha drejtimet, që çonin në Zhegoc, ngase njësitë e UÇK-së po bënin përpjekje mbinjerëzore për të ndalur depërtimin e forcave serbe. Në anën tjetër nga Shtabi i Zonës, në drejtim tjetër ishte nisur një njësi e udhëhequr nga Komandanti i Brigadës Salih Mustafa-Iliri dhe Avdyl Hasani-Kataliku, njësitit ishte nisur që të dalë mbi livadhet e Gadishit që ta mbulojë këtë drejtim dhe t'i prejë rrugën depërtimit të forcave serbe. Njësitit i komanduar nga Fatmir Mehmeti-Gilani, duhej të pozicionohej afër fshatit Plitkoviç me qëllim që të sigurohej rruga për tërheqjen e popullit për në Plitkoviç e Gadime. Me njësinë e cila mbetet të vazhdojë rrugën për në livadhet e Gadishit, komandant mbetet Avdyl Hasani-Kataliku, ndërsa me njësinë tjetër në të cilën ndodhej Kumanova shkon Salih Mustafa-Iliri e cila kishte për detyrë të pozicionohej mbi lagjen e Zhegocit të Epërm në drejtim të Rudarëve. Mirëpo, me të dalë në fushën mbi Lagjën e Zhegocit të Epërm kjo njësi hasë në një pritë të madhe të forcave serbe, që kishin depërtuar e kishin zënë pozicionet dhe po bënin shtrirjen në të dy krahët. Me të hetuar se forcat serbe gjenden aty përballë. Fillojnë përleshjet, në ndihmë u erdhi trimi i paepur Alban Ajeti, i cili duke luftuar nën një zjarr të kryqëzuar goditet dhe bie. Në këtë përleshje merr plagë edhe pjesëtari tjetër i këtij njësitit, ushtari Fadil Rashiti i Zhegocit. Njësitit me këto humbje një të vranë dhe një të plagosur tërhiqet drejtë pozicioneve rezervë ku ishte planifikuar që të bëhej rigrupimi i forcave të UÇK-së. Ndërkohë Shtabi i ZOK-ut ishte tërhequr në një pozicion më të sigurtë dhe kështu njësitet pasi marrin veten pak fillojnë tërheqjen për në pozicionet në fshatin Marec. Njësitit i pozicionuar në lagjen e Alibabëve

me Komandant Shaban Beqirin po mundohej që të orientoj e drejtoj të udhëheqë popullin drejt vendeve, që ofronin mbrojtje dhe strehim. Forcat serbe që vinin nga drejtimi i fshatit Parallovë mbështeteshin me granatime nga pozicionet serbe që gjendeshin në Llabjan, Prekove e lagjet përtej rrugës rajonale Gjilan-Prishtinë, të Parallovës, afër Kalasë së Novobërdes. Në pozicion më të mirë vrojtues ishte i pozicionuar njësitë, i cili gjendej në Bisak me komandant Abdurrahman Ramadanin-Ukën ,ngase nga ajo pozitë mund të kishte pamje më të mirë. Depërtimi i forcave serbe po vazhdonte me ndërprerje. Kjo njësi e gjendur nën trysinë e breshërive të armikut që , iu ofruan më pak se 50 m, u detyrua të bëjnë tërheqje, duke i lënë pozicionet aktuale për të kaluar në pozicionet rezervë. Forcat serbe nuk mundën të depërtojnë në Zhegoc deri rreth orës 16:00 derisa ishte tërhequr popullata në vende të sigurta, zbrapsja e forcave serbe nuk mund të zgjaste shumë por vetëm përkohësisht. Forcat e UÇK-së pozicionohen në Kodrën mbi Shkollën Fillore të Zhegocit deri te Rruga e Bilinicëve komandoheshin nga Nijazi Miftari-Miloti.Ato këtu ishin pozicionuar me qëllim të ndërprerjes dhe goditjes së befasishme për të arritur efektet e mundshme në dëmtimin e forcave serbe në njerëz dhe në teknikën luftarake. Një njësitë tjetër pozicionohet përballë shkollës fillore në shtrirje deri afër majës së kodrës ndërmjet dy rrugëve që vinin nga lagjja Zhegoc i Epërm në drejtim të shkollës dhe lidhej me Tërbovcin e tutje me Slllovinë. Një pjesë tjetër ishte e pozicionuar në kodër përballë pozicioneve, që UÇK-së i mundësonin që në aspektin taktik të jenë në përparësi, ngase prita në formë të pykës ishte e përshtatshme dhe në këtë territor mund të sillte rezultate evidente në të mirë të kësaj beteje e që sipas të gjitha parametrave në terren del se ka qenë pozitiv për njësitë e UÇK-së. Në mbrëmjen e 15 prillit diku rreth orës 21:00 h njësitë e Brigadës 171 “Kadri Zeka” rigrupohen. Shtabi i Zonës mbajti një minutë heshtje për dëshmorët dhe viktimat e luftës. Komandanti i brigadës, paraqet raportin për ngjarjet dhe zhvillimet e ditës, paraqiti humbjet e ditura dhe propozoi drejtimin e lëvizjes së forcave të UÇK-së, në drejtim të maleve të Marecit, ku gjendej një pjesë e Shtabit të ZOK-ut dhe pjesa tjetër e brigadës 171 „Kadri Zeka”.Sipas planeve të shtabit të ZOK-ut duhej të rigrupoheshin njësitë dhe rifreskoheshin, duke u pajisur me armë , municione ushqim veshmbathje e mbi të gjitha duhej rehabilitim. Forcat e UÇK-së të ndarë në grupe të vogla, drejtohen për në drejtimin e Malësisë së Marecit, duke kaluar një rrugë të gjatë e të mundimshme deri në lagjen e Hajdarajve të Marecit, të lodhur, por të vendosur për të vazhduar luftën deri në fund. Lufta e Zhegocit, kishte për pasojë vrasjen e ushtarëve të UÇK-së si: Pajazit Ahmeti, Tefik Zymberi, Hanumshahe Abdullahu-Zymberi, Alban Ajeti, Enver Miftari, Sahit Baftiu, Kastriot Baftiu, Shahin Baftiu, Zylfije Gashi,Ibrahim Pacolli, Njazi

Osmani, Ramadan Hyseni, Shaban Hyseni, Ilmi Hyseni, Feim Ajeti, Fadil Ajeti, Bashkim Ramadani, Ismet Ajeti, Fatmir Ademi, Blerim Ademi, Ismet Sadiku, Sherif Sherifi, Bahri Sadiku, Naile Canolli-Jahiri e Bahtir Jahiri, Bajram Gashi, Gafurr Hyseni etj. dhe viktime të luftës nga radhët e popullit civil. Ponesh nga barbarët u ekzekutuan Servet Shala, Shefik Shala, Islam Bajrami, Adil Uruçi, Arife Uruçi, e po ashtu edhe në Sllovi 49 civilë. Ushtria serbe la një numër të madh të të vrarëve nëpër malet dhe fushat e Zhegocit. Ushtria Çlirimtare ballafaqohet me strehimin e popullatës, ushqimin dhe mungesën e arsenalit ushtarak, që pashmangshëm ishin pengesa që lufta s'mund të bëhej në nivele ashtu çfarë duhej.

***INTERVENIMI USHTARAK I NATO-S NË KOSOVË (24 MARS 1999)
DHE HYRJA USHTARAKE E SAJ NË KOSOVË RESPEKTIVISHT NË
GJILAN (12 QERSHOR 1999)***

Në 23 mars 1999 në orën 22:30, Richard Holbrooke u rikthye në Bruksel dhe lajmëroi se bisedimet e paqes dështuan dhe i dorëzoi çështjen formalisht NATO-s për veprime ushtarake. Disa orë para lajmërimit, Jugosllavia lajmëroi në televizionin kombëtar se ka deklaruar gjendjen e emergjencës duke cituar një kërcënim të afërt lufte dhe filloi një mobilizim të madh trupash dhe resurshesh. Më 23 mars 1999 në orën 23:17 Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s, Javier Solana, lajmëroi se kishte urdhëruar Komandantin Suprem Aleat të Europës (SACEUR), Gjeneralin e Ushtrisë Amerikane Wesley Clark, që të "nisi operacionet ajërore në Republikën Federale të Jugosllavisë." Në 24 mars në orën 20:00 NATO nisi fushatën bombarduese kundër Jugosllavisë. Fushata bombarduese e NATO-s zgjati nga 24 marsi deri në 11 qershor 1999, duke përfshirë mbi 1,000 avionë që vepronin kryesisht nga bazat në Itali dhe në aeroplan-mbajtëset të stacionuara në Adriatik. Raketat kruiz Tomahawk u përdorën gjërësisht, të lëshuara nga avionët, anijet, dhe nëndetëset. Me përjashtim të Greqisë, të gjithë anëtarët e NATO-s u përfshinë sadopak. Në mbi dhjetë javet e konfliktit, avionët e NATO-s fluturuan mbi 38,000 misione luftimi. Millosheviçi e kuptoi se Rusia nuk do të ndërhynte të mbronte Jugosllavinë pavarësisht retorikës së fortë anti-NATO të Moskës. Kështu që ai pranoi kushtet e ofruara nga ekipit të ndërhyrjes Finlandezo-Rus dhe pranoi një prani ushtarake në Kosovë të drejtuar nga OKB, por me pjesëmarrjen edhe të trupave të NATO-s. Forcat speciale norvegjeze Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spezialkommando bashkëpunuan me UÇK-në në mbledhjen informacioneve të inteligjencës. Duke u përgatitur për pushtim në 12 qershor, forcat speciale Norvegjeze punuan së bashku me UÇK në zonat malore kufitare me Maqedoninë dhe kryesisht merreshim me zbulim për të

monitoruar ngjarjet në Kosovë. Bashkë me forcat speciale britanike, forcat speciale norvegjeze ishin të parat që kaluan kufirin për në Kosovë. Sipas gazetarit të Sky News Keith Graves, norvegjezët ishin futur në Kosovë dz ditë para marshimit të forcave të tjera dhe ishin ndër të parët që u futën në Prishtinë. Detyrat e Hærens Jegerkommando dhe Forsvarets Spezialkommando ishte të pastronin rrugën dhe të qetësonin palët serbëve dhe shqiptarëve. Më 3 qershor 1999, Millosheviçi pranoi kushtet e një plani ndërkombëtar paqeje për të ndaluar luftimet, ku në kuvendin kombëtar po pranoheshin propozimet pavarësisht debateve të ashpra dhe përleshjeve me grushta në disa raste. Në 10 qershor Komiteti i Atlantikut të Veriut ratifikoi marrëveshjen dhe pezulloi operacionet ajërore. Më 12 qershor, pasi Millosheviçi pranoi kushtet, misioni i drejtuar nga NATO Kosovo Force (KFOR) filloi të futej në Kosovë. KFOR ishte pregatitur të kryente operacione luftarake, por në fund, misioni i tij mbeti vetëm paqeruajtja. KFOR ishte i bazuar nën shtabin e Allied Rapid Reaction Corps (Trupat e Reagimit të Shpejtë Aleate) të komanduara nga Gjeneral Lejtnant Mike Jackson i Ushtrisë Britanike. Ku konsistonte në trupa britanike (një brigadë e ndërtuar nga brigada e IV e blinduar dhe brigada e V e parashutistëve), një brigadë e Ushtrisë Franceze, një brigadë e Ushtrisë Gjermane, të cilat hynë nga perëndimi ndërkohë të gjitha forcat e tjera avancuan nga jugu, me një brigadë e Ushtrisë Italiane dhe një brigadë e Ushtrisë Amerikane. Trupat e para të NATOs që u futën në Prishtinë në 12 qershor 1999 ishin forcat speciale Norvegjeze FSK Forsvarets Spezialkommando dhe forcat speciale ajërore Britanike S.A.S. 22 Special Air Service, pavarësisht se trupat ruse ishin të pranishme më parë në aeroportin e Prishtinës. Ushtarët norvegjezë të FSK Forsvarets Spezialkommando ishin të parat që ranë kontakt me trupat ruse në aeroport. Misioni i FSK ishte të implementonte paqen ndërmjet palëve shqiptare dhe serbe. Kontributi i SHBA, i njohur si Initial Entry Force (Forca Fillestare Hyrëse), u drejtua nga Divizioni i I-rë i Blinduar, i komanduar nga Gjeneral Brigade Peterson, e udhëhequr nga një togë nga Batalioni i II-të dhe nga Regjimenti Parashutist i 505-të i Këmbësoresë i bashkuar me Forcat Britanike. Të tjera njësi përfshinin Batalionet I dhe II nga Grupi i Forcave Speciale(parashutiste) nga Stuttgarti, Gjermani dhe Fort Carson, Colorado dhe shumë njësi të tjera të Ushtrisë Amerikane të vendosura në Europë dhe SHBA. Forcat fillestare të SHBA e vendosën zonën e veprimit përreth qyteteve të Ferizajt, më vonë Kampi Bondsteel, dhe Gjilan, në Kampin Monteith. Pas fushatës ushtarake, përfshirja e paqeruajtësve rusë rezultoi shumë e tendosur dhe sfiduese për KFOR. Rusët prisnin të kishin një sektor të pavarur të Kosovës, por u surprizuan kur misioni filloi nën komandën e NATOs. Pa

komunikuar paraprakisht ose koordinim me NATO-n, paqeruajtësit rusë hynë në Kosovë nga Bosnja dhe Hercegovina dhe pushtuan Aeroportin e Prishtinës para ardhjes së forcave të NATO-s. Gjë e cila rezultoi në Incidentin në Aeroportin e Prishtinës ku dëshira e Komandantit Suprem të NATO-s Wesley Clark ishte të bllokonte pistën e aeroportit me mjete të NATO-s, për të parandaluar përforcimet ruse, por u refuzua nga komandanti i KFOR Gjenerali Mike Jackson. Urdhri u tërhoq nga Gjenerali Jackson, me që rast nuk filloj nisjen e Luftës së Tretë Botërore.

DËBIMI ME DHUNË TË POPULLSISË SË GJILANIT NGA FORCAT SERBE PRILL 1999

Populli i Kosovës, krahas torturave, vrasjeve, ekzekutimeve, masakrave, rrënimeve, djegieve e plaçkitjeve të shtëpive e të pasurisë së tij, përjetoi edhe dëbimin me dhunë, zhvendosjen dhe deportimin masiv nga vatrata e veta dhe pastrimin etnik të Kosovës - masën më të rreptë të gjenocidit serb mbi shqiptarët. Dëbimi me dhunë të shqiptarëve nga Kosova në muajt mars - maj 1999" u krye në tri faza. Gjatë fazës së parë (24 mars - 6 prill 1999) shumica e refugjatëve erdhën nga Kosova perëndimore dhe jugperëndimore. Në fazën e dytë (7-23 prill) shumica e refugjatëve lanë shtëpitë e tyre në bashkitë në veri dhe në qendër të Kosovës. Gjatë fazës së fundit (24 prill - 11 maj), refugjatët erdhën kryesisht nga bashkitë e Kosovës perëndimore dhe jugore. Gjatë fazës së dytë dhe të tretë iu bashkëngjit edhe Gjilani, ku gjatë muajit prill dhe maj u shpërngulën pothuajse të gjitha fshatrat e Gjilanit. Shumica e fshatarve të Karadakut u larguan drejt Maqedonisë kurse fshatrat tjera ishin zhvendosur në qytetin e Gjilanit.

MASAKRA NË LLADOVË (2 PRILL 1999)

Fillimi i muajit prill shënon dhembje për disa fshatra të Karadakut. Sipas të dhënave në fshatin Lladovë janë vrarë këta persona: Beqir Ramiz Mahmuti i lindur më 13.03.1953, i vrarë më 2 prill 1999, Zijadin Kosum Mahmuti i lindur më 22.05.1960, i vrarë më 2 prill 1999, Daut Metush Mahmuti i lindur më 14.01.1963, i vrarë më 2 prill 1999, Hevzi Zekri Ajeti i lindur më 15.12.1970, i vrarë më 2 prill 1999, Ganimete Z. Ajeti e lindur më 27.03.1977, e vrarë më 2 prill 1999, Ahmetali Shaip Ajeti i lindur më 29.10.1960, i vrarë më 2 prill 1999. Të gjithë të vrarët janë gjuajtur me snajper nga forcat e ushtrisë si dhe grupet paramilitare të ardhura nga burgu i Nishit, Leskocit dhe Vranjës. Mufaili ishte plagosur për vdekje dhe së bashku me dy vajzat e tij Valbonën e Mevliden i zënë peng dhe i dërgojnë në

Budrikë. Mufailit pas dy ditësh i del humbja e vetëdijes dhe dëgjon se vajzat e tij Valbona e Mevlidja janë dërguar në Partesh. Hevzi Ajeti më 2 prill 1999 së bashku me mixhën e tij Faik Jakupin derisa po kalonin nga fshati Nasal janë ndalur nga një grup i paramilitarëve, kurse dy janë vrarë. Kështu më 25 mars 1999 në spitalin e Prishtinës ka vdekur Shaqir Veliu (1938) nga fshati Nasalë.

MASAKRA E LLOVCËS (5 PRILL 1999)

Masakra e fshatit Llovcë ku u vranë e u masakruan 7 shqiptarë. Vrasja e shtatë shqiptarëve në fshatin Llovcë mbanë datën 5 prill 1999. Në masakrën e fshatit Llovcë më 5 prill 1999 janë vrarë Rabbit Tahir Dalipi (1951) , Kokaj, Xhevrije Ramë Zeqiri (1944) , Xhemail Kadri Halimi (1969), Llovcë, Sami Abdyl Xhelili (1971), Llovcë, Avdi Selver Rexhepi (1975) , Kokaj, Rahim Bajram Ymeri (1954) , Llovcë, Nexhmije Riza Azemi (1949), Llovcë. Në 14 vjetorin e vrasjes askush nuk u përkujdes që të shënohet përvjetori i tyre. Nuhi Xhelili. Në këtë vrasje masive të plagosur kanë mbetur, Nazmi Hajdini dhe Marigona Azemi. Rreth 30 serb të armatosur kanë hyrë nëpër shtëpitë dhe kanë shtënë në drejtime të ndryshme. Kur kemi dëgjuar krismat kemi filluar të ikim në drejtim të Pograxhës e Slubicës. Duke rrugëtuar kam vërejtur se ishte vrarë Nexhmije Azemi dhe një fëmijë ishte plagosur. Gjithashtu duke vazhduar rrugën kemi parë trupat e vrarë të Rrahim Imerit, Sami Xhelilit dhe Xhemail Halimit. Në mesin e këtyre të vrarëve ishin edhe dy qytetarë të fshatit Inatovc, Rabbit Tahiri dhe Avdi Rexhepi. Të vrarë tjerë në këtë ditë kam parë edhe trupat e Xhevrije Zeqirit dhe Driton Xhelilit nga fshati Ranatovc Komuna e Preshevës. Ndërkaq të plagosur kanë qenë Nazmi Hajdini dhe Albulena Azemi.

MASAKRA NË BRESALC (10 PRILL 1999)

Në fshatin Bresalc të Gjilanit vrasjet ishin nga më të ndryshmet. Shabi Shaban Selimi, i cili edhe është plagosur në këtë ofensivë thotë se Feride Mujin e kam parë shumë afër derisa është vrarë me Gulinov kundërajror. Rreth 100 ushtar serb kanë sulmuar fshatin Bresalc nga të gjitha anët. Sipas tij Feride Muji ka vdekur në vend kurse Albert Miftari fëmijë tre muajsh është goditur me tre plumba dhe ka shpëtuar. Feridja është qëlluar me armë zjarri nga drejtimi i varrezave të fshatit ku edhe ishin të pozicionuara forcat paramilitare serbe. Feridja në atë moment ka qenë me fëmijët e saj Valbonën 18 vjeçare, Miradijen 15 vjeçare, Nisretin 13 vjeçar dhe Labinotin 10 vjeçar. Feridja kur është qëlluar, fëmijëve të saj u ka thënë që ta vazhdojnë rrugën dhe të ikin dhe pas pak ka dhënë shpirt rrëfen Arifja. Vdekja e Bahtir Hysenit, është vrarë pak orë më vonë. Paramilitarët e kanë urdhëruar që të ndalet, por ai nuk i

ka respektuar urdhrat e tyre dhe e kanë pushkatuar me një breshëri plumbash. Në këtë operacion të serbëve është plagosur edhe Nehat Selimi i cili ka marrë shtatë plumba në trup. Hasan Sefë Sylja është vrarë nga paramilitarët serb tek vendi i quajtur “Llazina”. Më 10 prill 1999 në fshatin Bresalc është plagosur edhe Shaban Sylja. Taip Muji është plagosur më 18 prill 1999. Është goditur me plumbat dum-dum në krahun e majtë. Nga plumbi i forcave serbe ai sot e ka të amputuar krahun e djathtë. Edhe vrasja e Servet Shalës nga fshati Ponesh është kryer më 16 prill 1999. Ai është zënë peng nga ushtria serbe së bashku me Servet Shalën dhe familjen e tij. Serveti është ekzekutuar në vendin e quajtur “Quka e Poneshit”.

MASAKRAT NË LLASHTICË (13-30 PRILL 1999)

Në Llashticë forcat serbe kanë vrarë në tri periudha civil të pafajshëm. Ushtria dhe policia në mënyrë të organizuar kanë kryer vrasje më 13, 14, 16, 22 dhe 30 prill 1999. Në këtë masakër (30 prill 1999) janë pushkatuar e rrafshuar me buldozer dhe djegur tërësisht : Hysen Deli Hyseni (1933), Ajshe Hysen Hyseni (1937), Fazli Hysen Hyseni (1963), Arife Fazli Hyseni(1963), Driton Fazli Hyseni (1982), Mirije Deli Hyseni(1970), Blerim Ramadan Halili (1983), Rifat Xhemajl Shabani (1919), Selami Rifat Shabani (1954), Zijavere Ejup Shabani (1962), Fisnik Selami Shabani (1996), Sylejman Ymer Ibishi (1932), Xhavit Banush Berisha (1935). Vendi ku është kryer krimi në Llashticë është vizituar nga mjekët kanadezë menjëherë pas luftës, por raporti i tyre kurrë nuk është bërë publik. Ndryshe në tërë fshatin janë djegur 123 shtëpi, 137 objekte ndihmëse, janë plaçkitur 90 traktorë, 120 motokultivator, 3 autokombajna, 3 kombibusa, një kamion dhe 130 vetura. Gjithashtu sipas të dhënave serbët kishin plaçkitur 680 kafshë të trasha. Në masakrën e 30 prillit kanë mbetur gjallë dhe janë plagosur: Deli Hysen Hyseni (1968), Dritë Fazli Hyseni (1984), Blerinë Fazli Hyseni (1994), Leonorë Deli Hyseni (1993), Vlorë Selami Shabani (1986). Më 13 prill 1999 janë vrarë : Ali Bejtë Selimi (1937), Enver Sylë Murseli (1949), Ymer Kadri Rashiti(1930), Lulzim Feti Musliu(1988). Derisa më 16 prill 1999 janë vrarë : Rukije Qazim Ramushi (1927), Habibe Idriz Ramushi (1909), Nezir Hasan Ramushi (1929), Xhyzide Shaban Hasani (1918), Lirim Nehat Shabani (1999). Kurse më 20 prill 1999 është vrarë Azem Limon Cani (1938).

MASAKRA NË ZHEGËR (MARS 1999)

Në fshatin Zhegër gjatë luftës forcat serbe kanë bërë shumë dëme materiale. Sipas shënimeve ushtria serbe dhe grupet paramilitare kanë djegur 410 shtëpi, 104 traktor të plaçkitur, tre kamion, 200 vetura, 96 kultivatora, 322 lopë, 140 tonë miell, 5 furgona. Sipas komisionit të fshatit, vlera e dëmit arrin në 19 milion e 320 mijë euro. Sipas të dhënave në Zhegër në

periudhën mars-qershor 1999 në këtë fshat janë vrarë 13 veta dhe janë plagosur 7 persona. Sipas dëshmime të gjitha operacionet që ka kryer ushtria serbe në Zhegër janë kryer në bashkëveprim me serbët vendor. Ishin banorët serb të Zhegrës që kishin kërkuar ndihmë nga Nishi dhe Serbia. Sipas të dhënave që janë evidentuar në kallëzimin penal vetëm nga burgu i Nishit në Zhegër ishin sjellur 8 autobus me 500 paramilitar me targa të Nishit, Smederevës, Prokupljes, Kraljevës, Novi Sadit etj. Të gjithë këta paramilitarë ishin sjellur më 29 mars 1999 dhe në mesin e tyre kishte të droguar dhe të atillë që ishin të dënuar me vepra të ndryshme kriminale. E veçanta e aksionit në Zhegër ishte se serbët vendor i kishin pritur me lista në dorë paramilitarët. Edhe vrasjet e shqiptarëve në Zhegër i ka konstatuar në një procesverbal ish gjykatësi hetues serb Zhivojin Janković në prezencën e inspektorit të SPB-së Jovica Petroviç. Sipas konstatimit të këtyre mjekëve viktimat janë vrarë me armë zjarri. Vizuelisht kufomat i ka shikuar mjeku dr. Vasiq Hranisllav thuhet në procesverbalin e datës 31 mars 1999. Në këtë procesverbal nuk jepen emrat e dëshmitarëve dhe nuk është bërë identifikimi i kufomave. Sipas të dhënave që kanë grumbulluar Këshilli i bashkësisë vendore në Zhegër në periudhën mars-qershor 1999 janë vrarë këta shqiptarë: Shyqeri Shukri Tahiri (11.05 .1956) i vrarë më 29.03.1999, Haxhi Ukshin Ukshini (1928) i vrarë më 30 mars 1999 Miradije Ukshini (1930) e prerë në fyt më 1 prill 1999, Milazim Habib Idrizi i lindur më 14.11.1934, i vrarë më 30 mars 1999, Qazim Habib Haziri i lindur më 08.05.1936, i vrarë më 30.03.1999, Qamile Jetulla Haziri e lindur me 03.06.1944, e vrarë më 30 mars 1999, Fitim Shukri Isufi (1977) person me të meta mentale, i vrarë në moshën 22 vjeçare, Raif Xheladin Rrustemi (1920) , i vrarë në moshën 79 vjeçare, Mustafë Asllan Mustafa (i vrarë në moshën 80 vjeçare , i moshuar dhe me aftësi të kufizuara, Sabedin Sejdi Hamiti (1975) , është vrarë në moshën 24 vjeçare, në kufirin Kosovë-Serbi më 8 maj 1999, Ukshin Sabit Maloku (1972) , është vrarë në moshën 24 vjeçare , më 9 maj 1999 në kufirin Kosovë-Serbi, Hasan Ilmi Maloku (1967) i vrarë më 8 maj 1999, Avni Sabri Zenuni (1975) është vrarë në moshën 24 vjeçare, i vrarë më 6 qershor 1999. Në fshatin Zhegër gjithashtu ushtria serbe, policia dhe forcat paramilitare kanë plagosur edhe këta persona: Nexharije Tahiri e plagosur më 29 mars 1999, Skender Selimi i plagosur më 30 mars 1999, Sahit Isufi i plagosur më 30 mars 1999 Bedrije Selmani e plagosur më 30 mars 1999, Zymrije Haziri e plagosur më 30 mars 1999 Mirishahe Kadriu e plagosur më 2 prill 1999. Edhe në fshatin Shurdhan forcat serbe kanë vrarë Muharrem Hazir Demirin (1915) i vrarë më 31 mars 1999 si dhe vëllain e tij Jetish Hazir Demirin i lindur më (1917) . Dy vëllezërit Demiri sipas dëshmime janë ekzekutuar, djegur dhe karbonizuar në shtëpinë e tyre në Shurdhan. Paramilitarët serb i ngulojnë në

shtëpinë e tyre vëllezërit Demiri ku edhe i'a vënë flakën shtëpisë duke i djegur për së gjalli. Edhe, Ymer Nasuf Kadriu i lindur më 26.03.1946 në fshatin Dunavë është vrarë më 30 mars 1999 nga ushtria serbe. Sipas dëshmitëve Ymer Kadriu likuidohet nga forcat paramilitare dhe ushtria serbe tek vendi i quajtur "Ura e Dunavit". Nebih Abaz Nebihu nga fshati Dunav i lindur më 17.10.1956, është vrarë nga forcat paramilitare më 30 mars 1999 në shtëpinë e tij. Trupi i tij është gjetur i masakruar. Sipas vëllezërve të tij Nuhiu, e Sabriu a'i ka bërë rezistencë deri në momentin e fundit, pasi i është përfunduar municioni paramilitarët e kanë djegur për së gjalli. Edhe, Ramiz Ibrahim Limani i lindur më 03.02.1921 në fshatin Pidiq është vrarë nga forcat serbe më 28 prill 1999 në fshatin Seferaj. Djali i tij Kadri Limani ka dëshmuar se Ramizi është gjetur i masakruar . I është prerë koka vetëm disa metra larg shtëpisë ku kishte qëndruar gjatë luftës. Vdekja e Musa Jetish Veselit (30.04.1964) nga fshati Stanqiq ka një histori të dhimbshme. Kishte vendosur mos ta braktisë fshatin duke u përkujdesur edhe për motrën e tij në Shurdhan. Gjatë një vizite që i bënë motrës së tij në Shurdhan kapet nga paramilitarët serb .Pas vrasjes trupin e tij e kanë djegur në tërësi. Sabedin Sejdi Hamiti i lindur më 10.10.1975 në fshatin Goden është vrarë më 9 maj 1999 në fshatin Norqë të Preshevës derisa po kalonte kufirin. Hasan Ilmi Maloku i lindur më 23.06.1967 në fshatin Selishtë.

TË VRARËT NË GJILAN (MARS-PRILL 1999)

Ushtria serbe granatoi shtëpinë e Ahmet Isufit, shtëpinë e vëllezërve të Kadri Zekës, shtëpinë e Shaban Hajdarit në Qenar Qeshme, si dhe shtëpinë e Xhemajl Ymerit, i cili gjatë këtij granatimi vritet. Aty u vra edhe një person dhe u plagosën disa të tjerë. U granatua edhe Malisheva e Epërme, ku u vranë tre e u plagosën dymbëdhjetë persona. Për krimet në lagjet "Arbëria" dhe "Bregu i Djegur", që kanë ndodhur më 28.03.1999, në ora 22:00. P olicin serb Iliq, i cili i ka koordinuar granatimet e ushtrisë serbe nga lagja "Zabeli i Sahit Agës". Gjuajtja e parë me granatë është bërë në shtëpinë e Shaip Zekës. Nga ky granatim janë plagosur Isa Zeka, Zyhrije Pireva (1978) dhe Fikrije Pireva (1981). Familja Pireva ishte nisur t'i dërgonte të plagosurat në ambulancën e qytetit, por policia serbe i kishte urdhëruar të kthehen mbrapa, madje kanë gjuajtur në veturë duke e plagosur për së dyti Fikrijen. Zyhrije Pireva ka vdekur në Spitalin e Gjilanit, ku familjarët e kishin dërguar më vonë. Granata e dytë e ka goditur shtëpinë e Ukshin Ajdinit. Granata e tretë ka vrarë Ramadan Salihun, ndërsa kanë mbetur të plagosur Hajdin Murtezi, Rama dhe e shoqja e tij. Granata tjetër ka qëlluar shtëpitë e Xhemajl Ymerit, Aziz Kadriut. Në ballkon të shtëpisë së vet është vrarë Xhemajl Ymeri. "Ishte një mbrëmje shumë e trishtueshme për këto familje dhe banorët e lagjes", thuhet nga dëshmitarët. Në ditën e varrosjes

së Ramadan Salihut dhe Xhemajl Ymerit, policia serbe ka ofenduar dhe torturuar pjesëmarrësit në ceremoninë mortore, thuhet në dëshmitë e familjarëve dhe të banorëve të lagjes. Krime janë kryer gjithandej, në 31 lokalitete të Gjilanit. Vrasja e Meleke Xhelal Rashitit më 28 mars 1999 pati tronditur tërë qytetin. Melekja e moshës 15 vjeçare (e mitur) është vrarë në mbrëmje diku rreth orës 21 e 45 minuta. "Vajza ime është qëlluar me pesë plumba në trup nga katër persona të uniformuar-paramilitarë. Ajo është goditur në anën e djathtë të abdomenit dhe krahut. Kam dëgjuar më vonë se në vrasjen e vajzës sime kanë marrë pjesë një serb i quajtur me emrin "Zara" dhe Nenadi". Nga plagët e marra dhe nga mos kujdesi mjekësor për shkak se spitali kontrollohej nga ushtria dhe policia Meleke Rashiti pas tri orëve vdes në shtëpinë e saj për tu varrosur të nesërmen.

TË TJERA

NGJARJE

PLLAKË OSE SIMBOL ME EMRAT E DËSHMORËVE, MARTIRËVE E VIKTIMAVE NË SECILIN FSHAT TË KOMUNËS SË GJILANIT, DUKE PËRFSHIRË ÇDO PERIUDHË HISTORIKE.

Për të nderuar të rënë në çdo vendbanim të komunës së Gjilanit të ngriten pllaka, simbole e përmendore përkujtimore për të gjithë të rënit gjatë historisë. Duke nderuar të rënë, si dëshmorë, martirë, viktimë e të gjitha luftërave. Më posht është lista me pllaka, simbole e përmendore që janë ndërtuar deri më tani në tërë komunën e Gjilanit.

Nr.	Përshkrimi-Emëri dhe Mbiemri	Rruga/ vendi/ lagja	Lloji	Dt.Themel.
1	////////////////////	Ne hyrje te fsh. Cernicë	Pllakë Perkujtimore	2002
2	Ramiz Halim Cernica	Fsh. Cernicë te shk.fill."Ramiz Cernica"	Busti	2008-05-25
3	Beqir .R. Mahmuti, Zijadin K.Mahmuti,Daut M. Mahmuti, Hevzi Z. Ajeti, Ganimete Z. Ajeti, Ahmetali Sh. Ajeti	Fsh. Lladovë(te udhekryqi per fsh.Llashtic)	Varrez e gjasht deshmoreve /martireve	Mars 2001
4	Idriz Sefri 1847-1927	Fshati Zheger	Busti	2007-06-15
5	Agim Hysni Ramadani	Fsh. Zheger te sh.mesme	Pllakë Perkujtimore	2002
6	Agim Hysni Ramdani	Fsh. Zheger sh.f. "Agim Ramadani"	Busti	2012
7	Martir te pushkatuar nga ushtria serbe tetor 1912	Te Xhamia ne f.sh. Zheger	Pllakë Perkujtimore	Pas 1999

8	Tahir V.Gruhuna, Arif T. Grouhuna,Xhemail T. Gruhuna, Ajdin T. Gruhuna, Halil T. Gruhuna, Saqip A. Gruhuna.	Ne fshatrat Jusufajt, Pidiq-Shurdhan	Pllakë Perkujtimore	Nentor 2012
9	Martiret e Llashtices 1912-1945	Sh.f "Esat Berisha" Llashticë (te varrezat e fshatit)	Pllakë Perkujtimore	1996-11-28
10	Menderez A.Ramushi,Blerim R.Halili, Merije Hyseni, Driton F.Hyseni, Arife Sh. Hyseni, Fazli H. Hyseni, Ajshe Hyseni, Hysen D. Hyseni, Sylejman Y. Ibishi, Fisnik S. Shabani, Zjavere J.Shabani, Selami R. Shabani, Rifat Xh. Shabani, Xhavit B. Berisha, Nezir H. Ramushi,Habibe I. Ramushi, Rukije Sh. Ramushi, Imer K. Rashiti, Enver S.Murseli, Ali B.Selimi	Ne fshatin Llashticë pertej xhamisë së fshatit	Varrez e 21 deshmoreve /martireve	2001-01-13
11	Lulzim Feti Musliu	Sh.f "Esat Berisha" Llashticë (te varrezat e fshatit)	Varres e deshmoreve /martireve	Pas 2000
12	Deshmoret e Kombit : Shaban Ukshini dhe Sami Ukshini	Te Koregjaj , Zheger	Pllakë Perkujtimore	2001
13	Abdullah Ramadan Tahiri	Ne fsh. Malishevë e Ulet	Pllakë Perkujtimore	2001
14	Abdullah Ramadan Tahiri	Ne fsh. Malishevë e Ulet	Busti	2008
15	Vebi Ibrahimimi, Fatmir Ibishi	Ne hyrje te fsh. Uglar	Busti	Pas 2003
16	Hoxhe Haxhi Saliu	Ne hyrje te fsh. Pogragjë	//////////	2012-11-28
17	Fatos Limani	Ne fsh.Pogragjë afer sh.f "Liria"	Busti + Sheshi	2008-11-28
18	//////////	Ne hyrje te fsh. Llovcë	Pllakë perkujtimor 1944-1999	Korrik 2001
19	Mehmetali Shukri Behluli, Mulla Nusret Fejzullahu.	Ne fsh. Mireshe (Doberqan) te parku	Pllakë Perkujtimore dhe sheshi	////////
20	Xhavit Ahmeti , Zija Shemsiu	Fsh. Perlepnicë (te salla e kultures)	Pllakë perkujtimor	////////
21	Xherxh Kastriot Skenderbeu	Fsh. Perlepnicë (te sh.f "Skenderbeu")	Busti	2001
22	Martiret: Menderes A. Ramushi 1977-99, Sejdi G.Rexhepi 1978-99, Mirnes L. Hajdini 1980-99, Agush G. Rexhepi 1973-99.	Fsh. Muçibabë, rruga magjistrale M25-2 Gjilan-Preshev	Pllakë perkujtimore 4 martir	2002
23	Agim Ramadani	Rr. "Bulevardi I Pavaresisë" Gjilan (te Teatri I Qytetit)	Shtatorja	2005
24	//////////	Rr. "Bulevardi I Pavaresisë" Gjilan (afer parkut, Soliterit)	Shtatorja Lnç	

25	Rexhep Malaj 1961-1984, Nuhi Berisha 1961-1984	Rr. "Bulevardi I Pavarsisë, Gjilan (perball "Hotel Kristal")	Permendore	2002
26	Pajazit M. Ahmeti "Paja" 1971- 99, Alban SH. Ajeti 1978-99.	Rr. "Abdullah Tahiri" Gjilan (ish TMK-ja)	Busti	2000
27	Rexhep Elmazi 1938-78	Sh.f "Rexhep Elmazi" Gjilan, rr."Qamil Bala"	Busti	2000
28	Reshat Z. Ymeri 1969-90	Rr. Haki Efendija" Gjilan	Pllak perkujtimore	////////
29	////////	Rr. "Zija Shemsiu" (kompleksi I shkollave te mesme)	Pllaka perkujtimore	Pas 2000
30	Zenel Hajdini	Sh.m Gjinnazi "Zenel Hajdini" rr. "Zija Shemsiu; Gjilan	Busti	////////
31		Fakulteti I Edukimit (ne oborr te Universitetit) rr. "Zija Shemsiu"	Pllakë perkujtimore	07.03.2010
32	Rexhep Mehmet Malaj	Rr. "Abdulla Presheva"	Pllakë perkujtimore	2012-11- 23
33	Musa Zami 1923-1943	Rr. "Dimetrije Tuloviq" (Sh.F "Musa Zajmi")	Bust	2006
34	Mulla Idrizi 1901-1949	Rr. M 25-2 Gjilan - Preshevë fsh. Velekincë (sh.f Mulla Idris")	Bust	2002
35	Tefi Zymberi 1960-99, Hanumshahe A. Zymberi 1962-99, Ramadan H. Hyseni 1954-99, Shaban H. Hyseni 1960-99	F.sh Zhegoc (afër permendores)	Pllakë perkujtimore	2004
36	Pajant Ahmeti 1971-99, Alban Ajeti 1987-99, Enver Miftari 1974-99, Bajram Gashi 1965- 99, Ibrahim Pacolli 1960-99, Nijan Osmani 1964, Sahit Baftiu 1952-99, Kastriot Baftiu 1952-99, Shahin Baftiu 1959- 99, Gafurr Hyseni 1948-99, Tefik Zymberi 1960-90.	F.sh Zhegoc (te udhekryqi)	Pllakë perkujtimore	2000
37	Sherif Sherifi, Enver Pacolli 1971-99, Ibrahim Beqiri 1974- 99,	F.sh Verbic e Zhegocit	Pllakë perkujtimore	Pas 2000
38	Alban Shyqeri Ajeti	Fsh. Zhegoc I Eperm	Pllakë perkujtimore	2001
39	Pajazit Paja Misin Ahmeti	Zhegoc (te pllaka kryesore - udhekryq)	Pllakë perkujtimore	2006
40	Ilmi Hyseni 1966-99, Feim H. Ajeti 1983-99, Bashkim Ramadani 1982-99	F.sh Verbice e Zhegocit	////////	Pas 2006
41	////////	Fsh. Zhegoc I Ulet	Pllakë perkujtimore	////////
42	Sahit B. Baftiu 1952-99, Kastriot B. Baftiu 1983-99, Shahin B. Baftiu 1959-99, Bahri Xh. Sadiku	F.sh Zhegoc I Ulet	Pllakë perkujtimore	2006
43	Enver Shefki Miftari 1974-99	F.sh Verbic Zhegocit	////////	2007
44	Ismet Hamdi Sadiku 1956-99	F.sh Verbic e zhegocit afër sh.f "Fetah Qerimi"	Pllakë perkujtimore	2008

45	Ismet I. Ajeti 1941-99, Fadil Sh. Ajeti 1977-99, Fatmir M. Ademi 1966-99, Blerim M. Ademi 1979-99	F.sh Verbic Zhegocit lagj. E Biliniceve	Pllakë perkujtimore	
46	Naile A. Canolli-Jahiri 1912- 1999	F.sh. Verbic e Zhegocit	Pllakë perkujtimore	2008
47	Ibrahim Xhemajl Pacolli 1960- 1999	F.sh. Verbic e Zhegocit	Pllakë perkujtimore	2008
48	Servet Shala -Martirre 1999	Fsh. Poneshë, rruga R 212	Pllakë perkujtimore	2002
49	Islam Bajrami-Martirre 1999	Fsh. Gadish-sh.f Afërdita	Pllakë perkujtimore	2003
50	Njazi Osmani-Dëshmor 1999	Fsh. Gadsih-afër Plitkoviqit	Pllakë perkujtimore	2002
51	Ibrahim Uruqi-Dëshmor 1999	Fsh, Bresalc, sh.f. I.Uruqi	Busti	2004
52	Dëshmorët-Martirët 1912-1999	Fsh, Bresalc, përballë Xhamisë	Pllakë perkujtimore	2012
53	Dëshmori Agim Rashiti 1999	Te Spitali Regjional-Gjilan	Busti	//
54	Dëshmorët-Martirët 1912-1999	Fsh. Livoq i Epërm	Pllakë perkujtimore	2003
55	Dëshmorët-Martirët 1912-1999	Kodra e Dëshmorëve	Pllakë perkujtimore dhe varrezat e dëshmorëve	2010

SIMBOL PËR SHTETET QË KONTRIBUAN NË ÇLIRIMIN E KOSOVËS.

Kosova deklaroi pavarësinë me 17 shkurt 2008. Menjëherë pas shpalljes së pavarësisë, u dërguan letra në drejtim të të gjitha qeverive të botës për njohjen e saj. Njohjet e para filluan menjëherë pas disa orësh, ndërsa më 18 shkurt 2008, Afganistani ishte shteti i parë që njohu Kosovën shtet të pavarur. Më 8 mars 2008, ministri i parë i jashtëm që e vizitoi Kosovën ishte Carl Bildt, Ministër i Jashtëm i Suedisë. Deri tani 112 entitete sovraane, nga 193 shtete anëtare të Kombeve të Bashkuara kanë njohur formalisht Republikën e Kosovës. Shumica e vendeve të Bashkimit Evropian gjithashtu e kanë njohur Kosovën (23 nga 28); Anëtarët e BE-së vendosin individualisht se a do ta njohin Kosovën, ndërsa BEja ka dërguar misionin EULEX për të siguruar paqe, mbikëqyrje të jashtme. Njëzetekatër (24) anëtarë të NATO-s nga njëzetetë (28) gjithsej e kanë njohur Kosovën. Shtetet anëtare të përhershme të Këshillit të Sigurimit, janë të ndara sa i përket pavarësisë së Kosovës. SHBA, Britania e Madhe dhe Franca, njohën pavarësinë e Kosovës, Rusia e ka kundërshtuar dhe konsideruar ilegal aktin e pavarësisë, ndërsa Republika Popullore e Kinës ka shprehur brengosjen e saj me këtë akt. Me 15 maj 2008, Rusia, Kina dhe India, lëshuan një deklaratë të përbashkët, në të cilën ftojnë për negociata të reja në mes të autoriteteve të Beogradit dhe Prishtinës. Nga fqinjët e Kosovës, Republika e Shqipërisë, Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë dhe Mali i Zi e kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Qeveria e Serbisë si reagim kundër shteteve që kanë njohur Republikën e Kosovës ka thirrur në konsultime ambasadorët e vet nga shtetet që e

kanë njohur pavarësinë e Kosovës. Por në korrik 2008, ambasadorët e saj në shtetet e BE-së u rikthyen. Serbia akuzoi liderët kosovarë për tradhti të lartë. Ministri i Jashtëm i Serbisë Vuk Jeremiç, me 15 gusht 2008, zyrtarisht dërgoi një kërkesë në OKB, për të kërkuar mendimin e Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë rreth aktit të pavarësisë së Kosovës. Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në takimin e saj në shtator 2008 vendosi ta çojë çështjen në Gjykatën Ndërkombëtare të Drejtësisë. GjND vendosi më 22 korrik 2010 se deklarata e pavarësisë së Kosovës nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare, me rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit.

SIMBOL PËR GRUAN – NËNËN NË AVANCIME TË PËRGJITHSHME TË SHQIPTARËVE.

Sipas burimeve historike, qëndresa dhe sakrificë e gruas shqiptare, si formë e rezistencës së saj, dëshmohet si vazhdimësi. Nga shumica e femrave shqiptare, të cilat qëndruan dhe vepruan në rrethana ngulfatëse të kohëve të ndryshme dolën heroina të shquara, trimëritë e të cilave i tejkaluan kufijtë gjinorë dhe kombëtarë. Kjo grua, gjatë gjithë historisë, me dinjtet e fisnikëri të lart, do të jetë e zonja që gjithmonë të mbaj lart flamurin e qëndresës dhe të familjes. Gjatë gjithë kësaj periudhe të gjatë të historisë, falë asaj-gruas sonë, populli i ynë arriti që të shpëtoj nga asimilimi, duke ruajtur në të njëjtën kohë gjuhën, historinë, traditën, kulturën dhe përkatësinë tonë kombëtare. Ajo, në rrethanat më të përshtatshme historike inkuadrohet në rrjedhat që i imponoheshin nga vetë faktori kohë. Burrat trima lindin dhe rriten vetëm nga nëna trimëresha, thotë një fjalë e popullit. Gruaja shqiptare e ka përbuzur kurdoherë frikacakun, ajo e ka përbuzur dhe e ka mallkuar edhe birin e saj kur plogështohet përpara vdekjes. Duke shfletuar faqet e historisë, gratë shqiptare i gjejmë pjesëmarrëse aktive në luftërat e Skënderbeut. Gjatë rrethimit të parë të Krujës, në vitin 1450, kur në Shqipëri erdhi mbarë ushtria otomane me në krye sulltan Muratin II, Skënderbeu urdhëroi të zbrazej plotësisht qyteti nga gratë, fëmijët dhe pleqtë dhe të mbeteshin vetëm luftëtarët, që duhej të mbronin kështjellën deri në vdekje. Për këtë ngjarje kronisti venedikas A. Sabellico, më 1478 shkruante: “në mes të zjarrit të luftës, kur çdo gjë shungullonte nga armët e barbarëve, në ato qytete ku Skënderbeu kishte mbretëruar, grupe vajzash e kishin zakon që në çdo tetë ditë të mblidheshin e të këndonin lavditë e princit të vdekur, ashtu siç bënin të moçmit për heronjtë e mëdhenj”. Nga kjo, mund të përfundojmë se gruaja shqiptare ishte aktive edhe atëherë, kur nuk dilte në fushën e betejës, por në një mënyrë tjetër e luftonte armikun - me armën e kurajos që u jepte luftëtarëve. Gruan shqiptare edhe më aktive e gjejmë në shekullin XIX

gjatë Rilindjes Kombëtare Shqiptare. Në këtë periudhë ajo me armë në dorë merr pjesë në luftërat për liri e pavarësi dhe me këtë dëshmoi se nuk ishte vetëm nënë e bashkëshorte e mirë, por mbi supet e saja të forta e krenare para armiqve të shumtë njësoj bartte tempullin e shenjtë dhe të fortë - çështjen e atdheut. Aty, nga mesi i shekullit XIX një nga njohësit e mirë të Shqipërisë Veriore, Jasint Hekard (Hyasint Hecquard), shkruante: “Gruaja shqiptare, qoftë myslimane, qoftë e krishterë, edhe pse është e nënshtruar ndaj burrit, ai këshillohet me të jo vetëm për punët e familjes, por edhe për çështjet e vendit”. “Gratë shqiptare”, vazhdon Hekardi, dinë t’i mbajnë lotët e dhembjes edhe kur janë përpara njerëzve të tyre më të shtrenjtë të shtrirë për dhe, shpeshherë duke mbajtur nëpër duar kufomat e tyre i kanë shpënë, ato në mes të luftëtarëve për t’i nxitur që të hakmerren kundër armikut”. Më poshtë vazhdon: “Më kanë treguar nëna që nuk i kanë pranuar në shtëpi fëmijët e tyre, të cilët kanë lënë nga frika luftën duke i shpënë ato vetë përsëri në fushën e betejës, ose nuse që janë ndarë nga burrat e tyre vetëm pse këta janë larguar në një çast nga zjarri i luftës”. Këta shembuj, të pakët i cekëm për të ilustruar trimërinë e tyre të pamohueshme që treguan për lirinë e vendit. Gruaja shqiptare ishte pjesëmarrëse aktive sidomos në kryengritjet e mëdha të viteve 1910-1912, në luftërat për çlirim kombëtar të atdheut. Me qindra gra ndihmuan kryengritjet me mjete e me strehim, me informata e kurajo. Në ato vite revolucionare gruaja nuk qëndroi vetëm në prapavijë. Me një guxim të rrallë ajo kaloi edhe në vijën e zjarrit. Gratë kosovare dolën me armë në dorë në Grykën e Kaçanikut, ballëpërballë armikut. Shembullin e tyre e ndoqën edhe gratë e Malësisë së Mbi – Shkodrës e të Dibrës. Gratë dolën në luftë anekënd Shqipërisë, aty ku kishte nevojë dhe ku buçiste lufta. Gazeta “Sabah” që delte në Turqi, shkruante më 16 prill 1911: “Ndërmjet kryengritësve shqiptarë kishte edhe gra. Në luftimet që u bënë në rrethet e Tuzit kishte edhe gra të veshura me rroba burrash...bile disa nga këto gra kanë treguar edhe trimërinë e tyre, aq sa të kalojnë në radhët e para të luftës”. Edit Durhami ishte çuditur kur i kishin tregua se si një grua mirëditore kishte vrarë burrin dhe dy fëmijët e saj, për shkak se burri kishte tradhtua tek turqit, kur vëllezërit e saj ishin bërë rrezik për ta. “Sigurisht se kjo ishte një tragjedi e dhembshme”, thotë Edit Durham, “por kjo grua me krenarin shqiptare nuk e ka durua tradhtinë dhe pabesin ndaj atdheut, për tradhtarin vdekja është hak”, shkruan Edit Durhami Virtytet e Gruas Shqiptare ishin frymëzim për shumë këndë që vizitonte viset tona. Njëri ndër ta ishte edhe Xhorxh Williams, i cili para, më shumë se 100 vitesh konstaton se “gruaja tek shqiptarët trajtohet me respektin më të lartë. Ajo vërtetë punonte në shtëpi, por zinte një vend të nderuar në shoqëri dhe se jeta e saj fisnikërohej me të qenit nënë. Është e vërtetë se ajo vlerësonte dhe vlerëson edhe sot shumë

lartë të qenit nënë dhe bashkëshorte. Gjithë jeta e saj ndërtohet në këto dy shtylla kryesore, por edhe jo rrallëherë ajo ka dëshmuar se që të dyja i sakrifikon për liri” gjë që e ngritë atë në pedestalin e barazisë me heronjtë. Në punimin “Krah për krah me burrin në luftën për liri”, autori Ligor Mile, shkruante se një shkencëtar i huaj kishte thënë për gruan shqiptare se gratë që nxjerrin në dritë burra të pamposhtur dhe trupmëdhenj dallohen gjithashtu për forcën e organizimit të tyre edhe për thjeshtësinë e zakoneve të tyre... Ato ndajnë me burrat punët, udhëtimet dhe rreziqet e tyre”. Gjatë lëvizjes kryengritëse, që shpërtheu në vitet 1844-1845 në verilindje të Shqipërisë, në Kosovë dhe në Dibër, dokumentacioni arkivor na dëshmon se në malësitë e lira “gra dhe fëmijë bënin pjesë në radhët e luftëtarëve”, se “gratë qenë të ngjeshura me armë, të veshura ushtarakisht, duhet dalluar, sidomos gratë, në Shqipërinë e Sipërme”. Duhet cekur se gruaja shqiptare në asnjë periudhë kur ishte vendi në rrezik nuk qëndroi duarkryq. Shembujt e pjesëmarrjes së gruas në luftërat për liri janë të shumta, sidomos duhet përmendur luftërat që nga Lidhja Shqiptare e Prizrenit e këndej. Ky patriotizëm i njohur i gruas shqiptare, këto cilësi të rralla morale të saj, morën një përmbajtje të re dhe u shfaqën me forcë në ato gra e vajza të popullit që ngjeshën amët dhe luftuan krah për krah me burrat gjatë LDB. Edhe pse kishte përfunduar Lufta e Dytë Botërore, burrat e gratë e Kosovës nuk u kënaqën me gjendjen ekzistuese. Ata gjetën forma e mënyra që ti kundërvihën okupuesit të “ri”. Gratë shqiptare në Kosovë dhe viset tjera shqiptare në ish-Jugosllavi, krah për krah me burrat u ndodhën në krye të detyrës duke organizuar fillimisht grupe e organizata ilegale e më vonë morën pjesë në demonstratat gjithë popullore të vitit 1968, 1981, 1989. Por, me formimin e UÇK-së, dolën edhe në male duke u bërë pjesë e denjë e luftës për liri. Prandaj Gruaja apo Nëna shqiptare duhet nderuar!

SIMBOL PËR ROLIN DHE KONTRIBUTIN E MËRGATËS SHQIPTARE NË PROCESIN E LIRISË DHE PAVARËSISË KOMBËTARE.


Emigrimi masiv i shqiptarëve ishte ai i Arbëreshëve të Italisë, arnautëve të Turqisë, të Rumanisë, të Egjiptit , të Amerikës e shumë të tjerë. Enklava shqiptarësh janë të njohura që nga Greqia në Moldavi, që nga Zara e Dalmacisë në Argjentinë, nga Rumania në Australi e deri në vendet Arabe, ku është e rëndësishme të përmendim emrat e disa mërgimtarëve, si në Rusi psh. Elena Gjickën, Mehmet Ali Pashën në shtetin e Egjiptit të sotëm, Aleksandër Moisiun artistin e shquar të teatrit botërorë e shumë e shumë të tjerë. por sot ne duhet të drejtohem tek migracionet më masive të shqiptarëve që ishin në kohët ma të vona , pas Kongresit të Berlinit më 1878 e deri në luftën e fundit në Kosovë 1998 – 99. Kësaj radhe do

ndalemi në migrimin e shqiptarëve në Gjermani siç e quante sundimi i atëhershëm Jugosllav „ Emigrimi i punëtorëve të përkohshëm“ ku pos Gjermanisë vinë Austria, Holanda, Zvicra, Italia, Belgjika e deri në Amerikë e Australi, ku edhe sot e kësaj dite më së shumti janë të përqendruar shqiptarët. Kjo erdhi si kusht i zhvillimit të hovshëm industrial të tyre, ku fuqia punëtoresh ishte e domosdoshme. Gjithë ky emigrim ishte si fryt i mjerimit të madh në trojet ku jetonin shqiptarët, por më e rëndësishme ishte se armiku jonë e kishte planifikuar për ti zbratur tokat shqiptare e për ti sllavizuar me popullatën e tyre, siq ka ndodhur më herët në tokat tona në territorin e sotëm të Serbisë siq janë Prokupla, Kushumlia, Nishi dhe fshatrat të tëra rreth Surdulicës e deri tek Medvegja e cila po zbratet çdo ditë, pra edhe në ditët e sotme. Këto zbrazje Serbia i bënte edhe për një qëllim tjetër, për ta mbajtur nën kontroll çdo shqiptarë që merrte në atë kohë pasaportë, sepse çdo veprimtari të tyre e përcillte hap pas hapi me ndihmën e bashkëpunëtorëve të vet që ishin edhe dashakqinjë të popullit shqiptarë, sepse për interesa personale ata e bënë të pa mundurën, u shitën lirë dhe lehtë në dëm të vëllezërve të tyre shqiptar. Historia e zbrazjes së trojeve shqiptare në ish. Jugosllavi nuk ka filluar as në vitin 1968, as 1981, as 1990, as 1998 por përpjekjet e shqiptarëve për Liri shtrihen në hapësirë dhe në kohë që nga Dardania e Vjetër, pra që nga ardhja e armiqve tonë sllav në trojet e Ballkanit. Edhe pas gjithë ati mudi që mërgimtarët shqiptarë e bënë, udhëheqja jonë politike, institucionet politike dhe ato komunale diasporën gjithmonë e lanë pas dore, sikur të mos kishte ekzistuar fare, këtë lënë pas dore e vazhduan edhe institucionet e pas luftës deri në gjysmën e dytë të vitit 2011 ku e formuan sa për sy e faqe ministrin e Diasporës e cila ka vetëm fjalë e shpenzime. U harrua shumë shpejt mudi dhe angazhimin që bëri mërgata në Evropë, si protestat me nga 100.000 shqiptarë në Bon, Bernë dhe Bruksel e vende të tjera. Shpejt u harruan miliona Marka Gjermane, Franga Zvicerane e Dollar Amerikan mërgimtarët shqiptarë i dhanë për Kosovën. Shpejtë u harrua ndihma e vetme që u dha nga mërgimtarët shqiptarë për luftërat e Kosovës, si dhe pjesëmarrja aktive e qindra të rinjve, që lanë luksin e çdo gjë që patën dhe mësymë frontin kundër armikut, ku dhanë edhe jetën për Lirinë e Kosovës. Se di se sa e kupton kjo udhëheqje, se në çfarë gjendje ishte Kosova para luftës, pas luftës e çfarë është sot. A e dinë këta të shkretë se sa ndihma humanitare është dërguar në Kosovë nga shoqata humanitare „ Nëna TEREZE“ që tërë bota ja kishte zili kësaj shoqate për organizimin e ndihmave, para luftës gjatë luftës dhe pas luftës, ku kjo shoqatë sa fëmijët por edhe të rriturit i ka ndihmuar për shërim, ku me operimet që janë bërë është shpëtuar jeta e tyre ku, këta njerëz s’patën kurrfarë shanse të shërohen në Kosovë. A e kuptojnë këta zotëri se si mërgimtarët e Kosovës kanë arritur tekë fitimi i kësaj

paraje, dhe me sa mund e djersë janë fituar, për të mbijetuar me familjet e tyre që kishin pas vetës, pastaj ndihmat që u deshtë të dërgohen në Kosovë, për të afërmit e tyre dhe për shtetin e Kosovës që ende s'ishte formuar. Pjesa dërmuese që punonte i paguante 3% të ardhurave në bruto, pastaj për luftën në Drenicë, me thirrjen „ O sot – O kurrë“, pastaj aksionin „Vendlindja thërret“, pastaj investimet për UCK-në, e sa e sa detyrime të tjera, që sot ato e kanë humbur adresën e saktë, ku për këto gjëra duhet ti pyesim ministrat e Kosovës që janë marrë me këto organizime.

PËRBËRJA E KËSHILLIT

Sabit RRUSTEMI – LDK



Kryesues i Këshillit

Naim MUISLIU – PDK



Anëtar i Këshillit – Historian

Zyrije ShALA – LDK



Anëtare e Këshillit

Ahmet ĐAKU – Shoqatat e dalura nga Lufta e UÇK – së



Anëtar i Këshillit

Shaban REXHEPI – AAK



Anëtar i Këshillit

Gjilan
30 nëntor 2016